

Vrojtime leksikologjike

Homonimet në FGJSSH

Mr. Agim Spahiu

1 nëntor 2008

Përmbledhje

Në këtë shkrim jemi ndalur në çështjen e përfshirjes së homonimeve në **Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe** të vitit 1980, ngase kemi parë se ai është shumë i pasur me to. Prandaj, me anë të programeve të njohura të Linux-it, kemi arritur të sortojmë grupet e fjalëve që formojnë homonime, të shënuara me numra romakë: I, II, III etj. dhe kemi arritur të sajojme një **Fjalorth** me to, të cilin do të sjellim në vazhdim të këtij shkrimi.

Fjalori i gjuhës së sotme shqipe i vitit 1980 është shumë i pasur me homonime. Kjo njësi leksiko-semantike në **Fjalorin e gjuhës shqipe** të vitit 2006 përkufizohet në këtë mënyrë:

1. gjuh. fjalë që ka trajtë e tingëllim të njëllotë me një tjetër, por kuptim të ndryshëm (p. sh. **verë** «pije» dhe **verë** «stinë»: *homonime leksikore*¹.

Ndërsa studiuesi Xh. Lloshi e përkufizon në këtë mënyrë:

Homonomia është një polisemi e rreme, domethënë kemi po atë kompleks tingullor, por jo me kuptime të ndryshme, sepse me të vërtetë janë leksema të ndryshme, që kanë përkuar fonetikisht. Në ligjërimin e zakonshëm ajo nuk bie në sy, madje janë gjuhëtarët që e tregojnë si dukuri, përndryshe folësit nuk e njohin aspak².

Po arsyeja e lindjes së homonimisë Xh. Lloshi e shpjegon në këtë mënyrë:

Arsyeja kryesore e lindjes së saj është se gjuha ndryshon, lëviz, zhvillohet në të gjitha pjesët e sistemit të vet. Fjalë dikur krejt e largëta, me ndryshimin e gjatë fonetik që pësojnë në përputhje me ligjet e brendshme të gjuhës shqipe, dalin më në fund me tingëllim të njëjtë. Nga vëzhgimet mbi homonimet në gjuhën shqipe del se ato kanë lindur edhe gjatë fjalëformimit, ndërsa një

¹Shih *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 391.

²Shih Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999, f. 130.

numër tjetër dalin gjatë huazimit të fjalëve nga dialektet, e së fundi, në raste të veçanta, homonimia lind për shkak të largimit të madh të kuptimeve të po asaj fjale, për shkak të zberthimit të polisemisë³.

Në këtë vepër ky studiuës ka folur edhe për vështirësitë që mund t'i shkaktojnë homonimet në kontekste të caktuara të ligjëritit⁴.

Në të shumtën e rasteve homonimet formohen nga pjesë të njëjta të ligjëratës, dhe ky fakt sjell vështirësi shpeshherë në identifikimin e tyre, si p. sh.: **PUÇ I m.** libr. Grusht shteti që organizohet në fshehtësi nga një grup i kufizuar njerëzish, të cilët nuk kanë asnjë mbështetje në popull; rrëzimi i pushtetit shtetëror dhe marrja e tij me këtë rrugë. Puç fashist (kundërrevolucionar, ushtarak). Organizojnë puçe. U zbulua një puç. U dështoi puçi; dhe **PUÇ II m.** 1. Maja e kokës, but. Në puç të kokës. I dhemb puçi i kokës. 2. Maja e vezës. I përplasnin vezët nga puçi. * Janë në majë e në puç shih te MAJ/Ë, A; ose: **PRUAJ I** kal. krahin. Pretoj; plaçkit. **PRUAJ II** jokal. krahin. I bie pas një sëmundjeje duke bërë mjekime popullore etj. **PRUAJ III** kal. krahin. Ruaj, mbroj. Pruaje nga qentë!

Mirëpo, ato mund të formohen edhe nga pjesë të ndryshme të ligjëratës, si p. sh.: **DO I pakuf.** krahin. Disa, ca. Do njerëz. Do fjalë. Do ditë. Do rrush. Do bukë. **DO II** bised. *pavet.* e DUA (shih te DUA 13). Do thënë. Do bërë. Do shkuar. **DO III pj.** Pjesëz që shërben për të formuar trajtat gramatikore të kohës së ardhme dhe të mënyrës kushtore të foljes. Do të punoj. Do të shkoja; Së fundi mund të dal edhe si një notë muzikore: **DO f. muz.** Nota e parë e shkallës muzikore; shenja për këtë notë. Nota do.

Në vijim të këtij shkrimi po e sjellim këtë **Fjalorth** të homonimeve të sajuar nga **Fjalori i gjuhës së sotme shqipe** i vitit 1980:

A I 1. Një nga zanoret e gjuhës shqipe dhe shkronja e parë e alfabetit të saj, e cila shënon këtë zanore. Zanorja a. Tingulli a. Shkronja a. 2. si em. f. Zanorja dhe shkronja a. A-ja e vogël (e madhe). A-ja e dorës (e shtypit). A-ja nistore. 3. si em. f. fig. Fillimi i një pune, pikënisja për diçka; njohuritë fillestare e më të thjeshta për diçka, abëcëja. A-ja e çështjes (e punës). Filloj nga a-ja. E bëj nga a-ja. 4. Simboli i një lloji vitaminash. Vitamina A. * Nga a-ja deri te zh-ja nga fillimi deri në fund, fund e krye, tërësisht.

A II lidh.

1. Përdoret për të lidhur dy gjymtyrë të një fjalie ose dy fjali, që përjashtojnë ose

që zëvendësojnë njëra-tjetrën; ose, o. Sot a nesër. Shpejt (herët) a vonë. I vogli a i madhi. Çift a tek? Atë a këtë? Bën a s'bën? Vjen a s'vjen? E di a s'e di?

2. Përdoret e përsëritur për të lidhur dy gjymtyrë të një fjalie ose dy fjali që veçohen njëra nga tjetra, që i kundërvihen njëra-tjetrës nga kuptimi ose që plotësojnë njëra-tjetrën; ose. A unë a ti. A sot a kurrë. A s'e ka ditur, a e ka harruar.

3. Përdoret për të lidhur dy gjymtyrë të një togfjalëshi foljor, ku folja përsëritet me mohim për ta shprehur veprimin në shkallë të lartë; apo. Këndonte a s'këndonte. Qante a s'qante. Binte a s'binte shi.

³Shih Xh. Lloshi, *Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe*, në: **Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I**, botuar nga USHT, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1972, f. 227.

⁴Shih *vep. e cit.*, po aty, f. 227.

* Pak a shumë shih te PAK.

A III pj.

1. Përdoret në fillim të një fjalie pyetëse për të theksuar më shumë pyetjen; përdoret në një fjali pyetëse retorike për të përforcuar shprehjen e pohimit, të mohimit a të dyshimit që nënkupton a jo. A do të vish? A më kupton? A e mban mend? A je mirë? A ka? A mos e di? A thua? A ka gjë më të rëndë? A nuk e di ti? A do të vijë ajo ditë?

A je, si je? pyetje, që përdoret në vend të përshëndetjes, kur takohen dy veta.

2. Përdoret në krye të njërës prej dy fjalive pyetëse të zhdrejta, kur e dyta lidhet me lidhëzën veçuese «apo», për të theksuar kundërvënien e veprimeve. Pyete, a do të bëhet tani mbledhja, apo u shty. Shih a erdhën, apo s'duken ende.

3. Përdoret zakonisht në fund të një fjalie pyetëse, që shpreh habi, ironi, qesëndi, zemërim, miratim etj.; ë. Nuk e paske, a? Po lahet, a? S'e dashka, a?

4. Përdoret zakonisht në fillim të fjalisë për të theksuar përçmimin, qesëndinë ose ironinë; ama. A, për ujë që qenka! A, për burrë që qenka!

* A thua se ... sikur.

A IV pasth.

1. Përdoret për të shprehur habi kur ndodhemi papandehur përpara një të papriture; ah. A, kush qenka!

2. Përdoret për të theksuar shprehjen e gëzimit të kënaqësisë, të miratimit etj.; ah. A, sa e bukur qenka!

3. Përdoret kur shprehim zemërim, urrejtje, qortim, dhembje, keqardhje etj.; ah.

A, sa më dhemb! A, në të zënça!

4. Përdoret për të shprehur mospërfillje, ironi, qesëndi ose kundërshtim, pakënaqësi për dikë a diçka që nuk e miratojmë. A, mos e pyeti. A, jo, nuk jam në një mendje me ty. A, këtë dashke ti!

5. Përdoret kur i drejtohem një njeriu zakonisht të afërt a të njohur, me fjalë a me

shprehje që kanë ngjyrimë emocionale. Mirë, a derëbardhë! Ç'u bëre, a i vrrarë!

Mirë, a të keqen nëna!

6. Përdoret kur kujtohem papritur për diçka gjatë bisedës me dikë; aha. A, po, m'u kujtua.

AH I m. bot. Dru gjethor i pyjeve malore, me trung të trashë, me lëvore të lëmuar të bardheme ose ngjyrë mishi, lënda e të cilit përdoret për orendi, në ndërtim etj. Ah i bardhë (i kuq). Pyll ahu. Dru ahu. Dërrasë ahu. Tryezë (dollap) ahu.

AH II m. 1. Britma që del me shpirt për të shprehur një ndjenjë dhembjeje, hidhërimi, keqardhjeje etj. ose një ndjenjë habie, gëzimi etj. E shkonin jetën me ahe e me ohe. Në ah të vdekjes në grahmen e fundit.

2. fig. Nëmë, mallkim. E zuri (e gjeti) ahu.

* Me ah e me bah me rënkime të mëdha, duke u ankuar për çdo gjë. Lë në ahe lë në mjerim, në vuajtje.

AH III m. shih HAK, ~U I. Mori ahun.

AJAZMË I fet. vjet. Ujë i bekuar (sipas paragjykimeve e dogmës së rritit fetar ortodoks); ceremonia e përgatitjes së ujit të bekuar në kishë ose e spërkatjes me ujë të bekuar shtëpi më shtëpi.

AJAZMË II f. bot. shih MEND/ËR, ~RA. Ajazmë e egër (e butë).

AJKËTORE I f. 1. Vegël e posaçme, që përdoret për t'i marrë ajkën qumështit.

2. Kadishtë ku mbledhin ajkën e qumështit për ta përpunuar më vonë. Mbushin ajkëtoreset.

AJKËTORE II f. vjet. Dyqan ku shitej kryesisht ajkë qumështi.

AKREP I m. 1. zool. Kafshë e vogël helmuese me ngjyrë të zezë, me këmbë nyjanyja, me dy gëthapë përpara dhe me një thumb të përkulshëm nga pas; sfurkth, përcollak. Akrep i zi. Helmi i akrepit. Vaj akrepi bar që përgatitet me vaj e

me helmin e akrepit dhe që përdoret në mjekësinë popullore. Fole akrepash. E hëngri (e pickoi) akrepi.

2. keq. Njeri dorështrënguar.

3. keq. Njeri shpirtkeq, i pabesë e tinëzar.

* M'u bë akrep m'u bë ferrë, s'e shoh dot me sy.

AKREP II m. Secila nga shigjetëzat, që rrotullohen në fushën e sahatit për të treguar orën, minutat ose sekondat; shigjetëz treguese në aparatet matëse, të ngjashme me orën, gjilpërë. Akrepat e sahatit. Akrepi i madh (i minutave). Akrepi i vogël (i orëve). Akrepi i hollë (i sekondave). Në drejtim të akrepave të sahatit. Lëviz akrepat.

AKTIV I m. 1. Pjesa më e gjallë, më e përparuar dhe më e dalluar e njerëzve në veprimtarinë e një organizate ose të një kolektivi. Aktivi i partisë (i rinisë, i bashkimeve profesionale). Aktivi i prindërve. Mbledhja e aktivitetit. Zgjerohet aktiviteti.

2. Mbledhje e pjesës më aktive të një organizate, e aktivistëve të lidhur drejtpërdrejt me një veprimtari; formë organizative për shqyrtimin dhe zgjidhjen e problemeve kryesore të një dege ose të një veprimtarie. Aktiv kombëtar. Aktiv i zgjeruar. Aktiv i kulturës (i tregtisë...). U thirr aktiviteti.

AKTIV II m. Pjesë e bilancit ekonomik të një ndërmarrjeje, që përfshin të gjitha vlerat e saj materiale, shumën e parave në arkë, të ardhurat dhe detyrimet që i kanë ndërmarrjet e tjera; kund. pasiv. Aktivi dhe pasivi.

AKTIV I mb. 1. Që vepron me gjallëri, që merr pjesë vetë e me zell në një punë, veprues; që bëhet a që zhvillohet në mënyrë të gjallë e vepruese; kund. pasiv. Anëtar (luftëtar) aktiv. Pjesëmarrje aktive. Mbrojtje aktive. Jetë aktive. Pushim aktiv. Popullsia aktive popullsia në gjendje pune. Luan rol aktiv. Tregohet aktiv.

2. spec. Që merr pjesë dhe vepron në një proces; që vazhdon të veprojë, që nuk është shuar; që rrezaton ose jep një energji të caktuar. Qymyr aktiv. Lëndë aktive. Pus aktiv. Vullkan aktiv. Sëmundje aktive. Shtresa aktive e tokës.

3. Që zotërohet mirë e vihet në përdorim të gjallë. Përvetësim (zotërim) aktiv.

Fjalori aktiv. Zotëroj në mënyrë aktive një gjuhë.

4. usht. Që është në shërbimin e rregullt e të vijueshëm. Oficer aktiv. Shërbimi ushtarak aktiv.

AKTIV II mb. fin. Që ka më shumë të ardhura se shpenzime, që del me të ardhura më të mëdha se shpenzimet; që ka të bëjë me aktivitetin e bilancit. Llogari aktive. Bilanc aktiv bilanc ku të ardhurat janë më të mëdha se shpenzimet.

* Bilanc aktiv libr. gjendje kur janë aritur shumë suksese në punë.

AMË I f. 1. Vendi ku nis një rrjedhë uji, burim; shtrati i një rrjedhe uji. Ama e ujit (e vijës). Ama e lumit. Del nga ama.

2. fig. Burim, gurrë.

3. Bimë ose kafshë mëmë. Ama e bletës mbretëresha e bletëve, matka. Pulë (patë) amë pulë (patë) që bën vezë e që shtrohet për të çelur zogj. Bimë amë.

4. anat., bot. shih VEZOR/E, ~JA. Ama e gruas. Ama e lules.

5. Dru i shkurtër, që shërben për të mbajtur a për të shtrënguar. Ama e çatisë cungali, baballëku. Ama e vegjës shuli i vegjës.

6. Pjesa e kreut në një bllok biletash, çekesh, faturash etj., që ruhet si dëshmi për pjesën e këputur. Amë e bijë.

7. spec. Kopje negative prej metali që bëhet për një gdhendje me reliev dhe që shërben për të nxjerrë prej saj kopje të tjera.

* Doli nga ama i kaloi kufijtë, e shkeli rregullin e zakonshëm e të lejueshëm. E shtie në amë e sjell përsëri brenda kufijve, e vë në udhë.

AMË II f. shih AMËZ, ~A. Amë e mirë (e keqe). Ama e luleve. Ama e djathit. Ka (merr) amë.

I jep amë.

* S'merr amë nga diçka nuk e njeh diçka, nuk merr erë nga një punë etj.

AN I m. anat. Organ i gruas dhe i femrës së gjitarëve, ku zihet e zhvillohet pjella, shtrati, këmisha që mbështjell pjellën. Ani i fëmijës. I bie (i shket) ani. Ngre anin.

AN II m. Vendi ku lidhen eshtrat, kyç. Ani i dorës.

ANË I f. 1. Pjesa e një sendi ose e një vendi, që gjendet më larg nga mesi i tij; skaj, buzë, pjesa ku mbaron sendi a vendi; pjesa e majtë a e djathtë e një sendi ose e një vendi, krah. Ana e djathtë (e majtë). Ana e arës (e lumit). Ana e pëlhurës (e lakrorit). Anët e një barazimi. mat. Në anën e rrugës (e tryezës. .). Në (nga) të gjitha anët. Sa nga një anë në tjetrën. Kthehem nga ana tjetër. Marr anët qethem anash. U morën anët u morën krahët, i rrethuan. Nxjerr në anë. Anë për anë buzë me buzë. Me një anë mënjane.

2. Hapësira a trualli në një krah ose afër skajeve jashtë kufijve të një sendi a vendi; hapësira a vendi në një drejtim të caktuar, si edhe vetë ky drejtim. Në këtë anë të shtëpisë (të fshatit. .). Nga ana e malit. Katër anët e horizontit. Ana e shiut (e mesditës) jugu. Ana e borës veriu. Ana e diellit lindja. Ana e detit perëndimi. Me atë anë matanë. Anë e më anë anembanë. Në të katër anët kudo, në çdo vend. Nga të katër anët nga çdo vend, nga të gjitha drejtimet; në të gjitha vendet ose drejtimet. Anë e kënd (e skaj, e cekë) anekënd.

3. Faqe e një trupi, njëra nga sipërfaqet kufizuese të një sendi. Ana e mbarë (e prapme, e pasme). Ana e sipërme (e poshtme). Anë mali. Ana e padukshme e Hënës. Anë më (për) anë tejpertej, tejdanë.

4. Krahinë, vend. Në (nga) anët tona. Në ato anë. Banorët e atyre anëve. Është nga ana jonë.

5. Skaji me i largët i një vendi, i një hapësire; fundi, mbarimi i diçkaje. Në anë të dheut (të botës). S'ka anë. Pa anë e pa fund. Nuk i gjendet ana. Në anë të anës shumë larg. Nga ana e anës nga vise shumë të largëta.

6. Palë, njeri a grup njerëzish, që i kundërvihen një pale ose një njeriu a grupi tjetër. Anët kundërshtarë. Ana paditëse. Ana e djalit (e vajzës). Në anën e popullit. Marr anën e dikujt radhitem përkrah një tjetri në mendime e veprime, bëhem me dikë.

7. Anësi, pajë. I mban anën dikujt. Mban anë. Kam anë me mbajnë pajë, me përkrahin.

8. Pjesë përbërëse e diçkaje, element i një çështjeje, veprë etj.; tipar, veçori që karakterizon diçka. Anët e mira (të dobëta, të errëta). Ana praktike (formale, teorike). Ana politike (objektive). Ana tjetër e çështjes. Zëvendës për anën mësimore (shkencore, administrative).

9. Pikëpamje; kënd vështrimi. Nga ana e jashtme (e brendshme). Nga ana parimore (teknike). Nga ana sasiore. Nga çdo anë.

10. Gjysma e barrës së kafshës së ngarkuar, njëri krah i barrës së kafshës. Ana e mushkës. I ngre (i mbaj) anën. E ha ana i rëndon me shumë njëra gjysmë e barrës, i varet barra nga njëra anë.

* Nga ana e dikujt lidhur me njeriun që bën a që thotë diçka, për dikë. Nga ana e burrit (e gruas, e vëllait, e babait...) në vijën e lidhjes familjare me burrin (gruan, vëllanë, babanë...). Me anën e dikujt me ndihmën e dikujt, nëpërmjet dikujt. Me anë të diçkaje (me anën e diçkaje) me një mjet, me një mënyrë a me një rrugë; me ndihmën e..., me. Nga njëra (një) anë... nga ana (me anë) tjetër përd. fj. ndërm. përdoret kur kundërvihen dy fakte, dy rrethana, dy kënde vështrimi, dy rrugë zgjidhjeje etj. Në anën tjetër

të barrikadës shih te BARRIKAD/Ë, ~A. Ana e keqe euf. djalli. Ana tjetër e medaljes shih te MEDALJ/E, ~A. Dal (e nxjerr) në anë (e) shpëtoj nga një e keqe, kapërcej një vështirësi. S'ia di anën diçkaje nuk e di ku e ka burimin, shkakun diçka. Ia gjej anën

a) gjej mjetin, mënyrën për të zgjidhur diçka ose për të mbaruar një punë;

b) gjej rastin për të kërkuar diçka prej një njeriu ose për t'i bërë diçka. S'i gjendet ana diçkaje nuk ke ku e kap, është bërë copë-copë (për rrobat etj.). S'ia gjej dot anën diçkaje

a) nuk di nga ta nis një punë, s'ia gjej dot fillin;

b) nuk ia dal dot mbanë, nuk e kryej dot një punë. Më ha ana me dikë shih te HA. Më heq ana më dikë a më diçka prirem, anoj nga dikush a diçka. E kaloi për anash vetëm sa e përmendi, nuk e trajtoi gjerë a nuk e zbërtheu thellë. Marr anë

a) çlodhem pak, rri pak mënjanë për të marrë frymë;

b) vjet. marr pjesë. Ia ka marrë anën (krahun, dorën)një pune shih te MARR. Më merr ana

a) anohem padashur, përkulem anash gati për t'u rrëzuar;

b) bie nga shëndeti, plakem, rrëgjohe. Në atë anë (krah, brinjë) fli! iron. shih te KRAH, ~U. Nuk ka anë e udhë nuk gjen dot arsye për ta shpjeguar, nuk përligjet; nuk ka kuptim, nuk ta rrok mendja. S'pyes (s'dëgjoj, s'dua t'ia di) nga ajo anë nuk i trembem një gjëje, nuk çaj kokën për diçka. I hyn era në të katër anët shih tek ER/Ë, ~A I. I priste shpata (palla, kordha, sëpata) nga të dyja anët (djathtas e majtas) shih te PRES I. Nga një anë të puth, nga tjetra të pret keq. shih te PUTH. Të mos na presë thika vetëm në njërën anë shih te THIK/Ë, ~A.

ANË II f. tekst. Fill mëndafshi a pambuku jo shumë i trashë, që përdoret në endje me tepër për pjesët anësore të pëlhurave dhe

për vijat e zbukurimeve. Anë e bardhë (e kuqe). Anë mëndafshi (pambuku).

APOSTROFIM I m. let. Veprimi sipas kuptimit të foljes APOSTROFOJ I.

APOSTROFIM II m. gjuh. Veprimi sipas kuptimit të foljes APOSTROFOJ II.

APOSTROFOJ I kal. let. I drejtohem me një apostrofë, i bëj thirrje.

APOSTROFOJ II kal. gjuh. Vë apostrof, përdor apostrofin për të zëvendësuar një zanore a një rrokje që bie.

AR I m. 1. kim. Metal i rrallë e i çmuar, me ngjyrë të verdhë, që është i butë e punohet mirë dhe që përdoret për të bërë sende zbukurimi, monedha etj. ose si masë e vlerave; flori (simboli Au). Ar i pastër (i kulluar). Shufër ari. Monedhë ari. Medalje (unazë, kupë...) ari. Fill ari. Minierë ari. Ngjyrë ari. I larë me ar. 2. Fill i praruar, që përdoret për qëndisje; bised. veshje e qëndisur me këtë fill. Jelek ari. Qëndis me ar. I veshur në ar. 3. përd. mb. Në ngjyrë të verdhë të ndritshme, i artë. Flokë ari. Ngjyey në ar.

* Ari i bardhë pambuku. Ari i gjelbër drurët e pyllit si lëndë e vlefshme për ndërtim e për orendi. Ari i zi nafta ose qymyrguri. Fjalë ari fjalë të vërteta e me vlerë, fjalë me vend; fjalë e urtë. I ra ari në ujë u zemërua, i mbeti hatëri.

AR II m. Njësi matjeje e sipërfaqes së tokës, e barabartë me 100 metra katrorë (shkurt. a). Një ar tokë.

ARBËR I m. 1. hist. Emër përmbledhës për shqiptarët në mesjetë; arbëresh, shqiptar. Lufta e arbit. Pushka e arbit. Krerët e arbit.

2. krahin. Shqiptar, për ta dalluar nga të ardhurit ose të huajt.

3. krahin. Banor i një pjese të Labërisë së Vlorës.

ARBËR II m. krahin. 1. Fushë, rrafsh i hapët (në krahasim me malësinë). Mal e arbër malësorët dhe fusharakët, gjithë populli. Bie në arbër zbres në fushë.

2. zakon. Banorët e fushave bregdetare të vendit tonë (në krahasim me banorët e krahinave malore).
- ARBËRESH** I m. 1. Emër që përdoret sot për shqiptarët e Italisë së Jugut, të Greqisë dhe të Dalmacisë, të shpërngulur nga Shqipëria në mesjetë. Arbëreshët e Italisë. Arbëreshët e Greqisë.
2. vjet. Shqiptar i kohës së mesjetës, arbër.
3. krahin. Banor i një pjese të Labërisë së Vlorës, arbër.
- ARBËRESH** II m. zakon. Banorët e fushave bregdetare të vendit tonë (në krahasim me banorët e krahinave malore), arbër.
- ARMATË** I f. 1. usht. Njësi e madhe ushtarake, e përbërë nga dy a me shumë trup-armata dhe e pajisur për veprime luftarake strategjike. Armatë tankesh. Komandant armate.
2. fig. Masë e madhe njerëzish, që punojnë së bashku në një lëmë ose për një qëllim të vetëm; ushtri. Armatë e fuqishme. Armata e punëtorëve të pararojës. Armata e arsimitarëve (e mjekëve).
3. fig. Sasi e madhe, grumbull i madh mjetesish teknike. Armatë traktorësh (buldozerësh).
- ARMATË** II f. Zinxhir ari që e varnin gratë në qafë si stoli, varëse grash. Var armatën.
- ARMATOR** I m. det. Pronar ose qiramarrës anijesh, i cili i pajis dhe i përdor ato për tregti. Armatori i anijes.
- ARMATOR** II m. min. shih ARMATUES,~I.
- ARNISHTË** I f. 1. Copë e vjetër që përdoret për arnë.
2. Gjë e vjetër me arna.
- ARNISHTË** II f. Pyll arneni.
- ARSEJ** I kal. 1. I jap arsim, i jap dituri, e mësoj; arsimoj. Arsej fëmijët.
2. Qortoj, këshilloj; edukoj, e mësoj dikë si të silllet; stërvit. Arsej me fjalë të mira. Arsej qenin (ogicin).
- ARSEJ** II kal. krahin. 1. Dëboj, përzë, nxjerr jashtë (një kafshë shtëpiake).
2. fig. E nxjerr nga duart një punë, i jap fund një pune, përfundoj, kryej.
- ARTIKULL** I m. 1. Shkrim me përmbajtje publicistike a shkencore, që trajton një çështje të caktuar dhe që botohet në një gazetë, në një revistë ose në një përmbledhje. Artikull kryesor. Artikull kritik (shkencor, informativ). Artikull përkujtimor. Artikull gazete. Autori (titulli) i artikullit. Përmbledhje artikujsh. Shkruaj (botoj) një artikull.
2. Ndarje në një fjalor, që përfshin fjalën titull, shpjegimet dhe të gjitha të dhënat e tjera për të. Artikujt e fjalorit. Artikulli për fjalën...
3. drejt. shih NEN,~I. Artikulli i parë i ligjit.
- ARTIKULL** II m. Lloj prodhimi, malli a sendi, i caktuar për t'u shitur. Artikuj industrialë (ushqimorë). Artikuj shkollorë (kulturorë, sportive). Artikuj të ndryshëm. Artikuj ndërtimi. Artikuj të përdorimit të gjerë. Artikuj për fëmijë. Lista e artikujve. Prodhoi një artikull të ri.
- ARRÇ** I m. bot. Shkurre gjetherënëse dy-tre metra e lartë, me gjethe të këmbëra si të arrës, me lule të blerta në të verdhë, që bën kokrra të vogla e të zeza dhe që përdoret për ngjyrosje e në mjekësi; pjerëz. Arrç i egër. Gjethe arrçi.
- ARRÇ** II m. anat. Arrëza e fytit.
- ARRÇ** III m. zool. Dosëz, bushtërz.
- ARRËZ** I f. anat. 1. Rruaza e parë e qafës, mbi të cilën mbështetet koka. Arrëza e qafës. Thefsh arrëzën! mallk.
2. Fikthi i fytit. Arrëza e fytit (e gushës).
- * Theu arrëzën shih te THYEJ. Thyej (këput) arrëzën (qafën)! keq. largohu që këtej, shporru! Zuri arrëzën u rrëzua e u vra, theu qafën.
- ARRËZ** II f. Arrishtë, pyll me arra.

- ARRËZ** III f. bot. Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe si të tërfillit, të vendosura dendur rreth kërcellit, që rritet nëpër fushat anës detit.
- AS** I m. 1. Letër loje, e para në ngjyrën e vet, që ka vetëm një shenjë në mes, njëshi. Asi spathi (kupë). Hedh asin. Man me as.
2. edhe ~Ë, ~ËT fig. Njeri i shquar, me aftësi të veçanta në një fushë të caktuar. As i skuadrës së futbollit. As i kinematografisë. As i aviacionit.
* Më doli asi fitova, më eci.
- AS** II m. hist. Monedhë e vogël romake prej bakri. Okë e as fare lirë.
- ASILLOJ** I dëft. bised. shih ASISOJ I. Asisoj sendesh.
- ASILLOJ** II ndajf. bised. shih ASISOJ II. Mendon po asilloy.
- ASISOJ** I dëft. bised. I atij soji, i atillë. Asisoj njerëzish. Një rrobë asisoj.
- ASISOJ** II ndajf. bised. Në atë mënyrë; ashtu. Bëje asisoj.
- ASHËR** I f. 1. Ashkël, dru e vogël e çarë për zjarr. Ashra dushku. I bëj degët ashra.
2. Copë druri e çarë si dërrasë e hollë, që përdoret si petavër ose për të mbuluar çatinë; hartosë, pullazinë. Çati me ashra. Çaj (bëj) ashra.
* Ashër e pisë (i zi) shumë i zi. M'u bënë ashër (ashra-ashra) m'u plasaritën, m'u ashpërsuan (për duart, gjuhën etj.). Janë bërë ashër u ka hyrë grindja, janë zënë; janë përçarë.
- ASHËR** II f. bot. Gështenjë e egër.
- ASHIK** I m. 1. Eshtë e vogël në gjurin e kafshëve të imëta, testembel (përdoret edhe në një lojë fëmijësh); kyçi i këmbës së njeriut. Luaj me ashikë.
2. krahin. Çelës i veglave muzikore me tel.
- ASHIK** II m. vjet. 1. Dashnor. Këngë ashikësh. Zuri një ashik.
2. keq. Njeri i dhënë shumë pas qejfeve.
- ASHT** I m. 1. shih ESHT/ËR,~RA 1. Ashti i krahut (i këmbës). Luge ashti. Pa iu pjekur ashti pa iu forcuar kocka, në moshë të njomë. Asht e lëkurë kockë e lëkurë, shumë i dobët. (Deri) në asht deri në kockë, shumë thellë.
2. krahin. Kopsë e vogël prej kocke.
* I ka shkuar (i ka vajtur) thika në asht (në kockë) shih te THIK/Ë,~A.
- ASHT** II m. bot. Bimë barishtore njëvjeçare e livadheve, me gjethe të vogla e të rralla në trajtë vezake, me lule ngjyrëvjollcë dhe me kërcell të degëzuar, që kur këputet lëshon një lëng të bardhë.
- ATA** I përem. 1. vetor. Tregon frymorë a sende (të shënuar nga emra të gjinisë mashkullore), që zihen në gojë, por që nuk janë aty; zëvendëson një emër të gjinisë mashkullore (në numrin shumës), që është përmendur pak më parë ose që do të përmendet më pas. Ata vetë pikërisht ata. Para tyre. Disa prej tyre. Mbi ta.
2. përd. em. Pala që ndryshon nga botëkuptimi dhe nga mënyra e jetesës prej nesh; pala që ka qëllime e synime të kundërta o të ndryshme prej nesh; të tjerët, kundërshtarët; kund. ne. Te ne dhe tek ata.
3. dëft. Tregon frymorë a sende (të shënuar nga emra të gjinisë mashkullore), që ndodhen me larg folësit se frymorët a sendet e tjera të atij lloji; zëvendëson një emër të gjinisë mashkullore (në numrin shumës), që është përmendur më parë se një tjetër; kund. këta. Ata atje. Ja ata. Ata shokë. Ata drurë.
4. dëft. Përdoret me një emër të gjinisë mashkullore (në numrin shumës) për të treguar pjesën e kohës, që shënohet nga emri ose që është përmendur më parë. Ata muaj. Ata shekuj.
5. dëft. Përdoret para një fjalie të varur, e cila përcakton frymorët a sendet që tregon përemri (të shënuar nga emra të gjinisë mashkullore në numrin shumës), ose para një fjalie kryefjalore, e cila përcakton frymorët a sendet, që zëvendëson

përemri, pavarësisht nga gjinia, me kuptimin «kushdo»; përdoret për të treguar ose për të zëvendësuar frymorët a sendet që përmenden më parë me një cilësi a tipar të caktuar. Një nga ata pleqtë patriotë. Ata të malit (të fushës). Atyre që ndjekin shkollat.

6. dëft. libr. Përdoret në vend të një emri të gjinisë mashkullore (në numrin shumës) për të mos u përsëritur emri. Punonjësit e ndërmarrjeve dhe ata të kooperativave.

ATA II përem. vjet. bised. 1. vetor. Tregon një send (të shënuar nga një emër i gjinisë asnjane), për të cilin bëhet fjalë, por që nuk është i pranishëm, zëvendëson një emër të gjinisë asnjane (në numrin njëjës), të përmendur pak më parë ose që do të përmendet më pas.

2. dëft. Tregon një send (të shënuar nga një emër i gjinisë asnjane), që ndodhet më larg folësit se një send tjetër i njëjtë; kund. këta. Ata lesh (gjalpë, mish). Ata ujë.

3. dëft. shih ASO 2.

* Ç'që ata? vjet. si ndodhi? si rastisi? si qe puna? Ç'që ata! vjet., iron. Çudi! Si është e mundur! Si mund të ndodhte! Ç'është ata! vjet. Përdoret si përgjigje për ta qetësuar bashkëbiseduesin, duke e siguruar se diçka do të bëhet, me kuptimin: patjetër, pa asnjë dyshim.

ATLAS I m. Përmbledhje hartash gjeografike; përmbledhje hartash, pasqyrash, skicash, grafikësh etj. me të dhëna për një fushë të shkencës. Atlas gjeografik. Atlas botanik. Atlas gjuhësor (dialektologjik). Atlasi i botës. Atlasi i anatomisë.

ATLAS II m. anat. Rruaza e parë e qafës, tek e cila mbështetet koka, arrëza e qafës.

AUTO- I fjalëform. libr.

Pjesë e parë e fjalëve të përbëra, që ka kuptimet:

1. Automobilistik, i automobilave, që ka të bëjë me automjetet, i automjeteve; p.sh. autogarazh, autokolonë, autotopart, autopark, autotransport etj.

2. Që është vendosur në një automobil, automobil; p.sh. autoambulancë, autodyqan, autokinema, autosondë, autovinç etj.

AUTO- II fjalëform. libr.

1. Pjesë e parë e fjalëve të përbëra, që ka kuptimin: «vetëlëvizës, që lëviz me motor të vetin»; p.sh. autokombajnë, automjet, autoqerre etj.

2. Pjesë e parë e fjalëve të përbëra, që ka kuptimin: «automatik, që punon në mënyrë automatike»; p.sh. autopilot, autotimonier etj.

AUTO- III fjalëform. libr.

Pjesë e parë e fjalëve të përbëra, që nga kuptimi u përgjigjet fjalëve: i vet, i vetes; vetë: p.sh., autoakuzë, autobiografi, autogol, autokontroll, autoportret etj.

BACKË I f. Dackë. I ra me backa. I futi (i dha) ca backa.

BACKË II f. Gropa në mes të leqeve të këmbës, gropa e këmbës në anë të kundërt të gjurit.

Më dhemb në backë.

BALË I f. 1. Pullë e bardhë që kanë disa kafshë në kokë ose në trup. Ka me balë. Dhi me bala.

2. Kafshë shtëpiake (zakonisht dele, dhi ose lopë), që ka një pullë të bardhë në ballë, në turi ose në trup. Moli balën.

3. fig. Njollë turpi, damkë, vulë. Iu vu bala u njollos me turp.

BALË II f. krahin. Baldosë.

BALLË I m. 1. Pjesa e sipërme e fytyrës së njeriut midis syve dhe flokëve; pjesa e sipërme e turirit të shtazëve. Ballë i lartë (i gjerë, i ngushtë). Ballë i dalë (i futur). Me ballë të ngrysur (të vrenjtur). Shtegu (mesi) i ballit. Lulja e ballit. Damari (nervi) i ballit. Lëkura (kocka) e ballit. Rrudhat e ballit. Djersa e ballit. Rrudh ballin. Fshij ballin.

E puth në ballë. Lëshoj flokët mbi ballë.

2. edhe ~Ë, ~ËT. Faqja e përparme e kryesore e një ndërtese, e një sendi etj.;

pjesa që duket, ana që bie në sy. Balli i shtëpisë. Balli i anijes. Ballët e arkës anët më të ngushta të arkës. Ballët e krevatit kokat e krevatit. Balli i samarit. Balli i djepit. Ballët e vozës ballësoret. Ballët e dhomës dy faqet e ngushta të dhomës. Me ballë nga dielli. Në ballë të odës.

3. edhe fig. Pjesa e fillimit të një sendi, fillimi i diçkaje, kreu; fillimi i një stine a i një kohe; radhët e para, vendi që ndodhet në krye e më i rëndësishmi. Balli i oxhakut qoshja. Balli i kolonës (i demonstratës). Balli i kopesë. Balli i vendit. Balli i gazetës. Balli i ujit. Në ballë në vijën e parë, në krye; në udhëheqje; në fillim, herën e parë.

4. min. Pjesa e përparme e një galerie, e një tuneli, e një pusi etj., ku bëhet gërmimi për të nxjerrë mineral. Ballë i verbët. Balli i galerisë (i tunelit, i pusit). Balli i punimit. Ballë kërkimi.

5. Vija e ndeshjes me kundërshtarin, front. Balli i parë. Ballë i gjerë. Zunë ballin.

6. fig. Pjesa më e zgjedhur; ai që është më i mirë, lulja, ajka; gjëja më e parë e më kryesore. Balli i djemve (i djalërisë, i burrave, i trimave). Balli i vajzave (i nuseve). Balli i miqve. Balli i grurit. Balli i kuajve. Balli i gjellëve. Balli i rakisë. Marr ballin e ballin marr pjesën më të mirë.

7. përd. parafj. Përballë, përkundrejt, përpara. Ballë një muri. Ballë armikut.

* Ballë për ballë

a) njëri kundrejt tjetrit, me fytyrë njëri përballë tjetrit; përballë, përkundrejt;

b) njëri kundër tjetrit si kundërshtarë; në luftë të hapur me dikë a me diçka, pa iu trembur e me guxim. Ballë e fund kokë e këmbë, krejt. Balli i kazanit rakia e parë dhe më e fortë që nxjerrim kur bëjmë raki. As ballë as bisht as nga të parët as nga të fundit, i mesëm. Me ballë hapur (hapët) shih te HAPUR. Me ballë të hapur (të çelur) shih te HAPUR (i, e). Me ballë (me ballin) lart ballë

lart. Me ballë të larë shih te LARË (i, e). Për ballë të laraskës (për bishtin e laraskës) shih te BISHT, ~I. Bëri (dha) ballë shih te BËJ. I bëj ballë dikujt a diçkaje shih te BËJ. Të çan (ta jep) në ballë është shumë i ftohtë; është shumë i fortë (për pijet). Laj ballin para dikujt shih te LAJ. Iu nxi balli shih te NXIHEM. Në rogë të ballit shih te ROG/Ë, ~A. Rrudhi (ngrysi, mblodhi) ballin (vetullat) shih te RRUDH. Për sytë e ballit (për këta sy që kam në ballë) bet. shih te SY, ~RI. Shikon (vështron) nën ballë shikon shtrembër e me inat, shikon me zemërim. Ylli i ballit lulja e ballit. Me yll në ballë shih tek YLL, ~I. Për dy gisht ballë për nderin e vet. E kam ballin të hapur shih te HAPUR (i, e). I kam sytë në ballë shoh, e kam kujdes vetë; i hap sytë mirë. E ka të shkruar në ballë duket qartë, e sheh kushdo. I kërceu (i hipi, iu ngrit) delli i ballit shih te DELL, ~I. Mbjaj ballin lart jam i guximshëm e i papërkulur, qëndroj krenar. Ngre ballin (lart) shih te NGRE. Pash (pasha) sytë e ballit betim. shih te SY, ~RI.

I ka plasur cipa (peta) e ballit keq. është i pacipë, s'ka turp fare. I ka plasur damari (delli) i ballit (i marres) keq. shih te DAMAR, ~I. I qeshi shtegu i ballit shih te SHTEG, ~U. Ia qëndisi në lule të ballit shih te LUL/E, ~JA. I ra ballit me dorë shfaqti në mënyrë të papritur habinë, pendimin a zemërimin e vet. E ruaj (e dua) si sytë e ballit (si dritën e syve) shih te SY, ~RI. Rron me djersën e ballit shih te DJERS/Ë, ~A 3. Vë ballë për ballë i vë njërin përballë tjetrit; i vë njërin kundër tjetrit, bëj që të ndeshen njëri me tjetrin. E putth dhe e vë në ballë e pëlqej, e pranoj me gjithë qejf diçka që është më e mirë se një tjetër më e keqe; ku ta gjej! Nga vë ballin, vë thembrat (thembrën) tall. kthehet mbrapsht, tërhiqet nga ka ardhur.

BALLË II m. spec. Njësi për të matur shkallën ose forcën e tërmetit, të erës etj. Tërmet shtatë ballësh. Era vajti pesë ballë.

BALLË III m. Krehër pushke me pesë a gjashtë fishekë; krehër që mban fishekët e pushkës. Tre ballë fishekë. Mbush ballin me fishekë. I vuri pushkës ballin. E shkrepiti të gjithë ballin.

BALLUK I m. Ballësor, kaptell. Balluku i samarit. Balluku i djepit.

BALLUK II m. Cjap me balluke.

BANDË I f. 1. Grup muzikantësh, që luajnë me vegla fryme; orkestër frymore kryesisht me vegla bronzi dhe vegla me goditje. Bandë muzikore. Banda ushtarake.

Banda e qytetit. Pjesë (melodi) për bandë. Festivali i bandave.

2. keq. Grup njerëzish të bashkuar për të bërë vjedhje, plaçkitje e krime; grup njerëzish, zakonisht në pushtet, që vepron në dëm të popullit me metoda kriminelësh e tradhtarësh. Bandë e armatosur. Bandë balliste (reaktionare).

Bandë diversantësh (hajdutësh, kriminelësh, tradhtarësh). Bandë të arratisurish.

Kreu i bandës. Asgjësuan bandat.

BANDË II f. 1. mjek. shih FASH/Ë,~A 1. Lidh me bandë.

2. tek. shih SHIRIT,~I 2. Bandë magnetofoni. Bandë për film.

3. sport. Rrip pëlhure, që vihet buzë rrjetës së volejbollit, të tenisit etj. për ta forcuar. Bandat pingule.

4. Rrip pëlhure i qëndisur ose sixhade e vogël, që varet në muret e dhomës për zbukurim. Bandë muri.

5. det. Pjesa e ngritur anës një barke ose një anijeje. Kapem pas bandës.

BANKË I f. 1. Tryezë e gjatë, zakonisht me syprinë pak të pjerrët, me ndenjësë të lidhur me të, në të cilën rrinë e shkruajnë nxënësit në shkollë. Banka e parë (e fundit). Bankë shkolle. Rresht bankash. Ulem në bankë. Dal nga banka. Vë mbi bankë.

2. Tryezë e posaçme prej druri a prej metali, me pajisjet e nevojshme, ku kryhen punë të ndryshme me dru, me metal etj. Bankë zdrukthëtari. Bankë për punën me dru (për punën me metal).

3. gjeol. shih STOM,~I 2. Bankë mbulesë. Bankë kripe.

* Në bankat e shkollës shih te SHKOLL/Ë,~A. Ulem në bankat e shkollës shih tek ULEM. Në bankën e të pandehurve (e të akuzuarve) në gjyq si i pandehur; në një gjendje të tillë, kur dikujt i kërkohet të japë llogari për fajet që ka bërë ose për përgjegjësinë që ka në një vepër a veprimtari të dëmshme.

BANKË II f. Institucion financiar shtetëror në vendin tonë, i cili ka të drejtën të emetojë kartëmonedha e monedha dhe, në përputhje me planin e zhvillimit të ekonomisë popullore, zbaton buxhetin, jep kredi, bën veprimet e llogarisë pa të holla në dorë, bën veprimet me monedhë të huaj, grumbullon mjetet e lira financiare të ndërmarrjeve, të kooperativave e të popullsisë për t'i përdorur për zhvillimin e vendit, organizon qarkullimin e përqendruar të parasë, ushtron kontroll me anën e lekut në të gjitha fushat etj.; institucion financiar privat a shtetëror në vendet kapitaliste, që kryen veprime të ndryshme me paratë e me letrat me vlerë, përqendron kapitalin dhe jep hua me qëllim që të nxjerrë fitime. Banka kombëtare. Bankë bujqësore. Bankë ndërkombëtare (botërore). Banka e Shtetit Shqiptar. Biletë (çek) banke. Nëpunës banke. Derdh paratë në bankë. Hapi një llogari në bankë.

BAR I m. 1. bot. Bimë zakonisht njëvjeçare, me kërcell të hollë e të njomë që nuk drunjëzohet, me gjethe të holla e të gjata në ngjyrë të gjelbër, e cila mbin e dendur në livadhe e në vende të tjera dhe shërben kryesisht si ushqim për kafshët; përmb. tërësia e bimëve të këtij lloji, që rriten vetë në livadhe, në ara etj.; mbulesa e gjelbër me këto bimë; lëndinë. Bar i gjelbër. Bar i njomë (i ri, i thatë). Bar i

egër bimë barishtore që mbin e rritet vetë. Bar i dendur. Bar helmues (i kripur). Bar mali (kënete). Bar vjeshte.

Fije bari. Mullar bari. Kosë bari. Ngjyrë bari. Një dorë (një gojë) bar. Del (mbin) bari. E mbuloi bari. Ka zënë bar. I shtie (i hedh) bar. Korr (kosit) bar. Mbledh (lidh) barin. Shkul barërat. Ha bar. Shkel (shtrihem) mbi bar.

2. fig. Gjë pa shije, ushqim si kashtë; gjellë që s'ka fare kripë.

* Bar helmues shfaqje e mbeturinave ose e ndikimeve të një ideologjie të huaj e reaksionare; mbartësi i një ideologjie të huaj e reaksionare. Bar i keq të meta, vese e koncepte të dëmshme që pengojnë mbarëvajtjen e punës; ai që ka këto të meta, vese e koncepte. Me bar e me gjethe me të gjitha ç'kam; kokë e këmbë. E bëri bar e rrënoi, e shkretoi, e la pa gjë prej gjëje. E hëngri barin (livadhin, çairin) shih te HA. Nuk ha bar (kashtë) shih te HA. E ka mbuluar bari (ia ka mbuluar varrin bari) ka vdekur prej kohësh, prej kohësh nuk është më. I ka dalë (i ka mbirë) bari (në faqe, në sy) ka vdekur prej kohësh; është tepër vonë tashti. I mbiu bari në faqe ka shumë kohë që po pret. Ç'i shtie bar! përb. ç'ia var, mos u merr me të! E bëri të hante bar përb. e vuri poshtë, e mposhti. Fluturon me një fije bar përçm. i rritet mendja shpejt; rrëmbehet lehtë. E ha barin pa shkop keq. shih te SHKOP,~I. I dha barin e ballkotit dikujt shih te BALLKOT,~I. Mbledh me bar blete mbledh në shtëpi një shumicë njerëzish të ndryshëm, duke i joshur me diçka. Kërkon gjilpërën (qimen) në bar (në kashtë, në mullar) shih te GJILPËR/Ë,~A. E la tokën bar e la tokën djerr, pa punuar. Zë peshk në bar është shumë i shkathët, është shumë i zoti, bën të pamundurën. Më zuri goja bar (erë) jam fare vetëm, s'kam me kë të ndërroj dy fjalë. I vajti bari sa hanxhari shih te HANXHAR,~I. I zëntë shtëpia (oborri) bar! mallk. i vdekshin njerëzit e shtëpisë, u shoftë me gjithsej, iu shoftë pragu. S'di gomari ç'është bari mospërf.

shih te GOMAR,~I. Prit gomar të mbijë bar! shih te GOMAR,~I. S'e lë hunda të hajë (të kullotë) bar tall. shih te HUND/Ë,~A. Zog bari zool. shih te ZOG,~U.

BAR II m. 1. Lëndë e përgatitur posaçërisht për mjekimin a parandalimin e një sëmundjeje ose për shërimin e një plage, ilaç; bimë ose pjesë e një bime, e përgatitur në një mënyrë të caktuar, që përdoret për mjekime. Bar qetësues (mjekues, nxitës). Bar i hidhur. Bar pluhur (me kokrra). Bar kundër gripit (kundër helmimit). Bar plakash. Recetë barnash. Shishe me bar. Pi barin. I jap një bar.

2. Lëndë kimike, zakonisht helmuese ose me erë të keqe, që përdoret për të zhdukur a për të larguar insektet e kafshët e dëmshme. Bar mole (lëkurësh) naftalinë. Bar pleshtash. Bar tartabiqesh. Bar morri. Bar miu (minjsh).

3. fig. Mjet a mënyrë që ndihmon për të kapërcyer një fatkeqësi, për të dalë nga një e keqe a vështirësi ose për të harruar një hidhërim etj. Kërkon barin. Ia gjeti barin. S'ka bar për këtë.

* Bar djathi farë djathi që bëhet nga mulleza e qengjit; farë djathi. Bar dhëmbësh pastë dhëmbësh. Bar kulaçi sodë buke.

BAR III m. sh Lokal i vogël, ku pinë zakonisht më këmbë. Bar veror.

BAR IV m. fiz. Njësi e matjes së shtypjes atmosferike. Shtypje një bar.

BAR I HIDHËT bot. shih RRUSHKULL,~I.

BAR I IMËT bot. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të shkurtër e me nyja, me gjethe të holla, që nxjerr lule të imëta, të bardheme e të mbledhura tufë dhe bën fara të zeza e shumë të vogla.

BAR I KEQ kryes. bot. Bimë barishtore që mbijnë vetvetiu nëpër ara, nëpër kopshte etj. dhe që dëmtojnë a pengojnë rritjen e bimëve të dobishme.

BAR I MADH bot. shih SHPEND/ËR,~RA.

- BAR** I QELBUR bot. Bimë barishtore me gjethe të holla si të pishës, me lule të kuqe, që mban erë të qelbur.
- BAR** I TRASHË bot. Madërgonë.
- BAR** I VERDHË bot. Kuskutë.
- BARBARIZËM** I m. 1. Veprim i egër, i pamëshirshëm e çnjerëzor, sjellje prej barbari, mizori. Barbarizmat e ushtarëve fashistë. Barbarizmat e nazistëve. Bënë barbarizma.
2. vet. nj. shih BARBARI, ~A 1.
- BARBARIZËM** II m. gjuh. Fjalë ose shprehje e huazuar pa nevojë nga një gjuhë tjetër. Pastrimi i barbarizmave.
- BARI** I m. 1. Ai që kullot, që ruan dhe që mbarësh-ton bagëtinë, çoban. Bari lopësh (dhensh, dhish, derrash). Barinjtë e kooperativës. Bariu i fshatit. Kërraba e bariut. Fyelli i bariut.
2. fet., vjet. Prift i krishterë, i cili, sipas paragjy-kimeve fetare, e quante veten udhëheqës shpirtëror të besimtarëve.
- * Mbeti si bariu pa bagëti mbeti i shkëputur nga masa që drejtonte. Mbetën si dhentë pa bari mbetën pa udhëheqje, pa drejtues a pa kujdestar. Vuri (bëri) ujkun bari i ngarkoi një detyrë me përgjegjësi një njeriu të pandershëm e të pabesë në një lëmë ku ai patjetër do të dëmtonte. Dhentë pa bari i ha ujku një nga një fj. u. pa një udhëheqje të mirë, bëhesh pre e armikut. Gjej njëherë bari, pastaj shko e bli dhi! fj.u. merr të gjitha masat e nevojshme, para se të nisësh një punë.
- BARI** II m. zool. Shpend notues, me pupla ngjyrë kafe, me sqep si të pulës, që jeton nëpër kënetat dhe ushqehet me peshq të vegjël. Bariu vjen era peshk.
- BARI** I ARIUT bot. shih KRAHNJER, ~I.
- BARI** I ÇIKËS bot. Bimë barishtore, me gjethe si të borzilokut e me push, me lule të bardha, që përdoret në mjekësinë popullore kundër lulëzës së syrit.
- BARI** I DALËS bot. Bar plasjeje.
- BARI** I DREQIT bot. shih KUSKUT/Ë, ~A.
- BARI** I DRITHIT bot. Bimë barishtore me gjethe të holla, të gjata e të dhëmbëzuara, me lule të bardha të grumbulluara në majë, që shtrohet në hambarët me drithë për të larguar kandrrat e dëmshme.
- BARI** I GJËSË bot. Bar plasjeje.
- BARI** I JETËS bot. Bimë barishtore njëvjeçare, që rritet në fusha e nëpër hamullore dhe që bën fara të helmëta, lëngu i të cilave, po të pihet, sjell të vjella e gjumë.
- BARI** I LOTZONJËS bot. Drekëz.
- BARI** I MINURIT bot. Bimë barishtore me kërcell të degëzuar, me gjethe gjatore e të dhëmbëzuara, me lule si të blerta, që mban erë të keqe kur thërrmohet.
- BARI** I SË PAEMRËS bot. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të gjatë e të degëzuar, me gjethe pak më të vogla se të hitrës, me lule të bardha si të borzilokut, që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e shpërgëtisë.
- BARI** I SYRIT bot. Bimë barishtore, me gjethe si të borzilokut fletëmadh, me fara në majë si të arrësit, që rritet rreth dy pëllëmbë.
- BARI** I TË HASURIT bot. Bimë barishtore me gjethe të vogla e të shpeshta, me lule të bardha, që rritet për tokë në vende me lagështirë dhe që, sipas besëtytnive, përdoret për mjekimin e «të hasurit» a të shuplakurit.
- BARI** I ZGJEBES bot. Bimë barishtore njëvjeçare ose shumëvjeçare, me kërcell të degëzuar e të gjatë deri një metër, me gjethe të dhëmbëzuara, me lule si gjysmërruzull në ngjyrë trëndafili, vishnjeje a të bardhë, që përdoret në mjekësinë popullore kundër zgjebes ose për të ngjyer.
- BARITUR** I mb. Që ka shije të shpëlarë si bar; që ka humbur shijen, pa shije. Gjellë e baritur.
- BARITUR** II mb. bised. I shëtitur.
- BARKËS** I m. Shuli i përparmë i tezgjahut, ku mblidhet pëlhura e endur.

BARKËS II m. Një lloj jeleku prej leshi, pa mëngë, që e veshin zakonisht gratë; xhamadan pa mëngë.

BATHORE I f. 1. Tokë e mbjellë me bathe.

2. Kërçelli i thatë i bimës së bathës, i bimës së pambukut etj. Bathore pambuku. Shkul (djeg) bathoret.

3. krahin. Fasule kokërrmadhe.

BATHORE II f. bot. Presh i egër, badër. Kokat e bathoreve.

BAXHË I f. 1. Dritare e vogël në çati për të hyrë drita nga lart ose për të dalë mbi çati; kapak në tavan për t'u futur nën çati, kapanxhe. Kapaku i baxhës. Dal nga baxha. Hap një baxhë.

2. Dhomë nën kulmin e shtëpisë, mbi tavan, me dritare në çati, që shërben për të banuar ose për të mbajtur sende të ndryshme në të. Dritaret e baxhës. Hyj (ngjitem) në baxhë. Fshiheshin në baxhë. Vë në baxhë.

3. Vrimë në çati për të dalë tymi ose vrimë në mur për të hyrë drita; frëngji. Baxha e oxhakut.

BAXHË II f. hist. Taksë bashkiake që paguhej në kohën e sundimit osman dhe në vitet para Çlirimit për shitjen e bagëtive e të sendeve të tjera në treg. Paganin baxhën. Merrej baxhë.

BEBE I f. Foshnjë. Këmishë bebeje. Pudër për bebe. Lindi një bebe. Lidh (mbaj) beben. Bën si bebe sillet si foshnjë. Është bebe nga mendja.

BEBE II f. Vrimë e vogël dhe e rrumbullakët në të zezën e syrit, nëpër të cilën hyjnë rrezet e dritës brenda në sy; bebëz, ninëz. Iu zgjeruan bebet. I shkëlqejnë (i ndritin) bebet.

E ruaj si beben e syrit.

* E shikoj (e vështroj) në bebe të syrit

a) nuk trembem nga diçka, i qëndroj përballë me guxim;

b) kujdesem shumë për dikë, e rrit me pekule dhe shqetësohem shumë për të, e shoh në dritë të syrit (zakonisht për një

fëmijë të vetëm). Ia njoh beben e syrit dikujt e di se sa trim është, e di se sa vlen. Nuk i dridhet bebja e syrit (syri, qerpiku) shih te SY, ~RI.

BEJLEG I m. vjet. Dyluftim. E thirri (doli) në bejleg. U mat (luftoi) në bejleg. Nduu bejlegun bëri dyluftim.

BEJLEG II m. krahin. 1. Tufa e luleve në majë të bimës së misrit, lulja e misrit. Lëshon (nxjerr) bejleg.

Ka ardhur misri në bejleg po lëshon lule misri.

2. ~GË, ~GËT. Tufë flokësh; balluke. Grua me bejlegë. La bejleg. Preu bejlegët.

3. Kec a qengj trupvogël ose që është pjellë para kohe.

4. fig. Njeri që dallohet nga një shenjë a nga një cen; njeri trupvogël e i fortë.

BEL I m. Pjesa më e ngushtë e trupit të njeriut midis kraharorit dhe kërdhokullave; ijët dhe pjesa mbi kryqet, mesi; pjesa më e ngushtë e rrobave, që mbështjellin trupin në këtë vend. Bel i ngushtë (i hollë, i gjerë, i trashë). Me bel të këputur me bel shumë të hollë. Rrethi i belit. Rripi i belit. Gjerësia e belit. Fustan (pallto) me bel. E kapi për beli.

Vuri duart në bel. Më dhemb beli.

* M'u këput beli shih te KËPUTEM 1. Rri me duar në bel (në ijë, në brez, në mes) keq. shih tek IJ/Ë, ~A.

BEL II m. Vegël bujqësore si lopatë, me teh trekëndësh, zakonisht me një këmbëz, që përdoret për të punuar thellë tokën ose për të hapur hendek. Bel çatall bel me tehun të trashë e të ndarë si bigë. Bel uluk bel me teh të kthyer si lug që përdoret për të hapur gropë. Bishti i belit. Punoj (kthej) me bel. Thellë një bel thellë sa gjatësia e tehut të belit. Bëj belin e parë gërmoj (hendekun etj.) një radhë me bel.

* Beli ka (edhe) bisht fj. u. çdo veprim ka edhe pasojat, dardha e ka bishtin prapa.

BEND I m. Pellg me një ledh si pritë, ku grumbullohet ujë për të ujitur ose për një punë tjetër; hauz. Bend uji. Bendi i mullirit. Hapëm një bend. Gjuaj peshk në bend.

BEND II m. kryes. 1. Shpoti, fjalë e thënë me thumb; fjalë të kota, gjepura. Flet (nget) me bende.

U kapën me bende. Shet bende.

2. Arsye të kota, që nuk qëndrojnë. Nxjerr (qet) bende.

* Është në bend të mirë është në qejf.

BEND III m. keq. Ai që i shkon pas dikujt për të përfituar prej tij. Bendi i beut.

BENG I m. zool. Zog shtegtar sa një harabel, me pupla në ngjyrë të verdhë të ndritur, me krahë të zinj e me sqep të kuq, që ushqehet me fiq; fikës. Tufë bengjesh. Femra e bengut.

BENG II m. krahin. Gjerdan me gurë të çmuar ose me florinj. Beng me margaritarë.

BERETË I f. Kapelë e rrumbullakët dhe e sheshtë prej stofi të butë, pa strehë dhe pa rreth anash. Beretë burrash (grash). Beretë marinari (peshkatari). Mbjaj beretë.

BERETË II f. Revolver i vogël i prodhimit italian. Fishekë beretë. Qëlloi me beretë.

BERONJË I f. 1. Grua që nuk bën fëmijë; femër e kafshëve shtëpiake që nuk pjell; shterpë. Mbeti beronjë.

2. përd. mb. Që nuk bën fëmijë; që nuk pjell; që nuk prodhon: shterpë. Grua beronjë. Dele (dhi) beronjë. Tokë (arë) beronjë. Misër beronjë.

BERONJË II f. 1. zool. Gjarpër i hollë e i gjatë, që i mbështillet njeriut a shtazës përreth kur do ta hajë; ber, shigjetull.

2. bot. Ashe. Fletë beronjë.

BIE I jokal. 1. Rrëzohem nga një vend i lartë në një vend më të ulët, këputem nga lart posht ë(për trupat nën veprimin e peshës së tyre). Ra një tullë (një gur, një kokërr). Ra tavani. Ra një yll. Ra një aeroplan.

Ra nga shkëmbi (nga buza, nga bregu). Ra nga pema (nga dega). Ra nga çatia (nga muri, nga dritarja, nga kati i dytë). Ra nga kali (nga biçikleta, nga makina). Ra zogu nga çerdhja. Ra nga qielli. Më ra nga duart. Më ra nga xhepi. Bie nga lart. Ra në pus (në gropë, në humnerë, në lumë, në përrua, në det). Bie në fund. Bie përtokë (përdhe). Bie shpejt (lirisht, butë, me forcë). Ra më këmbë. Dardha nën dardhë bie. fj.u.

2. Rrëzohem përdhe, kur humbas mbështetjen, lidhjen ose drejtpeshimin; rrëzohem padashur, gremisem, shembem. Ra lisi (mullari). Ra shtëpia (muri, gardhi).

Ra makina. Ra në borë (në baltë, në rrugë, në kalldrëm, në dysheme). Ra me bark (përmbys, më hundë, sa gjatë gjerë). Ra i vdekur (top, shakull, në vend, pa ndjenja).

Ra e u vra (theu këmbën). U pengua (rrëshqiti) e ra. Mbjaje të mos bjerë! Lëre të bjerë! Gati (desh) rashë. Ka rënë gruri.

3. vet. veta III. Shqitet, hiqet a shkëputet nga një vend ose nga e tëra, rrëzohet. Bien gjethet. I ranë qimet (flokët). Po i bie lëkura. I ranë dhëmbët. I ranë pendët. I ra pushi. I ra korja (plagës). Më ra thoi. Ra suvaja. I ka rënë boja. I ka rënë pulla (zarfit).

I ra gjuha këmborës. Bie një rrokje (një tingull). gjuh.

4. Ulem vetë ndenjtur, më gjunjë ose shtrirë; shtrihem; hidhem, lëshohem drejt dikujt a diçkaje. Bie në shtrat (në krevat, në rroba, në dyshek). Bie barkas (më gjunjë, përmbys, në shpinë). Bie poshtë shtrihem të fle. Bie të fle. I ra në krahë (në prehër, ndër këmbë). Ra i sëmurë zuri shtratin nga një sëmundje. Ra lehonë qëndroi e shtrirë në shtrat si lehonë; nisi lehoninë. Bie me pulat. bised. shtrihet të flejë shumë herët.

5. Rrëzohem i plagosur ose i vdekur; vritem a vdes, jap jetën për një çështje të

drejtë. Ra në betejë (në luftë, në fushën e nderit, në krye të detyrës). Ra dëshmor (si hero, heroikisht). Ra për liri (për atdhe). Ra fli (theror). Një bie, mijëra ngrihen.

6. vet. veta III. Rrjedh teposhtë, kulon, del e shkon poshtë; bised. derdhet (për lumin, përruan etj.). Bie ujëvara (rrëkeja, çurka). Më bien lot. Më bie gjak nga hundët. I bien jargë. Më bien djersë. Bie pikë-pikë. Lumi bie në det.

7. vet. veta III. Rrëzohet mbi tokë nga lart (për reshjet); përhapet mbi tokë e mbi sendet, mbulon tokën e sendet. Bie shi (borë, breshër, llohë, vesë). Bie brymë.

Bie mjegull. Bie pluhuri (tymi). Bie me shtamba (me rrëshekë). Fryn e bie.

8. vet. veta III. Varet lirshëm teposhtë; ulet e mbështetet lirshëm mbi diçka tjetër, shtrihet mbi diçka. Bie perdja. I ranë krahët poshtë. I kanë rënë supet. I ranë pantallonat. I ra koka në gjoks. I bien flokët mbi supe (mbi ballë). I bie kapela mbi sy.

I ka rënë gusha. I kanë rënë faqet.

9. Heq dorë nga qëndresa, pushoj qëndresën, dorëzohem (për kala, për qytete, për shtete). Ra qyteti. Ra kështjella (kalaja). Ra perandoria. Ra pa luftë.

10. Zbres nga fuqia, humbas pushtetin, vendin, detyrën etj.; caktohem në një detyrë më të ulët; vet. veta III humbet fuqinë vepruese, nuk vepron më, shfuqizohet (për ligjet. etj.). Ra qeveria (kabineti). Ra nga fuqia (nga froni). Bie një ligj nga fuqia.

Ra ky mendim.

11. vet. veta III. Zbret pjerrtas ose pingul, shkon drejt një vendi më të ulët. Shkëmbi bie thikë. Shpati bie pingul (pjerrtas). Kodra bie butë. Bie shkallë-shkallë.

12. Shikoj në një drejtim, përshkoj; i dal; vet. veta III kalon, del. I bie fushës (bregut të lumit). Bjeri vaut! I bie nga kjo rrugë. I bie shkurt (drejt, rrotull,

qark, anash, nga e majta, nga qendra). I ra kryq e tërthor (pash më pash). I ra lumit tej për tej. I ra me not. I bie përpara i dal përpara. I ra prapa (pas) e ndoqi riga pas. I ka rënë botës mbarë.

13. Zbres, lëviz tatëpjetë; shpërngulem e zbres nga një krahinë më e lartë dhe vendosem në një më të ulët; vij a shpërngulem nga malësia në fushë ose nga fshati në qytet. Ra në fushë. Ranë në Shkodër.

14. bised. Vete për të bujtur, shkoj për të kaluar natën. Ranë te një mik. Ra në hotel.

I ra në shtëpi.

15. vet. veta III. Ulet, pakësohet (si numër, si sasi, si vëllim etj.); edhe veta I më ulet vlera, humbas cilësinë, zbres në një shkallë më poshtë. Bie numri. Ra çmimi.

Ranë aksionet. Ra kursi. Ra shpejtësia. Ra prodhimi. Ra lumi. Ra niveli. Ra në kategorinë e dytë. Ra goma u shfry goma. I ra barku. I ra vlera (ndikimi, autoriteti).

16. vet. veta III. Pakëson a humbet forcën e vet, i ulet vrulli, dobësohet, zbutet. Ra era (deti). Ra të nxehtë (të ftohtë). Flakët po binin. Bie fashë qetësohet, pushon.

I ranë ethet. I ra temperatura. Ra tryshnia. Ra vrulli (ritmi). I ra gëzimi (entuziazmi).

I ra inati (zemërimi). Biseda ra. Ra kureshtja (interesimi). Puna nuk binte.

17. fig. Humb vlerat a cilësitë e mira; më keqësohet gjendja; ulem nga ana morale, marr të tatëpjetën. Ra nga mjeshtëria (nga zanati). Ka rënë në mësim. Bie nga shëndeti. Ra nga gjendja. Ra në sytë e të tjerëve. Ra moralisht (shpirtërisht). Ka rënë, s'është më i pari. Sa poshtë ka rënë.

18. vet. veta III. Ndodh, vjen rastësisht; qëllon. rastis; e merr, e prek, e përfshin (kryes. me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor në r. dhanore). Më ra udha (rruga). Më ra rasti. Më ra puna.

I ra (e zuri) lotaria. Më ra ndër mend. I ranë sytë mbi diçka. Më ra (më hyri, më shkoi, më erdhi) në vesh. Më ra papritur (e papritur, befas).

Ra fjala. Sido që të bjerë puna. Lajmi ra si bombë. Ra biseda (muhabeti). Ra tërmeti. Me ç'të më bjerë në dorë. I ra një vdekje. I ra plani një shtëpie etj.

19. vet. veta III. Qëllon në një kohë të caktuar, e ka kohën në një vit, në një muaj, në një javë a në një ditë të caktuar, rastis. Bie të hënën. Bie në fund të javës. Kur bie Viti i Ri? Ra në pranverë.

20. edhe fig. Ndodhem papritur ose padashur në rrethana zakonisht të këqija e të vështira; arrij në një gjendje të caktuar, kaloj në një gjendje shpirtërore; hyj, futem (edhe në një varg njësisish frazeologjike). Ra në grackë (në lak, në kllapë, në kurth, në grep). Ra në greminë. Ra në pritë (në pusi). Ra në rrezik (në fatkeqësi). Ra në hall (në vështirësi, në bela). Ra rob (pre, viktimë). Ra në burg. Ra brenda. thjeshtligj. e futën në burg. Ra në duart (në thonjtë, në kthetrat) e dikujt. Ra nën sundimin (nën ndikimin) e dikujt. Ra ngushtë (keq). Ra në gjak (në armiqësi). Ra në zi. Ra në gabime. Ra borxh. bised. Ra në përleshje (në luftë, në përplasje). Ra në varfëri (në mjerim, në skamje). Bie në mendime (në mëdyshje). Ra në të thella. Ra në të zeza u zhyt në mendime të këqija. Ra në dëshpërim (në hidhërim). Ra në dashuri. Ra në plogështi. S'bie në vetëkënaqësi (në shkollarizëm, në formalizëm). Ranë në oportunitizëm (në idealizëm, në subjektivizëm). Ranë kllapi. Bie në gjumë (në qetësi, në heshtje). Ra në krizë (në amulli). Ra me barrë. Ra kllaçkë pula. Më ranë veshët rehat. bised. Ra si miu në hauz (në poç). Shpëtoi nga shiu e ra në breshër. fj.u. Shpëtoi nga lumi e ra në det. fj.u.

Iku nga tymi e ra në zjarr. fj.u.

21. Ndesh papritur në diçka; gjej; befas diçka, zakonisht me shumicë; turrem i etur mbi diçka. Ra në tokë të butë. Ra

sharra në gozhdë. Ramë në një pyll. Gjeologët ranë në bakër. Ra në para (në bollëk). Ranë në mina. Bie në gjurmë. Delet ranë në kripë.

Ra si kali në tagji.

22. Qëlloj në një grup njerëzish, rastis me të tjerë, hyj rastësisht në marrëdhënie me dikë ndodhem. Ra në një familje (në një kolektiv) të mirë. Kishte rinë me shokë të këqij. Ra në një klasë të dalluar. Ra me ca udhëtarë të njohur.

23. edhe fig. E godit, e qëllor me diçka (zakon. me një trajte të shkurtër të përemrit vetor në r. dhanore). I ra me gur (me grusht, me shkelma, me pël-lëmbë, me shkop, me kamxhik). I ra me pushkë (me kobure, me top, me shpatë, me shigjetë). I ra kokës (turinjve). I ra në kurriz (në krah). I ra kalit. I bie topit. I bie tokës me këmbë. Më ra era në shpatulla. I ra rrufeja. I ra nga prapa. I ra në lule të ballit. S'bie rrufeja dy herë në një lis. fj. u. Nuk bie reja (rrufeja) në hithra. tall. Nuk i hipën dot dardhës, i bie fikut. fj. u. S'ka ç'i bën gomarit, i bie samarit. fj. u.

24. vet. veta III edhe fig. Drejtohet, shkon në një pikë a në një vend të caktuar, përplasat a zë vend diku; më prek a më godit një nga shqisat a një organ te trupit (për dritën për erën, për zërin etj.); më prek a më godit ndjenjat. Ra në shenj. I bie drita. Më bien rrezet në sy. Topi ra në mur. I ra dielli në kokë. Më ra rëndë ushqimi.

I ra rëndë ajo fjalë. Më ra si plumb,(si rrufe).

25. Godit diçka: për të nxjerrë një tingull a një zë, bëj të tingëllojë; vet. veta III nxjerr një tingull a një zë kur goditet, tingël-lon; dëgjohet (një zë, një krismë etj.).

I bie derës (ziles, çangës). I bie daulles. I bie fort (ngadalë). Bie dera (zilja, kambana, telefoni, ora). Bie, boria (sirena). Bien pushkë. I bie pragut të dëgjojë dera (i bie derës të dëgjojë qilari) e hedh fjalën për diçka. Kur ta varësh zilen, duhet t'i biesh. fj. u.

26. Luaj me një vegël muzikore; luaj një pjesë muzikore; vet. veta III nxjerr tinguj një vegël muzikore, dëgjohej, tingëllo. I bie një vegle: I bie lahutës (fyellit, çiftelisë, gajdes, violinës, pianos). Nuk di t'i bie kitarës: Binte muzika. Binin sazet. I bie një kënge popullore (një vals, një tangoje)

27. Sulem mbi dikë a mbi diçka, vër-sulem; e sulmoj dhe e godit. Ranë mbi armikun.

I ranë pushtuesit. Bini mbi ta! I ranë qytetit. Ra ujku ndër dhen. Ra bisha në bagëti.

Ra dhelpra në pula.

28. fig. bised. Sulmoj me fjalë, qortoj a kritikoj rreptë; i vërsulem, e godit. I ra kundërshtarit. I ra një veprë (një romani). I ra pa të drejtë. I ra në kokë. I ra pas shpine (prapa krahëve).

29. vet. veta III. Ndodhet në një vend, gjendet, shtrihet në një anë, është. Bie në veri.

Bie afër (larg). Bie nga e majta (djathtas). Ku bie ky fshat? Na bie në rrugë. Bie nga oborri. Bie në Shqipëri. Bie i treti (i fundit). Theksi bie në fund. gjuh.

30. vet. veta III. Fillon, vjen dhe përhapet, shtrihet e sundon mbi dikë a mbi diçka, mbulon, pllakos. Bie errësira (nata, mbrëmja, muzgu). Ra agu (mëngjesi).

I bie drita (hija). Ra drita zbardhi agoi. Ra dielli doli dielli. Ra qetësi (heshtje).

Ra zjarr. I ra flaka. I ra, një çehre (një ngjyre) e verdhë.

31. vet. veta III fig. Vjen e përhapet; me kap, më zë, më prek, më godit; më vjen.

Ra gripi (kolera). I ra një sëmundje. I ra barku i verës. I ra sëmundja e tokës.

U ra flama (pulave). I ra pika (damllaja). U ra krimbi. I ra të fikët. I ra në zemër.

Më ra për thonjsh (nga të ftohtët). I ra gjaku e zuri gjaku. Më ra vera në kokë. I ra një fatkeqësi (një e keqe). I kanë

rënë halle. I ra mbi kokë (barra e një pune). Dyshimi binte mbi të. I rëntë flama! mallk. I rëntë pika! Pika që s'i bie! maspërf.

32. Hyj në marrëveshje me dikë, hyj në marrëdhënie të caktuara me të; pajtohem në mendime a në veprime me dikë, lidhem. Bie në marrëveshje (në ujdi, në fjalë).

Bie në kuvend. Ranë në pazar. S'bie në kompromis. libr. Ra në grindje, (në sherr).

Bie në kundërshtim me dikë; a me diçka.

33. bised., Kam lidhje gjaku, farefisnie ose afërsie. Më bie kushëri i parë (kunanat).

Bien baxhanakë (krushq).

34. bised. Bëj një punë shpejt me një vegël; heq a pastroj me një mjet; punoj me një vegël, i jap (zakon. me një trajtë të shkurtër te përemrit vetor në r. dhanore). I rashë me fshesë dhomës. U bie më furçë këpucëve (rrobave, mureve). I bie me brisk mjekrës (faqes). I bie me drapër (me kosë). Ra drapri (në ara) nisën te korrat. I bie kosës me grihë (me limë). I bie me zdrukth. Bjeri kazmës! puno!

35. bised. Jepem pas diçkaje, më tërheq shume diçka; lidhem me dikë a me diçka dhe kujdesem shumë për të. Bie pas muzikës (pas pikturës, pas artit; pas sportit).

Bie pas bujqësisë. Bie pas gjahut. Ka rënë pas librave. Bie pas punëve. Kishte rënë pas qejfeve (pas rehatit, pas rakisë). Bie pas fëmijës.

36. fig. Lodhem shumë, duke bërë të njëjtën gjë vazhdimisht, këputem se beri diçka pa pushim (edhe në disa njësi frazeologjike). Më ranë këmbët (copë) së ecuri (së kërkuari). U ranë krahët (së punuari). I binin thonjtë (së lari rroba, së bëri çorape).

U ranë kryqet (kërbishtet). U ra bretku (kurrizi) në punë. Më ra goja (së thëni,

së foluri). Më ra buza (gjuha). Na binin brinjët (kokkat).

37. bised. Nis diçka shtruar dhe i jap fund, e faroj diçka; filloj të ha me ngulm një gjellë a diçka tjetër ose të pi diçka dhe e mbaroj shpejt; i futem, i përvishem (një gjelle etj.). I ra kosit (byrekut, bakllavasë, verës). U ra fasuleve (patateve). I ra pjatës (tepsisë). U ra mollëve. U ranë shqerrave e i therën (i shitën).

38. vet. veta III. Më nxë, më vjen për shtat, më rri si duhet, më bën. Më bien mirë këpucët. S'i bie fustani. Më bien tamam. Mezi më bien.

39. vet. veta III fig. Më vjen për shtat, përputhet, pajtohet me diçka, më shkon, më vjen në një mënyrë (me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor në r. dhanore). Na bie mirë (keq). I bie mbarë. I bie për shtat i pëlqen, i vjen ashtu si do ai. I binte pas qejfit (pas midesë, pas dëshirës).

40. vet. veta III edhe fig. bised. Më kushton; më qëllon ta blej, ta paguaj diçka (lirë a shtrenjte). Na ra lirë (shtrenjtë). U ra sa qimet e kokës e blenë shumë shtrenjtë.

41. Më përket; më takon, e kam unë për-sipër. I ra në pjesë (në hise). Nga sa na bie?

Më bie radha. Më bie barra (përgjegjësia). I bie për detyrë. I ra atij të fliste. Të bie ty të shkosh. I bie merita (nderi). Ra në kurrizin tim. Ra mbi supet (mbi shpatullat) e mia.

Shpenzimet bien mbi të. Mos fut hundët tek s'të bie!

42. Them diçka, flas në një mënyrë. I bie drejt (shkurt anës e anës, larg e larg).

I bie copë. Mirë i ka rënë.

43. vet. veta III. Lëshon, ka. Bie erë. I bie erë të keqe (goja, plaga). Bie era shkru mb.

Bie erë barut. Po s'hëngre hudhra, s'bie erë. fj. u.

44. përd. pavet. sipas kuptimeve 4, 12, 14, 20, 23, 25-28, 32, 34, 37, 42. S'i bihet murit me kokë. fj. u.

* Ra në baltë shih te BALT/Ë, ~A. Ra në bark shih te BARK, ~U. S'i bie barku shih te

BARK, ~U. I ra në besë shih le BES/Ë, ~A 4. Ra në bigë shih te BIG/Ë, ~A. Ra në bisht shih te BISHT, ~I. Ra boria shih te BORI, ~A. Ranë në brazdë shih te BRAZDË, ~A. Erdhi (ra) në brazdë (në hulli) shih te BRAZD/Ë, ~A. Ra brenda (me këmbët e tij) shih te BRENDA. I ra në bri shih te BRI, ~RI. I ra bruzi shih te BRUZ, ~I. I ra pas buze shih te BUZ/Ë, ~A.

I bie buzukut tall. shih te BUZUK, ~U. Ra në bylyk vjet. shih te BYLYK, ~U. Bjeri t'i biem punë e kotë, kot për kot (përdoret kur diçka bëhet në rrëmujë, pa pasur një synim të caktuar). Bie copë shih te COP/Ë, ~A. I bie cyles shih te CYL/E, ~JA. I bie një çakalleje shih te ÇAKALL/E, ~JA. Ranë çanakun e dikujt keq. shih te ÇANAK, ~U. I bie çekanit diku a në diçka shih te ÇEKAN, ~I. Të bjerë (të rrahë) çekani diku ose në diçka shih te ÇEKAN, ~I. I bie çokut shih te ÇOK, ~U. Ka rënë në dardhë dikush shih te DARDH/Ë, ~A. Bjeri daulles! mospërf. shih te DAULL/E, ~JA. I bie daulles shih te DAULL/E, ~JA. I bie daulles së dikujt keq. shih te DAULL/E, ~JA. I bie daulles në një vend shih te DAULL/E, ~JA. Ka rënë nga dega shih te DEG/Ë, ~A. I ra në dorë shih te DOR/Ë, ~A. Ra në duar të liga diçka shih te DOR/Ë, ~A. Më kanë rënë dhëmbët (dhëmbë e dhëmballë) shih te DHËMB, ~I.

Bie (mban, vjen) erë shih tek ER/Ë, ~A II. I bie në erë dikujt a diçkaje shih tek ER/Ë, ~A II. Bie (mban) era barut shih te BARUT, ~I. Bie (mban) erë myk diku shih te MYK, ~U. Ra (zbriti, u rrëza) nga fiku iron. shih te FIK, ~U. Bie fjala shih te FJAL/Ë, ~A. I ra në fije (në fill, në të) shih te FIJ/E, ~A.

Ra në fill me të shih te FILL,~I. I ka rënë flaka (zjarri, flama) nuk gjendet gjëkund, është mbaruar është zhdukur (për një send). I ra në fjalë dikujt shih te FJAL/Ë,~A. I ra fshesa (kosa, gërshëra) u spastrua, u shkurtua, u hoq diçka. Ra (hyri) në gojë të dikujt shih te GOJ/Ë,~A. Bie në gjumë më zë gjumi, fle. Ra në gjunjë shih te GJU,~RI. I ra në (më) gjunjë (ndër këmbë) dikujt shih te GJU,~RI. Bie në gjurmë të dikujt a të diçkaje shih te GJURM/Ë,~A. I ra me hanxhar diçkaje shih te HANXHAR,~I. I ra me sëpatë shih te SËPAT/Ë,~A. Ka rënë nga hëna iron. shih te HËN/Ë,~A. I ra hiles shih te HIL/E, ~JA. I ra hunda tall. shih te HUND/Ë,~A. I ra në hundë diçka shih te HUND/Ë,~A. I ka rënë hunda në dhe (përdhe) iron. shih te HUND/Ë,~A. Nuk i bie hunda në shesh shih te HUND/Ë,~A. Binte jashtë vjet. shih te JASHTË.

I bie jongarit shih te JONGAR,~I. I ranë (i zbritën) kacabunjtë shih te KACABUN,~I. I ranë (i zbritën) xhindët (qipujt) shih te XHIND,~I. Ra kalaja shih te KALA,~JA. Ra nga kali shih te KAL/Ë,~I. Bie kambana shih te KAMBAN/Ë,~A. Të gjithë i bien një kambane shih te KAMBAN/Ë,~A. I bie kavallit (fyellit) shih te KAVALL,~I. I ra këmbës shih te KËMB/Ë,~A. U ra (ua mbathi, ua dha) këmbëve shih te KËMB/Ë,~A. Më ra këmisha shih te KËMISH/Ë,~A. I bie kokës, (në kokë) shih te KOK/Ë,~A. I ra në kokë shih te KOK/Ë,~A. I bie kokës me grusht e shih te KOK/Ë,~A. I bie krahëve dikujt shih te KRAH,~U. I bie supeve (i rreh supet) dikujt shih te SUP,~I. Ra (u hodh) në krahët e dikujt shih te KRAH,~U. Ra në kurriz shih te KURRIZ ~I. I bie lapshit (kalemit) i bën mirë hesapet; e llogarit diçka si i del më mirë. I bie legenit thjeshtligj. shih te LEGEN,~I. I bie rran-gallës shih te RRANGALL/E,~JA. I bie teneqes tall. shih te TENEQE,~JA. I ra me limë shih te LIM/Ë,~A. Ka rënë në lllum (në batak) shih te LLUM,~I. I ra

maska shih te MASK/Ë,~A 4. Bie në mendje (në vete) vjen në vete; mbledh mendjen. I bie mendjes (prapa) shih te MENDJ/E,~A. Ra mësysh vjet. shih te MËSYSH. I ra moh (hasa) shih te MOH. I bie ndesh shih te NDESH. I ra ndore dikujt shih te NDOR/E,~JA 1.

I ra më not diçkaje shih te NOT,~I. Ra ora për diçka shih tek OR/Ë,~A1. I ranë (i zbritën) orët shih tek OR/Ë,~A. I bie pas (prapa) dikujt a diçkaje shih te PAS. I bie sherrit prapa shih te PRAPA. I ranë (iu rrëzuan) pendët (puplat) dikujt shih te PEND/Ë,~A. I ra pikës shih te PIK/Ë,~A. Ka rënë poshtë dikush a diçka shih te POSHTË. S'bie poshtë shih te POSHTË. Ra (u hodh) në prehrin e dikujt shih te PREH/ËR,~RI 6. Ra (mbeti) pykë shih te PYK/Ë, ~A. I ra në (më) qafë dikujt shih te QAF/Ë,~A. I ra qarit shih te QAR,~I. Ra liga qielli shih te QIELL, ~I. I ra në qokë shih te QOK/Ë,~A. I bie qylit thjeshtligj. shih te QYL,~I III. I bie rrotull dikujt a diçkaje shih te RROTULL. Nuk i ranë sqep shih te SQEP~I. Bie në sy shih te SY,~RI.

I ra me sy (udhës, sheshit, fushës) i hodhi një vështrim (udhës, sheshit...). I bie në shenjë (i bie shenjës) shih te SHENJ/Ë,~A. Ra nga shkallët dikush shih te SHKALL/Ë,~A. Bien shkopinjtë mbi dikë shih te SHKOP,~I 5. I ra (i erdhi, i doli) në shteg shih te SHTEG,~U 4. I ra në teste shih tek TEST/E,~JA II. I ra nëpër të

a) e kaloi përciptazi diçka; nuk i hyri thellë;

b) iu afrua, e gjeti afërsisht mendje. Ra në tokë shih tek TOK/Ë,~A I. Ra për tokë shih tek TOK/Ë,~A I. I ra me top shih tek TOP,~I. Ra trashë me dikë shih tek TRASHË. I ra në tru shih tek TRU,~RI. Ra në thekër shih tek THEK/ËR,~RA. Ra në thundër shih tek THUND/ËR,~RA. Nuk ranë në va edhe poh. shih te VA,~U. I ranë veshët shih te VESH,~I. I ra veshit shih te VESH,~I. I ra (i shkoi, i hyri, i erdhi) në vesh

diçka shih te VESH,~I. I rëntë (i ardh-të) pas veshit (pas qafës)! mallk. shih te VESH,~I. I ranë vetullat dikujt shih te VETULL,~A. I ra vula dikujt shih te VUL/Ë,~A. O rashë o vdiq a s'ka rrugë tjetër, ndryshe s'ka ç'më duhet vetja; s'ka si bëhet ndryshe, patjetër (kur diçka e kërkojmë me çdo kusht). Bjer e çohu (ngrehu e bjer)

a) gjithnjë po ajo gjë, vazhdimisht po një-soj;

b) me shumë vuajtje, me mundime të mëdha. Ku më ka rënë koka ku kam lindur. I bie po atij avazi (po atij teli, po asaj gozhde) përsërit të njëjtën gjë, thotë gjithnjë po atë gjë. S'i bie atij krahu shih te KRAH,~U. Nuk i bie (nuk rreh) në atë krah edhe poh. shih te KRAH,~U. S'bie në ato ujëra shih tek UJ/Ë,~I. Më ra çatia (shtëpia, tavani, qielli) mbi (në) kokë nuk dija ku të fute-sha nga turpi, nga një e papritur etj. Nuk bie (nuk shkel) në dërrasë (në dhogë) të kalbur shih te DERRAS/Ë,~A. Ka rënë në duar të liga shih te DOR/Ë,~A4. I bie gjoksit me grushte shih te GJOKS,~I. I ka rënë gjuha e këmborës shih te KËMBOR/Ë,~A. I kanë rënë leshtë (i kanë rënë qimet) e kokës shih te LESH,~T. I bie nenit të këmbës shih te NEN,~I. S'ka, çelës që i bie shih te ÇELËS,~I. S'e lë të bjerë përdhe shih te LË. Ra qielli dhe e zuri (e mbuloi) shih te QIELL,~I. Ka rënë nga shtatë degët shih te DEG/Ë,~A. I ra uji i valë shih te VALË (i, e). Sa poshtë ka rënë katundi! mospërf. shih te POSHTË. Ku rafsha mos u vrafsha! le të dalë ku të dalë! (thuhet kur dikush nuk çan kokën për asgjë, nuk shqetësohet fare për pasojat që mund të vijnë nga një veprim etj.). Vaji në lakra bie fj.u. nuk vete dëm diçka, aty e ke. Gjalpi në lakror bie (derdhet, mbetet) fj. u. vaji në lakra bie.

BIE II kal. 1. Mbart diçka nga vendi ku është dhe e sjell afër, sjell; e zhvendos, e sjell dikush nga larg në vendin ku jam unë; kund. shpie, çoj. E bie dollapin nga kati i dytë në të parin. E bie nga Shkodra

në Tiranë. E bie tryzën afër dritares. I pruri me karrocë (me makinë, në krahë). I prunë eshtrat e rilindësit të shquar në atdhe. E prunë ujin (dritën elektrike) në fshat. Më bjer një kazmë (një lopatë, një darë)! I pruri një karrige.

Më bjer një pjatë (një lugë)! Më bjer një gotë ujë! Bjerma ta shoh!

2. Marr e sjell diçka me vete, sjell diçka për një njeri; vet. veta III sjell, çon diku, nxjerr. I pruri një letër (një telegram). I pruri një dhuratë. Pruri një lutje (një kërkesë, një ankesë). Bjere edhe djalin kur të vish! Bie me vete. Lumi pruri kërcunj. E pruri rryma. E prunë me zor.

3. Vij e bëj të ditur, vij e njoftoj diçka, sjell një lajm a diçka tjetër, sjell. Pruri një lajm (të mirë,të keq). Ka prurë një përgjigje. Pruri të falat (përsëritjet, falënderimet) e dikujt.

4. Nxjerr dhe parashtroj, paraqit; e sjell, e nxjerr atje ku dua. Bie prova (argumente, fakte). Bie një shembull (një citat). E pruri fjalën (bisedën, muhabetin). E bie në mend.

5. fig. Sjell një pasojë, shkakton; bëj të ketë; siguroj; sjell. Kjo erë bie shi. Bie dobi (të mira, mbarësi, gëzim). Bie shëndet. Pruri çrregullime (vështirësi, pengesa, fatkeqësi). Bie si pasojë. E pruri koha (rasti). Ja pruri mbarë. Sido që ta bjerë puna sido që të ndodhë, sido që të jetë. Ç'bie sahati, nuk bie moti. fj. u.

6. Tërheq për të ardhur, bëj të vijë; më sjell diku, më çon. E pru malli për djalin. Ç'erë (ç'e mirë) të pruri? Ç'dreq e pruri? thjeshtligj. Gjurmët e prunë deri në shtëpi.

7. Bëj të jetë, e sjell në një gjendje të caktuar. E bie në rregull (në vijë). E pruri në qejf (në vete). E pruri në terezi punën. bised. E pruri në atë ditë (në atë gjendje) e soll në një gjendje shumë të keqe. E pruri në fuqi.

* E pruri (e solli) në din. dikë shih te DIN,~I. E pruri (e vuri) në dyzen shih te

DYZEN, ~I. E bie (e vë) në (për) fije (fill) diçka shih te FIJ/E, ~A. E pruri kokën përçm. shih te KOK/Ë, ~A. E pruri (e solli, e qiti) në jetë shih te JET/Ë, ~A. E bie rrufull shih te RRUFULL. E pruri (e nxori, e çoi) rruga (udha) shih te RRUG/Ë, ~A. Ma pruri (fjalën) në shteg shih te SHTEG, ~U. Ia bie (ia sjell, ia hedh) fjalën rrotull (larg e larg) shih te RROTULL. Ma pruri zemrën në vend shih te ZEM/ËR, ~RA 3. Ma pruri (ma solli) shpirtin në fyt (ndër dhëmbë) shih te FYT, ~I.

BISBIQ I m. gjell. Kulaç që bëhet me miell misri të situr hollë, me qumësht dhe me gjalpë.

BISBIQ II m. 1. Bagëti (dele ose dash) që e ka trupin të imët e të dobët dhe që zakonisht nuk është e shtruar e ndahet nga tufa.

2. keq. Njeri zakonisht me trup të vogël a të hequr, por shumë i lëvizshëm; llafazan e ngatërrestar; mistrec.

3. përd. mb. sipas kuptimeve të emrit. Dele bisbiqe. Fëmijë bisbiq.

BISHTAK I m. 1. Mëz njëvjeçar. Hingëllin si pela për bishtakun. mospërf.

2. fig. Fëmijë i vogël, që ende nuk është ngritur më këmbë.

BISHTAK II m. 1. Enë me bisht të gjatë që përdoret për ujë; lugë e madhe me bisht të gjatë, që përdoret për të ndarë gjellën, bishtore.

2. Pjesa e fundit e dorakut të parmendës. Bishtaku i parmendës.

BLANË I f. 1. Shenjë ose dangë që mbetet në trup nga një plagë, nga një goditje a nga një sëmundje. Blanë e zezë (e kuqe). Blanë plage. Blanë shpate. Blanë në ballë. Më mbeti blanë. La blanë (plaga).

2. Njollë; shenjë me një ngjyrë tjetër, balë. Blanë drite. Blanë yndyre. Dele me blana.

3. Sëmundje e disa bimëve, që shfaqet me njolla të zeza në gjethet e në frytet. Blana e ullirit. I ra blana.

BLANË II f. bot. Urra e drurit.

BOCË I f. shtypshkr. Fletë e shtypur me një tekst libri, gazete etj., që shërben për provë dhe për të bërë ndreqjet e gabimeve të shtypit. Bocat e para (e dyta). Bocat e librit (e gazetës, e revistës). Boca në shtylla (në faqe).

BOCË II f. Enë prej qelqi për ujë, për verë etj., që zakonisht mbahet mbi tryezë; shishe e vogël. Bocë njëlitërshe (dylitërshe). Bocë me ujë (me verë). Bocë për bojë.

BOJALLI I mb. Që është i ngjyrosur me ngjyra të ndryshme, ngjyra-ngjyra; që ka ngjyrë të bukur. Basma bojallie. Gur bojalli.

BOJALLI II mb. bised. Që ka shtat të lartë e të hedhur, shtathedhur. Djalë (burrë) bojalli. Vajzë (grua) bojalleshë.

BOJË I f. 1. Lëndë e lëngshme ose në trajtë pluhuri të tretshëm, që përdoret për të ngjyer rroba, për të lyer sende të ndryshme, për të shkruar, për të pikturuar etj.; shtresa e kësaj lënde në sendet e lyera me të. Bojë e kuqe (e zezë). Bojë vaji. Bojë uji. Bojë dheu. Bojë arre. Bojë leshi (pambuku). Bojë këpucësh. Bojë shkrimi. Bojë flokësh. Shishja e bojës. Kutit bojërash. Lapsa me bojëra. Njollë boje. Lyej (bëj) me bojë. I jap bojë e bojatis. I vë bojë. Ngjyen me bojë. S'merr bojë. I ra boja. Ruhuni nga boja!

2. Ngjyrë. Bojë argjendi. Bojë bari. Bojë hiri. Bojë qielli. Bojë limoni. Në bojë të verdhë (të kuqe, të gjelbër...).

3. bised. Ngjyra e fytyrës ose pamja e përgjithshme e njeriut, çehre; keq. fytyra.

I mirë nga boja. Iu prish boja. I iku (i ndryshoi) boja. I erdhi boja në vend, ia tregon boja. S'ia kam parë bojën. E ka ruajtur (e ka mbajtur) bojën e ka ruajtur bukurinë e njomësinë e fytyrës (thuhet zakonisht për gratë në moshë mesatare a të thyer). Mos iu duktë boja! mallk. Mos ia pafsha bojën! mallk.

4. krahin. Vrug që u bie bimëve kur ka lagështirë të tepërt dhe që i mbulon gjethet me një shtresë të hollë pluhuri të kuq. U ka rënë boja.

* U bë si boja u prish në fytyrë, u zbeh a u pre në fytyrë nga një lajm i papritur, nga zemërimi, nga frika etj. I doli boja keq.

a) u zbulua se kush ishte, i doli në shesh fytyra e vërtetë;

b) i iku vlera, u vjetrua, doli jashtë përdorimit; humbi emrin e mirë ose nderimin nga të përsëriturit e dendur, u bë bajat;

c) s'ka më pikë turpi, i ka plasur cipa. I humbi (i treti, nuk i duket) boja nuk shihet ose nuk gjendet më asgjekundi, u zhduk. I dha (një) bojë e zbukuroi nga jashtë, e lustroi për të fshehur thelbin e vërtetë. S'merr bojë një punë nuk është mirë të veprohet në këtë mënyrë, nuk ka hije kështu. Katran me bojë shumë i keq; në gjendje shumë të keqe.

U nxi me bojë e zuri e keqja, e gjeti e zeza. Ia nxori (ia hoqi, ia qiti) bojën keq. e zbuloi se kush është, ia nxori të palarat në shesh, ia zbuloi fytyrën e vërtetë para të gjithëve. I shuari (i nxiri) me bojë i shkreti, i mjeri. Pa u tharë (mirë) boja libr. pa kaluar shumë kohë, shpejt, menjëherë (për punë që bëhen pas një vendimi).

Iu vu (i mbeti) njolla me bojë shih te NJOLL/Ë,~A.

BOJË II f. bised. 1. Shtat. I shkurtër (i gjatë) nga boja. Hedh (lëshon, merr) bojë rritet. Ishte në bojën tënde ishte i gjatë sa ti.

2. Masë për lartësi, e barabartë me gjatësinë e një njeriu mesatar. Një bojë njeriu.

Tri bojë burri.

BOKS I m. sport. 1. Ndashje sportive, në të cilën secili prej dy kundërshtarëve përpiqet të mposhtë tjetrin, duke e goditur me grushte të veshura me doreza të posaçme lëkure; sporti i ndashjes me

grushte, sipas disa rregullave të caktuara. Ndashje boksi.

Doreza boksi. Bënë boksi.

2. ~A, ~AT bised. Goditje me grusht, grusht; ndashje me grushte. I dha një boksi.

U zunë me boksa.

BOKS II m. Lëkurë e fortë, zakonisht prej gjedhi, e regjur mirë dhe pa rrudha, që përdoret për faqe këpucësh, për doreza, për veshje mobilie etj. Boksi viçi. Çizme (këpucë) boksi.

BOKS III m. 1. E ndarë e vogël brenda në stallë, e ndërtuar zakonisht me thurje, ku mbahen të vegjlit e sapolindur të kafshëve shtëpiake për t'i veçuar nga nënat a për t'u kujdesur për ta. Boksi i viçave (i qengjave, i gicave). Boksi i zogjve. Bokse për pjellje. Shtie (fut, mbyll) në boksi.

2. Koçek, zakonisht me thurje, ku shtien pambuk, misër etj. Bokset e pambukut (e misrit).

BORIMË I f. Borë e imët e përzier me shi. Bie borimë. Zunë borimat.

BORIMË II f. Rrip toke në anë të arës, që mbetet pa punuar, pasi nuk e zë plugu kur kthehen pendët ose traktorët; anie.

BOTË I f. 1. Rruzulli i Tokës; dheu me gjithçka që është në të, sipërfaqja e Tokës dhe gjithë qeniet që jetojnë në të, dheu, toka. Lëmshi (rruzulli) i botës. Harta e botës. Kontinentet (shtetet) e botës. Lumenjtë (ujërat) e botës. Rreth botës. Në fund të botës. Në të katër anët e botës. Udhëtim nëpër botë. Sa të jetë bota përjetë të jetëve.

2. ~Ë, ~ËT. Trup qiellor; planet. Botë të panumërta. Botët e gjithësisë.

3. Tërësia e formave të materies, realiteti; tërësia e çdo gjëje që është pavarësisht nga ndërgjegjja. Bota objektive (materiale). Bota e jashtme. Njohja e botës. Uniteti i botës. Pasqyrimi i botës. Prejardhja e botës.

4. përmb. bised. Njerëzit e tjerë, gjindja që na rrethon, njerëzia; njerëzit e huaj,

me të cilët nuk kemi të bëjmë; një njeri tjetër, dikush. Gjithë bota. Si gjithë bota.

Në shtëpi të botës. Fjalët (gojë) e botës. U bë gazi i botës. Malli i botës mall i huaj.

Në dasmë të botës. Me fjalët e botës. Çuditet gjithë bota. E di (flet) e gjithë bota. U rrit në dyert e botës. Hyri botë hyri si i huaj në shtëpinë e një tjetri. Jam botë për të jam njeri i huaj e i panjohur për të, s'jam i tij. Mos hyr në pus me litarin e botës. fj. u. Mos shtjer kripë në gjellën e botës! fj. u. Pret thika në mish të botës. keq. Hanë bukën tonë e bëjnë davanë e botës (rrahin thekrën e botës). I nxjerr gështenjat (nga zjarri) me duart e botës. Nuk shikon traun e tij, po shikon qimen e botës. E pafsha nëpër dyert e botës! mallk.

5. edhe ~Ë, ~ËT. Shoqëria njerëzore e një vendi ose e disa vendeve, që është organizuar sipas një rendi të caktuar dhe që dallohet nga tipare historike e kulturore të veçanta; mënyra e jetesës dhe e organizimit shoqëror në një vend, në një grup vendesh ose në një periudhë historike. Bota e re. Bota e vjetër.

Bota shqiptare. Bota antike. Bota ilire (greko-romake, arabe). Bota socialiste.

Bota kapitaliste (feudale). Bota perëndimore. Bota e Lindjes. Bota përparimtare. Bota e jashtme vendet e tjera, vendet e huaja. Njollat e botës së vjetër. Lufta ndërmjet dy botëve.

6. Tërësia e qenieve të gjalla, që kanë veçori të përbashkëta të zhvillimit e të jetesës; tërësia e sendeve ose e dukurive që na rrethojnë; fushë veçantë e dukurive a e sendeve të realitetit objektiv. Bota e gjallë. Bota bimore. Bota organike (joorganike). Bota njerëzore. Bota shtazore (e kafshëve). Bota e pyllit. Bota e ngjyrave (e tingujve). Bota e yjeve. Në botën e përrallave.

7. Fushë e veçantë e veprimtarisë së njerëzve, sfera e punës së njeriut; rreth njerëzish, që merren me një veprimtari

të njëlojtë a që kanë interesa të përbashkëta, që i përkasin një mjedisi etj. Bota shkencore (letrare, artistike). Bota financiare. Bota fshatare. Bota e fëmijëve. Bota e shkrimtarëve (e artistëve). Në botën e shkencës dhe të teknikës.

8. Tërësia e dukurive të jetës shpirtërore e psikike të njeriut (perceptimet, ndjenjat, mendimet etj.), tërësia e ndjenjave dhe e mendimeve të njeriut; një rreth shfaqjesh psikike, që lidhen me moshën, me veprimtarinë mendore etj., rrethi i interesave të njeriut. Bota shpirtërore e njeriut. Bota vetjake (e brendshme). Botë e vogël (e mbyllur, subjektive).

9. Jeta në Tokë, jeta e vërtetë objektive; jeta në tokë dhe jeta e pëртеjme në kundërvënje njëra me tjetrën, sipas paragjykimëve fetare e pikëpamjeve idealiste. Kjo botë. Bota jonë. Bota tjetër (e pëртеjme, e pëртеjvarrit). Doli në botë lindi (për fëmijën). E la këtë botë vdiq. Shkoi (vajti) në atë botë (në botën tjetër) vdiq. E dërgoi në botën tjetër. përçm. e vrau, e mbyti.

10. euf. Sëmundja e tokës, epilepsia. E kapi bota.

* I biri (burri) i botës përçm. një burrë a një djalë çfarëdo, një burrë a një djalë i panjohur; tjetri, dikush. E bija (gruaja) e botës përçm. një grua a një vajzë çfarëdo, një grua a një vajzë e panjohur; tjetra, dikush. M'u errësua bota (vendi) shih tek ERRËSOHEM. E dërgoi prapa botës (prapa diellit) dikë shih te DIELL,~I. Është jashtë botës keq. s'merr vesh nga bota; sillet ndryshe nga të gjithë e jo ashtu si duhet. Është prapa botës (prapa dynjasë)

a) është i paditur, ka mbetur prapa, nuk është i zhvilluar me kohën;

b) nuk di se ç'bëhet, nuk merr vesh të rejtat. Mori botën (dynjanë) shih te MARR. Mori botën (dheun) ndër (në) sy shih te MARR. Në sy të botës (të dynjasë) para të tjerëve, haptas, botërisht. Sa për sy (sa për faqe) të botës shih te SY,~RI. I shtiu botën i kalli tmerrin, i

shtiu frikën. U bë përrallë e botës dikush shih te PËRRALL/Ë,~A. S'është në këtë botë (në këtë dynja) s'merr vesh çfarë po bëhet. Ka parë botë (dynja) me sy shih te SHOH. Që kur bota është botë prej kohësh shumë të lashta. Edhe sikur bota (dynjaja) të përmbysset! çfarëdo që të ndodhë, edhe e keqja më e madhe po të ndodhë, në asnjë mënyrë, kurrsesi. Bota është e rrumbullakët fj.u. shih te RRUMBULLAKËT (i,e). Miell nga thesi i botës (i huaj) iron. shih te MIELL,~I. Kali i botës të lë në udhë fj. u. gjëja e huaj s'të mbaron punë. S'merret bota në krahë (në kurriz) fj.u. nuk është e mundur të bëhen a të mbarohen të gjitha punët menjëherë, punët duhen bërë me radhë sipas kushteve e mundësive. Pula e botës duket më e majme fj.u. iron. shih te PUL/Ë,~A.

BOTË II f. Një lloj deltime me ngjyrë të përhime në të bardhë, që përdoret në disa krahina për të larë kokën ose rrobat; lloj deltime që përdoret për të bërë enë, për të lyer muret etj. Botë e bardhë (e kuqe). Enë (prej) bote.

* Hëngri (kafshoi) botë (dhe) përçm. vdiq.

BRENGË I f. Gjendje shpirtërore e shqetësuar dhe e rëndë, trishtim i thellë nga malli për dikë, nga vuajtjet etj.; vuajtje e rëndë shpirtërore, hidhërim. Jetë me brenga. Pa halle e pa brenga. Ka (e mundon) një brengë. Larg brengave e mundimeve. Brenga e shkuar, brenga e harruar. fj. u.

* E kam brengë më mundon vazhdimisht përbrenda, e kam gozhdë në zemër. Më mbeti brengë diçka më mbeti merak; më mbeti peng.

BRENGË II f. 1. mjek., veter. Sëmundje e grykës, që shfaqet me ënjtje të saj, fyti i keq, difteria.

2. Mëllë, bullungë që u del njerëzve e kafshëve dhe shenja që lë në trupin e tyre; gjurma, shenja e një plaje; gjurmë që mbetet si gungë në trup të bimëve, pasi

është mbyllur një prerje, një gërvishtje etj.

* **BRENGË THIU** bot. Bimë barishtore me degë të gjata e të shtrira përtokë, me gjethe të imëta e të mprehta, që del e rritet zakonisht nëpër pyje.

BRERIMË I f. 1. Shi që bie me rrëmbim, me pika të mëdha e të dendura, shi i madh. Bie brerimë.

2. Zhurmë e njëjtë dhe e vijueshme e pikave të shiut kur bien në çati, në tokë etj.; zhurmë tjetër e ngjashme me këtë. Brerima e shiut.

3. Të ftohtë i hidhur me shi e me erë, të ftohtë që të pret, thëllim. Brerima e dimrit.

BRERIMË II f. Shkarëzimë.

BRETK I m. zool. Mashkulli i bretkosës. Bretk moçali.

* Lule bretku bot. zhabinë.

BRETK II m. vet. nj. anat. shih KRYQE,~T. Më ra bretku u sëmura nga kryqet, më ranë kryqet nga një peshë e rëndë. Ngre bretkun fërkoj e ngre kryqet e sëmura.

* I ra bretku (në punë) u lodh shumë, u këput nga një punë e rëndë dhe e gjatë. I kalli bretkun thjeshtligj. e la pas dore, s'çau më kokën për të, e braktisi. Ç'bretkun ke? thjeshtligj. ç'ke?; ç'dreqin ke?

BROKË I f. 1. Enë druri e rrumbullakët, që përdoret si masë drithi dhe që nxë rreth njëzet e pesë kilogramë. Një brokë misër (grurë). Lëmi hodhi tridhjetë broka.

2. Enë prej balte, prej qelqi, prej porcelani etj. në trajta të ndryshme, me grykë të gjerë e me një vesh, që shërben për të mbajtur ujë, verë etj. Brokë balte (qelqi, porcelani). Brokë uji. Pi me brokë.

BROKË II f. 1. Xhungë, bullungë. Lis me broka.

2. Larë, pullë. Dhi (lopë) me broka.

BUBË I f. zool. 1. Vemje e rritur, para se të shndërrohet në flutur ose në krimb, zakonisht e mbuluar me push, krimbalesh, krimb mëndafshi.

2. Rre, glistër. Bar bubash. Ka buba. Ngjyrë bube ngjyrë e verdheme.
3. Rrëshqanor që të ha (gjarpër, zhapi etj.).
4. Morr i vogël.
5. krahin. Pushi i një rrobe të leshtë. Buba e shajakut (e velenxës).
- BUBË** II f. mit. 1. Qenie fantastike, që, sipas paragykimeve, përfytyrohej si përbindësh a si gjarpër i madh, me të cilin trembnin zakonisht fëmijët e vegjël; gogol, vovë. E fryftë buba! mallk.
2. Dordolec.
- * U bë bubë u bë tmerri i të tjerëve, u bë gogol për dikë. Ia bëri bubë një punë ia bëri të tmerrshme, ia bëri gogol.
- BUBURIZË** I f. 1. Kokrrizë gjalpi që del përsipër, kur rrahim qumështin në tundës.
2. Buburiskë.
- BUBURIZË** II f. zool. 1. Mollëkuqe.
2. Morr i vogël bimësh e pemësh, zakonisht i gjelbër a me pika.
- BUÇ** I m. krahin. Xhungë, bullungë. Buçi i lisit. Buçi i gishtit. Iu bë një buç.
- * Vë buç nxjerr bark, fryhet më një anë.
- BUÇ** II m. zool. krahin. Gjarpër, nepërkë.
- * Bar buçi bot. shih te BAR,~I I.
- BUKATOR** I m. Punëtori që fut duajt e grurit në makinën
- BUKATOR** II m. Pjatë a enë e thellë, që nxë miell sa për të bërë një bukë.
- BUKËL** I f. zool. Kafshë e vogël mishngrënëse e familjes së kunadhes, me trup të hollë e të shkathët, me qime të murrme pak si të kuqërreme sipër e të bardha në bark; nuselalë, bishtafurkë. Lëkurë bukle.
- * U ka hyrë bukla u ka ardhur njeriu që duhej dhe i ka kapur një e nga një në faj, ua ka zbuluar fajet.
- BUKËL** II f. Tufë e trashë flokësh, e dredhur si kaçurrel.
- BULMETORE** I f. 1. Dyqan bulmeti. Bulmetorja e lagjes.
2. vjet. Punishte për përpunimin e qumështit, punishte bulmeti.
- BULMETORE** II f. Fem. e BULMETOR,~I.
- BUNGË** II f. 1. shih XHUNG/Ë,~A. Bungë druri (ulliri). Bungat e qafës. Dru me bunga.
2. fig. Lëmsh, komb, nyje që të bëhet në fyt a në zemër nga hidhërimi, nga vuarjtjet etj. Ka (iu bë) një bungë. M'u mblodh bungë.
- BUQICË** I f. Dry. I vuri buqicën. Mbyll me buqicë.
- BUQICË** II f. zool. Zog i vogël sa një trumcak, me ngjyrë të blertë si në të hirtë, që e ndërton çerdhen si të dallëndyshes nëpër guva e shpella.
- BURI** I f. shih BORI,~A.
- BURI** II f. Sasi e madhe, shumicë, mori, mbushullim. Buri pemësh. Buri kafshësh. Ka me buri.
- BURI** III f. Bucelë uji. Buri druri.
- BURMË** I f. 1. Vidhë e vogël. Koka e burmës. Mbërthej me burmë.
2. shih BURGJI,~A 2. Burma e sahatit.
- * I janë liruar (i kanë luajtur) burmat (vidhat, burgjitë) dikujt shih te VIDH/Ë,~A. Ia di (ia njoh) burmat (vidhat) dikujt ia gjej pikën ku mund të kapem, ia gjej vendin dikujt ku duhet të kapem për të zbërthyer diçka etj. Ia gjeti burmat (vidhat, burgjitë) shih te VIDH/Ë,~A.
- BURMË** II f. Fik i rreshkur, rrekë. Një varg me burma. Është bërë burmë.
- BURMË** III f. 1. Gropëz në mjekër a në faqe, qukë. Burmat e faqeve. Burma e mjekrës. Burmat e fëmijërisë. I bëhen burma kur qesh.
2. Gropëz a vrimë e vogël, që mban diçka (si bubëza e pushkës, kupëza e lules etj.). Burma e pushkës.

- BURSË** I f. Shumë e caktuar të hollash, që shteti ose një kooperativë i jep çdo muaj një nxënësi a një student për të kryer studimet në një shkollë. Burse e plotë. Gjysmë burse. Student (nxënës) me burse. Me bursën e kooperativës. Marr bursë. I dhanë bursë.
- BURSË** II f. 1. Institucion financiar e tregtar në vendet kapitaliste, ku kapitalistët ndjekin kursin e monedhave të arit, të aksioneve e të letrave të tjera me vlerë, luajnë me to dhe bëjnë marrëveshje financiare e tregtare për të nxjerrë fitime në kurriz të masave punonjëse dhe të njëri-tjetrit; ndërtesa e këtij institucioni. Bursa financiare. Bursa tregtare. Bursa e mallrave. Veprimet e bursës. Kursi i bursës. Ulja (rënia) e vlerave në bursë. Buletini i bursës. Luan në bursë.
2. Institucion ndërmjetësues në vendet kapitaliste, që shërben për t'u gjetur krahë pune sipërmarrësve; ndërtesa e këtij institucioni. Bursa e punës.
- BURSIST** I m. Nxënës a student që ndjek studimet me burse.
- BURSIST** II m. Kapitalist që luan në bursë me kursin e monedhave të arit, të aksioneve e të letrave të tjera me vlerë dhe që bën marrëveshje tregtare e financiare për të nxjerrë fitime në kurriz të masave punonjëse e të kapitalistëve të tjerë.
- BURTH** I m. bot. Bimë barishtore, me kërcell të shkurtër, me gjethe në trajtë zemre, me lule të merme ngjyrë trëndafili në të bardhë, që çelin në korrik; ciklamin i egër.
- BURTH** II m. veter. Sëmundje e kafshëve njëthundrake, që shfaqet në qiellzën e gojës me flluska të mbushura me gjak. I ra burthi. U sëmur nga burthi.
- BUSH** I m. bot. Shkurre me shumë degë ose dru deri tetë metra i lartë, me gjethe vezake jorënëse, me lule të vogla në tufë, që e ka lëndën të verdhë, të fortë e me palcë dhe që përdoret për të bërë orendi, vegla pune, çibukë, lodra etj. Bush i egër. Çibukë (lugë, fyell) bushi.
- BUSH** II m. mit. Qenie e përfytyruar si kafshë, e cila, sipas besimeve të kota, jetonte nëpër kënetat dhe ndillte shi duke ulëritur. Si deshi bushi, bëri koha. fj.u.
- BUT** I m. Vozë e madhe druri, që shërben për të mbajtur verë, djathë, turshi etj. Butet e verës (e vajit). Dy bute djathë.
- * Prish bute e bën kënaçe prish një punë të rëndësishme ose një gjë të mirë për të bërë diçka tjetër më të vogël a pa ndonjë vlerë të madhe; prish bucela e bën kënaçe.
- BUT** II m. 1. anat. Pjesa e butë në çaçkën e kokës te fëmijët e porsalindur; çaçka e kokës, maja e kokës. Buti i kokës. I ra në but.
2. Tul nga kofsha e bagëtisë së therur. But derri (viçi).
- BUXHAK** I m. 1. Cepi i dhomës; qoshja pranë oxhakut të shtëpisë; vatra; oxhaku me gjithë vatër. Buxhaku i dhomës. Buxhaku i vatrës. Rri në buxhak.
2. Shesh i vogël në mes të pyllit, lirishtë.
- BUXHAK** II m. bot. Bimë barishtore njëvjeçare, e ngjashme me grashinën, me kërcell të gjatë e të përkulshëm, me gjethe çift e me lule të kuqe, që lëshon bish-taja me shumë fara të zeza e të rrumbullakëta dhe që mbillet si hasëll për ushqim të kafshëve. Buxhak hasëll. Farë (bish-tajë) buxhaku. Kullot në buxhak (lopët). Ushqen me buxhak.
- BUZËZ** I f. veter. Sëmundje e kafshëve, sidomos e bagëtisë së imët, që shfaqet me disa puçrra në buzë; puçrrat që dalin në buzë nga kjo sëmundje. I ka rënë buzëza. I kanë dalë buzëza.
- BUZËZ** II f. Rrjetë e vogël prej litari, që u vihet qeve në gojë gjatë punës që të mos bëjnë dëme; hundëz.
- BUZHELË** I f. Flluskë që del zakonisht në buzë nga ethet ose nga djegjet. Iu bënë buzhela.
- BUZHELË** II f. Turjelë e madhe për të hapur vrima në dru, e cila rrotullohet me të dyja duart. Shpoj me buzhelë.

CA I pakuf. bised. 1. Një sasi e papërcaktuar, jo e madhe, më shumë se dy-tre, por jo shumë (njerëz, kafshë, sende etj.), disa. Ca njerëz. Ca pëllumba. Ca fiq. Në ca vende. Para ca ditësh. Ca vjet më parë. Pas ca muajsh. Aty e ca muaj të shkuar.

2. Një pjesa, jo të gjithë, disa nga një shumicë; një pjesë nga një lëndë; një sasi, pak. Ca bukë (ujë). Ca mish. Ca drithë. Ca kohë. Ca ushtarë luanin, ca këndonin.

3. Disa njerëz, disa kafshë ose disa sende. Ca niseshin, ca ktheheshin.

Cave u pëlqen më shumë dimri se vera. Ca të nënës, ca të njerëzës.

4. përd. pj. Përdoret përpara emrit të një frymori ose të një sendi, kur folësi shpreh një farë habie, admirimi a përçmimi ose kur atij i duket se dikush a diçka ngjan me një tjetër. Kishte ca dhëmbë të bardhë si rruaza. Atje tej u dukën ca si njerëz.

* Ca e ca njerëz disa njerëz.

CA II ndajf. 1. Në një farë sasive ose shkalle, jo aq pak; një kohë jo shumë të gjatë; diçka, pak. Edhe ca. Ca e vështirë. Ca i madh. Ca i vogël. Ca si tepër. Fjeti ca. U lodhëm ca. Hëngri ca. Punoi (pushoi) ca. Rron (mban, qëndron) edhe ca. Priti ca. Zbutet ca.

Eja ca. Pas ca.

2. Edhe pak, akoma (me mbiemra e ndajfolje të shkallës krahasore). Ca më i ri (më i madh, më i vogël, më i gjatë, më i lartë, më i fortë). Ca më mirë (më shumë, më tepër). Ca më tutje (më larg, më tej, më thellë). Ca më vonë (më pas).

3. Në një farë shkalle, pjesërisht, pak (përdoret në krye të një fjalie të varur shkakore ose të një plotësi shkak, për të theksuar shkakun, i cili sjell një pasojë). Ca nga puna, ca nga vapa filluan t'i rridhnin djersët.

* Ca nga ca

- a) pak nga pak; dalëngadalë;
- b) pjesë-pjesë, pak e nga pak. ... e ca diçka më tepër, edhe pak mbi atë sasi,

edhe disa të tjerë përveç atyre (pas një numërori). Erdhën njëqind e ca veta. Ishte pesëdhjetë e ca vjeç.

CAPË I f. shih ÇAPË

CAPË II f. Shtresë e fortë e tokës nën shtresën e butë që punohet; taban. I qiti capën tokës.

CAPINË I f. 1. Vegël prej metali, me majë hekuri të kthyer pak e me bisht të gjatë, që përdoret për të tërhequr rrëshqanë dhe për të rrokullisur trupat e drurëve. I nguli capinën trungut të pishës.

2. tek. Mashë e madhe për të kapur dhe për të lëvizur pjesë metalike të nxehta.

CEKË I f. shih CEKËTIN/Ë, ~A. Cekë lumi. Cekë rëre. Anë e cekë anakënd, vend e trevë.

Ka ceka (lumi, deti). Gjej (kaloj) cekën. Dal në cekë. Ngeci në cekë. Nxjerr (lundrën) në cekë.

CEKË II f. Pjesa më e mirë e diçkaje, pjesa me e zgjedhur, balli; maja. Ceka e duhanit. Ceka e tokës. Ceka e miellit. Ceka e leshit. Ceka e dhenve. Cekë gjelle. Ceka e qumështit ajka.

CEKË III f. Qit cekën: vendos të bëj diçka, ia vë vetes si qëllim të bëj diçka, kam ndër-mend të bëj diçka.

CEKË IV f. Loja cekash, loja «ta lashë».

CEKOJ I kal. 1. shih CEK.

2. jokal. Ndash në fundin e detit, të liqenit ose të lumit, prek në vend të cekët; zë në tokë. Cekon në fund. Cekon në dhe (në tokë). Cekoi lundra.

CEKOJ II kal. 1. E bëj të zërë cekët, të mos hyjë thellë në tokë (për parmendën).

2. det. Heq (nga barka) ujin ose peshkun, zbraz (barkën). Cekoj ujin nga barka. Cekoj peshkun nga lundra.

CEP I m. 1. Pjesa e fundit e këndit të një sendi, maja e këndit ose vendi ku bashkohen dy vijat a dy faqet e brendshme të një sendi; skaj, kënd; qoshe; pjesa e zgjatur dhe e mprehtë e diçkaje, maja;

pjesë e ngushtë, rrip i ngushtë në skaj të një sendi. Cep i ngushtë. Capi i tryezës. Capi i dhomës. Cepat e shamisë. Capi i jorganit. Capi i jakës. Cepat e shalilit. Capi i rrugës. Capi i arës (i oborrit). Capi i syrit. Cepat e mustaqeve. Cepat e gojës (e buzëve). Yll me pesë cepa. Gur me cepa. Ulem në cep. Rri në një cep. Vë në cep. Lidh cepat. Po më shtrove cepin e gunës, të shtroj gunën të tërë. fj.u.

2. Vend i largët ose i mënjanuar dhe jo shumë i rrahur. Cep i largët. Cep kufitar. Capi më verior (më jugor). Në një cep të atdheut. Në cep të fshatit. Në çdo cep të botës.

3. fig. Pjesë anësore e diçkaje, skaj, skutë. Në një cep të mendjes. Në një cep të zemrës.

4. gjeom. Këndi i jashtëm i një figure gjeometrike.

* Cep më cep në çdo anë, në çdo kënd, kudo; nga një anë në tjetrën, nga një skaj në tjetrin. I bën cepa dikujt përpiket t'ia hedhë tjetrit, i nxjerr bishta, e mashtron.

I tregoi cepin dikujt i tregoi vendin. Flet me cep flet me thumba, i hedh spica tjetrit. E la në një cep e la mënjanë, e braktisi, hoqi dorë prej diçkaje. E mori me cep e keqkuptoi, e mori për së mbrapshti fjalën; e mori me të përpjekur, nuk e mirëpriti diçka. E ka marrë për cep dikë e ka marrë inat sa nuk do t'ia shohë sytë. Ma zuri cepi i veshit mora vesh pak, ma zuri veshi diku, dëgjova. E ka kokën me cepa (me çipa) është shumë kokëfortë, nuk gdhendet kollaj, është kokëshkëmb.

CEP II m. 1. Vesh i vogël rrushi, bistak i vogël. Këput një cep.

2. Lloj rrushi i bardhë, që bën bistakë plot me kokrra të ngjeshura e me majë.

CËRIT I kal. 1. Nxeh a djeg vajin, gjalpin etj. ose tret dhjamin në tigan; skuq diçka në tigan. Cërit vajin. Cërit gjalpin.

2. jokal. vet. veta III. shih **CËRCËRET**. Cërit tigani.

CËRIT II kal. 1. Thumbuj; shpoj, nguc. Cërit mushkën (gomarin).

2. fig. I shkaktuj një dhembje therëse; e pikëlloj, e përvëloj, e djeg. I cërit zemrën.

3. jokal. vet. veta III fig. Me bën të ndiej një dhembje therëse, më ngjall një ndjenjë të mprehtë shqetësimi e trishtimi. I cërit zemra. Me cërit në zemër (në shpirt).

CIMË I f. Litar i trashë prej liri ose prej teli, me të cilin lidhin anijen në breg; litar. Shkallë prej cime. Lidh (hedh, mbledh) cimën. Lidh me cima. Tërheq cimat.

CIMË II f. bot. Tufë lulesh të një bime, e cila përbëhet nga një lule e parë dhe nga disa lule të tjera rrotull saj, që dalin më vonë nga e njëjta nyjë.

CINGËRIMË I f. 1. Të ftohtë i madh e i thatë, acar; ngrica e dimrit. Cingërimë e madhe (e hidhur). Cingërima e dimrit. Ditë me cingërimë. Në mes të cingërimës.

2. vet. Dridhje e trupit nga të ftohtët, mornica. Me shkojnë cingërima.

CINGËRIMË II f. 1. Zë i hollë, i zgjatur dhe si i çjerrë; të qarët e një kafshe, kuitje, pingërimë. Cingërima e qenit. Cingërima e gjinkallave.

2. Zhurmë e lehtë, e hollë që bëjnë sendet kur përplasen pak, tringëllimë.

3. Tingull i hollë e i zgjatur, që na ushton në veshë, kumbim që ndiejmë në veshë.

CINGËROJ I jokal. Kam shumë të ftohtë, mërdhij shumë, ngrij së ftohti.

CINGËROJ II jokal. 1. Nxjerr një zë të hollë, të zgjatur dhe si të çjerrë; kuis, pingëroj (për kafshët e insektet); qan me zë të hollë e vajtues, nxjerr një zë të hollë e të zgjatur (zakonisht për fëmijët e vegjël). Cingëron qeni. Cingërojnë zogjtë. Cingëron gjarpri. Cingërojnë minjtë. Cingëron fëmija.

2. fig. Ankohe për diçka, qahem.

3. Ndiej një tingull të hollë e të zgjatur në vesh, më ushton, më kumbon.

- CIPULL** I m. etnogr. Vel i hollë që i hidhej nuses në kokë; nape.
- CIPULL** II m. Fik që bën kokrra të mëdha e në ngjyrë të kuqërreme, të cilave, kur piqen, u pëlçet lëkura.
- CITOS** I kal. Mbërthej me gjilpërë, zë, kap; ngul (një gjilpërë).
- CITOS** II kal. 1. Mbush me të rrasur, e zë mirë me të ngjeshur; fut e ngjesh; mbush plot sa nuk nxë më. Citos thesin. Citos vrimat. Citos gardhin.
2. Mbështjell mirë me rroba, ia ngjesh mirë anash rrobat e shtratit.
- CITOSEM** I vetv. 1. Mbërthehem me gjilpërë, kap diçka në trupin tim me gjilpërë.
2. Pës. e CITOS I.
- CITOSEM** II vetv. 1. Mbushem plot sa nuk nxë më.
2. Mbështillem mirë e mirë, mbulohem mirë me rrobat e shtratit.
- CJAP** I EGËR zool. Kafshë përtypëse e ngjashme me cjapin, me brirë të gjatë që rron në male të larta e të thepisura.
- CULE** I f. kryes. 1. Shtresat e mbulesat për të fjetur. Culet e foshnjës shpërgënjtë. Bie (futet) në cule. Shtroj (ngre) culet. Marr culet në krahë.
2. Rroba të vjetra, zhele. Vishej me cule.
- CULE** II f. shih CYL/E, ~JA.
- CULLOHEM** I vetv. krahin. Bëhem si fëmijë.
- CULLOHEM** II vetv. krahin. Më fryhet barku.
- CUMËR** I m. 1. Copë e shkurtër trangu, që shërben për t'u ulur në të ose për të mbështetur diçka mbi të. Pres një cumër. Rri në cumër.
2. krahin. Bucelë.
- CUMËR** II m. zool. Lloj qefulli me trup bosh-tor e të zhdërvjellët, qefulli i verës, gush-tak.
- CUMRAK** I m. 1. Cung i vogël, cumër i vogël. Ulem në një cumrak. Pres mishin në cumrak.
2. shih CUNG, ~U 3. I mbetën krahët cumrakë.
3. fig. Njeri shumë i shkurtër; burrac; fëmijë i vogël me shtat të parritur ende.
- CUMRAK** II m. zool. Cumër i vogël
- ÇAFËR** I m. 1. zool. Peshk pendëkuq i ujërave të ëmbla, i gjatë një pëllëmbë, me bark të gjerë e me shumë hala.
2. fig. Fëmijë i shkathët e i mprehtë. E ka djalin çafër.
- ÇAFËR** II m. bot. Lloj gruri me kokrra të mëdha e të rrumbullakëta.
- ÇAFKË** I f. 1. zool. Shpend uji, që ka qafë të gjatë e këmbë të gjata, sqep të hollë dhe një tufë puplash të zeza në krye; gatë. Çafka e bardhë. Çafka e kuqe. Çafka e përhime. Çafkë deti.
2. fig. Grua e dobët dhe e hollë.
- ÇAFKË** II f. 1. Filxhan ose gotë me vegjë për të pirë. Çafkë uji. Çafkë me raki (me qumësht). Mbush një çafkë. Pi një çafkë.
2. Maja e kokës, buti i kresë. Çafka e kokës. I ra në çafkë. I çau çafkën. Po me luan çafka e kokës po më luan mendja. Mblidhe çafkën! mblidhe mendjen!
3. Tufë pendësh në majë të kokës së pulave ose të disa zogjve; kaçul. Çafka e këndesit lafsha e këndesit. Pulë me çafkë. Ka një çafkë në kokë. Mban çafkën përpjetë.
4. Lëvozhgë, gujavë. Çafka e vezës. Çafka e lajthisë.
- ÇAKË** I f. Vendi ku ndahet uji i një vije që të kalojë në arë për ta ujitur; presë. Çakat e arës. Hap (mbyll) çakën. I vë një plis çakës. Kthej ujin te çaka.
- ÇAKË** II f. Këmborë e vogël që u varet lopëve e qeve. Tingëllima e çakave. I vuri një çakë. I ra çaka.

- ÇALË** I f. veter. Sëmundje ngjitëse e bagëtive, që i bën t'u ënjten e t'u qelbëzohen indet dhe të çalojnë. Iu ngjit çala. U ra çala dhive. I zuri çala kuajt.
- ÇALË** II f. Rrudhë që ngelet në një rrobë, çapë. Shami me çala. Rrobë me çala. U bë me çala.
- ÇALLË** I f. 1. Kokërr e papjekur e disa pemëve. Çalla fiku (dardhë, kumbulle). I hahen edhe çallat.
2. përd. mb. I papjekur, i pabërë (për kokrrat e disa pemëve). Fik (dardhë, bajame) çallë. I ka çalla kokrrat.
- ÇALLË** II f. shih ÇALLAT/Ë, ~A. Çallë e vogël. Çallë në dru (në shkëmb). E bëri me çalla.
- ÇAM** I m. Banor vendës i krahinës së Çamërisë ose ai që e ka prejardhjen nga Çamëria. Fshatrat e çamëve. E folmja e çamëve.
- ÇAM** II m. bot. shih BREDH, ~I. Çam i bardhë. Dru çami. Pyll çami.
- ÇAP** I m. 1. Një e hapur e këmbës gjatë ecjes; hap; tingulli që del kur ecim duke shkelur me këmbë. Çap i shkurtër (i gjatë). Me çapa të shpejtë (të mëdhenj). Me çap te lehtë (të rëndë). Me çapa të ngadaltë (të nxituar). Dy çapa i gjerë. Pak çapa me tej. Dy çapa larg fare afër. Bëj disa çapa. Hedh një çap. Eci me çapa. Shpejtoj çapet. Nuk bëj çap (përpara) nuk lëviz fare nga vendi, nuk eci. E mbaj çapin diku ndaloj diku, nuk eci me tej.
2. fig. bised. Mënyra si veprojmë për të arritur diçka ose në një rast të caktuar; puna dhe përpjekjet për të arritur një qëllim a synim; hap. Çapi i parë. Bëj çapat e parë.
* Çap pas çapi
a) pa iu ndarë, këmba-këmbës, në çdo hap, vazhdimisht;
b) shkallë-shkallë, pak nga pak, hap pas hapi. Në çdo çap (hap) shih te HAP, ~I. S'bëj çap nuk arrij të bëj asgjë, nuk ia dal dot. I mat çapin dikujt shih te MAT.
- Kaq e ka çapin (hapin) kaq mundësi ka, kaq fuqi ka, kaq e ka frymën. Nuk më arrin çapi është jashtë mundësive të mia. Deri ku i arrin çapi brenda mundësive të tij, aq sa është i aftë për të bërë diçka. Nuk e lë të bëj çap e ndaloj në vend, nuk e lejoj të ecë përpara a të bëjë diçka.
Bëje (mate, lëshoje) vrapin sa ke çapin (hapin) fj. u. shih te VRAP, ~I 3.
- ÇAP** II m. Zagar, lingua. Çap qimezi (qimekuq). Çap gjahu. Çap për lepuj. Marr çapin për gjah. Leh si çap.
- ÇAP** I jokal. bised. 1. Shkoj diku, nisem për të vajtur në një vend (përdoret kryesisht në mënyrën urdhërore). Çap në shtëpi. Çap për ujë. Çap për gjah. Çap e merre (e shiko, e i thuaj...). Mos çap atje. Çap e jakë shpejt.
2. Çapitem. Mezi çapte. Nuk çapi dot më.
3. kal. Hap këmbën për të ecur. Çap këmbën.
* Bëj (shkoj, eci) çap e jakë shih te JAKË, ~NI.
- ÇAP** II kal. krahin. Përçap. Çap bukën. Çap një copë (një kokërr).
- ÇAPEM** I vetv. bised. 1. Shkoj diku, çap. Çapu deri te porta! Çapu përpara! Çapuni të shikoni!
2. Çapitem. Çapet si foshnjë. Mezi çapet. Sa ka nisur të çapet.
- ÇAPEM** II vetv. bised. Përtypem, përçapem.
- ÇAPË** I f. 1. Vegël bujqësore për të prashitur, që ka ten si sqepar në njërën anë, dy dhëmbë në anën tjetër dhe bisht prej druri. Prashit me çapë. I jap një çapë. Punoj me çapë.
2. Çapëza e hostenit. Çapa e hostenit. Krua me çapë.
- ÇAPË** II f. krahin. 1. Kafshatë. Çapë e madhe. Një çapë bukë. Ha një çapë bukë ha pak. Çapa e madhe të zë fytin. fj.u.
2. Zhubër që ngelet në një rrobë, rrudhë. Napë me çapa. Rrobë me çapa. Bëhet me çapa.

- ÇAPIT** I jokal. bised. 1. Eci me ngadalë ose rëndë, hedh hapat, hedh këmbët; shkoj ngadalë ose me vështirësi, çapitem. Çapit ngadalë. Çapit rëndë-rëndë. Mezi çapit. Çapit tutje. Çapit poshtë e lart. Çapiti drejt shtëpisë.
2. kal. Hap këmbën ngadalë ose me vështirësi për të ecur. Nuk i çapit dot këmbët.
- ÇAPIT** II kal. Shkriçeroj tokën ose thyej plisat me çapë, punoj me çapë. Çapit tokën. Çapit plisat. Çapit grurin (duhanin). Çapit lehtë (thellë). Çapit midis rresh-tave.
- ÇAPITJE** I f. bised. Ecje e ngadaltë ose e rëndë, hap i ngadaltë ose i rëndë.
- ÇAPITJE** II f. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve ÇAPIT II, ÇAPITET. Çapitja e parë. Çapitja e pambukut. I bëj çapitjen.
- ÇEK** I m. fin. Urdhërpagesë e shkruar sipas një modeli të caktuar, me të cilën dikush ka të drejtën të tërheqë nga banka ose nga arka një shumë të caktuar prej llogarisë së ndërmarrjes, të institucionit ose të personit që e ka lëshuar këtë dokument në emër të tij. Çek bankar. Çek postar. Çek i bardhë çek i paplotësuar. Çek i kufizuar. Çek llogarie. Çek udhëtimi. Titullari i çekut. Librezë (bllok) çekesh. Lëshoj (pres) një çek. Nënshkruaj çekun.
- ÇEK** II m. Banor vendës i Çekisë ose ai që e ka prejardhjen nga Çekia.
- ÇEK** III m. Ushqimi që merr me vete bariu për të ngrënë gjatë ditës. Mori çekun me vete.
- ÇELË** I f. Vija prej nga fillojnë disa lojëra të fëmijëve. Çela e dokrrës. Vrapoj te çela. Zë çelën.
- * I gjej çelën i gjej rastin e përshtatshëm, i gjej anën, i gjej fillin. I zë çelën e zë shumë ngushtë, e vë në gjendje të vështirë e pa rrugëdalje.
- ÇELË** II f. Pjesa e zgjedhur dhe më e mirë e diçkaje; ajka, lulja. Çela e grurit (e miellit). Çela e trimave. Çela e nuseve. I marr çelën e çelën.
- ÇELË** III kryes. Këpucë të vjetra të grisura, brashnja, shkarpa. Mbath ca çela. U bënë çela këpucët.
- ÇIK** I kal. 1. Prek lehtë; takoj, cek. Çik krahun. Çik flokët. E çiku në sup. Sa e çika me gisht.
E çiku padashur.
2. fig. Përmend ose trajtoj shkurt diçka, cek. Çik një çështje.
3. Ngacmoj lehtë me fjalë dikë. E çikën fëmijët.
4. jokal. Prek a takon lehtë në diçka. Çiku në tokë. Çiku në fund të detit.
- ÇIK** II kal. 1. Ndaj diçka në copa a në pjesë shumë të vogla, bëj çika-çika; grij. Çik bukën.
Çik mishin. E çik me thikë.
2. vet. veta III jokal. Pikon nga pak, rrjedh me pika të vogla, cirkon; gjerbon pak. Çik uji. Çik shtëpia. Nuk çik çatia.
- ÇIKË** I f. 1. Copë a pjesë e vogël, që këputet nga diçka ose që del kur thyhet, copëtohet a grihet diçka; grimë. Çika buke (mishi). Çika letre. Çika balte.
2. Një sasi ose një pjesë fare e vogël nga diçka, një pakicë, një grimë. Ha një çikë bukë. Piu një çikë ujë. Do edhe një çikë kripë. Mblodhi (mori) vetëm ca çika. Ia dha edhe ato çika që kishte. I tha ato çika që dinte.
3. Pjesë kohe shumë e vogël, kohë e shkurtër që zgjat shumë pak. Një çikë herë. Për një çikë. Pas një çikë. Prit një çikë.
4. krahin. Pikë e vogël uji që bie nga çatia; vendi në çati ku pikon shiu; buza e çatisë jashtë murit ku rrjedh uji i shiut; strehë; gjerbë. Çikat e shiut. Çikat e shtëpisë. Çika e mullirit. Pikojnë çikat. Zë çikat. Hyj (futem) nën çikë.
5. Pikë a pullë shumë e vogël me ngjyrë tjetër në një sipërfaqe, në trupin ose

në lëkurën e disa kafshëve dhe të disa njerëzve; njollë e vogël. Çika të zeza (të hirta). Çikat e fytyrës. Gjarpër me çika. I ka rrobat me çika. E bëj me çika e stërpik.

6. Çikëza e syrit; lulëz. Çika e syrit. I ka rënë çika.

7. krahin. Shkëndijë, xixë. Çika zjarri. Çikat e urorit. Lëshon çika.

8. zool. krahin. Xixëllonjë. Çikat e natës. Dolën çikat.

9. vet. krahin. Degë të vogla e copa të thata druri që përdoren për të ndezur zjarrin, shkarpa. Mbledh çika. Na sill ca çika. E ndez zjarrin me çika.

10. fig. Pjesa më e zgjedhur dhe më e mirë e diçkaje a e një grupi njerëzish, balli, lulja. Çika e trimërisë.

11. përd. mb. fig. Shumë i mirë, i zoti e trim, që i ka të rrallë shokët. Atë çikë vëlla.

Ai çikë djalë.

12. përd. mb. fig. mospërf. Përdoret pranë një emri për të treguar se një njeri a një send është i vogël, i parëndësishëm, pa ndonjë vlerë të madhe. Ajo çikë letërsie. Atë çikë grua që kishte.

13. përd. ndajf. Në copa a në pjesë shumë të vogla, çika-çika. E bëri çikë e copëtoi shumë, e griu imët.

* (Burrë, djalë, trim...) me çika trim e i zoti, që shquhet midis të tjerëve. Asnjë çikë aspak; fare. Për një çikë për pak, gati sa, për një fije, pothuaj. Çikën e pikën gjithçka, çdo gjë. Çikë e nga një çikë pak nga pak. Pa çikë e pa nishan pa lënë asnjë gjurmë, pa nam e pa nishan. Jep çikë dikush a diçka nis të dalë, zë e shfaqet. I doli çika diçkaje doli në shesh, u zbulua. E bëri copë e çikë (copë, thërrime, copë e kothere, copë e thërrime, copë e grime) shih te BËJ. I lëshojnë (i bëjnë, i nxjerrin) sytë çika (xixa, shkëndija) shih te SY,~RI.

ÇIKË II f. Vajzë, çupë. Çikë e vogël. Djem e çika. Çikat e malësisë. Ka tri çika.

ÇIKË III f. zool. Zog i vogël shtegtar që i ka puplat ngjyrë ulliri në pjesën e sipërme të trupit, të bardha në të verdhë në pjesën e poshtme.

* **ÇIKË E VOGËL** zool. Zog i vogël me kaçule të verdhë në majë të kokës, me pupla ngjyrë ulliri në pjesën e sipërme të trupit dhe me dy rripa të bardhë e të hollë në krahë.

ÇIKËZ I f. Pikë e vogël e bardhë që del në beben e syrit për shkak të një sëmundjeje; lulëz.

I ka rënë çikëza. Ia vret syrin çikëza.

ÇIKËZ II f. Mjet peshkimi i përbërë nga një rrjetë e vogël me dy shkopinj anash, që tërhiqet brenda në ujë nga dy veta dhe që përdoret zakonisht për të gjuajtur në vende të ngushta; mjet peshkimi, i përbërë nga një rrjetë katërkëndëshe e lidhur në cepa me dy kularë, që ulet në ujë e ngrihet me një dra të gjatë dhe që përdoret zakonisht për të gjuajtur në lumë. Shkopinjte e çikëzës. Druri i çikëzës.

ÇIKJE I f. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve ÇIK I, ÇIKEM. Çikja e krahut.

ÇIKJE II f. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve ÇIK II, ÇIKET. Çikja e mishit.

ÇILE I f. 1. zakon. Thinjë. Plak me çile. I kanë dale çilet.

2. Gunë me lesh dhie në ngjyrë të hirtë. Çilja e bariut. Heq çilen. Shtroj çilen.

ÇILE II f. Shkul penjsh. Çile peri. Një çile li (pambuk).

ÇIRAK I m. 1. hist. Djalë që punonte si ndihmës te një zejtar për disa vjet pa shpërbim për të fituar mjeshtërinë. Çiraku i armëtarit (i këpucarit). Hynin çirakë. E futi çirak.

2. vjet. Djalë i vogël që bënte punë ndihmëse për mjeshttrin a për të zotin e dyqanit.

Çiraku i dyqanit. Dërgonte çirakun për ujë.

3. fig. përb. Ai që u shërben verbërisht interesave të dikujt, shërbëtor.

Çirakët e imperializmit.

* E bëri (e qiti, e nxori) çirak dikë edhe iron. e ndihmoi shumë dikë, i bëri një shërbim të madh, e nxori në dritë. Doli çirak edhe iron. i kaloi vështirësitë që kishte pasur, doli në dritë.

ÇIRAK II m. 1. Kandil, bishtuk. Flaka e çirakut. Ndez (shuaj) çirakun. I hedh vaj çirakut.

2. Mbajtëse prej druri a prej metali ku vendosej kandili, qiriu ose ndonjë dritë tjetër; pishtar. Çiraku i kandilit. Çiraku s'i sheh këmbët e veta. fj.u.

3. vet. Tre gurë ose tri tulla që vihen si këmbje në vatër ose anës zjarrit. Çirakët e zjarrit. E vë kazanin mbi çirakë.

ÇKA I përem. 1. pyetës. Çfarë, ç'. Çka i tha? Çka deshi? Çka po thotë?

2. lidhor. Që, i cili. Atë çka është përparimtare. Atë çka dinë. Për atë çka u fol.

3. lidhor. Ai që..., ajo që... Çka është kryesorja. Për çka folëm. Për çka u tha këtu.

ÇKA II ndajf. bised. 1. As mirë as keq, njëfarësoj, disi, jo edhe aq keq (zakonisht në përgjigjen për një pyetje). - Si shkon me të? - Çka, mirë. - Si e ke djalin? - Çka, më mirë. - Si janë të lashtat? - Çka. - A ishin mirë? - Çka. - Si ia çon? - Çka.

2. përd. pj. S'ka gjë, nuk prish punë; njësoj është. Çka, e pranoj. Çka, çka, i vogël është ai.

ÇOJ I kal. 1. E marr me vete dhe e përcjell deri në një vend tjetër ose deri te dikush, shpie; e nis dikë që të shkojë deri në një vend për një qëllim, për të bërë një punë, për të mbaruar një porosi etj., dërgoj; kund. sjell. E çoi djalin në fshat. E çoi në shtëpi.

E çoi në punë (në luftë). Çoj në shkollë (në aksion). E çoi me shërbim. I çoi krushqit.

E çoi me lopë (me dhen). E çoj për dore. E çoj zvarrë.

2. Bart deri te një vend ose deri te dikush për ta lënë atje; nis me një njeri, me një

mjet ose me një mënyrë tjetër deri në një vend tjetër ose deri te dikush, dërgoj; kund. sjell, bie. I çoj librin (gazetën). I çoj një letër (një telegram); I çova ca plaçka.

Ia çoi drutë. I çoj kafen. I çoi të hajë e të pijë. I çoj me postë diçka. Ma ço me djalin.

Ia çoj në shtëpi (në shkollë, në punë). E çoj në vend. I çuan me anije (me tren).

3. Ia bëj të njohur diçka nëpërmjet një njeriu ose me letër, njoftoj nga larg; i shpreh nëpërmjet dikujt ose me letër urime, përshëndetje etj., i dërgoj nga larg.

I çoj fjalë (haber). I çoj zë për diçka. I çoj të fala (përshëndetje, urime).

4. E drejtoj diçka që të shkojë a të godasë në një vend ose në një shenjë, dërgoj.

E çoj në shenjë. Çoj topin në rrjetë. Çoj plumbin në tabelë. Çoj sytë (vështirimin) hedh sytë, shoh në një drejtim.

5. vet. veta III. Lë të kalojë nëpër të një drejtim të caktuar, shpie. Kanali e çon ujin shumë larg. Gypat e çojnë lëngun te kazanët. E çon rrymën elektrike deri në fshatrat më të largëta.

6. vet. veta. III. Të drejton në një vend të caktuar, të shpie. Rruga të çon në fshat.

Kjo udhë të çon në Shkodër. Ku të çon kjo kthesë? Të çon në veri (në jug).

7. fig. Udhëheq në një drejtim; ndihmoj që të zhvillohet, të përparojë, të ecë; shpie.

E çoj drejt fitores. E çon përpara revolucionin. E çoi në rrugë të drejtë. Përpiqet ta çojë prapa.

8. Bëj që të arrijë në një përfundim të mirë ose të keq, e shpie në një gjendje të caktuar; vet. veta III ka si rrjedhim a si pasojë; shpie. E çoi në litar (në greminë, në varr). E çoi në fitore (në shkatërrim të plotë). E çoi dëm diçka e prishi, e dëmtoi.

Këtu të çon kokëfortësia (mendjemadhësia, pakujdesia).

9. E shpie deri në një cak a në një shkallë; rrit a zmadhohj deri në një numër. E çoi numrin e golave në pesë. E çoj numrin e lopëve deri në dyqind. E çoi në kulm. E çoj deri në fund. E çoj më tej (më përpara).

10. vet. veta III. Më bën të shkoj diku, më detyron të vete, më shpie. Më çon puna.

Më çoi detyra. E çoi nevoja (halli).

11. Kaloj a shkoj kohën; kaloj jetën; jetoj në një mënyrë të caktuar; rroj; shpie. E çon shumë mirë në fshat. E çoi jetën në mërgim. Si ja çoni andej? Si ia çon me punë? Ka çuar jetë ka rrojtur mirë. Si ia çoni me fqinjët? Ia çoj mirë (keq).

12. vet. veta III. jokal. bised. Shkon edhe ca kohë, përdoret diçka edhe për një farë kohe; rron. E çojnë edhe ca muaj këto këpucë. Nuk më kanë çuar shumë (gjatë).

13. bised. E vazhdoj a e zgjat diçka për një farë kohe; jokal. zgjat a vazhdon për një kohë të caktuar. E çoi gjatë kuvendin (bisedën). E çuan gjatë luftën. Nuk e çon shumë kjo luftë. S'po e çojmë më tutje (më tej) nuk po e zgjatim më bisedën, po e lëmë me kaq.

14. bised. E gëlltit a e kapërcej në grykë një ushqim; e shkoj poshtë a e thith në mushkëri. S'e çoj dot më bukën. Mezi e çoj duhanin e fortë.

15. bised. Drejtoj a ngas një kafshë pune ose një mjet transporti a udhëtimi; nis.

Çoj qetë (kuajt). Çoj biçikletën. E çoj makinën (veturën): S'di ta çojë mirë!

* Çoj më andej (më tej) e shpie më përpara diçka, bëj që të arrijë në një cak më të përsosur. E çon batbat diçka shih te BATBAT. E çuan (e shpunë) dardhë! shih te DARDH/Ë,~A. E çoi (e dërgoi) në djall (në dreq) dikë a diçka thjeshtligj., keq. shih te DJALL,~I. E çoi (e shpuri) fjalën për dikë a për diçka shih te SHPIE. S'e çon (nuk e shpie) më gjatë shih te GJATË. E çoj (e shpie) mendjen diku a te dikush e sjell ndër mend diçka a dikë,

nis të mendoj për diçka a për dikë. E çoi poshtë dikë a diçka shih te POSHTË. E çoi (e nxori, e pruri) rruga (udha) shih te RRUG/Ë,~A. E çon trashë dikush shih tek TRASHË. E çoi në varr dikë shih te VARR,~I. E çoj (e shpie) në vend (një fjalë, një urdhër, një porosi etj.) shih te VEND,~I. E çoj (e marr, sjell)për veshi dikë shih te VESH,~I. Të çon (të shpie, të hedh) degë më degë shih te DEG/Ë,~A. E çofshin me katër veta! mallk. vdektë! Mos e çoftë kryet (kokën) shëndoshë! mallk. vdektë! Ku të çon (të shpie) mushka! shih te MUSHK/Ë,~A. Çon (shpie) ujë në mullirin e dikujt shih tek UJ/Ë,~I. Ta çon (ta shkon, ta lëshon, ta fut, ta kalon) ujin nën rrogoz (nën hasër, nën vete) shih te RROGOZ,~I. E çoi në vend të vetën shih te VEND, ~I. Çon një pelë e ha një thelë fj. u. shih te PEL/Ë,~A.

ÇOJ II kal. 1. Shkëput diçka nga toka ose nga dysHEMEJA dhe e mbaj pezull në duar, marr diçka nga vendi i vet dhe e mbaj në dorë ose e vë më lart, ngre; kund. ul.

Çoj thesin (barrën, valixhen). Çoj tezgën (vigun). Çoj dorezën e telefonit. E çoj peshë.

Çoj lart.

2. Drejtoj lart, zhvendos në drejtimin nga poshtë lart. Çoj dorën (gishtin). Çoj kokën.

Çoj grushtin. Çoj vetullat përpjetë.

3. Bëj që të ngrihet lart a më lart nga ç'është, ngre. Çon shumë pluhur (era).

Çoj degën e pemës.

4. E kaloj nga gjendja e shtrirë në qëndrimin pingul; bëj që të qëndrojë lart diçka që ishte e shtrirë, e varur dhe e kapur diku; ngre; kund. ul. Çoj rrasën. Çoj kapakun.

Çoj jakën e palltos (e xhaketës). Çoj perdet. Çoj velat e barkës.

5. Kthej në gjendjen e mëparshme më këmbë ose pingul diçka që ishte rrëzuar, përmbysur ose rrokullisur; bëj që të ngrihet në këmbë dikush që ishte ulur

a shtrirë, ngre. Çoj karriget (bankat, tryezat). Çoj gardhin. Çoj fëmijën e rrëzuar. E çoi plakun.

6. E bëj që të lëvizë a të ngrihet nga vendi, ngre. Çoj nga vendi (nga karrigia).

E çoj në mësim (në dërrasë të zezë) e thërres për t'u përgjigjur në mësim.

7. I prish gjumin dikujt; e ngre, zgjoj. Çoj nga krevati (nga shtrati). E çoj nga gjumi.

Çoje djalin! E çoi herët (vonë).

8. gjah. Nxjerr nga strofka a nga vendi ku ishte fshehur një kafshë a një shpend për të gjuajtur. Çoj rosat (shkurtat...). E çoi lepurin qeni.

9. E bëj diçka më të lartë nga sa ishte; ngre diçka. I çoj themelet mbi tokë. E çoj shtëpinë edhe një kat. Çojnë mullarë. I çojmë fitilat.

10. E bëj më të madh, i shtoj madhësinë, vlerën, masën a shkallën diçkaje; ngre (edhe fig.) Çoj çmimin. Çoj normat. Çoj rendimentin (prodhimin). E çoi moshën.

I çoj moralin.

11. E bëj të dëgjohet më shumë, e bëj më të lartë a më të fortë; forcoj. Çoj zërin.

Çoj radion.

12. fig. E bëj dikë që të marrë pjesë gjallërisht në një luftë të drejtë, në një aksion a në një veprimtari të rëndësishme shoqërore; frymëzoj për diçka, i jap zemër; ngre.

Çuan popullin. I çoi në luftë (në aksion).

13. bised. Heq diçka nga një vend dhe e shpie në një vend tjetër.

Çoj tryezën heq enët dhe ushqimet nga tryeza pas të ngrënit.

14. Bëj punimin e parë të tokës; lëroj, kthej. Çoj tokën (arën). Çoj ugarin.

15. fig. I ngjall a i shkaktoj diçka, zgjoj. Më çon mallin. I çon etjen. I çon vaj.

16. bised. Mbledh, grumbulloj. Çoj ushtri.

* E çoi (e ngriti, e nxori, e qiti) nga balta dikë shih te BALT/Ë,~A. Çon (ngre) dorë (dorën) kundër dikujt shih te NGRE. Çoi (ngriti) duart lart (përtpjetë) shih te NGRE. Çoj (ngre) gotën (dollinë, kupën, shëndetin) shih te NGRE. Një gur s'çon (s'bën) mur fj.u. shih te GUR,~I. Çon (ngre) hundën (përtpjetë) shih te HUND/Ë,~A. Nuk çon (nuk ngre) kandar (peshë) edhe poh. shih te KANDAR,~I. S'e çon (s'e ngre, s'e mban, s'e heq) kandari shih te KANDAR,~I. Çoj (ngre) kokë (krye) shih te NGRE.

Çon kokën (kokë) mëkëmbet, e merr veten nga ana ekonomike; përmirësohet, e merr veten pas një sëmundjeje të rëndë. S'e çon (s'e ngre) kokën nga diçka shih te NGRE. E çoi (e ngriti) në (më) këmbë shih te KËMB/Ë,~A. Më çon (më nxjerr) mallin e dikujt a të diçkaje shih te NXJERR. Çon (ngre) peshë dikë shih te PESHE.

Çon (ngre) peshë (mendjet, zemrat) shih te PESHË. E çoj (e ngre, e hipi) në qiell shih te QIELL,~I. Çoj (ngre, mbledh rrudh) supet shih te NGRE. Çon (ngre) veshët shih te VESH,~I. Çoj (ngre) zërin (në qiell) shih te NGRE. Ul e ço (ngre) shih tek UL.

I çoi (i ngriti, i bëri) këmbët bigë mospërf. shih te BIG/Ë,~A,. Nuk çon (nuk nxjerr, nuk qit) lepur nga shtrofulla shih te LEPUR,~I. I çoj peshë zemrën dikujt shih te PESHË.

ÇUARJE I f. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve ÇOJ I, ÇOHET.

ÇUARJE II f. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve ÇOJ II, ÇOHEM.

ÇUES I m. Ai që nis ose i jep një njeriu një send a diçka tjetër, për ta shpënë deri në një vend ose te dikush, dërgues. Çuesi i letrës.

ÇUES II m. 1. Ngrësi i mullirit me ujë, ulës i mullirit. Çuesi i mullirit (i gurit të sipërm). Çuesi i lugut të koshit.

2. gjah. Pjesëmarrës në gjah, që ngre ose nxjerr nga strofka a nga vendi ku

është fshehur një kafshë (duke e trembur me zë ose me një zhurmë) për ta qëlluar gjahtarët e tjerë. Çues i zoti. Gjah me çues.

DAC I EGËR zool. Rrëqebull.

DADO I f. 1. Grua që ushqen me gji fëmijën e dikujt tjetër, mëndeshë, tajë. E ka pasur dado.

2. vjet. Grua që e merrnin me pagesë familjet e pasura për t'u rritur fëmijët dhe për t'u përkujdesur për ta; shërbëtore. Dadoja e fëmijëve. Ishin rritur me dado.

3. Kafshë femër, e zgjedhur për të ushqyer me qumësht të vegjlit e një kafshe tjetër. Dado për viçat. U vunë dado qengjave.

4. Përd. mb. sipas kuptimit 3 të emrit. Lopë (dele, dosë) dado.

DADO II f. tek. Kundërvidhë. Shtrengo (liroj, vidhos, zhvidhos) dadon.

DAMË I f. Lojë me tridhjetë e dy gurë (gjashtëmbëdhjetë të bardhë e gjashtëmbëdhjetë të zinj), që luhet nga dy veta mbi një pllakë druri etj., të ndarë në gjashtëdhjetë e katër katrorë të barabartë, ku gurët mund të lëvizin vetëm në vijë të drejtë; pllaka prej druri etj. dhe gurët që shërbejnë për këtë lojë. Gurët e damës. Tabela e damës. Luajnë damë. Bleu një damë.

DAMË II f. 1. vjet. Grua e martuar, zonjë. Damë plakë. Damë shoqërimi.

2. Grua a vajzë që vallëzon me një kavalier. E ndërroi damën. Kërceu me të gjitha damat. Damat në fuqi!

3. shah. Mbretëresha në lojën e shahut. Dama e bardhë (e zezë). I mori damën. Ndërruan damat.

4. Një nga figurat kryesore në lojërat me letra që paraqet një grua; letra me këtë figurë; çupë. Damë kupë (spathi). Hodhi damën.

DATË I f. 1. Dita e muajit të një viti të caktuar sipas radhës në kalendar; shifra

që shënon këtë ditë. Data e sotme (e djeshme). Në datën 12.8.19.. Letër pa datë. I vë (shënoj) datën. Sa është data sot?

2. Koha a dita, sipas kalendarit, në të cilën ka ndodhur një ngjarje e caktuar; treguesi i një akti (dokumenti, letre etj.), që shënon kohën (shekullin, vitin, muajin, ditën) kur ky është shkruar a është botuar; afat. Datë e shënuar. Datë historike.

Datë jubilarë. Data e ardhjes (e largimit). Data e fillimit (e mbarimit). Data e nisjes

(e kthimit). Data e lindjes (e vdekjes). Data e dokumentit. Data e ngjarjes. Caktoj datën. Shtyj datën. Pa datë.

DATË II f. bised. 1. Frikë e madhe, tmerr, lemeri. I zuri (i hyri) data. I kalli (i futi, i dha) datën.

Ka marrë datën.

2. Krupë, neveri, ndot, të vështirë. Të ngjall (të shtie) datën.

DELMERE I f. Fem. e DELMER, ~I.

DELMERE II f. zool. Bishtatundës.

DËRRMOJ I kal. 1. E bëj diçka copa-copa të vogla, e bëj copë e grimë, e bëj thërrime, e thërrmoj. Dërrmoj bukën (djathin). E dërrmoi duhanin. Dërrmon plisat. Mos e dërrmo shumë! Dërrmoj grurin (misrin) në mokër.

2. bised. Shkoq misrin, grurin etj. Dërrmojnë misrin. E ka dërrmuar mirë grurin kali në lëmë.

3. Vras keq a plagos një pjesë të trupit, duke e përplasur diku etj.; e shemb, e copëtoj. E dërrmoi dorën (këmbën, kokën). I dërrmoi gishtat. Ia dërrmoi nofullat (hundët).

4. fig. I jap dikujt a diçkaje një goditje të fortë shkatërruese, e mund a e thyej keqas, e shpartalloj krejt; prish, shkatërrtoj. E dërrmuam armikun. Dërrmuam fashistët e tradhtarët. I dërrmoi kundërshtarët. E dërrmuam burokratizmin. Dërrmojmë të vjetrën (shfaqjet e huaja, zakonet prapanike).

5. E lodh a e dobësoj shumë dikë, e këput, e rraskapit; e mendoj shumë. Jeta në mërgim e kishte dërrmuar fare. E dërrmoi pagjumësia.

6. fig. E trondit shumë dikë, e vras shpirtërisht. Ia dërrmoi shpirtin (zemrën).

E dërrmoi vdekja e të birit.

* I dërrmoi (i theu) hundët (brinjët, turinjët, dhëmbët, nofullat) dikujt përçm. shih te THYEJ.

DËRRMOJ II jokal. krahin. Zbres, zdirgjem. Dërrmuan nga mali. Dërrmoi nga kali.

DIETË I f. Rregull në të ngrënë e në të pirë, që i caktohet dikujt nga mjeku; pehriz. Dietë e fortë (e lehtë, e rëndë, e gjatë). Dietë barishtesh (pemësh, qumështi). I caktoi (ia hoqi) dietën. Mban dietë. E prishi dietën. Është me dietë.

DIETË II f. fin. Shumë e caktuar parash që i jepet një punonjësi për shpenzimet e ditës (për të ngrënë e për të fjetur), kur shkon me shërbim larg qendrës së tij të punës (zakonisht jashtë rrethit). Mori dietat. Shkon pa (me) dietë.

DIKTIM I m. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve DIKTOJ I, DIKTOHEM I. Diktimi i gjurmëve. Diktimi i sëmundjes.

DIKTIM II m. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve DIKTOJ II, DIKTOHET II. Diktimi i tekstit. Diktim me zë të lartë.

2. Ushtrim me shkrim që mësuesi u bën nxënësve në klasë, duke u diktuar një tekst të caktuar zakonisht për të përvetësuar drejtshkrimin a për të kontrolluar dijet e tyre në mësimin e gjuhës; teksti që diktohet në këtë ushtrim. Diktim sqarues (kontrolli). Diktim për përdorimin e presjes. Ora e diktimit. Fletorja e diktimit.

Bëjnë diktim.

* Gjyqi i diktimit drejt., vjet. shih te GJYQ, ~I. Gjykata e diktimit drejt., vjet. shih te GJYKAT/Ë, ~A.

DIKTOHEM I Pës. e DIKTOJ I. Nuk u diktuan nga armiku. U diktua nga roja.

DIKTOHET II Pës. e DIKTOJ II. Diktohet nga kushtet (nga nevojat).

DIKTOJ I kal. 1. Zbuloj dikë a diçka pasi e kam gjurmuar, e gjej, e shoh pasi e kam ndjekur ose e kam vëzhguar, e pikas. Diktoi armikun. Diktoi gjurmët. S'diktoi asgjë. S'e diktoi dot. E diktoi menjëherë.

2. Zbuloj diçka të fshehtë, arrij ta kuptoj, i bie me të. Diktoi qëllimet e dikujt.

Ia diktoi mendjen ia bleu mendjen.

DIKTOJ II kal. 1. Lexoj a them diçka qartë, ngadalë, shkoqur e me zë të lartë, në mënyrë që dëgjuesi të arrijë ta shkruajë ose ta mësojë mirë; lexoj një tekst në klasë fjalë për fjalë, qartë, ngadalë e me zë të lartë, në mënyrë që nxënësit të shkruajnë bukur e pa gabime, të ushtrohen për të përvetësuar drejtshkrimin etj. U diktoi ligjëratën (tekstin, pyetjet). Dikton me zë të lartë.

2. I kërkoj dikujt të bëjë medoemos atë që dua unë, pa marrë parasysh vullnetin ose dëshirën e tij, e detyroj të veprojë në një mënyrë të caktuar. I dikton vullnetin.

U diktoi kushtet. U diktoi një marrëveshje të pabarabartë. U diktoi afatin. Ua diktojnë rrethanat (kushtet). Ua dikton nevoja.

DIKTUES I m. Ai që gjen dikë a diçka pasi e ka gjurmuar, ai që dikton dikë a diçka; zbulues.

DIKTUES II m. Ai që dikton një tekst etj.

DISIPLINË I f. 1. Zbatimi i detyrueshëm i disa rregullave të caktuara nga të gjithë anëtarët e një kolektivi; zbatimi i rreptë e i përpiktë i ligjeve, i vendimeve e i kërkesave të caktuara në një fushë të veprimtarisë shoqërore; bindja që formohet për zbatimin e këtyre rregullave e kërkesave; rregulli që vendoset nga zbatimi i tyre. Disiplinë e ndërgjegjshme. Disiplinë shembullore (e fortë, e rreptë, e shëndoshë, e hekurt, e dobët). Disiplina shtetërore. Disiplina proletare. Disiplinë

ushtarake. Disiplinë financiare. Disiplinë teknike (shkencore). Disiplina e planit (e prodhimit). Disiplina e partisë (e organizatës, e shkollës, e klasës). Disiplina në punë. Mungesa (shkelja) e disiplinës. Rregullorja (rregullat) e disiplinës. Forcimi i disiplinës. Shembull disiplinë. Vendos (mbaj) disiplinën. Thyen (prish) disiplinën. Atje s'ka disiplinë. Ka vetëm një disiplinë. Nuk ka dy disiplina.

2. Shprehia që fitojmë për t'iu përmbajtur me përpikëri disa rregullave të caktuara në jetë e në punë; të qenët shumë i rregullt në diçka. Disiplinë e brendshme. Disiplina e mendjes. Ka disiplinë në të ngrënë.

DISIPLINË II f. libr. 1. Degë e një shkence, degë e diturisë; lëndë mësimore në shkollë. Disiplinat mjekësore (gjuhësore).

2. Lloj i caktuar sporti. Disiplinat e atletikës së lehtë.

DITAR I m. 1. Tërësia e shënimeve të përditshme a të kohëpaskohshme, që mbahen për ngjarje nga jeta vetjake ose nga jeta e një kolektivi; shënime për vëzhgimet që bëhen ose për përfundimet që arrihen gjatë ditës në një ekspeditë studimi, në një eksperimentim shkencor, në një udhëtim të gjatë etj.; fletorja a blloku ku mbahen këto shënime. Ditari partizan. Ditari i kujtimeve (i ngjarjeve). Ditari i vrojtimit. Ditari i punës (i luftës). Ditari i anijes. Ditari i udhëtimit. Fletët e ditarit. Pjesë nga ditari. Mbaj ditar. Shënoj në ditar.

2. let. Vepër letrare a pjesë e saj, e shkruar në trajtë shënimesh të tilla.

3. Tërësia e shënimeve që bën mësuesi ose një punonjës në planin ditor të punës së vet; plani ditor i punës së dikujt; fletorja a blloku ku shënohet ky plan; fletore a regjistër ku shënohen emrat e nxënësve të një klase në shkollë, temat e mësimit, detyrat që u jepen nxënësve, vlerësimet e mësuesit etj. Ditari i shkol-

lës (i mësuesit). Ditari i llogarisë. Ditari i veprimeve luftarake.

DITAR II m. vjet. Njësi mase për tokën, afërsisht e barabartë me sipërfaqen që mund të lërojë një pendë qe në një ditë. Mbolli dhjetë ditarë me grurë. I dhanë disa ditarë tokë.

DIVAN I m. 1. Kanape e gjerë dhe e gjatë si shtrat, me susta a me sfungjer dhe e veshur si kolltuk, që shërben për të ndenjur ose për t'u shtrirë; shtrat i ngushtë anës murit të dhomës, ku mund të ulemi ose të shtrihemi. Divan me raft. Hap divanin.

Ulet (shtrihet) në divan. Fjeti në divan.

2. Korridor i gjerë, zakonisht në katin e dytë të një shtëpie, ku dalin dyert e dhomave, paradhomë, mesore.

3. Ballkon i mbuluar në hyrje të shtëpisë ose në katin e dytë. Doli në divan. Hanin bukë në divan. Në verë flenë në divan.

4. hist. Këshilli i zyrtarëve me të lartë në oborin e sulltanit të Turqisë, që kryente funksionet e gjykatës së lartë; dhoma ku mbledhej ky këshill.

DIVAN II m. let. Përmbledhje poezish lirike në letërsinë orientale, të renditura sipas llojeve e formave të tyre. Shkruante divane.

DJEGËS I m. Punëtori që djeg furrën për pjekjen e tullave e të tjegullave. Punon si djegës.

DJEGËS II m. bot. Bimë barishtore me gjethe vezake, me lule të bardha, të verdha a të kuqërreme, të mbledhura në vile e me erë shumë të mirë, që rritet në vende me klimë të butë e mund të mbahet edhe si bimë zbukuruese.

DO I pakuf. krahin. Disa, ca. Do njerëz. Do fjalë. Do ditë. Do rrush. Do bukë.

DO II bised. pavet. e DUA (shih te DUA 13). Do thënë. Do bërë. Do shkuar.

DO III pj. Pjesëz që shërben për të formuar trajtat gramatikore të kohës së ardhme dhe të mënyrës kushtore të foljes. Do të punoj. Do të shkoja.

- DOÇE** I f. 1. vet. nj. Lojë fëmijësh me disa veta, njëri prej të cilëve përpiqet të hedhë një koçan misri a një copë të vogël druri të rumbullakosur në një gropë që ruhet me shkopinj nga lojtarët e tjerë. Doçja luhet me shkopinj të gjatë.
2. Koçan misri ose një copë e vogël druri e rumbullakosur, që përdoret në këtë lojë. Me doçe në dorë. Mori (hodhi, goditi) doçen. I ra doçes.
- * E qiti në doçe e nxori pa gjë, e nxori pa pjesë, e la me gisht në gojë. Ka gjetur shkopi doçen keq. shih te SHKOP,~I.
- DOÇE** II f. Shtambë e vogël, zakonisht me një vesh. Pinë me doçe.
- DOÇKË** I f. shih DOÇ/E, ~JA I.
- DOÇKË** II f. zvog. përk. Dorë e vogël, dorë e njomë, dorë fëmije. Tundte doçkat. I puthi doçkën.
- DOK** I m. tekst. Pëlhurë e dendur prej pam-buku, që përdoret sidomos për veshje të lehta verore ose për rroba pune. Dok i ngjyrosur. Dok i gomuar. Pantallona (xhaketë, kostum, këmishë, rroba) doku. Vishet me dok.
- * Dok diagonal dok i thurur me fije që kalojnë në mënyrë të tërthortë.
- DOK** II m. Plis dheu.
- DOK** III m. det. Vend i posaçëm në një port për ngarkimin e shkarkimin e anijeve ose për ndreqjen e tyre. Dok i madh. E nxorën në dok anijen e çuan anijen në dok për ta ndrequr. Punon në dok.
- DORËS** I m. Bishtak.
- DORËS** II m. muz. Harku i lahutës.
- DOSË** I f. 1. Femra e derrit. Dosë e majme. Dosë race. Polli dosa.
2. fig. mospërf. Grua me trup të shëndoshë dhe zakonisht të trashë.
3. fig. keq. Grua shumë kokëfortë.
4. fig. shar. Grua a vajzë e pandershme, bushtë.
- * Si tym dose me të shpejtë, s'u duk nga vajti. Hyn derri e dosa keq. shih te DERR,~I.
- DOSË** II f. zool. shih DOSËZ,~A.
- DRAGË** I f. Ortek bore, reshme. E mori draga përpara. E zuri draga.
- DRAGË** II f. Anije e posaçme që ka pajisjet e nevojshme për të thelluar lumenjtë e portet, për të pastruar kanalet etj.; makinë e posaçme me pajisje për gërryerje, që përdoret për shfrytëzimin e vendburimeve minerare etj. Dragë thelluese. Ekuipazhi i dragës.
- DRANG** I m. krahin. 1. Këlysh maceje; këlyshi i disa kafshëve të egra. Drang maceje. Drang ujku (luani).
2. fig. shar. Këlysh. Drangu i dreqit. Drang lugati.
- DRANG** II m. krahin. 1. shih SHUL,~I 1,2. Drangu i portës. I vë drangun. Mbyll me drang.
2. Rrem i shkurtër si lopatë që shërben për të ngarë lundrën në ujë të cekët.
- DREDHËS** I m. 1. Punëtori që punon në makinën e dredhjes së fillit, të telit etj.; ai që merret me dredhjen e fillit. Puna e dredhësit.
2. Punëtori që përgatit lidhëset ose gjalma për rrogoza.
3. Vegël e thjeshtë prej dy copash druri të kryqëzuara, që shërben për të tjerë lesh, pambuk etj., çikrik për të tjerë; boshti për të tjerë lesh, drugë. Dredh me dredhës. U mbush dredhësi.
4. Boshti i mullirit të kafesë.
5. Burgjia e llambës ose e furnelës me vajguri. Dredhësi i llambës (i furnelës).
6. Dorezë prej druri, në trajtën e një kryqi, e cila shërben për të ngritur ose për të ulur lugun që ndodhet nën kosh, nga ku kokrrat e drithit bien në gurin e mullirit (kur duam ta blujmë miellin më të hollë a më të trashë). Ngre (ul) dredhësin.
- DREDHËS** II m. zool. Dre mashkull me brirë të degëzuar.

- DREDHËZ** I f. bot. 1. Luleshtrydhe. Dredhëza të pjekura. Reçel dredhëzash.
2. Dredhkë. Shkul dredhëzat.
3. Urth. Mur i mbuluar me dredhëza.
4. Dredhë hardhie etj. Ka nxjerrë dredhëza. Është kapur me dredhëza.
- DREDHËZ** II f. Zbukurim me dredha në petkat kombëtare, i bërë me tehri. Jelek (tirq) me dredhëza. I zbukurojnë me dredhëz.
- DREDHUR** I f. 1. Dredha e rrugës, e lumit etj. Rrugë me të dredhura.
2. gjell. Dredhanik.
- DREDHUR** II f. shih DRIDHUR, ~A (e) 1.
- DUDË** I f. zakon. anat. Trysat.
- DUDË** II f. Man i zi; kokërr mani shumë e pjekur dhe e butë, që bie vetë në tokë.
- DUSHK** I EGËR bot. Ashe.
- DYSHE** I f. Shami e madhe katrore, që gratë e vënë në kokë duke e palosur me dysh si trekëndësh. Lidhi dyshen në kokë.
- DYSHE** II f. 1. Grup i përbërë nga dy qenie ose nga dy sende. Dyshja e parë. Tri dyshe. Formojnë një dyshe.
2. Valle që kërcëhet nga dy veta, valle dyshe. Dyshe myzeqare. Luan (kërcen) dyshen.
- DYSHEME** I f. 1. Pjesa e poshtme e një dhome, e një salle etj., përkundrejt tavanit, e shtruar me dërrasa a me pllaka; shtroja e një dhome, e një salle etj. Dyshemeja e dhomës (e sallës). Dysheme me dërrasa (me pllaka). Dërrasat e dyshemesë. Shtroi dyshemenë. Lau dyshemenë. U shtri në dysheme.
2. Pjesa e poshtme e një vendi, e një sendi etj., që është e rrafshët dhe përbën shtratin e tij ose që shërben si mbështetje për diçka. Dyshemeja e qerres (e urës). Dyshemeja e djepit (e karriges). Dyshemeja e magjes (e zgjoit, e furrës).
3. gjeol., min. Shtresë dheu, shkëmbi etj., mbi të cilën gjendet minerali i dobishëm a një damar i tij. Dyshemeja e minierës. Dyshemeja e qymyrgurit.
- DYSHEME** II f. Shami e madhe, e punuar në vegjë, që e hedhin gratë në kokë a e lidhin si përparëse, që e mbajnë burrat në qafë si shall a të lidhur në mes si brez ose që përdoret për të mbështjellë plaçka në bohçe. Lidh me (në) dysheme.
- DHE** I lidh. 1. Përdoret për të lidhur dy gjymtyrë fjalie të një fare ose dy fjali të bashkërenditura këpujore a shtuese; e. Punëtorë dhe fshatarë. Burra dhe gra. Të rinj dhe të reja. Pleq dhe fëmijë.
Shokë dhe shoqe! Është i ndershëm dhe punëtor. Punojnë dhe mësojnë.
2. Përdoret e përsëritur përpara dy a me shumë gjymtyrëve a fjalive të një fare, kur ato numërohen me radhë njëra pas tjetrës ose kur shënojnë a tregojnë sende, dukuri, veprime që kanë të njëjtën rëndësi, vlerë etj., që janë të njëkohshme etj.; edhe. Dhe i aftë, dhe i palodhur. Dhe për të sotmen, dhe për të nesërmen. Dhe në teori, dhe në praktikë. Dhe për shkollën, dhe për jetën. Dhe për dimër, dhe për verë.
Dhe punon, dhe mëson. I mori të gjithë me vete ? dhe fëmijët, dhe prindërit, dhe shokët.
3. Gjithashtu, po ashtu, ashtu edhe, edhe. Si ai dhe ti. Si i ati dhe i biri. Sipas vendit dhe kuvendi. fj.u.
4. Përdoret për të kundërvënë dy gjymtyrë të një fjalie a dy fjali të një fare; e, edhe. Duhet punë dhe jo fjalë. Dhe qeros, dhe fodull. Duhej të shkonte me shokët dhe jo të rrinte.
5. Përdoret për të lidhur dy fjalë a dy trajta të së njëjtës fjalë në togje me bashkërenditje, që tregojnë përsëritje a vazhdimësi veprimi ose gjendjeje, që shprehin përforcim etj. Mirë dhe me mirë. Vetëm dhe vetëm. Keq dhe mos me keq. Foli dhe foli sa u lodh. Kur zë dhe ha, s'ka të ngopur. Kur zë dhe mburret, s'durohet.
6. Përdoret për të lidhur trajtat e njëjta të një foljeje (një herë me pjesëzën mohuese «s» ose «nuk» dhe një herë pa të)

për ta paraqitur veprimin a gjendjen e shprehur prej saj si jo të sigurt, jo të prerë etj. Dhe e bën, dhe s'e bën. Dhe e thotë, dhe s'e thotë. Dhe është, dhe s'është. Dhe vjen, dhe s'vjen.

7. Përdoret në fillim të një fjalie që plotëson, zhvillon a sqaron një mendim të shprehur nga një fjali tjetër para saj. E lan, e ushqen, ia bën të gjitha gati. Dhe pas-taj ka gojë e flet. Shkuan të gjithë. Dhe fëmijët. Japim gjithçka për mbrojtjen e vendit tonë socialist. Dhe jetën.

8. përd. pj. Përdoret në fillim të një togfjalëshi a të një fjalie për të përforcuar ose për të theksuar kuptimin që shprehet prej tyre ose për t'i dhënë gjallëri e bukuri ligjëritimit a për të rritur fuqinë shprehëse të tij. Dhe pranvera erdhi. Dhe sot fshati lulëzon. Dhe lindi te ne jeta e re.

9. përd. ndajf. Përdoret përpara mbiemrave dhe ndajfoljeve në shkallën krahasore me kuptimin «në një shkallë me të lartë, me shumë, me tepër, ca».

Dhe me të mëdha. Dhe me i fortë (me i mirë...). Dhe me bukur (me shumë, me keq...).

DHE II pj. Përdoret për të theksuar a për të përforcuar kuptimin e një fjale, të një togfjalëshi a të një fjalie. Dhe atje nuk u mësua. Dhe të lodhur katër sy shohin prapë me mirë se dy. fj.u.

* Dhe ja shih te JA. Si dhe përdoret si lidhëz bashkërenditëse këpujore a shtuese, si edhe, dhe. Si ..., (ashtu) dhe përdoret si lidhëz bashkërenditëse këpujore a shtuese për të lidhur dy fjalë të një fjalie a dy fjali të një fare që krahasohen midis tyre; ashtu edhe, gjithashtu.

E. I

1. Një nga zanoret e gjuhës shqipe dhe shkronja e shtatë e alfabetit të saj, e cila shënon këtë zanore. Zanorja e. Tingulli e. Shkronja e.

2. si em. f. Zanorja dhe shkronja e. E-ja e madhe (e vogël). E-ja e dorës (e shtypit).

E-ja e theksuar (e patheksuar).

E II

1. Nyjë e përparme e gjinisë femërore tek emrat e rasës gjinore, tek emrat e mbiemrat e nyjshëm, te numërorët rresh-torë dhe te disa përemra, kur emri me të cilin lidhen është në rasën emërore ose kallëzore; nyjë e përparme e gjinisë mashkullore tek emrat e rasës gjinore, te mbiemrat e te disa përemra, kur emri me të cilin lidhen është në trajtën e shquar dhe në rasën kallëzore të numrit njëjës ose në rasën emërore a kallëzore të num-rit shumë. Vajzë e mirë. Fushat e gjera. Lugina e Drinit. Djemtë e fshatit. Trimëritë e partizanëve. E reja mirditore. Nga e hëna tek e diela. Klasa e parë (e dytë, e pestë). Doli e para e klasës. E mira s'ka fund. Erdhën të gjitha shoqet e saj. Një punë e tillë të nderon. Sh-prehu mendimin e vet. Thirri djalin e madh. Të njohim heronjtë e pavdekshëm. I këshilloi djemtë e tij (e tyre).

2. Nyjë e përparme me kuptimin e përemrave pronorë të vetës së tretë të numrit njëjës, e cila përdoret me emrat femërorë që tregojnë lidhje gjaku a gjinie ose lidhje familjare; e tij, e saj. E ëma. E bija. E motra. E mbesa. E emta. E vjehrra. E shoqja.

E kunata. E kushërira.

E III

Trajtë e shkurtër e përemrave vetorë të vetës së tretë në rasën kallëzore të num-rit njëjës. E plotësoi detyrën. E pashë në rrugë. Nuk e kuptova mirë. Këtë e shoh qartë.

Atë e dinë të gjithë. Merre (merreni) me vete! Thuaje hapur!

E IV lidh.

1. Përdoret për të lidhur dy gjymtyrë fjalie a dy fjali të një fare ose dy fjali të bashkërenditura këpujore a shtuese; dhe. Klasa punëtore e fshatarësia kooperativiste. Shkoi e u kthye shpejt. Të vriste natën e të qante ditën.

2. Përdoret për të lidhur dy fjalë a dy trajta të së njëjtës fjalë në togje

me bashkërenditje, që tregojnë zakonisht përsëritje ose vijimësi veprimi a gjendjeje, që shprehin përforsim etj. Tani e tutje. Vetëm e vetëm. Një herë e përgjithmonë. Rreth e rrotull. Për orë e orë të tëra. Keq e mos më keq. Mirë e më mirë. Ec e ec e s'ka të sosur. Bie e fle. Zë e gërhet. Ka gojë e flet.

3. Përdoret për të kundërvënë dy gjymtyrë të një fjalie a dy fjali të një fare; dhe, edhe. Duhet punë e jo fjalë. Duhej t'ia kishe thënë e jo të heshtje.

4. Përdoret te numërorët e përbërë për të lidhur klasat e ndryshme të tyre (njëshet, dhjetëshet etj.). Njëzet e dy. Dyqind e tridhjetë. Një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre.

5. përd. pj. Përdoret në fillim të një togfjalëshi a të një fjalie për të theksuar kuptimin që shprehet prej tyre. E sot fshati duket si në festë. E u nis pastaj tërë gëzim.

EDHE I ndajf. 1. Ende. Jeton (punon) edhe. S'ka ardhur edhe.

2. Përdoret përpara mbiemrave dhe ndajfoljeve në shkallën krahasore, me kuptimin «në një shkallë me të lartë, më shumë, më tepër». Edhe më të mëdha. Edhe më i bukur. Edhe më mirë. Edhe më shumë.

EDHE II lidh. 1. Përdoret për të lidhur dy gjymtyrë fjalie të një fare ose dy fjali të bashkërenditura këpujore a shtuese; e, edhe. Nxënësit edhe mësuesit. Punojmë edhe mësojmë. Lexoj edhe dëgjoj. Ia them edhe s'ia them. E bën edhe s'e bën.

2. Gjithashtu, po ashtu, ashtu dhe. Si bleta edhe mjalti. fj. u. Sipas vendit edhe kuvendi. fj. u.

3. Përdoret për të lidhur dy fjalë a dy trajta të së njëjtës fjalë në togje me bashkërenditje që tregojnë përsëritje ose vijimësi veprimi a gjendjeje, që shprehin përforsim etj.; e, dhe. Vetëm edhe vetëm. Mirë edhe më mirë. Keq edhe më keq.

4. Përdoret e përsëritur për të lidhur dy gjymtyrë fjalie a dy fjali të një

fare shtuese a kundërshtuese; hem...hem. Edhe i aftë, edhe i ndershëm. Edhe sot, edhe nesër. Edhe për të sotmen, edhe për të ardhshmen. Edhe në shkollë, edhe në jetë. Edhe për verë, edhe për dimër. Edhe qeros, edhe fodull. fj. u. Edhe mishi të piqet, edhe helli të mos digjet. fj. u. Edhe të qorton edhe të do.

5. Përdoret përpara një vargu gjymtyrësh fjalie të një fare ose para fjalish të së njëjtës farë, kur ato numërohen me radhë njëra pas tjetrës. I mori të gjithë me vete ? edhe djalin, edhe çupat, edhe nënën, edhe gjyshin. Është e domosdoshme edhe të punohet toka thellë, edhe të thërrmohen plisat, edhe të hapen vijat kulluese, edhe të hidhet fora me kohë.

6. Përdoret në fillim të një fjalie që plotëson, zhvillon e sqaron një mendim të shprehur nga një fjali tjetër para saj. Mjeku i ka thënë të mos pijë me duhan, por ai s'e ka lënë. Edhe pastaj ankohet. Dolën të gjithë në fushë, gra e burra.

Edhe pleqtë. Jemi gati të japim gjithçka për Atdheun. Edhe jetën.

7. përd. kallëzues. mat. Shtojmë (kur mbledhim një numër me një tjetër). Dhjetë edhe dy. Katër edhe katër bëjnë tetë.

8. si em. ~, ~JA f. ~, ~TË mat. Shenja e mbledhjes (+); plus.

EDHE III pj. Përdoret për të theksuar a për të përforsuar kuptimin e një fjale, të një togfjalëshi ose të një fjalie. Edhe sot e kësaj dite. Edhe atje ai nuk hoqi dorë.

* Edhe në qofte se... (edhe po qe se... edhe në... edhe sikur...) përdoret kur tregojmë se diçka prapëseprapë do të ndodhë, megjithëse ka rrethana që e pengojnë atë. Edhe pse përdoret për të lidhur një fjali të varur lejore me fjalinë kryesore. Jo vetëm ..., por edhe ... shih te VETËM. Jo vetëm që ..., por edhe ... shih te VETËM. Si... (ashtu) edhe... përdoret për të lidhur dy gjymtyrë fjalie të një fare ose dy fjali që krahasohen ndërmjet tyre.

- EGËRTI** I f. përmb. Tërësia e kafshëve të egra, egërsirat. Ka egërti në mal. I hëngri egërtia.
- EGËRTI** II f. 1. Dora e parë që i jepet një muri kur lyhet me gëlqere. Presin sa të thahet egërtia.
2. Muret e një ndërtese pa suva e pa shtesat e plotësimet e brendshme, karabina.
- EHULL** I m. 1. Hell a qiri akulli; vesë e ngrirë. Këput një ehull.
2. Erë e ftohtë që fryn në mëngjes herët. Të pret ehulli.
- EHULL** II m. Lende lisi. Bien ehujt.
- ELIPS** I m. Vijë e lakuar dhe e mbyllur që ka trajtë vezake si të vijës së përfutur nga prerja e pjerrët e një koni ose e një cilindri me një rrafsh. Harku i elipsës. Qendra (vatrat, boshtet) e elipsës. Në trajtën e elipsit.
- ELIPSË** II f. Heqja e një gjymtyre ose e më shumë gjymtyrëve të nënkuptueshme në një fjali, me qëllim që, pa e vështirësuar kuptimin, mendimi të shprehet më shkurt. Përdor elipsën.
- EMISAR** I m. Njeri që dërgohet diku nga një shtet a nga një organizatë politike me detyra të posaçme, sidomos të fshehta. Emisar politik. Emisar fuqiptotë (i posaçëm). Emisar i imperializmit.
- EMISAR** II m. tek. Kanal nëpër të cilin kalon e derdhet në det a diku gjetkë uji i një kënetë, i një liqeni etj. Emisari kryesor. Emisari i Tërbufit.
- END** I kal. 1. Bashkoj kryq, gërshetoj fijet e perit që janë për së gjati me ato për së gjeri duke i rrahur fort për të bërë pëlhurë, stof, qilim etj. (në vegjë ose në tezgjah); bëj pëlhurë, cohë etj.; punoj në vegjë ose në tezgjah; kund. çend. End pëlhurë. End qilimin.
End në vegjë (në tezgjah).
2. Thur (një shportë, një kurorë etj.) me thupra, me fije etj.
3. vet. veta III. Thur një pëlhurë të veçantë me fijet që nxjerr vetë, bën pëlhurë (për merimangën e krimbin e mëndafshit). Merimanga end pëlhurën.
4. fig. Krijoj a shestoj diçka; thur, trilloj. End vjersha (këngë). End intriga (komplote).
- END** II kal. 1. Hedh pa ndërprerje diçka në një drejtim të caktuar a në disa drejtime. End dritën (për hënë). End shikimin.
2. Bëj që të endet, e sjell rrotull. E endi ca ditë, pastaj i mbaroi punë.
- END** III jokal. Çel lule, lulëzon; lidh kokërr (për pemët a për një bimë). Endi dardha (molla, kumbulla, arra). Endi lulja. Endi gruri.
- END** IV kal. Lëshon vezët në diçka, e pështyn (për mizën). E ka endur miza mishin.
- ENDËS** I m. 1. Ai që end pëlhurë etj., ai që punon në vegjë a në tezgjah. Endës i shkathët. Endës pëlhurash.
2. tekst. Boshti ku vendosen kallamat me fijen e perit për të endur majën.
- ENDËS** II m. bot. Mugull, syth i bimëve.
- ENDËS** I mb. 1. Që shërben për të endur pëlhurë. Makinë endëse.
2. Që end pëlhurë etj., që punon në vegjë ose në tezgjah. Punëtor endës.
- ENDËS** II mb. Endacak. Fiset endëse.
- ENDËZ** I f. Pëlhurë merimange, cergë.
- ENDËZ** II f. 1. Endë.
2. zool. Vezët që lëshon miza në mish, në peshk etj.
3. zool. Lloj fluturë e vogël, si mushkonja, që zakonisht fluturon në tufë bashkë me të tjera e që ushqehet kryesisht me nektarin e luleve. Endëza e pishës.
- ENDËZ** III f. vjet. Masë gjatësie, e barabartë me perimetrin e kokës së njeriut, që përdorej për të matur pëlhurën, basmën etj. Një endëz. Dy endëza pëlhurë.
- ENDJE** I f. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve END I, ENDET. Endja e pëlhurës (e stofit). Punëtor i endjes. Reparti i endjes.

ENDJE II f. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve END II, ENDEM. Endjet nëpër male. Endja lart e poshtë.

ENDUR I mb. Që është punuar në vegjë ose në tezgjah. Pëlhurë (rrobë) e endur.

ENDUR II mb. Që është pështyrë nga mizat (për mishin, peshkun etj.) Mish (Sallam) i endur.

ENJË I f. Dhi, dele ose lopë që vijon të japë qumësht, megjithëse ka dështuar ose i ka ngordhur pjella. Mbeti enjë. Edhe enja jep qumësht.

ENJË II f. bot. Bërshen.

ERË I f. 1. Rrymë ajri që lëviz në drejtime të ndryshme. Erë e ftohtë (e ngrohtë). Erë e lehtë (e fortë, e tërbuar, e hollë, e lagësht, e thatë). Erë pranverore. Era mëngjesore. Era e malit (e fushës). Era e diellit era që fryn nga lindja. Era e lindjes (e perëndimit, e veriut, e jugut). Erë bore (shiu) erë që sjell borë (shi). Erë me shi (me dëborë). Forca (shpejtësia) e erës. Drejtimi i erës. Matës i erës. Mot me (pa) erë. I shpejtë si era. Fryn erë. Fishkëllen era. Pushoi (ra) era. Të than (të pret, të shkurton, të gërryen) era.

E rreh (e zë, e kap, e ha) era. Vend i mbrojtur nga era.

2. bised. Ajër. Vrimë (baxhë) për erë. Shtie (qëlloj) në erë. Fluturoi në erë. Marr erë marr frymë.

* Erë me erë gjithkund, kudo. Fjalë në erë (në hava) fjalë të thëna pa u menduar, fjalë pa kuptim, fjalë të kota. U bë erë iku shumë shpejt, u zhduk menjëherë. Flet në erë flet pa u menduar, flet kot. Hedh në erë diçka.

a) shpërthej, shkatërroj me lëndë shpërthyesë diçka;

b) prish, shkatërroj menjëherë planet e dikujt. E merr era dikë është i dobët me trup, s'mbahet dot më këmbë. E mori era diçka shkoi kot; nuk zuri vend; u zhduk pa lënë gjurmë. E ka sjellë era dikë

a) s'dihet nga ka ardhur dhe përse ka ardhur;

b) diçka është diçka e panjohur dhe e rastit. Ngopet me erë kënaqet me fjalë e me premtime të kota, ngopet me lugë të zbrazët. Prashit në erë flet fare kot, flet në tym; dërdëllit. Ruan erërat shih te RUAJ. Shkel në erë është shumë i shpejtë (për kalin, për kaprollin etj.).

Bën (ndërton, ngre) kështjella në erë (në ajër) keq. shih te KESHTJELL/Ë,~A.

Është si era e malit është shumë mendjelehtë e i papjekur. Fjalët i merr era fj.u. s'kanë vlerë fjalët, po qe se nuk shoqërohen me vepra; fjalët harrohen shpejt.

Ia hodhi leckat në erë dikujt përçm. shih te LECK/Ë,~A. I hedh paratë në erë i prish paratë kot, i bën paratë rrush e kumbulla. Ia hodhi potkonjtë (në erë)shih te HEDH.

Ia hodhi trutë në erë keq. e vrau (zakonisht me plumb dhe duke e qëlluar në kokë).

Humbi si pluhuri në erë shih te PLUHUR,~I. Kërkon të arrijë erën përpiqet më kot, i hyn një pune që nuk mund të bëhet. Kthehet (shkon) nga të fryjë era është i paqëndrueshëm në bindjet a në pikëpamjet e tij, është i lëkundshëm, nuk është parimor, kthen gunën nga të fryjë era. Kthen gunën (gëzofin, shpinën, kurrizin, krahët) nga fryn era shih te KTHEJ. I ka marrë koka (kryet, mendja) erë shih te KOK/Ë,~A. Ia ka marrë mendtë era dikujt është shumë mendjelehtë. Ia kishte marrë era çatinë ishte shumë i varfër e i këputur, ishte pa plëng e pa shtëpi. Ia ka shkundur era trutë shih te SHKUND. I hyn era në të katër anët (për një shtëpi)

a) është ndërtuar shumë keq;

b) është shtëpi e vjetër e gjysmë e shkatërruar. Kush mbjell erën do të korrë furtunën (stuhinë) fj.u. shih te MBJELL.

ERË II f. 1. Vetë e disa trupave që lëshojnë grimca të padukshme, të cilat veprojnë mbi shqisën e të nuhaturit; grimca të padukshme që lëshojnë këta trupa; diçka që ndihet me anë të organit të të nuhaturit. Erë e mirë (e këndshme). Erë e

keqe (e rëndë, e qelbur).Era e lules (e duhanit,e barit të thatë,e qepës).Era e djathit (e peshkut, e gjellës).Era e djer-sës. Erë vajguri. Era e ilaçeve. Rrush me erë. Sapun me erë të mirë.

I vjen era; I marr erë lules (trëndafilin) nuhat erën që ka. Mban (bie) erë diçka. I del era. Merr erë diçka qelbet, prishet. Po nuk hëngre hudhër nuk të vjen era (nuk bie erë).fj.u.

2. vet. Erëza.

* Bie (mban, vjen) erë ka gjurmë, shenja ose shfaqje të diçkaje. I bie në erë dikujt a diçkaje i bie në gjurmë, e diktoj, kam gjetur shenja për ta zbuluar.

I doli era (tymi) shih tek TYM,~I. Mori erë diçka u bë e ditur, u mësua prej të gjithëve, u zbulua. S'merr erë nga diçka edhe poh. nuk merr vesh nga një punë, nuk e njeh fare diçka. I mbaj erë diçkaje shih te MBAJ. I vjen era diçkaje po del në shesh, po zbulohet. Bie (mban) erë barat shih te BARUT,~I. Bie (mban) erë myk diku shih te MYK,~U. I ka marrë erë barutit shih te BARUT,~I. Më zuri goja erë (bar) shih te BAR,~I I. I kanë marrë erë në qafë dikujt shih te QAF/Ë,~A. Ia ka marrë erën dikujt a diçkaje pasi e ka njohur mirë dikë a diçka nuk ka më frikë prej tij a prej saj. E mban me erë të mollës dikë e mban me fjalë, me premtime e me shpresa të kota; e gënjen si të ishte foshnjë. I mban goja erë qumësht shih te QUMËSHT,~I. I ardh-të era dhe! mallk. shih te DHE,~U. Pata piqet këtu e era shkon në Stamboll shih te PAT/Ë,~A.

ERË III f. libr. 1. Periudhë kohe shumëshekullore në historinë e njerëzimit, që fillon me një ngjarje të njohur; ngjarje e shënuar ose që quhet si e tillë, e cila shërben si pikënisje për një periudhë të re historike dhe për numërimin e viteve; epokë.

Era e re (jonë). shkurt. e.r. Në shekullin e dytë të erës sonë. Para (pas) erës së re.

2. gjeol. Ndarja më e madhe kohësore e historisë së Tokës.

ERËZA I f. vet. Bimë me erë të mirë ose gjetet, lulet e frytet e këtyre bimëve (si majdanozi, kopra, rigoni, piperi etj.), që shtihen në gjellë e në gatesa të tjera. Erëza natyrore. Erëza bimësh tropikale. Gjellë me erëza. I shtie (i hedh) erëza.

ERËZA II f. vet. euf, krahin. Bajga të thata bagëtish. Ndzite zjarr me erëza.

ETER I m. kim. Lëng i pangjyrrë, i djegshëm, shumë i avullueshëm e me një erë të mprehtë i cili përftohet nga bashkimi i alkooleve në mjedis acidi dhe përdoret kryesisht në mjekësi, në parfumeri e në teknikë. Eteret e thjeshta (e përbëra). Thith eter.

ETER II m. libr. 1. Sipas mitologjisë së grekëve të lashtë pjesa më e pastër e më e tejdukshme e ajrit në shtresat më të larta të atmosferës.

2. poet. Ajri i pastër mbi retë; hapësira qiellore. Zëri përhapej në eter.

3. fiz. Lëndë që sipas parafytyrimeve të kohës së lashtë ishte e pakapshme e lëvizte lirisht. dhe zinte gjithë hapësirën mbi atmosferë një lëndë e tillë, pa peshë që mendohej se mbushte hapësirat ndërmjet grimcave dhe ishte përçues i dritës dhe elektricitetit.

ETIKETË I f. 1. Copë e vogël zakonisht prej letre a kartoni, që i ngjitet një malli a diçka tjetër për të treguar se cila fabrikë a ndërmarrje bujqësore e ka prodhuar, përmbajtjen, çmimin, vendin ku dërgohet a ndonjë të dhënë tjetër për të. Etiketë e shisheve. Mall pa etiketë. I vë (i ngjit, i heq) etiketën.

2. Cilësi a karakteristikë me të cilën dikush a diçka shfaqet para të tjerëve; shenjë që e tregon dikë a diçka. Me etiketa të ndryshme. Nën etiketën e...

ETIKETË II f. libr. Një varg rregullash a mënyrash të caktuara; sipas të cilave sillen njerëzit në shoqëri, rregullat e jashtme në marrëdhëniet me të tjerët. Etiketë socialiste. Etiketë borgjeze. Etiketë oborrtare. Etiketë

- zyrtare. Etiketa e mirësjelljes. Flet me etiketë. E kërkon etiketa.
- Ë I 1.** Një nga zanoret e gjuhës shqipe dhe shkronja e tetë e alfabetit të saj, e cila shënon këtë zanore. Zanorja ë. Tingulli ë. Shkronja ë.
2. si em. f. Zanorja dhe shkronja ë. Ë-ja e madhe (e vogël). Ë-ja e dorës (e shtypit).
- Ë II pj.** 1. Përdoret zakonisht në fund të fjalive pyetëse për të përforcuar pyetjen. Ashtu mendon ti, ë? Atëherë kush duhet të përgjigjet për atë, ë? S'të vjen mirë, ë?
2. bised. Përdoret zakonisht veçan, kur kërkojmë të përsëritet një pyetje ose një mendim që nuk është dëgjuar mirë. Ë? Flisni edhe një herë ju lutem, se nuk e dëgjova
3. Përdoret zakonisht në fund të një fjalie kur shprehim habi, ironi, qesëndi, mospërfillje, zemërim, miratim etj.; a. Nuk do të vijë, ë? Nuk ta dha, ë?
- Ë III pasth.** 1. Përdoret zakonisht e përsëritur për të shënuar zërin që del kur qan një fëmijë a dikush tjetër ose kur rënkon një i sëmurë; ëh. Bënte ë, ë, ë.
2. Përdoret kur shprehim kënaqësi, miratim etj. ose për të përforcuar shprehjen e këtyre ndjenjave. Ë, sa m'u bë qejfi!
3. Përdoret kur kujtohem papritur për diçka. Ë, po, m'u kujtua tashti.
- ËNJT** kal., ~A, ~UR vet. veta III. 1. Shkakton fryrjen e trupit të një frymori a të një pjese të tij. Ia ënjti dorën.
2. bised. Fryj (duke ngrënë, duke pirë). E ënjti barkun me bukë (me ujë, me verë).
3. bised. E rrah shumë, e zhdëp në dru.
5. fig. bised. E mërzit a e shqetësoj shumë dikë; e hidhëroj shumë. Na ënjti me fjalë. Ma ënjti zemrën.
- FAJKORE I f.** zool. Femra e fajkoit.
- FAJKORE II f.** Lundër e madhe; anije e vogël. Peshkojnë me fajkore.
- FALË I f.** 1. anat. shih KYÇ, ~I 3. Falat e gishtërinjve. Fala e gjurit pjesa prapa gjurit, ku përthyeret këmba.
2. shih FALËZ, ~A.
- FALË II f.** etnogr. Dhuratë (zakonisht veshmbathje) që u çonte nusja njerëzve me të afërm të burrit.
- FARASHKË I f.** 1. Farashë.
2. Farashë me fund në trajtën e një krehri ose me vrima, që shërben për të mbjellë farë rasati.
- FARASHKË II f.** bot. Melekuqe.
- FASHË I f.** 1. Copë e hequr nga një pëlhurë, nga një stof, nga një lëkurë etj.; një copë e tillë e prerë si rrip, që shërben zakonisht për të lidhur diçka. Fashë stofi (letre).
2. mjek. Rrip prej pëlhure të hollë e të rrallë, që përdoret për të lidhur plagët.
- Fashë e pastër. Zgjidh fashën. Lidh me fashë.
3. Diçka që ka trajtën e një rripi të ngushtë. Fashë drite. Fashë uji.
- * I hoqi (ca) fasha e mundoi shumë, e sfliti. Ia lidhi gojën me fashë ia mbylli gojën, nuk e la të flasë.
- FASHË II f.** 1. Gjendje e qetë; qetësi, prehje. Ra në fashë.
2. përd. ndajf. Në qetësi. Bie fashë pushon, qetësohet, fashitet.
- FIKËS I m.** 1. Vegël e posaçme a aparat që shërben për të fikur zjarrin ose flakën. Fikës me ujë.
2. vjet. Mjet i thjeshtë (një bisht i gjatë prej druri me një kapuç prej teneqeje) që përdorej për të fikur qirinjtë në kishë.
- FIKËS II m.** zool. Beng.
- FIL I m.** 1. zool. Elefant.
2. shah. Secila nga dy figurat, që vendosen anash mbretit dhe mbretëreshës dhe lëvizin cepazi në të gjitha kutitë e fushës; oficer. Fil i bardhë (i zi). Lëviz filin. Shkëmbej filat.

- FIL** II m. det. Buza në të dy anët e kuvertës së anijes. Mbështetem në fil.
- FILIK** I m. I vogli i derrit të egër.
- FILIK** II m. Filiqe.
- FILLAK** I m. 1. Dru i gjatë e i drejtë.
2. Filiz, bisk. Kur pritet druri, nxjerr fillakë.
- FILLAK** II m. Mbulesë e vogël prej leshi për fëmijë, velenxë e vogël e endur me një faqe, fillore e vogël.
- FILLESË** I f. 1. shih FILLIM, ~I. Fillesë e mbarë.
2. Formë fillestare e diçkaje; zanafillë, pikënisje. Fillesat e organeve të trupit të njeriut.
- FILLESË** II f. tek. Pjesa e vjaskuar e një vidhe, e një kundërvidhe etj.; Vjaskë. Fillesa e vidhës. Iu prish fillesa.
- FILLORE** I f. Mbulesë leshi e endur me një faqe dhe e shkelur në dërstilë, velenxë me një faqe.
E mbuloi me fillore.
- FILLORE** II f. Vegël e drunjtë e avlëmendit, që çon fijet e indit nëpër fijet e majës, drugë.
- FLAKËRIJ** I jokal. 1. vet. veta III. Digjet me flakë, lëshon flakë. Flakërijnë zjarret.
2. vet. veta III. Lëshon dritë të fortë, shkëlqen, flakëron. Flakërinin xixat.
3. vet. veta III. Shkëlqen, shndrit, flakëron (edhe fig.). Flakërinin shpatat. I flakërinin sytë.
- FLAKËRIJ** II kal. Hedh me forcë diçka, flakëroj, flak. E flakëriu era.
- FLAKËRIT** I jokal. shih FLAKËROJ I.
- FLAKËRIT** II kal. shih FLAKËROJ II. E flakëriti në erë. E flakëriti jashtë.
- FLAKËRITEM** I vetv. pës. shih FLAKËROHEM I.
- FLAKËRITEM** II pës. shih FLAKËROHEM II.
- FLAKËRITJE** I f. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljeve FLAKËRIT I, FLAKËRITEM I. Flakëritja e diellit.
- FLAKËRITJE** II f. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve FLAKËRIT II, FLAKËRITEM II.
- FLAKËROHEM** I vetv. 1. vet. veta III. Duket sikur merr flakë, përflaket; bëhet flakë i kuq, skuqet.
U flakërua qielli. Iu flakërua balli. Iu flakëruan sytë.
2. Pës. e FLAKËROJ I.
- FLAKËROHEM** II Pës. e FLAKËROJ II.
- FLAKËROJ** I jokal. 1. vet. veta III. Lëshon flakë; digjet duke bërë flakë. Flakëronte zjarri.
2. vet. veta III. Lëshon një dritë të fortë e të menjëhershme. Flakëron dielli. Flakërojnë shkëndijat.
3. vet. veta III. Duket sikur merr flakë, përflaket; kuqëlon. Flakëron horizonti. Flakërojnë flamujt në erë.
4. vet. veta III. Shkëlqen fort, shndrit (edhe fig.). I flakëronte fytyra. I flakëronin sytë.
5. kal. vet. veta III. I jep një ngjyrë të kuqe, të ndezur, e ndez, e përflak, e bën që të kuqëlojë. Dielli e flakëroi qiellin.
6. kal. E djeg shumë diçka, e përzhit (për bukën etj).
7. vet. veta III fig. Ndizet flakë, zien, vlon. I flakëron zemra. I flakëron gjaku.
8. kal. fig. Mbush me ndjenja të zjarra, ia ndez zemrën flakë.
9. kal. Godas me pëllëmbë, i jap një shuplakë.
- FLAKËROJ** II kal. 1. Hedh me forcë, flak. E flakëroi përdhe.
2. jokal. Sulem me shpejtësi të madhe në një drejtim të caktuar, lëshohem menjëherë diku; largohem me shpejtësi. Flakëruan njerëzit. Flakëruan copërat. Flakëroi si vetëtima.

FLETË I f. 1. Gjethe. Fletë e njomë (e thatë). Fletë molle (hardhie, fiku, lisi, ahu), fletë misri (duhani, panxhari, lakre). Fletë mëllage. Bien fletët.

2. Cipë e hollë si gjethe, që mbulon disa organe të bimëve ose të drurëve e të shkurreve; flegër.

3. bised. Petël. Fletët e trëndafilut.

* Fletë (gjethe) fiku shih te FIK, ~U. Fletë delli bot. shih GJETHE DELLI te GJETH/E, ~JA.

FLETË II f. 1. Copë letre katërkëndëshe, që përdoret zakonisht për të shkruar mbi të; secila nga fjetet e një libri, reviste etj. Fletë e bardhë (e shkruar, e pastër). Fletë fletoreje (vizatimi, libri). Fletë cigareje. Kthej (palos, thyej, gris) fletën.

2. Një copë letre e shkruar që shërben si vërtetim, si dëshmi ose për qëllime të tjera. Fletë luftarake fletë e shkruar, ku flitet për sukseset e një kolektivi punonjës a për zotimet që ka marrë ai ose ku bëhet thirrje për të vënë në lëvizje edhe të tjerët, duke marrë shembull nga më të mirët. Fleta e votimit. Fleta e provimit. Fleta e udhëtimit. Fleta e kontrollit. Fletë nderi. Fletë lavdërimi.

3. fig. Pjesë nga jeta e një njeriu ose nga historia e një populli, e një kombi, e një vendi etj.; faqe. Fletë e lavdishme. Hapi një fletë të re.

4. Copë e hollë, e gjerë dhe e sheshtë druri, metali, plastike etj.; diçka që ka formën e një pllake të hollë ose të një cope letre. Fletë ari (argjendi). Fletë çeliku (kallaji, llamarine). Fletë kompenstate. Fletë xhami.

5. Palë a pjesë përbërëse e diçkaje, zakonisht më e gjatë se e gjerë. Fletët e qilimit. Fletët e çadrës.

6. Secili nga dy kapakët prej druri që mbyllin derën, dritaren etj., flegër dere a dritareje, kanat. Fletët e derës (e dritares). Derë me dy fletë. Hap (mbyll) një fletë.

7. përd. mb. Që ka trajtën e një cope letre a të një pllake të hollë. Duhani fletë.

Bakër fletë.

* I vuri fletë gojës e mbylli gojën, nuk foli, e qepi, i vuri kyç gojës. E ktheu (e ndërroi) fletën (pllakën) keq. shih te PLLAK/Ë, ~A. Fletë dylli shtypshkr. letër e posaçme që përdoret për të shumëfishuar kopjet në shaptilograf. Fletë tipografike shtypshkr. fashikull me gjashtëmbëdhjetë faqe dhe me dyzet mijë shenja.

FLETË III f. 1. Krah shpendi ose insekti. Fletët e zogut. Fletët e fluturës.

2. Krah aeroplani; diçka që ka trajtën e krahëve të shpendëve ose të insekteve. Fletët e aeroplanit.

3. Penda e peshkut ose e disa kafshëve të tjera ujëse. Fletët e peshkut.

4. Pjesë e rrafshët e si lopatë, që mbërthehet në boshtin e një pende, të një rote etj. Fletët e mullirit.

* U bënë me fletë (me krahë) u gëzuan shumë nga një lajm, nga një fitore etj; dhe morën guxim e forca të reja. I ranë fletët (pendët) shih te PEND/Ë, ~A. I dolën fletë (krahë) shih te KRAH, ~U, I dha fletë (krahë) shih te KRAH, ~U. Mori fletë (krahë) shih te KRAH, ~U. Trim me fletë trim i madh; njeri shumë i zoti që çan përpara pa iu trembur vështirësive.

FOKË I f. 1. zool. Gjitari i deteve polare, me trup të madh e me qafë të shkurtër, me këmbë si lopatë, me lëkurë të mbuluar me qime të shkurtra, që ushqehet me peshq dhe që gjuhet zakonisht për t'i marrë dhjamin e lëkurës. Mish (dhjamë, lëkurë) fokë. Gjuetia e fokave. Është si fokë.

2. bised. mospërf. Njeri i trashë, i rëndë e i ngathët, që mezi lëviz.

FOKË II f. mjek. Sëmundje e rëndë ngjitëse, që shfaqet me ethe dhe me mahisje të lëkurës, të kuqtë e madh. I ka rënë foka.

FORT I ndajf. 1. Me forcë të madhe, me tërë forcën; shtrënguar me forcë, në mënyrë që të mos shqitet, të mos ndahet etj. E goditi fort. Mbaj fort. Shtrëngoji (lidhi) fort.

2. Në një shkallë të lartë, shumë. Fort i bukur. Fort e me fort. Me fort se kurrë. Shkëlqen (ndriçon) fort. E dua fort. U zemërua fort.

3. Me zë të lartë. Këndon fort. I foli (i bërtiti) fort.

II pj. Përdoret me një mbiemër a ndajfolje për të formuar shkallën sipërore, shumë. Fort i bukur. Fort i ndershmi...vjet. përdoret para emrit të një njeriu kur i drejtoheshin me fjalë ose i shkruanin letër me nderim. Fort mirë. Fort pak. Bukur (mirë) fort. * Aq me fort veçanërisht, sidomos, aq me tepër; aq me shumë. Punë e madhe fort! mospërf. shih te PUN/Ë,~A.

FORTESË I f. Kështjellë, kala.

* Fortesë ajrore (fluturuese) aeroplan bombardues i rëndë.

FORTESË II f. Rrip prej kartoni a prej një lënde tjetër të fortë, që u vihet jakave të këmishëve, majave a thembrave të këpucëve etj. për t'i forcuar.

FORUM I m. libr. 1. Mbledhje e gjerë e anëtarëve të një organi drejtues të zgjedhur të një partie a organizate tjetër, si edhe vetë ky organ; mbledhje e gjerë e përfaqësuesve të fushave të ndryshme të veprimtarisë shoqërore me karakter kombëtar a ndërkombëtar, ku shqyrtohen çështje të rëndësishme. Forumet e larta (e ulëta). Forum drejtues (udhëheqës). Forum shkencor. Forum kombëtar (ndërkombëtar).

2. hist. Shesh në Romën e vjetër ku bëheshin mbledhje të gjera të popullit, zhvilloheshin gjyqe, panairë etj.

FORUM II m. krahin. 1. Oxhaku i dhomës.

2. Sobë.

FRE I m. 1. Gojëza prej metali së bashku me rripat, e cila u vihet kuajve e mushkave për t'i drejtuar ose për t'i ndaluar. Rripat e frerit. Gojëza e frerit. I vë frerin. Tërheq (shtrëngoq, lëshoj) frerin. Ia heq frerin.

2. Gojëz prej teli, prej druri a prej një rrobe të trashë, që u vihet disa bagëtive

për të mos ngrënë ose për të mos pirë. Freri i viçit (i kecit, i demit).

3. fig. Pengesë që të detyron të qëndrosh në vend e të mos përparosh; diçka që ndalon a që vështirëson zhvillimin.

* Pa fre pa u përmbajtur; lirisht, pa asnjë kufizim. S'ka fre është i papërmbajtur; s'ka njeri që e mbikëqyr e që kujdeset për të. Ia lëshoi (ia liroi) frerin (kapistallin, kapistrën) dikujt keq. shih te LËSHOJ. Mban frerin shih te MBAJ. E mban në fre dikë e mban nën kontroll të rreptë, nuk e lë të bëjë si të dojë; nuk e lë të shkojë përpara në një fushë të veprimtarisë; e frenon. Ia shtrëngoq (ia mblodhi) frerin (rripat) dikujt shih te MBLEDH. I vë fre dikujt a diçkaje e pengoj, e ndaloj; e frenoq. Vë (fat) në fre dikë e vë nën kontroll të rreptë; përiquem ta frenoq. Ia lëshoi frerin gojës (gjuhës) filloj të flasë pa u përmbajtur, nuk matet mirë kur flet. E mori frerin nëpër këmbë nuk ka me frikë nga njeri, nuk pyet me për asnjëri, ka marrë vrull e kujton se nuk e pengon dot askush. Ia shtrëngoq frerin gojës (gjuhës) flet më me kujdes, tregohet më i matur në të folur, e mblodhi gojën. I vuri fre gojës (gjuhës) përmbahet në të folur; nuk flet shumë, tregohet më i matur në të folur. I vë fre pleshtit merret me gjëra fare të kota e të parëndësishme; krijon probleme për hiçmosgjë. Gjithkujt i duhet (i hyn në punë) një fre çdo njeri duhet të dijë kur e sa të flasë dhe si të flasë, si të silllet e të veprojë.

FRE II m. 1. Kërçelli i veshit të rrushit që mbetet po t'i heqim kokrrat. Freri i rrushit.

2. Bishti i frutit të disa pemëve e perimeve. Freri i fikut (i kungullit).

FSHIHEM I vetv. 1. Shkoj në një vend ku nuk dukem a që nuk e di njeri që të mos më gjejnë dot; futem në një vend të fshehtë për t'u ruajtur nga ndonjë rrezik. U fsheh prapa derës (pas gardhit). U fsheh në qilar. U fsheh në pyll.

2. vet. veta III fig. Gjendet në gjirin e diçkaje, ruhet e padukshme në brendinë

a në përbërjen e diçkaje. Në tokë fshihen minerale me vlerë. Fshihen rezerva të mëdha.

3. vet. veta III bised. Perëndon. U fsheh dielli.

4. pës. e FSHEH.

* Fshihet pas bregut shih te BREG,~U. Fshihet pas (prapa) gishtit (pas hijes së gishtit) shih te GISHT, ~I. Fshihet pas gjuhës së vet shih te GJUHË,~A I. Nuk fshihet derri në thes fj. u. shih te DERR,~I. Nuk fshihet (nuk mbulohet, nuk zihet) dielli me shoshë fj. u. shih te DIELL,~I. Nuk fshihet (nuk hyn, nuk futet) hosteni (minarja) në thes fj. u. shih te MINAR/E, ~JA.

FSHIHEM II vetv. 1. Fshij me peshqir a me një rrobë të thatë trupin ose një pjesë të tij pasi jam larë a jam lagur. Fshihem me peshqir (me shami).

2. Heq me furçë, me leckë etj. pluhurin ose ndonjë njollë nga rrobat a nga trupi im, pastrohem. Fshihem me kujdes (shpejt e shpejt).

3. vet. veta III fig. Nuk është më diçka, shlyhet zhduket. Fshihet nga kujtesa.

4. Pës. e FSHIJ.

FTOHEM I vetv. 1. vet. veta III. Bëhet më i ftohtë, i pakësohet të nxehtë; i ikën të ngrohtët e bëhet i ftohtë; kund. ngrohet. Ftohet moti (koha). Ftohet uji (toka, rëra). U ftoh kosi (bostani).

2. Freskohem në hije etj., flladitem. U ftohëm jashtë (në hije).

3. Marr të ftohtë, sëmurem nga të ftohtët. Është ftohur fëmija.

4. fig. Dobësoj a prish lidhjet e marrëdhëniet e mira që kisha me një tjetër nuk kam më për të dashurinë e mëparshme, largohem prej tij; vet. veta III dobësohet, zbehet, humbet gjallërinë, fuqinë e ngrohtësinë e mëparshme (për një ndjenjë etj.). U ftoh me shokët (me miqtë, me vëllezërit). U ftoh miqësia (dashuria). U ftohën marrëdhëniet. Iu ftohën dëshirat. Po ftohej biseda.

5. vet. veta III. bised. Shuhet, fiket. U ftoh drita (llamba, kandili). U ftoh zjarri. U ftohën yjet.

6. fig. bised. Qetësohem, më del inati a zemërimi, bëhem gjakftohtë. Ftohu pak dhe merre më shtruar!

7. euf. Vdes.

8. Pës. e FTOH.

* Nuk më ftohen fasulet thjeshtligj. shih te FASUL/E,~JA. U ftohën (u ulën, u shuan. u shtruan, u zbutën) gjakrat shih te GJAK,~U I. Iu ftoh gjaku shih te GJAK,~U I. Nuk më ftohet pilafi (byreku) thjeshtligj. shih te PILAF,~I. Iu ftoh zemra shih te ZEM/ËR,~RA. T'u ftohtë zemra! mallk. vdeksh!

FTOHEM II Pës. e FTOJ.

FUGË I f. 1. zool. Femra e bengut.

2. fig. Vajzë trupvogël, e shëndoshë dhe e ngathët.

FUGË II f. 1. Zjarr, flakë. I vuri fugën. I doli fuga në majë (mbi çatë).

2. Vapë e madhe, të nxehtë i madh. Fugë e madhe. Sot është fugë.

3. fig. bised. Hov, vrull.

* E bëri fugë dikë a diçka e dogji fare, e bëri shkrumb e hi. I vuri fugën diçkaje e rrënoi krejt, e prishi fare.

FUGË III f. krahin. 1. Vrap, fugim. E ka fugën të shpejtë. Merr fugë nxiton, ikën me vrap. Merr me fugë diçka nxitohet, e merr me vrap, ngutet.

2. Shtjellë, vorbull. Fugë ere. Fugë lumi.

3. përd. ndajf. bised. Menjëherë, shumë shpejt, fluturimthi. U nis fugë për në shtëpi. Erdhi fugë.

FUGË IV f. 1. Lodër fëmijësh: një kon prej druri me majë metalike, i cili mbështillet me pe dhe hidhet në tokë që të rrotullohet rreth vetes. Hedh fugën, përdridhet si fugë.

2. Lodër fëmijësh: një copë dërrasë, e lidhur me pe të fortë, me anën e të cilit rrotullohet në ajër.

3. Lodër fëmijësh: një bosht i drunjtë, i rrumbullakët e i dhëmbëzuar, i cili rrotullohet me anë të një doreze e trokëllin fort; rrake. Zhurma e fugës. Tund fugën. Luan me fugë.
4. tek. Pjesë e një mekanizmi në trajtë të rrumbullakët, që rrotullohet rreth një boshti. Fugë e madhe.
- FUNT** I m. Njësi peshe e barabartë me rreth 500 gramë. Funti anglez njësi peshe e barabartë me 453,6 gramë. Funti gjerman njësi peshe e barabartë me 409,5 gramë. Funti i farmacisë njësi peshe që përdoret në farmaci dhe që është e barabartë me 307,3 gramë.
- FUNT** II m. Njësia monetare bazë e Anglisë dhe e Irlandës së Veriut; monedhë që ka këtë vlerë.
- FUREM** I vetv. 1. Mbytem me litar a me diçka tjetër që më shtrëngon a më zë grykën; varem në litar. U fur në lak. U fur me ujë.
2. vet. veta. III (me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor në r. dhanore). Më mbetet diçka në grykë, më ngec në fyt, mbytem. Iu fur buka.
3. Pës. e **FUR**.
- * Iu fur shpirti u mërzit shumë, i ka ardhur shpirti në maje të hundës.
- FUREM** II vetv. 1. Hyj menjëherë diku, futem me rrëmbim; rrasem. U fur drejt e në dhomë.
2. fig. I sulem dikujt a diçkaje; i turrem me vrull një pune a diçkaje tjetër. Ia furën armikut. I furem punës. Iu fur gjithë inat.
- FUSTË** I f. 1. Fund i gjerë grash a vajzash, fund. Vesh fustën.
2. Këmishë e brendshme për gra ose për vajza.
- FUSTË** II f. vjet. Lloj barke e shpejtë, që përdoret për qëllime luftarake.
- FUTËS** I m. 1. Punëtori që fut tullat në furrën e pjekjes.
2. tek. Pajisje ose pjesë e një mekanizmi që shërben për të futur brenda diçka. Futësi i kapsulës.
- FUTËS** II m. Kredharak.
- GABË** I f. krahin. Gafë. Flet (lëshon) gaba. Ka bërë disa gaba.
- GABË** II f. zool., krahin. Shkabë. U bë si gabë u dobësua sa i duken kockat.
- GAJTAN** I m. 1. Shirit ose gjalmë i përdredhur prej mëndafshi, leshi a pambuku, që u vihet anës veshjeve a rrobave për stoli ose për të mos u dalë thekët; fill i trashë e i përdredhur prej ari, argjendi ose mëndafshi, me të cilin qëndisen a stolisen veshjet kombëtare. Gajtan i zi (i kuq). Gajtan ari (argjendi). Gajtan mëndafshi. Thur gajtan. I vë gajtan.
2. përd. mb. poet. I hollë e i drejtë (zakonisht për vetullat). E ka vetullën gajtan.
- * E sjell gajtan muhabetin e vërtit si të dojë, e dredh sipas qejfit.
- GAJTAN** II m. Ka ose cjaq me qime të murme; ka i zi me disa vija si të kuqe.
- GARGARIT** I jokal. Shpëlahj grykën për qëllime mjekimi me ndonjë bar të lëngshëm, të cilin e bëj të gurgullojë në gojë, duke e mbajtur kokën lart e nga pas, bëj gargarë.
- GARGARIT** II jokal. 1. Nxjerr një zë të veçantë, të fortë e të ndërprerë (për bretkosën), kuak. Gargaritin bretkosat.
2. zakon. veta III fig. bised., mospërf. Nxjerr një zë si te bretkosës; dërdëllit.
- GARGË** I f. zool. Bregcë.
- GARGË** II f. krahin. 1. Gëzhjojë fisheku.
2. fig. Gërdallë.
- GASHTË** I f. Kupa e gjurit
- GASHTË** II f. Gur grihës, grihë; gur i fortë në ngjyrë të zezë që përdoret për të provuar arin dhe argjendin. Mpreh me gashtë. Provoj me gashtë.

GAZ I m. 1. Trup zakonisht pa ngjyrë e i padukshëm, që në trysninë dhe në temperaturën e zakonshme është në një gjendje fizike si ajri a si avulli dhe përhapet lehtë e mbush plotësisht çdo hapësirë; lëndë e tillë që del nga nëntoka dhe përdoret për djegie a për ndriçim; lëndë e tillë që çlirohet nga disa trupa; lëndë e tillë që dëmton a helmon organizmin. Gaz i rrallë (fisnik). Gaz i thatë (i lëngshëm). Gaz i plogët gaz që nuk bashkëvepron a nuk lidhet kimikisht me lëndë të tjera. Gaz karbonik. Gaz sulfuror.

Gaz metan. Gaz natyror. Gaz i djegshëm (ndriçues). Gaz lotsjellës (helmes).

Gazrat e naftës. Gazi i minierave (i kënetave). Gaz pa ngjyrë (me ngjyrë). Vetitë e gazit. Lëngështimi i gazit. Shkëmbimi i gazeve. Dhoma e gazit dhomë ku fashistët dhe imperialistët mbytin të burgosurit a robërit e luftës me gaz helmues. Ujë me gaz.

Balonë me gaz. Stufë me gaz. Ngrohje me gaz. Bombë me gaz. Mbush me gaz.

Punon me gaz.

2. Lënda djegëse e lëngët (benzinë, naftë etj.) e cila futet në trajtë piklash në motorët e ndryshëm dhe digjet aty për t'i vënë këta në lëvizje. I jap gaz (i pakësoj gazin) motorit. Shkel gazin shkel një këmbëz të posaçme për t'i dhënë motorit të automjetit më shumë lëndë djegëse.

3. vet.. ~RA., ~RAT. Lëndë në trajtë të gaztë që dalin nga stomaku a nga zonët.

Gazrat e stomakut (e zorrëve). Ka gazra.

4. bised., vjet. Vajguri. Llambë (kandil) me gaz. Enë për gaz.

5. krahin. Bishtuk me vajguri. Ndez (shuaj) gazin.

* Ia shkeli gazin thjeshtligj. shih te SHKEL.

GAZ II m. 1. Ndjenjë gëzimi e kënaqësie; gjendje e gëzueshme; gëzim.

Gaz i madh (i papërshkrueshëm). Gazi i punës (i fitores). Lot gazi. Gjithë (plot) gaz e hare. Ndien gaz. Këndon me gaz. Fluturonte nga gazi. I sjell gaz. E kemi për gaz të vdesim për vendin tonë.

2. Të qeshura të forta e me zë të lartë që shprehin gëzim; e qeshur.

Me buzë në gaz (me gaz në buzë) duke qeshur, me gëzim, buzagaz.

Shkrihet (shkulet, vdes, fiket) gazit qesh me të madhe. Mbjaj gazin. Krisi (pushoi) gazi.

Ia plasi gazit. I hipi gazi. Vë (çoj, shpie, bëj) buzën në gaz qesh pakë, buzëqesh.

Iu tha gazi në buzë pushoi menjëherë së qeshuri nga diçka e papëlqyer që i erdhi papritur.

3. edhe~E, ~ET. Ngjarje e shënuar që i sjell njeriut gëzim e kënaqësi, rast i gëzueshëm; festimi i kësaj ngjarjeje; gëzim. Gazi i parë (i fundit). Gaz për derë! ur.

Për gaz e për të mira! ur. Gaz paç! ur. Qoftë për gaz! ur.

U mblodhën për gaz (për gazin e fëmijës). Kemi shumë gaze përpara.

4. bised. Dikush a diçka që na sjell gëzim e kënaqësi të veçantë.

Gazi i zemrës (i prindërve, i nënës). Ai është gazi i shtëpisë.

5. Shaka, tallje, hoka; shpoti. Bën gaz me shokët. Vënë gaz dikë. E pati me (për) gaz.

Foli për gaz. U bë për gaz. U bë gazi i botës (i dheut, i shoqërisë).

6. vjet. Qejf, zbavitje, dëfrim. Udhëtonte për gaz e jo për punë.

7. bised. Çifti që martohet (dhëndri dhe nusja). Gazi të trashëgohet! ur.

GAZOJ I kal. Ngop me gaz karbonik ujin a një pije, i fut gaz (një lëngu). Gazoj ujin (verën).

GAZOJ II kal. E vë në lojë, e tall dikë; shpotit.

- GDHE** I m. 1. Nyell i fortë në trungun a në degët e një druri. Gdheri i pishës. Dru me gdhe.
Shkop me gdhenj. Dërrasë me gdhe.
2. fig. Njeri i trashë nga mendja, njeri i pagdhendur; njeri që s'merr vesh çfarë i thonë, kokëfortë.
* E ka kokën gdhe është shumë kokëfortë, nuk ha fjalë e arsye.
- GDHE** II m. Pisha e zezë, borigë. Dërrasë gdheri.
- GËRDEC** I m. mjek. Sifiliz. Të rëntë gërdec! mallk.
- GËRDEC** II m. 1. bot. Shkurre e vogël e viseve të ftohta malore, me lule si vile të bardha a të kuqërreme e me gjethe të trasha, që përdoren në mjekësinë popullore për sëmundjet e veshkave a të fshikëzës së ujit.
2. përd. mb. I ngurtë e i fortë si i ngrirë; i pazier ose i papjekur mirë (për mishin). Mishi qenka gërdec.
* U gdhi gërdec
a) u gdhi me trupin si të ngrirë;
b) u gdhi i vdekur, u gdhi kallkan.
- GËRHAÇ** I m. Njeri që gërhet shumë në gjumë.
- GËRHAÇ** II m. 1. veter. Sëmundje që u bie pulave në fyt e s'i lë të marrin frymë.
2. mjek. Kolla e mirë.
- GËRMAJË** I f. Vend i gërmuar si guvë.
- GËRMAJË** II f. krahin. 1. Grumbull, shumicë.
2. përd. ndajf. Në sasi të madhe, plot e përplot; grumbull. U mblodhën gërmajë. Ishte gërmajë me njerëz.
- GËRMICË** I f. veter. shih GËRMIT/Ë,~A.
- GËRMICË** II f. krahin. Zverk. Thesh gërmicën! mallk.
* Theu gërmicën mospërf. vdiq.
- GËRTHAC** I m. zool. Greth.
- GËRTHAC** II m. bot. Ullastër.
- GIC** I m. 1. I vogli i derrit, derrkuc. Gic mashkull (femër).
2. fig. përk. Fëmijë topolak, fëmijë shumë i shëndoshë.
3. Gur i vogël i rrumbullakët, guralec.
- GIC** II m. shih BIC/E,~JA 1.
- GOCË** I f. Vajzë, çupë. Gocë e vogël. Gocë e bukur (e mirë). Martoi gocën. Ka dy goca.
- GOCË** II f. zool. Butak i vogël deti, i mbështjellë me një guaskë të fortë e të ndritshme, të ndarë në dy pjesë; guaska që mbështjell këtë butak. Goca të bardha (të zeza). Goca deti.
- GODI** I f. bised. Marrëveshje, ujudi. Bie në godi merrem vesh me dikë për diçka. Arrij në godi. Lidh (bëj) një godi.
- GODI** II f. bised. Zbukurim, stolisje. I ka hije godia. Me mirë një godi se nëntë bukuri. fj.u.
- GODIT** I kal. 1. I bie dikujt a diçkaje me dorë, me këmbë a me një send tjetër, qëlluj dikë; e rrah. E goditi me dorë (me grusht, me pëllëmbë). E goditi me këmbë (me shkelm). E goditi me guri. E goditi me kamxhik. E goditi në fytyrë. (me kokë). Godit fort (rëndë, lehtë).
2. usht. Shtie a qëlluj me armë zjarri kundër dikujt a diçkaje; sulmoj dikë a diçka. Godit armikun. Godit me artileri. Godit aeroplanin me kundërajror.
3. sport. I bie topit me forcë (me dorë, me këmbë ose me kokë) në një drejtim të caktuar. Godit topin. Godit me dorë (me këmbë, me kokë).
4. krye. veta III. Prek diku a diçka me forcë, rreh diçka; i bie, e merr (plumbi etj.). Topi goditi shtyllën (në shtyllë). Plumbi e goditi në shpatull.
5. Lëndoq a plagos një pjesë të trupit duke përplasur a duke u përplotur pas diçkaje, vras. Goditi dorën (këmbën). Goditi kokën (ballin).

6. vet. veta III. E lë në vend, e vret; i bie rrufeja; i bie një sëmundje e rëndë dhe e papritur etj., e cila bën që të humbasë vetëdijen ose i shkakton vdekjen menjëherë. E goditi rrufeja. E goditi dielli. E goditi. bised. i ra pika; i ra damllaja. E goditi në zemër vdiq menjëherë nga zemra.

7. fig. Qortoj rreptë dikë për gabimet e të metat e tij, për qëndrimin a sjelljen e tij me qëllim që të ndreqet; vë në dukje me forcë gabimet e të metat për t'i zhdukur këto; kritikoj rëndë. Godit dembelët (parazitët, rrugaçët). Godit gabimet (dobësitë veset). Godit pikëpamjet e gabuara (zakonet prapanike). Godit ashpër. E goditi pas shpine (prapa krahëve).

8. fig. Dëmtoj rëndë a shkatërroj krejt dikë a diçka, i jap dërrmën, e shpartalloj. Godit kulakët. Godit armiqtë e popullit. Godit sektorin privat. Godit pa mëshirë.

9. vet. veta III. E prek, e kap një e keqe, që i shkakton dëm të madh. E goditi thatësira. E goditi tërmeti. I goditi kriza ekonomike. E kanë goditur shumë fatkeqësi (të këqija).

10. (zakon. me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor të r. kallëzore). Më prek thellë në ndjenja, më ther. Më goditi në zemër.

11. jokal. vet. veta III. Rreh me një trokitje (për zemrën, damarët, tëmthat ose për një mekanizëm). Godet zemra. Goditin damarët (tëmthat).

12. jokal. vet. veta III bised. Bie (për orën e murit). Ora goditi dymbëdhjetë.

13. jokal. fig. E kam qëllimin diku, synoj diku, rrah. E di ku godet ai. Aty godet ajo fjalë. Godet larg ai me këto fjalë.

14. jokal. pavet. Ndodh, rastis, qëllon. Godit të vijë. Goditi që u ndodha në shtëpi.

* Goditi (qëlloi) në shenjë shih te SHENJ/Ë, ~A.

GODIT II kal. 1. Ndërtoj. Godit një shtëpi (një urë, një rrugë).

2. Ndreq, rregulloj diçka të prishur, meremetoj. Godit karrigen (orën, këpucët).

3. Vë diçka në vendin e vet, e vë në rregull, ujdís, rregulloj, ndreq. Godit dhomën (shtëpinë). Godit tryezën. Godit plaçkat.

4. Stolis, zbukuroj. Godit nusen. Godit flokët.

5. I shtoj diçka për ta bërë më të shijshme a më të mirë (një gjellë etj.), ujdís, ndreq. Godit gjellën. E goditi me erëza.

6. bised. Hartoj, shkruaj, bëj, sajoj (një vjershë etj). Goditi një vjershë. Goditi një këngë.

GODITEM I vetv. 1. Zihem me grushte, me shkëlma etj. me dikë, rrihem. U goditën keq. I ndau se po goditeshin.

2. usht. Ndeshem në luftë me dikë, përleshem. U goditëm me fashizmin.

3. Pës. e GODIT I.

GODITEM II vetv. 1. Stolisem, zbukurohem; rregullohem. Po goditej nusja. Goditet para se të dalë.

2. Merrem vesh me dikë, bie në ujdí. Goditemi bashkë.

3. Pës. e GODIT II.

GODITËS I m. tek. Pjesë e një makine, e një mekanizmi etj. që gjatë punës godet si çekiç; rrahës. Goditës i rëndë.

GODITËS II m. Ai që ndërton diçka të re; ai që ndreq a rregullon diçka të prishur.

GODITJE I f. 1. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljeve GODIT I, GODITEM II. Goditja e objektivit. Goditja e veseve (e të metave, e zakoneve prapanike). Goditje me kokë (me dorë, me grusht, me këmbë). Goditje dënimi. sport. Goditje me armë (me pushkë, me artileri). Aksion me goditje të përqendruar aksion me forca të shumta, që përqendrohen në një punë e shfrytëzojnë të gjitha mundësinë për ta mbaruar shpejt e mirë.

2. Grushti a pëllëmba që i japim dikujt; shkëlmi që i japim dikujt kur e godasim a diçkaje kur e gjuajmë; ajo që pësojmë kur dikush a diçka na godet e na dëmton. Goditje e fortë (e fuqishme, e lehtë). Goditja nga dielli. Jap (marr) goditje.

3. usht. Sulm vendimtar e i befasishëm, që i jepet armikut me të gjitha forcat e me të gjitha mjetet ose me pjesën e tyre kryesore. Goditja kryesore (vendimtare, vdekjeprurëse). Goditja në krahë.

4. kryes. Rrahjet e zemrës, të një mekanizmi etj.; zhurma që dëgjohet kur goditim diçka me dorë, me çekiç etj.; trokitje. Goditjet e zemrës.

GODITJE II f. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve GODIT II, GODITEM II. Goditja e shtëpisë (e urës). Goditja e orës (e këpucëve).

GODITUR I mb. 1. Që ruan shenjat e lëna nga një goditje. Vendi i goditur.

2. fig. Që është thënë a është bërë mirë e me vend; i zgjedhur mirë, i qëlluar; i përshtatshëm. Mendim i goditur. Fjalë (përgjigje, figurë) e goditur. Tip (personazh) i goditur. Martesë e goditur.

3. fig. I mahnitur, i shtangur, i ngrirë (nga frika, nga habia, nga diçka e papritur etj.). Mbeti i goditur.

GODITUR II mb. 1. Që është ndrequr a është rregulluar (për diçka që ka qenë prishur), i meremetuar, i ndrequr. Shtëpi e goditur.

2. I rregulluar mirë, i ujditur; i zbukuruar. Dhomë e goditur. Nuse e goditur.

3. Që i është hedhur diçka për ta bërë më të shijshme, i ndrequr (për një gjellë). Gjellë e goditur.

GRADË I f. 1. Njësi e matjes së temperaturës, të shtypjes atmosferike etj.; shenja me vijë ose me shifër në një aparat a në një vegël që shërben për të matur temperaturën, shtypjen atmosferike etj.; shkallë. Gradat e termometrit (e barometrit). Dy grade nën zero. Në temperaturën njëzet grade.

2. ~Ë, ~ËT gjeom. Njësi e matjes së këndit ose të harkut, e barabartë me një të treqindegjashtëdhjetën pjesë të rrethit (simboli °); shenja me vijë ose me shifër në një aparat a në një vegël që shërben për të matur këndet ose harqet. Gradë këndore (harkore). Kënd nëntëdhjetë gradë.

3. ~A, ~AT bised. Termometër. Vë (heq) gradën.

4. ~Ë, ~ËT. Njësi e matjes së dendësisë së nja lëngu ose të sasisë së alkoolit në të. Sa gradë është kjo raki?

5. ~Ë, ~ËT gjeogr. Njësi matjeje e barabartë me një të treqindegjashtëdhjetën pjesë të paralelit a të meridianit. Gradë gjeografike. Gradë e gjerësisë veriore (jugore).

6. ~A, ~AT usht. Secila prej shkallëve të hierarkisë ushtarake; emërtim i çdo shkalle dhe shenja dalluese e saj (në ushtritë që kanë shkallë të tilla). Gradë oficeri. Gradë koloneli. Heqja e gradave.

7. ~Ë, ~ËT muz. Secili tingull në shkallën muzikore që shënohet me shifër nga nota e ulët deri në më të lartën. Grada e parë (e dytë, e tretë...).

8. ~A, ~AT. Emërtim që i jepet një punonjësi shkencor a mësimit ose një specialisti të lartë të prodhimit pasi ka plotësuar kërkesat e shkallës së parë a të dytë të kualifikimit pasuniversitar. Grada shkencore «kandidat i shkencave» («doktor i shkencave»).

9. ~Ë ~ËT mat. shih SHKALL/Ë, ~A 19. Ekuacion i gradës së parë (së dytë).

10. Rend a hallkë në një sistem të shkallëzuar; shkallë, instancë. Gjykim i gradës së parë (së dytë).

11. fig. Shkallë, gjendje; cak. Në gradën e fundit në gjendje shumë të rëndë a shumë të keqe. Në ç'gradë ka arritur puna? Gjer më një farë grade.

GRADË II f. krahin. 1. Çerdhe zogjsh nëpër drurë. Gradë zogjsh.

2. Trinë e rrumbullakët prej degësh, për të çelur mëndafsh.

- GRAFIK I mb.** 1. Që paraqet me anë vijash e figurash gjendjen dhe ecurinë e një pune a të një dukurie, zhvillimin e një veprimtarie, luhatjet e temperaturës gjatë një sëmundjeje etj. Pasqyrë grafike. Paraqitje grafike.
2. Që pasqyron në mënyrë të qartë e të përpiktë sasinë e punës dhe kohën që duhet për ta kryer këtë. Plan grafik.
- GRAFIK II mb. art.** Që ka të bëjë me grafikën, që i përket grafikës, i grafikës. Artet grafike. Ekspozitë (punime) grafike. Stil grafik.
- GRAFIK III mb. gjuh.** Që ka të bëjë me grafinë, që i përket grafisë, i grafisë. Sistemi grafik. Shenjë grafike.
- GRAFIKISHT I ndajf.** Me anë të një grafiku, me grafik. Paraqitet grafikisht zhvillimi i ekonomisë.
- GRAFIKISHT II ndajf.** Me anë to shenjave grafike. Paraqet tingujt grafikisht.
- GRAM I m.** 1. Njësi e matjes së peshës, e barabartë me peshën e një centimetri kub ujë të pastër në temperaturën 4 shkallë Celsius (shkurtimi g); guri i peshores që ka këtë peshë. Një gram. Peshon dyqind gramë. Një mijë gramë bëjnë një kilogram.
2. fig. Diçka e paktë, sasi shumë e vogël, thërrime, çikëz. Nuk mbeti asnjë gram. Nuk lëshon asnjë gram. Pesë gramë mend ka është fare i papjekur; është shumë mendjelehtë.
- GRAM II m. bot.** Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të nyjzuar e zvarritës, me gjethe të sheshta, të holla e të gjata, që rritet i shtrirë për tokë bashkë me të lashtat, më bimët prashitëse ose anës arave dhe që përdoret si ushqim për bagëtinë; krisje. Gram i trashë. Gram zvarritës. Rrënjët e gramit. Shkul gramin.
- GRASIM I m.** Veprimi sipas kuptimeve të foljeve GRASOJ, GRASOHET. Grasimi i makinës (i tornos, i pushkës). Pompa e grasimit. Bëj grasimin grasoj.
- GRASIM II m.** Përkore, qokë (në të ngrënë e në të pirë).
- GRASOJ I kal.** Lyej me graso një makinë, një mekanizëm ose pjesët e tij, në mënyrë që të punojnë me mirë dhe të ruhen nga ndryshku, nga lagështia etj. Grasoj makinën (motorin, rrotat). Grasoj pushkën.
- GRASOJ II jokal.** Jam i përkorë, përmbahem në të ngrënë e në të pirë.
- GRILL I m.** 1. Lloj guri i butë e petë-petë, me ngjyrë të hirtë, që thërrmohet lehtë.
2. Tokë që nuk prodhon, grillishtë.
3. Përd. mb. sipas kuptimit 2 të emrit. Tokë (vend) grill.
- GRILL II m. bot.** Shkurre zbukuruese, e cila rritet deri në dy metra e lartë, me gjethe trifletëshe e me lule të verdha në trajtë vileje, që lidhin fryte si bishtaja.
- GRIP I m. mjek.** Sëmundje ngjitëse, që shkaktohet nga një virus, që shfaqet me pezmatim të organeve të frymëmarrjes, me ethe, me dobësi të përgjithshme trupore etj. dhe që përhapet zakonisht si epidemi. Grip i fortë (i rëndë). Gripi spanjoll. Vaksinë kundër gripit. Ka grip. Është me grip. E zuri gripi. Ruhuni nga gripi!
- GRIP II m.** Pëllumb i bardhë me pika të zeza.
- GRISË I f. krahin.** 1. vet. Spica, kalla. Shtie grisa.
2. Grindje. Janë në grisë.
- GRISË II f. krahin.** 1. E grisur. I dukej mishi nëpër grisa.
2. vjet. Xhep. Mbush (zbraz) grisat.
3. Gërvishtje, e çjerrë. Një grisë e vogël në dorë. Grisë pa gjak.
- GROSHARE I f.** 1. vjet. Groshar.
2. Dele me pulla të kuqe ose kafe në turi; dele me pikla. Humbi grosharja.
- GROSHARE II f.** shih GROSHOR/E,~JA.
- GRYKËS I m.** Ai që ha shumë, ai që lakmon shumë në të ngrënë, hamës i madh, llupës. Grykës i madh.

- GRYKËS** II m. 1. Grykëza e parmendës.
2. Rreth hekuri që mban të mbërthyer bucelën e rrotës së qerres.
- GRYKËSE** I f. Fem. e GRYKËS, ~II. Grykëse e madhe.
- GRYKËSE** II f. 1. Veshja e sipërme prej pël-hure, e hapur përpara ose prapa e zakonisht me mëngë të gjata, që mbahet gjatë kohës së punës, në shkollë, në kopsht etj.; përparëse. Grykëse e bardhë (e zezë). Grykëse pune (shkolle). Vajza me grykëse. Vesh (heq) grykësen.
2. Këmishë burrash e mbyllur dhe e qëndisur, zakonisht pa jakë.
3. Jelek grash i qëndisur.
4. Jakë fustani që mbërthehet në grykë, jakë.
5. Qafë çorapi.
- GRYKJE** I f. 1. shih GRYKËS/E, ~JA 2.
2. shih GRYKËS/E, ~JA 3.
3. Jaka e këmishës; grykëz.
- GRYKJE** II f. Enë uji me grykë të lartë e të ngushtë.
- GUGASH** I m. zool. 1. Guhak.
2. Mashkulli i kumrisë.
3. fig. përk. Djalë i pastër dhe i bukur, pëllumb. Fli, gugashi i nënës!
- GUGASH** II m. Harku i lahutës.
- GUGUSHE** I f. Kumri.
- GUGUSHE** II f. bot. Lulja e lofatës.
- GUNISHTE** I f. Gunë e vogël dhe jo shumë e trashë; gunë për fëmijë.
- GUNISHTE** II f. bot. Bimë barishtore me fletë të vogla si të ullirit e të mbuluara me push, që çel lule ngjyrëmanushaqe.
- GJAKPIRËS** I m. Ai që shtyp e shfrytëzon pamëshirë të tjerët, shfrytëzues i egër dhe i pamëshirshëm që u pi gjakun të tjerëve. Gjakpirësit e popullit.
- GJAKPIRËS** II m. zool. Kafshë a kandërr që ushqehet duke thithur gjak.
- GJAKPIRËS** I mb. Që shfrytëzon egërsisht e në mënyrë të pamëshirshme; që mbështetet në shfrytëzimin e egër dhe të pamëshirshëm. Sundues (pronar, kapitalist) gjakpirës. Regjim gjakpirës.
- GJAKPIRËS** II mb. zool. Që ushqehet duke thithur gjak. Kafshë gjakpirëse. Insekt gjakpirës.
- GJEL** I EGËR zool. Shpend i madh i ngjashëm me këndesin, me pendë të zeza, me zë të çjerrë, që rron nëpër pyje; gjelegër.
- GJEMB** I BARDHË bot. Bimë e egër shumëvjeçare me gjethe të zgjatura e me gjemba, që rritet nëpër ara.
- GJEP** I m. 1. Shkop a kallam i hollë e i shkurtër për të mbështjellë perin që vendoset në sovajkë; masur. Mbush gjepat. Vë (heq, ndërroj) gjepin. U mbarua gjepi.
2. Gyp i hollë dhe i shkurtër; lëfyty, çep. Gjepi i kades. Gjepi i kroit.
3. Gypi i ngushtë në fund të lugut të mullirit.
- GJEP** II m. Enë me grykë të ngushtë e me lëfyty të hollë; ibrik.
- GJËLLIJ** I jokal. 1. vjet. Jetoj, rroj. Ka gjëllirë shumë. Gjëllinte ende. Gjëllinin në një shtëpi.
2. fig. Ha e pi dhe bëj një jetë të zbrazët, nuk bëj ndonjë punë me vlerë për shoqërinë, rroj sa për të ngrënë.
3. vet. veta III. Jeton një kafshë në një vend a mjedis të caktuar, është e përhapur. Gjëllin në ujë. Gjëllinin gjithfarë kandrash.
- GJËLLIJ** II kal. 1. vet. veta III. Kërkon andejkëtej ushqim duke e zgjedhur, qëmton (për shpendët e kafshët). Gjëllin pula. Gjëllin lopa. Gjëllin nëpër bar.
2. Zgjedh diçka duke kërkuar, qëmtoj. Gjëllij ca ullinj. Gjëlliu ca dërrasa.
3. I jap të hajë, e ushqej.

GJËMË I f. 1. Fatkeqësi e rëndë, mynxyrë e madhe, e lidhur zakonisht me vdekje; e zeza. Gjëmë e madhe (e zezë). E gjeti (e zuri) gjëma. Të rëntë gjëma! mallk. I lëshoi një gjëmë e mallkoi që ta gjejë një fatkeqësi, e mallkoi rëndë.

2. Lajmi i vdekjes, që u çohet të afërmeve, mandate. I erdhi gjëma.

Të ardh të gjëma! mallk.

3. etnogr. Vajtme me britma që bëhej në rast vdekjeje; britmë që nxirrej gjatë këtij vajtmi, britmë vajtuese. Shkoi për gjëmë. Vajtonte me gjëmë. Nisi (lëshoi, dha) gjëmën. Zunë gjëmën. Krisi (pushoi) gjëma. I bënë gjëmën. Të bëfsha gjëmën! mallk.

4. Sasi e madhe e diçkaje. Një gjëmë para.

5. bised., keq. Diçka e keqe dhe e shëmtuar, që mezi durohet. Ç'e ke atë gjëmë!? S'e shoh dot me sy atë gjëmë!

* Bën gjëmë vajton me britma, qan me kujë e ulërimë. Të bën gjëmën të sjell a të shkakton një fatkeqësi të madhe, të bën të keqen, të bën atë që s'ta ka prerë mendja.

GJËMËMADH I mb. 1. Që sjell a shkakton një fatkeqësi të madhe; që ndjell fatkeqësi a gjëmë. Rrebesh gjëmëmadh. Vdekje gjëmëmadhe. Humbje gjëmëmadhe. Fjalë gjëmëmadhe.

2. Që i ka rënë një fatkeqësi e rëndë; që ka vuajtur shumë, fatkeq; si mallk. që i rëntë një gjëmë.

3. Përd. em. sipas kuptimit 2 të mbiemrit.

GJËMËMADH II mb. 1. Që ka gjëmim të madh; që ka ushtimë të madhe. Bubullimë gjëmëmadhe.

Zë gjëmëmadh. Buçimë gjëmëmadhe.

2. fig. Që ka bërë bujë, që është shumë i dëgjuar; bujëmadh. Fitore gjëmëmadhe. Emër gjëmëmadh.

3. keq. Që bën shumë zhurmë e bujë, që ankohet në të katër anët, zhurmëmadh. Njeri gjëmëmadh.

4. Përd. em. sipas kuptimit 3 të mbiemrit.

GJËMOJ I jokal. 1. pavet. Ushton një krismë e fortë, një zhurmë e madhe dhe e zgjatur pas vetëtimës, bubullin. Gjëmon moti. Gjëmon për shi. Po gjëmon andej nga deti. Nuk gjëmon po s'vetëtiu. fj. u.

2. vet. veta III. Lëshon një zhurmë të fuqishme, të mbytur e të zgjatur; jehon nga tinguj a nga zëra të fuqishëm; ushton; uturin; buçet. Gjëmojnë topat. Gjëmojnë malet. Gjëmon deti (vala). Gjëmon traktori. Gjëmon salla nga duartrokjet. Gjëmonte shtëpia nga gëzimi. Më gjëmojnë veshët më uturijnë veshët.

3. vet. veta III. Dëgjohet gjithandej me fuqi, tingëllon e përhapet me forcë, ushton, buçet. Gjëmon kënga. Gjëmon zëri i komandantit.

4. Flas me zë të lartë e të ashpër, bërtas. I gjëmoi të birit.

GJËMOJ II kal. 1. vjet. Qaj me zë një të vdekur sipas zakonit, i bëj gjëmën.

2. jokal. Rënkoj mbyturazi nga dhembja ose nga një fatkeqësi.

GJËMOJ III kal. bised. 1. edhe jokal. Ndjek nga pas me vrap; gjurmoj. I gjëmoi nga prapa. E gjëmoi këmba-këmbës. Ky zagar e gjëmon shumë lepurin.

2. jokal. Vrapoj. Gjëmo këtej, gjëmo andej, u lodh.

3. fig. I bie pas një pune, e ndjek. I ka gjëmuar shumë kësaj pune.

HANE I bised. ndajf. 1. Shumë kohë më parë, prej kohësh, qëkur. Ka hane që ka ardhur. Ka hane që është gati.

2. Dikur, në kohët e para. Hane këtu punonin gratë. Hane këto rroba i vishnin burrat.

HANE II pj. 1. Përdoret për të dhënë shkallën më të lartë të habitës. Hane sa i thellë! Hane sa i gjatë! Hane sa larg! Hane sa do kjo punë!

2. Përdoret e përsëritur kur kemi një kundërvënie, një mospajtim a mospërputhje, me kuptimet «ku; tjetër; çfarë».

Hane ti, hane ajo. Hane ç'them unë, hane ç'thua ti. Hane tas, hane hamam tjetër flas unë, e tjetër thotë ai.

* Hane ku në një vend të largët, diku larg. Hane kur në një kohë të largët e të papërcaktuar.

HAPËS I m. Çelës. Hapësi i derës (i valixhes). Mbyll (çel) me hapës.

* I hodhi hapëset shih te HEDH. S'është në hapës nuk është në rregull nga mendja. Ka (mban) hapëset (çelësat) e kashtës iron. shih te KASHT/Ë,~A.

HAPËS II m. Punëtor që merret me hapjen e gropave, të puseve etj. Hapës pusesh.

Hapës varresh varrmihës.

HARMOÇ I m. 1. bot. Pisha e butë. Pyll me harmoçë. Dru harmoçi.

HARMOÇ II m. 1. Llaç i shkoqur, i përzier me gurë të vegjël që kanë rënë prej mureve.

2. krahin. Hurdhë përroi; vend i gërryer a gropë e vogël zakonisht në shtratin e një përroi.

HARRJE I f. zool. Kandërr shumë e vogël, me krahë të bardhë e të tejdukshëm, që del zakonisht në kohë të vapës, fluturon tufatufa duke lëshuar një zë të hollë, që hyn në sy a në vesh ose të pickon lëkurën. Iu ngjitën harrjet. Na hëngrën (na grinë) harrjet.

Është si harrje të bezdis e të mërzit vazhdimisht, është shumë i mërzitshëm.

* Iu bë harrje dikujt iu qep dikujt dhe e mërziti shumë, e bezdisi tej mase.

HARRJE II f. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve HARR, HARRET. Harrja e parë (e dytë). Harrja e grurit (e misrit). Harrja e barërave të këqija. Harrja e pemëve. Bënë harrjen.

2. Rrallishtë misri, harrë, bitërr. Mblodhi harrjet. U hedh harrje lopëve.

HEQËS I m. anat. 1. Eshtë e hollë, e gjatë dhe e lakuar, që bashkon kockën e gjoksit

me supin; kocka e gjoksit të shpendëve, shpori. Heqësi i pulës. Ka thyer heqësin.

2. Kunji që bashkon shtizën e parmendës me zgjedhën; shtiza e qerres.

Heqësi i parmendës. Heqësi i qerres.

3. bised. Ai që qëllon mirë me pushkë, qitës i mirë. Heqës i zoti.

4. bised. Kandar me bisht. E peshoj me heqës. E vë në heqës i vajti thika në heqës arriti në një gjendje shumë të vështirë sa s'durohet më; i vajti thika në kockë.

HEQËS II m. 1. Thikë e përkulur e me dy doreza, që përdoret për të gdhendur bishta sëpatash, kazmash etj., duke e hequr nga vetja. E gdhend me heqës.

2. usht. Kunj i vogël metalik, që e mban të larguar gjilpërën e shkrepjes nga kapsolla; këmbëza e pushkës që e tërheqim me gisht. Heqësi i pushkës. Heqësi i granatës. Heqësi i shkrepjes. Unaza e heqësit.

3. Rrjetë që përdoret për të zënë peshq duke e tërhequr në ujë. Hedh heqësin.

Gjuaj me heqës.

4. krahin. shih HEQËS/E,~JA 5.

5. Ai që merret me heqjen e diçkaje në një punë (punëtori që heq tullat nga furra, ai që heq të brendshmet e bagëtive të therura etj.). Heqësi i tullave.

6. fin., vjet. Ai që kishte të drejtë të tërhiqte paratë në emër të dikujt, tërheqësi i të hollave; Heqësi i parave.

HEQËS III m. 1. Ai që u tregon udhën të tjerëve, udhërrëfyesi; vjet. ai që ndihmonte një kusar për të vjedhur ose një gjakës për të vlarë dikë, duke i dhënë njoftimet e duhura; kallauz. Heqësi i fshatit.

2. Ai që është në krye të vargut të valltarëve, ai që heq vallen. Heqësi i valles.

3. Dashi a cjapi që prin kopenë, përçor. Heqësi i kupesë (i tufës).

HEQËS IV m. Heqkeqës. Heqësi e di të keqen. fj. u.

HEQJE I f. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve HEQ, HIQEM. Heqja e lëvozhgës (e lëvores). Heqja e dhëmbëve. Heqja e njollave. Heqja e lirisë.

2. Pjesë që hiqet nga një tekst. Ka heqje dhe shtesa në tekst.

3. fig. Vuajtje e madhe; dhimbje. Heqje e madhe (e rëndë). Shpëtoi nga heqjet.

4. fiz., vjet. Rëndesë. Qendra e heqjes.

HEQJE II f. Heqël.

HEROINË I f. Fem. e HERO,~I. Heroina kryesore. Heroinë e luftës. Heroinë e Popullit. Heroinë e Punës Socialiste.

* Nënë Heroinë titull nderi që u jepet në vendin tonë nënave që kanë lindur, kanë rritur dhe kanë edukuar mirë tetë fëmijë e lart.

HEROINË II f. Pluhur i bardhë kristalor, me veti qetësuese e gjumëdhënëse, i cili përdoret gjerësisht në vendet borgjeze e revizioniste si narkotik për të trullësuar njerëzit. Përdorin (marrin) heroinë. U helmua nga heroina.

HIKËRR I f. bot. 1. Lloj drithi që bën kokrra të vogla me cipë të murrme e përbrenda të bardha, të cilat përdoren më shumë si tagji për kafshët; grurë i zi, hejdë; kokrrat e këtij drithi.

Bollgur hikrre. Arë e mbjellë me hikërr.

2. Bimë e egër barishtore ose shkurre e livadheve, me shumë lloje, me gjethe të dhëmbëzuara si të domates që bën kokrra të vogla të rrumbullakëta. Hikrra e kuqe shkurre e tillë e shtrirë ose kacavarëse, që rritet deri 2-3 metra. Familja e hikrrave.

* Rron me hikrra kursen shumë në të ngrënë; është shumë dorështrënguar.

HIKËRR II f. 1. Qumësht i prerë; hirrë. Hikërr kosi. Bëhet hikërr qumështi pritët qumështi.

2. veter. Hirrëz, ngalosë. Sëmundja e hikrres.

HIPERBOLË I f. 1. let. Figurë letrare që ndërtohet mbi bazën e zmadhimit të mase të genieve, të sendeve, të vetive, të dukurive

etj., zakonisht nëpërmjet krahasimit, për të theksuar më shumë një mendim a një ide dhe për të bërë përshtypje më të madhe te lexuesi. Hiperbolë letrare. E shpreh me një hiperbolë.

2. Zmadhim të mase që i bëhet diçkaje kur u flasim të tjerëve. Flet me hiperbola.

HIPERBOLË II f. gjeom. Lakore që përftohet nga prerja e një koni të dyfishtë me anë të një rrafshi, i cili shkon paralel me boshtin e konit.

HIPI I f. 1. Mullar. Hipi bari. Hipi me kashtë (me dushk). Dhjetë hipi me grurë (me tërshërë).

Huri i hipisë. Vë (bëj) hipi.

2. Stivë. Hipi drush.

HIPI II m. kryes. Njerëz endacakë e të shthurur nga shtresat e pasura e mikroborgjeze, me flokë të gjatë e të veshur keq, që bëjnë gjoja një jetë primitive e të veçuar dhe që në thelb mohojnë nevojën e luftës revolucionare të masave punonjëse kundër sistemit të kalbur kapitalist. Grupet (turmat) e hipive.

HORË I f. arb. Vendi banuar, qendër banimi, qytet a fshat. Hora e arbëreshëve. Venë në horë.

Bredhin horë më horë.

HORË II f. bised. 1. Bar i keq që del nëpër ara, të cilin zakonisht e shkulin dhe e djejin.

2. edhe ~A, ~AT. Dordolec prej bari a prej kashte që e digjin në arë.

3. Zjarr, flakë. Mori horë kasollja.

4. përd. ndajf. Si zjarr, si flakë; me flakë të madhe. U dogj horë shtëpia. U ndez horë zjarri. U ndez horë fëmija. E kishte horë trupin.

* I digjet zemra horë ka dëshirë të flaktë për diçka. I mori horë (flakë) shpirti shih te SHPIRT,~I. I ndezi zemrat horë ngjalli gëzim të madh, i ngriti zemrat peshë.

HUPËT I mb. 1. Që është gatuar e pjekur shumë kohë më parë, që nuk është i butë e i shkrihet, i ndenjtur, bajat (zakonisht për bukën). Bukë e hupët. Kulaç i hupët. Simate të hupëta.

2. Që është i ngjeshur e i fortë, i ngurtë, i ngrirë. Dëborë e hupët.

HUPËT II mb. krahin. 1. I humbur. Para të hupëta para që nuk pritnim t'i merrnim, para që i quanim të humbura.

2. Që është i ngrënë a i zbrazët përbrenda, i zgavërt. Dru (shkëmb) i hupët.

3. Që nuk është i ngjeshur mirë, që nuk është rrasallitur; i imët e i butë.

Duhan (pambuk) i hupët. Dhe i hupët. Miell (sheqer) i hupët.

HUTË I f. 1. zool. Femra e hutit. Zogu i hutës. Ra huta në pula.

2. zool. Shpend grabitqar, me kokë dhe me gushë të mbuluar me pupla, me qafë të rrjepur, me kthetra të mëdha, të forta e pak të kthetra, që rron nëpër pyje. Huta e bardhë kali i qyqes. Hutë deti pulëbardhë.

3. fig. Grua a vajzë e trashë nga mendja; femër e shushatur e matufe. Kishte marrë një hutë.

4. Dele me veshë shumë të vegjël. I humbi huta.

HUTË II f. vjet. Lloj pushke e vjetër, me katër vjaska dhe me një fishek, që mbushej nga prapa.

Huta e kushtrimit. Çarku i hutës. Krisi huta. Gjëmoi huta shqiptare. Hutë dervishi lloj pushke e vjetër me një fishek. I pjekim hutat bashkohemi e luftojmë kundër armikut.

HUTËRROJË I f. zool. shih HUT/Ë, ~A 12.

HUTËRROJË II f. krahin. 1. Vajzë a grua që hutohet shumë, hutaqe. Hutërrojë e madhe.

2. Përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Plakë hutërrojë.

I I

1. Një nga zanoret e gjuhës shqipe dhe shkronja e trembëdhjete e alfabetit të saj, që shënon këtë zanore. Zanorja i. Tingulli i. Shkronja i.

2. si em. f. Zanorja dhe shkronja i. I-ja e madhe (e vogël). I-ja e dorës (e shtypit). I-ja nistore (fundore). I-ja gojore (hundore).

* Vë pikat mbi i libr. shih te PIK/Ë, ~A.

I II

1. Nyjë e përparme e gjinisë mashkullore tek emrat e rasës gjinore, tek emrat dhe mbiemrat e nyjshëm, te numërorët rreshtorë dhe te disa përemra. Këshilli i fshatit tonë. I sëmuri i treti. I zoti i punës. Qyteti i ri. I dashur shok! I pari në punë.

I tij. I saj. I vet. I tillë. I cili.

2. Nyje e përparme me kuptimin e përemrave pronorë të vetës së tretë të numrit njëjës, e cila përdoret me emrat mashkullore, që tregojnë lidhje gjaku a gjinie ose lidhje familjare; i tij, i saj. I ati. I biri. I vëllai. I nipi. I ungi. I vjehërri. I shoqi.

I kunati. I kushëriri.

I III

1. Trajtë e shkurtër e përemrave vetorë të vetës së tretë në rasën dhanore të numrit njëjës. I them (atij, asaj). I dhashë (atij, asaj). I kërkova (atij, asaj). I mora (atij, asaj).

2. Trajtë e shkurtër e përemrave vetorë të vetës së tretë në rasën kallëzore të numrit shumës. I pashë (ata, ato). I gjeta (ata, ato). I zura (ata, ato). I mbledha (ata, ato).

IDEAL I mb. psikol., logj., filoz. Që ka të bëjë vetëm me idenë a me ndërgjegjen, që vetëm përfytyrohet mendërisht; kund. material. Përfytyrim ideal. Figurë ideale. Qenie ideale.

* Trup (gaz, lëng) ideal trup (gaz, lëng) që merret teorikisht për qëllime studimi në një trajtë të caktuar ose me veti abstrakte.

IDEAL II mb. 1. Që mbahet si mishërim i tipareve më të larta, i vlerave më të mira, i vetive më të përsosura, që merret si model; që është shembull i përkryer i diçkaje, shembullor.

Burrë ideal. Grua ideale. Marrëdhënie (sjellje) ideale. Dashuri ideale.

2. bised. Që është i përkryer e i përsosur, që qëndron mbi të gjithë, shumë i mirë, i shkëlqyer. Jetë ideale. Kushte ideale. Zë ideal. Bukuri ideale. Lojë ideale. Në rastin më ideal në rastin më të mirë, më të përshtatshëm ndër të gjitha rastet e tjera.

IMSHTË I f. Pyll i dendur me drurë të hollë a me filiza; korije me drurë të rinj. Imshtë me dushqe (me ahe). Kujdesi për imshatat. Hyri në një imshhtë. Kaluan nëpër ca imshta.

IMSHTË II f. Arka e mullirit ku bie mielli; gryka nga ku derdhet drithi prej koshit të mullirit në mokër, dishtë. Imshta e mullirit.

IND I m. 1. Fill i tjerrë leshi ose pambuku, që thuret për së gjeri me majën kur bëjmë qilim, kur endim pëlhurë etj. Ind pëlhure. Masure të indit. Tjerr indin. Pëlhurës këqyri indin dhe fëmijës prindin. fj. u.

2. fig. Plan i ravizuar i një rruge, i një shtëpie, i një ndërtese etj., skicë. Indi i shtëpisë. Indi i rrugës. Bëj indin e ndërtesës.

* Ind e majë

a) fund e krye, me gjithçka;

b) i zgjuar; i djallëzuar, dreqi vetë; ngatërrestar i madh. S'është as për ind as për majë është shumë i vogël ose shumë pak, s'mjafton për asgjë, nuk arin. Është vetë ind e vetë majë është njeri pa njeri, ka mbetur fillikat i vetëm.

IND II m. anat. Lidhje a bashkim qelizash të njëllojta, që formojnë një pjesë të caktuar në organizmin e bimëve ose të frymorëve dhe që kryejnë të njëjtin funksion. Inde bimore (shtazore). Ind muskullor (kockor, eshtëror, nervor, dhjamor).

Inde lidhëse inde që gjenden në mes të indeve të organeve të ndryshme për t'i lidhur njërin me tjetrin, inde që lidhin pjesët e trupit. Ind i sëmure (i dëmtuar). Indet e një organi. Dëmtimi i një indi.

ITH I m. krahin. 1. Ngrohtësia e dheut, afshi i tokës. Del ith nga dheu.

2. Afsh; zjarrmi. Ithi i trupit.

ITH II m. Ana e prapme, pjesa e pasme.

ITH I ndajf. Prapa, pas.

II parafj. Prapa, pas. Ith meje (teje, nesh...).

JA I pj. 1. Përdoret për të treguar dikë a diçka, që gjendet zakonisht afër, që kalon pranë, që shfaqet papritur etj.; përdoret për të dëftuar diçka ose për të tërhequr vëmendjen për diçka që ndodh në afërsi, përpara syve a në kohën që flasim.

Ja shtëpia (shkolla, rruga, fshati) Ja shokët! Ja ku qenka! Ja ku po vjen! Ja, shih këtu! Ja, zbardhi dita. Kur, ja, u duk...

2. Përdoret me kuptim dëftor, kur zë fill tregimi, ligjërimi etj., kur ndryshojmë temën e bisedës ose kur duam të tërheqim vëmendjen për ato që do të themi.

Ja si ndodhi ...Ja ç'pashë ...Ja ç'më shkruan...

3. Përdoret kur shprehim nxitim, shpejtim etj., afërsisht me kuptimin: «menjëherë, tashti, këtë çast». Ja, tashti! Ja, vajta e erdha! Ja, sa të shoh (sa të vishem, sa ta lajmëroj)! Ja, sa erdhi!

4. Përdoret përpara përemrave vetorë e dëftorë, si edhe përpara disa ndajfoljeve, me kuptimin: «pikërisht». Ja, ai e shpëtoi! Ja, kjo është e gjitha. Ja, kësaj i thonë punë. Ja, ky është burri. Ja, këtë desha të them. Ja, kështu bëhet puna. Ja, kështu duhet menduar (duhet mësuar).

5. Përdoret për të shprehur qëndrimin e folësit ndaj asaj që dëgjon, që vë re etj. (zakonisht për të shprehur habi, kënaqësi, zemërim, përçmim etj.). Ja ç'na qenka! Ja dhe puna (shpikja) jote! Ja, si të them, s'di! Ja, thoni edhe ju! Ja ç'vete bën!

6. Përdoret zakonisht me një parafjalë a me një lidhëz kur përmbyllim një mendim, kur nisim të nxjerrim përfundimin, kur shpjegojmë arsyet e diçkaje, kur kumtojmë diçka me rëndësi ose kur fillojmë një numërim, kur flasim për diçka përfundimin e së cilës mezi e presim etj. Ja ku na doli! Ja tek e solli fjalën! Ja dhe ky! Ja edhe diçka tjetër... Ja pse u menit ai! Ja pra pse veprova kështu! Ja dhe kjo punë mbaroi. Ja ku e ke, merre! Ja ku po ta them. Dhe ja. Ja dhe.

* Ja që hë thjeshtligj. s'ke ç'i bën, hë pra.

JA II lidh. (vetëm e përsëritur). Ose... ose..., a... a... Ja vdekje, ja liri. Ja fol, ja rri. Ja di, ja s'di. Ja në qytet, ja në fshat. Ja e marr, ja s'ka. Ja i binte, ja s'i bënte pesë orë gjumë (punë). Ja ishim ja s'ishim pesë vetë. Ja me ne, ja me ata.

JAZ I m. 1. Vijë a hendek i vogël, që shpie ujin në mulli, në arë etj.; rrjedhë uji; vend a gropë e madhe ku grumbullojnë ujë për ujitje etj. Jazi i mullirit. Jazi i fshatit. Shtrati i jazit. Lahem në jaz.

2. fig. bised. Fillimi a burimi i diçkaje. Jazi i jetës.

JAZ II m. shih ZI, ~A. Mbante jaz. Ishte për jaz. Vishej në jaz.

JOORGANIK I mb. Që nuk ka të bëjë me organizmat e gjallë, që nuk lidhet me botën e gjallë; që nuk bëhet a nuk formohet prej qenieve të gjalla; që nuk është organik, jo i gjallë. Lëndë joorganike. Bota joorganike.

JOORGANIK II mb. Që përbëhet nga pjesë, të cilat nuk janë të lidhura mirë e në mënyrë të harmonishme; që nuk rrjedh nga vetë ndërtimi i diçkaje, që është i rastit, që s'është organik. Ndërtim joorganik.

JOSHË I f. Dhelkë fjalë e bukur, naze, bukuri etj., që të tërheq a që të bën për vete; diçka tërheqëse; fuqi që të josh. Joshë e fortë (e madhe). Joshua e rinisë. Ka

shumë joshë. Përdor si joshë (në gjah) përdor një ushqim, një kafshë etj. për të tërhequr në pritë kafshët që gjuaj.

JOSHË II f. Nëna e nënës, gjyshja nga ana e nënës. Shkoj te joshë.

JU I (dhan. JUVE, tr. e shkurt. JU; kallëz. JU, tr. shkurt. JU; rrjedh. JUSH) vector.

1. Përdoret për t'iu drejtuar një grupi njerëzish, me të cilët bisedojmë ose të cilëve u shkruajmë; përdoret për t'iu drejtuar bashkëbiseduesit dhe grupit të njerëzve ku bën pjesë ai. As ju as ata. Vetëm ju. Ju folët! Shkoni edhe ju! Ju e dini. Ju mësoni (punoni)! Varet nga ju (prej jush). Do të vijë pas jush. Punon me ju. Banon te ju. Është nga ju. S'është me ju.

2. Përdoret i ndjekur nga një emër për të dalluar bashkëbiseduesit ose bashkëbiseduesin së bashku me një grup njerëzish që kanë moshë të afërt; pikëpamje, interesa a diçka tjetër të njëjtë. Ju të rinjtë. Ju pleqtë. Ju vajzat. Ju punëtorët. Ju të fshatit (të qytetit, të malit, të fushës). Ju të punës mendore.

3. zyrt. Përdoret për të treguar përfaqësuesit e një organi drejtues, të një institucioni etj., të cilit i drejtohem. Ju, si këshill popullor. Ju, si komitet ekzekutiv.

4. Përdoret kur flasim me një njeri a kur i drejtohem dikujt që duam ta nderojmë. Ju, shoku mësues.

JU II përem. Trajtë e shkurtër e përemrit vector ju në rasat dhanore dhe kallëzore.

Ju them juve. Ju dhashë (ju kërkova) juve. Ju pashë (ju gjeta, ju mblodha) ju.

KAÇUP I m. 1. Calik për të mbajtur vaj, gjalpë, raki etj., kacek. Kaçup me vaj (me raki, me verë).

Si kaçup me hirrë. mospërf. i fryrë e pa vlerë (për njerëzit).

Ishte veshur si kaçup ishte veshur shumë trashë.

2. Gjyryku i kovaçit, kacek. Fryj kaçupin.

* U bë kaçup u fry (nga ndonjë sëmundje a nga të ngjallurit); u mbyt në ujë.

Bie shi me kaçupë bie shi i madh, bie shi me rrëshekë. Iu bë barku kaçup hëngri tepër, iu fry barku nga të ngrënët a nga të pirët, iu bë barku kacek.

KAÇUP II m. 1. Kaçul, kaçirubë.

2. Lulja e misrit, xhufka e misrit.

3. Kapë e vogël me degë misri, tufëz, dorëz. Katër kaçupë (misër).

KAFAZ II m. Nëpunës në shërbim të konsullit ose të një përfaqësie diplomatike; roja personale e konsullit ose e një zyrtari të lartë (në shtetet borgjeze; para Çlirimit edhe në Shqipëri).

KALANDËR I f. zool. 1. Lloj laureshe, me shpinë të përhime, me nga një njollë të zezë në të dyja anët e gushës, që e bën çerdhen në tokë. Fole kalandre.

2. Insekt me ngjyrë të ndritshme, që shumëzohet shpejt dhe dëmton drithërat (grurin, orizin etj.). Kalandra e grurit. Kalandra e orizit. Preket nga kalandra.

KALANDËR II f. tek. Makinë me cilindra, që shërben për të lëmuar ose për t'i dhënë shkëlqim një pëlhure a një stof, për të petëzuar a për të kthyer një metal (hekur, llamarinë, teneqe) etj. Kalandër me tre cilindra. Kalandër për kthimin e llamarinës. Reparti i kalandrave.

KALORE I f. 1. Thupër, me të cilën godasin kalin, mushkën etj. për t'i nxitur që të ecin më shpejt; purtekë e hollë.

2. përd. mb. fig. E hollë e truphedhur, e hajthme; që ngrefoset e kapardiset, që ecën me kokën përpjetë (për vajzat e gratë).

KALORE II f. 1. Secila nga dy shpatullat e sipërme të samarit.

2. Rripi mbi vithet e kafshës, që lidh samarin me nënbishten a me palldëmin.

3. Pjesa e kapistrës që i vihet kalit, mushkës etj. në hundë.

4. Cipë e drunjtë brenda arrës, që ndan thelpinjtë. I heq kaloren arrës.

5. Tjegulla që vihet sipër dy tjegullave të tjera të kthyer me lug përpjetë (në çati).

6. përd. mb. Qepje kalore: mënyrë qepjeje me zigzage duke e hedhur perin sipër buzëve të copës; qepje jo e kujdesshme; qepje e përkohshme me dorë, mbi të cilën shkohet një tegel me makinë.

7. përd. ndajf. në vijë të drejtë, me zigzage; jo me kujdes; përkohësisht (kur qepin); kaluar. Qep kalore.

KALORI I f. 1. shih KALORËSI, ~A 1, 2, 4.

2. Ecje; me kalë, shëtitje me kalë. Bënte kalori shëtiste me kalë për t'u dëfryer.

KALORI II f. fiz. Njësia e matjes së nxehtësisë, e barabartë me sasinë e nxehtësisë që nevojitet për të ngritur në një gradë temperaturën e një grammi uji të pastër; sasia e kalorive që jep një ushqim. Kalori mesatare. Kalori e madhe sasia e ngrohtësisë që nevojitet për të ngritur ose për të ulur në një gradë temperaturën e një kilogrami (a të një litri) uji të pastër. Sasia e kalorive. Jep (prodhon) kalori. Shprehet në kalori.

KALL I kal. 1. Fut brenda, shtie; shtie në dhe, këllas. Kall gozhdën në mur. Kall perin në gjilpërë. Kall dorën në xhep. Nuse, ku kalle këmbët.. . folk. nuse, ku hyre..

E kallën në dhe e varrosën.

2. Shtyj, nxit dikë, fut, shtie (kryesisht për të keq). Kalli njerëz për ta vrarë. Kalli një të vetin për çupin. Ia kalli në vesh diçka shtyri dikë që t'ia thotë.

3. I shkaktoj, i fut; këllas. I kalli frikën (tmerrin, lemerinë, datën). U kalli grindjen.

Më kalli në dyshim.

4. fig. Mashtroj dikë, ia hedh dikujt.

* I kalli bretkun bised. shih te BRETK, ~U. I kalli djallin (dreqin) dikujt a diçkaje thjeshtligj. nuk u interesua, nuk pyeti fare, nuk çau kokën për dikë a për diçka; e braktisi. I kalli (i shtiu) ethet dikujt shih tek ETH/E, ~JA

3. I kalli e i futi flamën (murtajën) dikujt a diçkaje thjeshtligj.

a) s'pyet më fare për të, as do t'ia dijë më për të;

b) i kalli tmerrin, i futi frikën. Ia kalli qimen thjeshtligj. shih te QIM/E,~JA.

I kalli spicat dikujt e shtyu për keq; e futi në grindje; i futi kallat. I kalli ujkun thjeshtligj. e braktisi, e la fare, i kalli flamën, i kalli djallin.

KALL II kal. krahin. Ndez. Kalli zjarrin (cigaren, eshkën). Kalle një! ndize një cigare!

* I kalli (i dha) barut shih te JAP.

KALLEM I vetv. 1. Hyj, futem brenda.

2. Pës. e KALL I.

KALLEM II vetv. 1. Ndzem.

2. Pës. e KALL II.

KALLËZIM I m. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve KALLËZOJ, KALLËZOHEM.

2. Tregim. Kallëzim i shkurtër. Kallëzime për fëmijë.

3. Njoftim që dikush i jep një institucioni, një zyre a një personi për veprimet e sjelljet e dikujt tjetër (zakonisht me qëllim të keq). Kallëzim i remë.

KALLËZIM II m. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimit të foljes KALLËZON. Kallëzim i hershëm

(i vonë). Para kallëzimit. Koha e kallëzimit të grurit. Është në kallëzim.

KALLËZUES I m. Ai që i njofton dikujt çfarë ka parë ose çfarë di për dikë a për diçka (zakonisht me qëllim të keq), ai që kallëzon dikë; ai që padit dikë.

KALLËZUES II m. Gjymtyrë kryesore e fjalisë, e cila shpreh një veprim, një gjendje ose një tipar të frymorit a të sendit që shënohet nga kryefjala. Kallëzues foljor (emëror).

Kallëzues i thjeshtë (i përbërë).

KAPË I f. 1. Kapelë. Vë kapën.

2. Grumbull a stivë sendesh të vëna njëri mbi tjetrin; disa duaj drithi (gruri, misri, thekre etj.), që janë mbledhur e janë vënë më këmbë ose stivë; kapule, kopicë. Kapë bari. Kapë gruri (misri). Bëj kapë. Vë në kapa.

KAPË II f. Kapëz, biberon.

KËNDOHET I 1. pavet. Duket, shfaqet, shprehet; del, kuptohet. I këndohet gëzimi në fytyrë.

2. pës. e KËNDOJ I 1, 5.

KËNDOHET II Pës. e KËNDOJ II 1, 3.

KËNDOJ I kal. 1. Nxjerr me zë tinguj muzikorë, duke shqiptuar fjalët e një vjershe, jap me zë një pjesë muzikorë, ia them këngës, ia marr një kënge; kam aftësi të posaçme për të nxjerrë me zë tinguj muzikorë. Këndo një këngë. Këndon bukur (shtruar, si bilbil). Këndon e kërcen.

2. jokal. Jam këngëtar, punoj si këngëtar në një ansambël, në estradë, në operë etj. Këndon në ansamblin e këngëve e të valleve (në korin e radios, në estradë).

3. jokal. vet. veta III. Nxjerr zë melodik, lëshon një zë si këngë, nxjerr tinguj të zgjatur si këngë (për disa shpendë dhe kandrra). Këndojnë zogjtë. Këndon bilbili (qyqja, lauresha, kanarina). Këndon gjinkalla. Këndoi këndesi (gjeli).

4. jokal. vet. veta III. Nxjerr një zhurmë të vijueshme që herë dobësohet, herë bëhet më e fortë; punon mirë duke nxjerrë një zhurmë të njëtrajtshme; nxjerr tinguj të harmonishëm; buçet. Këndo një telat e telefonit. Këndon burimi. Këndon mitralozi. Këndon motori (makina). Këndo, kitara ime!

5. edhe jokal. Bëj një vjershë për dikë, i kushtoj një këngë dikujt a diçkaje të shtrenjtë, thur këngë për nder të dikujt; i thur himn dikujt, e përjetësoj në këngë a në vargje, ngre lart në këngë a në vargje cilësitë e virtytet e tij. I këndojmë Atdheut (për trimat, për heronjtë). Këndo

trimëritë (heroizmin) e dëshmorëve. I këndojnë lirisë (punës). I këndon vashës.

6. jokal. vet. veta III fig. Shpreh një ndjenjë gëzimi a entuziazmi; merr një pamje të bukur e të gëzuar, duket sikur ia thotë këngës (për rrugët, ndërtesat etj.). I këndon zemra është shumë i gëzuar. Të këndoftë zemra! ur. Nuk i këndon buza nuk i qesh buza. Këndon dhoma (shtëpia). Këndojnë rrugët.

* I këndon alllluja dikujt shih tek ALILLUJA. I këndoi fermanin vjet. shih te FERMAN,~I. I këndon gishti dikujt shih te GISHT,~I. E këndoftë hoxha (prifti)! mallk. vjet. shih te HOXH/Ë,~A. I ka kënduar huti dikujt shih te HUT,~I. I këndoi kollofruthin thjeshtligj. shih te KOLLOFRUTH,~I. I ka kënduar kukuvaajka dikujt shih te KUKUVAJK/Ë, ~A. Nuk këndon me perde dikush shih te PERD/E,~JA. Këndon qyqja për dikë shih te QYQ/E,~JA. I ka kënduar qyqja dikujt a diçkaje shih te QYQ/E,~JA. I ka kënduar qyqja në derë shih te QYQ/E,~JA. S'këndon më ajo qyqe shih te QYQ/E,~JA. I këndoi në tru tall. shih tek TRU,~RI. Më këndon veshi

(i djathtë) shih te VESH,~I. I këndon (i fryn, i fishkëllen) në vesh dikujt shih te VESH,~I. I këndojnë (i kërcasin, i gërhasin) zorrët shih te ZORR/Ë, ~A. S'i këndon më gjeli në shtëpi shih te GJEL,~I. I këndojnë dyzet gjela mbi kokë shih te GJEL,~I. I këndon gjeli në samar shih te GJEL,~I. Kur të këndojë qyqja e kuqe (nga bishti) iron. shih te QYQ/E,~JA. S'këndon zhaba në të thatë fj.u. shih te ZHAB/Ë,~A.

KËNDOJ II kal. bised. 1. Lexoj, lëçit. Këndoj një letër (një libër). Këndoj gazetën. Ia këndova në sy.

Di (ka mësuar) të shkruajë e të këndojë.

2. jokal. vet. veta III. Shkruan, thotë. Ç'këndon këtu? Ç'këndon gazeta (sh-pallja)?

3. vjet. Ysht. E këndonte prifti (hoxha, yshtësja).

* Ti këndon (t'i lexon) kartat (letrat) në xhëp shih te XHEP,~I. Vetë këndon, vetë shkruan (vetë shkruan, vetë vulos) shih te SHKRUAJ.

KËPUTJE I f. 1. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljeve KËPUT, KËPUTEM. Këputja e luleve. Këputja e qengjave. Vendi i këputjes. Kam (ndiej) një këputje.

2. Rasti kur këputet një fill, një film etj.; vendi ku këputet një fill, një film etj.

Ka shumë këputje.

KËPUTJE II f. bot. Bimë barishtore shumëvjeçare e tokave të lagështa, e ngjashme me fierin, me gjethe të holla e të lëmuara si ato të pishës, që këputen lehtë.

KËRR I mb. Në ngjyrë të përhime, i përhimë. Kalë kërr. Pelë kërrë.

KËRR II mb. I zhveshur, pa drurë e pa bimësi. Vend kërr. Tokë kërrë.

KËSULËKUQE I f. bot. Lloj kërpudhe e vogël, në trajtën e një kupe, që e ka faqen e jashtme në ngjyrë si të kuqërreme.

KËSULËKUQE II f. folk. Figurë e përrallave popullore të disa popujve evropianë, që përfytyrohet si një vajzë e vogël, e urtë dhe e zgjuar me kësulë të kuqe në kokë.

KËSHILLTAR I m. 1. Ai që jep këshilla, ai që këshillon dikë, këshillues.

2. Ai që është caktuar pranë një institucioni, një organizate etj. për të dhënë mendimin për çështje të ndryshme dhe për të ndihmuar me këshilla në një fushë të caktuar të veprimtarisë shoqërore a shtetërore. Këshilltar teknik (ushtarak, tregtar). Këshilltar ligjor. drejt. nëpunës me arsim të lartë juridik pranë zyrës së ndihmës juridike, i cili ndihmon popullin për t'u njohur me legjislacionin dhe në raste të veçanta merr pjesë edhe në gjyq. Këshilltar i posaçëm. Këshilltar i ambasadës.

KËSHILLTAR II m. Ai që është zgjedhur nga populli si anëtar i organit lokal të

pushtetit shtetëror, anëtar i këshillit popullor; detyra e këtij të zgjedhuri. Këshilltarët popullorë. Detyrat (të drejtat) e këshilltarëve. U zgjodh këshilltar.

KËSHILLTARE I f. Fem. e KËSHILLTAR, ~I I.

KËSHILLTARE II f. Fem. e KËSHILLTAR, ~I II.

KËTA I dëft. 1. Tregon frymorë a sende (të shënuar nga emra të gjinisë mashkullore), që ndodhen më afër folësit se frymorët a sendet e tjera të atij lloji; zëvendëson një emër të gjinisë mashkullore (në numrin shumës), që përmendet në kohën kur flasim ose është përmendur pak më parë; kund. ata. Këta këtu. Ja këta. Këta shokë. Këta njerëz. Këta gurë. - Cilët folën? - Këta. - Cilët kërkon? - Këta.

2. Përdoret me një emër të gjinisë mashkullore (në numrin shumës) për të treguar pjesën e kohës, që shënohet nga emri ose që përmendet a është përmendur pak më parë. Këta muaj.

3. Përdoret para një fjalisë të varur, e cila përcakton frymorët a sendet që tregon përemri (të shënuar nga emra të gjinisë mashkullore në numrin shumës), ose para një fjalisë kryefjalore, e cila përcakton frymorët a sendet, që zëvendëson përemri, pavarësisht nga gjinia, me kuptimin «kushdo, cilido»; përdoret për të treguar ose për të zëvendësuar frymorët a sendet që përmenden në kohën kur flasim ose që janë përmendur pak më parë me një cilësi a tipar të caktuar. Një nga këta të rinjtë e uzinës. Këta të malit (të fushës). Këtyre që erdhën. Këtyre që ndjekin shkollat.

4. libr. Përdoret në vend të një emri të gjinisë mashkullore (në numrin shumës) për të mos u përsëritur emri. Punonjësit e qytetit dhe këta të fshatit.

KËTA II dëft. bised. vjet. Tregon një send (të shënuar nga një emër i gjinisë asnjënjëse), që ndodhet më afër folësit se një send tjetër i njëjtë; kund. ata. Këta ujë. Këta mish.

KILE I f. bised. Kilogram. Një (dy, katër) kile mollë. Dy lekë kilja.

* Ka me kile ka shumë, ka me okë, ka sa të duash. Nuk e ha kilen për okë edhe poh. shih tek OK/Ë, ~A.

KILE II f. 1. Gëzhjojë fisheku.

2. shih KILZ/Ë, ~A.

KOCË I f. Kocak.

KOCË II f. zool. Peshk deti me trup të gjerë e shpatuk, me një shenjë të verdhë si ar midis syve dhe me dhëmbë të fortë, që e ka mishin shumë të shijshëm.

KOCË III f. Dhi e zezë.

KOMB I m. 1. Bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit, të jetës ekonomike dhe të formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës. Kombi shqiptar. E drejta e kombeve për vetëvendosje. Baballarët e kombit. vjet. deputetët reaksionarë në parlamentin e regjimit zogollian.

2. spec. Shtet, vend. Lidhja e Kombeve. Organizata e Kombeve të Bashkuara.

KOMB II m. 1. Lidhje e shtrënguar e dy pjesëve a e dy anëve të një filli, të një litari etj. ose e dy cepave të një shamie, pëlhure etj.; nyjë. E lidhi komb. Zgjidh kombin.

2. Nyjë druri, gdhe.

3. anat., bised. Fikth. Me komb të dalë.

4. Pikë (uji, vere etj.); gllënjë, hurbë. Një komb ujë. S'ka mbetur asnjë komb s'ka mbetur as edhe një pikë (për lëngjet).

5. fig. Shtrëngim që ndien njeriu në grykë kur tronditet ose kur hidhërohet shumë, saqë nuk flet dot e nuk përcillet lirisht; lëmshe. Kam një komb në grykë. M'u bë (m'u mblodh) një komb. I është bërë komb diçka i është mbledhur dhe e mundon, e shqetëson shumë (një ndjenjë, një mendim etj.), i ka mbetur pikë në zemër. Iu lidh fjala komb nuk mundi të fliste, nuk nxirrte dot një fjalë nga goja (nga frika, nga mallëngjimi etj.).

- KOMISION** I m. 1. Grup njerëzish të zgjedhur a të caktuar për të hetuar, për të shqyrtuar ose për të studiuar një çështje, për të përgatitur një material, për të kontrolluar një punë etj. Komision qendror. Komision përgatitor (organizues). Komisioni ekonomik. Komision mjekoligjor. Komisioni i garave (i konkursit). Komisioni i hartimit të rregullores. Komisioni i provimit (i pranimit). Anëtarët e komisionit. Kryetari i komisionit.
2. Organizëm i përhershëm ose i përkohshëm, që krijohet pranë një organi shtetëror ose organizate shoqërore dhe që merret me ndjekjen e një veprimtarie të caktuar. Komisionet e Kuvendit Popullor. Komisionet e Këshillit Popullor. Komisioni i verifikimit të mandateve. Komisionet e zgjedhjeve.
- KOMISION** II m. Shitja e një sendi ose e një malli të dikujt, duke i mbajtur pronarit një përqindje për ndërmjetësimin. Dyqan me komision.
- KORE** I f. 1. Cipa e jashtme e fortë, që zë buka a ndonjë ëmbëlsirë kur piqet ose kur thahet; cipë e fortë që zë zakonisht dheu kur ka thatësirë të madhe. Kore e djegur (e fortë).
- Nuk i ha koret. I prish koren dheut.
2. Lëkurë e trashë dhe e thatë, që mbështjell trungun e disa drurëve.
- Korja e pishës (e dushkut, e vidhit).
3. Cipë e trashë dhe e fortë, që zë plaga përsipër kur fillon të shërohet, dregëz.
- Plaga zuri (vuri) kore. I heq koren. Ra korja.
- * Ka zënë (ka vënë) kore (dregëz) plaga është harruar, nuk kujtohet më një ngjarje e hidhur a një plagë e vjetër shpirtërore. Korja e tokës gjeol. shtresa e fortë në pjesën e sipërme të rruzullit tokësor. Korja e trurit anat. cipa e trurit.
- KORE** II f. krahin. Turp, marre.
- * Ia la koren (turpin) te dera shih tek TURP,~I.
- KRAPJE** I f. Qershi që bën kokrra pak si të forta, zakonisht të zeza dhe të ëmbla.
- Krapje kokërrmadhe (kokërrvogël).
- KRAPJE** II f. 1. anat. Heqës. Nxori krapjen.
2. bised. Amanet. Ia la krapje. E kam krapje.
- KREP** I m. Pëlhurë prej mëndafshi ose prej leshi, e punuar hollë, por me sipërfaqe jo të lëmuar, që përdoret zakonisht për veshje të lehta grash; copë e zezë nga kjo pëlhurë, që përdorin gratë për të mbuluar kokën, zakonisht si shenjë zie. Krep i bardhë (i zi). Fustan (shami) krep.
- KREP** II m. 1. Shkëmb me majë të mprehtë, shkëmb i thepisur; shkrep. Krepat e malit.
2. Copë e madhe akulli, shkëmb akulli. Krep akulli.
- KRIPANIK** I m. 1. Mbajtëse kripe, kripës.
2. gjell. Lakror i gatuar me miell misri, me gjizë të kripur e me dhallë.
- KRIPANIK** II m. 1. Njeri shumë i varfër e i këputur, njeri që s'ka gjë prej gjëje.
2. Përd. mb. sipas kuptimit të emrit.
- KRISJE** I f. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve KRIS, KRISËT. Shkakton krisje.
2. Krisë.
- KRISJE** II f. bot. Gram. Shkul krisjet në arë.
- KROS** I m. sport. Vrapim me shumë pjesëmarrës, që bëhet zakonisht në vende të hapura me pengesa natyrore dhe në lartësi të mëdha. Kros pranveror. Kros popullor. Kros fushor.
- Fituesit e krosit. Kampionati kombëtar (lokal) i krosit. Bëj kros. Marr pjesë në kros.
- KROS** II m. Qeros.
- KUADËR** I m. zyrt. 1. përmb. Tërësia e punonjësve (e nëpunësve dhe e punëtorëve) të një ndërmarrjeje, të një institucioni etj.; edhe secili nga këta punonjës që bën një punë të caktuar sipas organikës. Kuadri i institutit. Kuadrot teknike. Kuadri i mesëm kuadri me arsim të mesëm. Kuadrot e arsimit.

Kuadrot me arsim të lartë. Lëvizja e kuadrit.

Kualifikimi (forcimi) i kuadrit. Zyra e kuadrit. Përgjegjësi i kuadrit. Politika e kuadrit.

2. Punonjës a nëpunës i kualifikuar që ka mbaruar zakonisht një shkollë të lartë a speciale dhe që kryen një detyrë drejtuese, organizuese etj. Kuadri vendës. Kuadrot tona. Kuadër drejtues (komandues). Kuadër me origjinë punëtore. U bë kuadër.

3. përmb. usht. Tërësia e ushtarakëve që kanë për detyrë përgatitjen luftarake e politike të trupave në një njësi ushtarake; edhe secili nga këta ushtarakë. Kuadri i repartit.

4. bised. Zyrë e veçantë (seksion, dege, drejtori) në çdo ndërmarrje, institucion etj., që mban organikën dhe dokumentet e tjera të punonjësve përkatës. Shkoi në kuadër.

5. bised. Organika e punonjësve që tregon detyrën dhe vendin ku caktohet të punojë secili. Doli kuadri i arsimit.

KUADËR II m. 1. Tablo, pikturë me ngjyra vaji. Kuadër i bukur. Var kuadrin. Vë kuadrin në kornizë.

2. kinem. Pjesë e shkëputur a skenë e veçantë nga një film artistik, nga një film dokumentar etj. U dhanë disa kuadro nga filmi.

3. elektr. Kuti a dhomëz e pajisur me aparate të posaçme nga ku drejtohet hapja e mbyllja e dritave, funksionimi i një mekanizmi etj. Çelësi i kuadrit.

4. fig. libr. Tërësia e caqeve brenda të cilëve ndodh, zhvillohet ose kryhet diçka. Në këtë kuadër. Jashtë këtij kuadri. Në kuadrin e festës. Del nga ky kuadër.

KUÇ I bised. kryes. fëm. Emërtim për çdo qen (përdoret edhe për të ndjellë qenin). Leh kuçi. E kafshoi kuçi. Përzëre kuçin! Kuç, kuç!

* Erdhën (ikën, shkuan) me kuç e me maç (me qen e me mace) erdhën me

gjithçka që kishin; erdhën duke marrë me vete të gjithë e çdo gjë.

KUÇ II m. Enë e madhe balte si vorbë, pa dorëza, që shërben për të zier gjellën, për të mbajtur ujë të ngrohtë pranë zjarrit etj. Ziejnë fasulet në kuç.

KUKOJ I kal. Përkul si hark, lakoje, kukëzoje. Kukoi kurrizin.

KUKOJ II kal. Mbush plasat e vozës a të një ene tjetër prej druri me kapcele ose me copa leckash që të mos rrjedhë. Kukoi vozën.

KUMBARA I f. Kuti e vogël prej teneqeje etj., e mbyllur mirë, që ka një vrimë, ku fëmijët hedhin para për t'i ruajtur.

KUMBARA II f. vjet. shih BOMB/Ë, ~A 1. Kërsiti topi e kumbaraja.

KUQËL I f. Lëng si i kuq që lëshojnë ullinj të kur mbahen në fuçi a kur shtypen për t'u marrë vajin; llumi që lëshon vaji në fund të shishes a të enës, fundërria e vajit. I heq kuqlën vajit.

KUQËL II f. 1. zool. Rosë e madhe kuqalashë. 2. Kafshë (lopë, dhi etj.) me qime të kuqe a si të kuqe.

KURTH I m. 1. Mjet prej druri a prej metali, i ndërtuar posaçërisht për të zënë kafshë të egra, minj, zogj etj.; çark, grackë. Kurth minjsh. Zë me kurth. Nuk zuri gjë kurthi.

2. Vend i fshehur, i rrethuar a i mbyllur, nga i cili nuk mund të shpëtojë ose e ka shumë vështirë të dalë ai që futet aty. E tërhoqën armikun në kurth.

3. fig. Gjendje e vështirë që krijohet me dredhi e me keqdashje për dikë për ta dëmtuar a për ta asgjësuar; dredhi që i kurdiset dikujt pas shpine.

Ra (e futi, e shtiu) në kurth. Ngrinte kurthe. Shpëtoi nga kurthi.

KURTH II m. kryes. 1. Degëzimet e kungullit, të pjeprit etj., që shtrihen e zgjaten në tokë.

2. Gropa ku mbillet kungulli, pjepri etj.

LAHURI I f. shih LAHUR, ~I.

LAHURI II f. krahin. Lahutë. I binte lahurisë.
U këndonte trimave me lahuri.

LAKËRISHTË I f. 1. Kopsht a arë që është mbjellë me lakra.

2. vet. Lakrat, lakrurinat.

LAKËRISHTË II f. bot. Bimë barishtore ujëse, me kërcell të gjatë, me lule të bardha dhe me gjethe të gjera gjithë push, të cilat rrinë të zhytura në ujë.

LALË I m. vjet. 1. Emër i lashtë i banorëve të Myzeqesë.

2. Emër, me të cilin të pasurit thirrnin me përbuzje fshatarin e varfër të Myzeqesë.

3. Emër, me të cilin thirrej banori i krishterë i Myzeqesë nga banorët myslimanë.

LALË II m. bised. 1. Babai në moshë të re kundrejt fëmijëve të vet. E ka lalë.

2. Vëllai i madh kundrejt vëllezërve më të vegjël ose kundrejt motrave më të vogla; kunati ose kunati i madh kundrejt kunatave; xhaxhai kundrejt nipërve ose mbesave. Lala i madh. Lala i saj. Hajde te lala! Do të shkoj te lala. E do shumë lalën. E kanë pasur lalën në vend të babait.

3. Përdoret për të quajtur një njeri, të cilin e kemi shumë të afërt ose e thërresim me nderim e me dashuri. Lalë Gjoni. Hajde, or lalë! Ta bën lala ty! Ku di gjë ti, mor lalë!

* Nusja e lalës zool. nuselalë.

LALË III f. Lloj guri lara-lara.

LARËZ I f. bot. shih LARUSHK, ~U.

LARËZ II f. zool. 1. Zog i vogël sa një harabel, me trup të larmë, që rri më shumë livadheve.

2. zool. Lloj peshku i vogël me lara në trup.

LASKAR I m. 1. Dru i trashë e i gjatë, zakonisht me majë të gdhendur e shpatuke, që përdoret për të ulur a për të ngritur gurin e mullirit, për të lëvizur nga vendi gurë e

sende të ndryshme etj.; ngritës. Laskari i mullirit. E ngriti (e uli) me laskar. I vuri laskarin.

2. Tezgë me dy drunj të trashë anës e me një shtrojë thuprash për të mbajtur dhe e sende të rënda.

3. Lopatë lundre.

4. fig. shar. Njeri me trup të madh e i trashë nga mendja, shul.

LASKAR II m. Landare. Laskar rrushi. Laskar kungulli. Laskar arre (gështenje).

* U bë laskar u dobësua shumë, u tret nga trupi.

LASHTË I mb. 1. Që i përket një kohe shumë të largët, i hershëm; që ka qenë ose që ka ndodhur shumë kohë më parë, i dikurshëm; që është krijuar a formuar shumë shekuj më parë; që ka jetuar në të shkuarën e largët, shumë i vjetër, i moçëm. Në kohë të lashta. Ngjarje (ndodhi) e lashtë. Njerëzit e lashtë. Kultura e lashtë. Zakonet (traditat) e lashta. Popull i lashtë. Gjuhë e lashtë. Qytet i lashtë. Tokë e lashtë. Veshje e lashtë. Fjalë e lashtë fjalë e urtë. Histori e lashtë historia e periudhës më të hershme.

2. Që është shumë i vjetër në moshë, që është i kaluar në moshë, i moçëm.

Burrë (plak) i lashtë. Është i lashtë në moshë.

3. Që rritet e zhvillohet në një kohë më të shkurtër se të tjerët, që jep prodhim a piquet më parë se llojet e tjera, i hershëm; kund. i vonë. Fik i lashtë. Misër i lashtë. Qengj (kec) i lashtë.

4. Që është prej bagëtie të vjetër. Mish i lashtë.

5. Përd. em. sipas kuptimeve 2, 3 të mbiemrit.

LASHTË II mb. bised. Që është bërë me miell të lashtash. Bukë e lashtë.

LATË I f. 1. Sëpatë e vogël me teh të gjerë, që përdoret për të prerë degë të holla dhe për të gdhendur e sheshuar trungjet, trarët etj., sëpatë marangozi, cakorre; sëpatë e madhe me qafë të gjatë. E latoi

(e gdhendi) me latë. E çau trungun me latë.

2. Thikë e madhe, zakonisht me teh të gjerë e të harkuar, me të cilën kasapi pret mishin. Lata e kasapit.

3. Pjesa e metaltë e sëpatës, e kazmës etj., që është shpatuke dhe me teh.

Lata e sëpatës (e kosës, e sqeparit, e shatit, e kazmës). I mprehu latin.

4. Trung druri i gdhendur, që përdoret për lëndë ndërtimi; send i latuar, latesë.

Latë e fortë. Latat e shtëpisë.

5. Kllapë e gdhendur në dru. Latat e çeteles.

* Si lata, sëpata keq. njësoj janë, si njëri ashtu edhe tjetri. Kur shkoi lata, të shkojë edhe sëpata kur ikën pjesa më me vlerë, s'ke ç'e do tjetrën; ikën sytë, le të ikin edhe vetullat.

LATË II f. 1. Pjesë e një triske ose copë e vogël letre, zakonisht në trajtë katrore, e cila ka të shënuar sasinë e druve, të vajgurit etj. që mund të marrë një familje a një njeri. Latat e triskave. Latat e druve (e vajgurit). Latat e mensës.

2. Fletë e vogël, që i jepet shoferit së bashku me patentën për të ngarë një automjet, në të cilën i shënohen shkeljet e rregullave të qarkullimit dhe që në raste të rënda i merret si ndëshkim bashkë me patentën. Lata e parë (e dytë, e tretë). I bëri një shenjë në latë. I preu latën. Ia mori (ia hoqi) një latë.

LEDH I m. 1. Vend i ngritur buzë arave ose anës shesheve, udhëve, hendeqeve etj., mezhde, trap. Ledhi i arës (i livadhit, i rrugës, i hendekut). Ledhet e llogoreve. I pengojnë edhe ledhet. Ecte nëpër ledh (ledh më ledh). Mbroheshin pas ledhit. I prishën ledhet e i bashkuan arat.

2. Pendë dheu që bëhet për të penguar ujërat, sfrac. I bënë ledhe të larta lumit. U çanë ledhet nga ujërat.

3. Rrip i ngushtë arë; lehe. Ledhet e perimeve. Dy ledhe misër.

4. Mur i trashë guri i një kalaje a qyteze; mur guri pa llaç, që bëhet në toka të pjerrëta për të mos shkarë dheu. Ledh i lartë (i gjatë). Brezare me ledhe.

Kala me ledhe të forta.

5. fig. Pengesë, gardh; prag. I vuri (iu bë) ledh diçkaje. E hodhi (e kapërceu) ledhin.

* S'i hedh dot ledh punës edhe poh. nuk e rregullon dot, nuk gjen dot një zgjidhje të drejtë e të qëndrueshme për një çështje. Zuri ledhin (përruan) keq. shih te ZË.

LEDH II m. bised. 1. Lym; baltë. Ledh lumi. Ledhi i vijave (i kanaleve). U mbush me ledh. E lyen me ledh. E bënë murin me ledh.

2. kryes. Tokë a arë anës lumenjve a përrenjve, e cila mbulohet me lym nga vërshimi i tyre; ledhishtë, lymërishtë. Bëhet mirë drithi në ledhet.

* Zuri ledh dikush vuri pasuri, u bë i pasur, zuri dhjamë. E zuri ledhi dikë i ra në dorë papritur një pasuri si trashëgim, u bë papandehur i pasur; i erdhi e mira te dera; i eci mbarë, e ndihmoi fati.

LEDHISHTË I f. 1. Vend a tokë me ledhe e me brezare.

2. kryes. Mure të trasha mbrojtëse rreth e qark një kështjelle, një qyteze etj., ledhnajë. Ledhishtat e kështjellës (e qytezës).

LEDHISHTË II f. 1. Tokë a arë e mbuluar me lym nga vërshimi i ujërave; tokë që është krijuar nga lymi; lymore, lymërishtë.

2. Vend që ka shumë baltë e llucë, baltak.

LEGEN I m. 1. Enë e madhe, e rrumbullakët dhe mjaft e thellë prej metali a prej ndonjë lënde tjetër, që shërben për të larë fytyrën, duart e këmbët, për të larë rroba etj.

Legen alumini (llamarine, bakri, plastike). Laj duart (fytyrën, këmbët, fëmijën, rrobat) në legen.

2. fig. bised., mospërf. Njeri që nuk është serioz e i qëndrueshëm në sjelljet e

në veprimet e tij, njeri pa vlerë e llafazan, të cilin e trajtojnë të gjithë me mospërfillje e si të duan. Është bërë legen ai.

3. Pjesa e plugut mbi plorin, e gjerë e pak e përkulur, që shërben për të kthyer plisin. Legeni i plugut.

* I bie legenit thjeshtligj.

a) flet kot më kot, flet gjepura; flet, po s'ia var njeri;

b) bën një punë fare të kotë, tund derën. Legen i shpuar mospërf. shih te SHPUAR (i,e).

I vunë (i varën) legenin (teneqenë) dikujt mospërf. shih tek TENEQE,~JA. Bie shi me legenë (me gjyma, me shtamba, me kova, me ibrikë) shih te GJYM,~I.

LEGEN II m. anat. Pjesë e skeletit të njeriut, e cila përbëhet nga brezi i harkuar i eshtrave të kryqeve e nga kërdhokullat; brezi i eshtrave të kafshëve gjitare në pjesën e prapme të trupit, që vjen si e harkuar. Eshtrat e legenit.

LEGË II f. Erë e fortë që rrotullohet, dredhë. Po fryn lega.

LEGË II f. Masë gjatësie me vlera të ndryshme sipas vendeve, por më e madhe se dy milje.

Legë detare masë gjatësie për udhëtimet detare e barabartë me 4,445 km ose 5,556 km.

LEGJENDË I f. 1. Gojëdhënë. Legjendat popullore. Legjendat mesjetare. Legjenda e Mujit dhe e Halilit. Legjendat për Gjergj Kastriotin - Skënderbeun. Mbeti legjendë. Hyri në legjendë.

2. fig. Trillim që përhapet me qëllime të caktuara për dikë a për diçka; diçka që nuk i ngjan fare së vërtetës, diçka e pabesueshme. S'u besonte kush atyre legjendave.

* E bëri legjendë diçka e zgjati shumë tregimin për diçka, duke i shtuar edhe gjëra të paqena e duke e zbukuruar me trillime.

LEGJENDË II f. libr. 1. Shenjat e posaçme dhe shpjegimet që jepen poshtë ose anës një harte, një skice etj.

2. Mbishkrim në një monedhë a në ndonjë figurë. Legjenda e një monedhe (e një figure).

LERANË I f. 1. Vend i pjerrët a i sheshtë, i mbuluar me gurë të rënë nga mali; pjesë zalli ku janë mbledhur shumë gurë nga ujërat e përroit a të lumit; përrua plot me gurë të sjellë nga mali.

2. Grumbull gurësh të sjellë nga ujërat ose të mbetur nga një ndërtesë e rrënuar; rrënojë, gërmadhë. U bë shtëpia leranë.

LERANË II f. Dru i trashë ku mbështetet boshti i mullirit të blojës.

LERË I f. 1. Baltë e hollë, llucë; vend a gropë e gjerë me baltë të hollë e me ujë të ndenjuri; tokë e s'qullët që të thith brenda, moçalishte. Gropë me lerë. U bë lerë. Ngeci në lerë. I futi buajt në lerë.

2. Zhul në trup a në rroba, që bëhet nga të palarët për një kohë të gjatë; llum, zdralë. Lera e kokës (e flokëve, e trupit). Lera e rrobave (e jakës). Ka zënë lerë.

3. Llum vaji; papastërti të ndryshme që zë një send. Lera e pushkës. Pastroi lëren e tytës.

4. edhe ~A, ~AT. Pellg me ujë në kullotat malore, që bëhet gjatë verës kur shkrin bora; gropë e madhe që mbushet me ujë për të pirë bagëtitë në kohën e thatësirës. Lerat e kullotave. I çoi bagëtitë në lerë.

5. fig. Diçka e turpshme dhe e fëlliqur; njollë turpi; turp. I vuri lerë dikujt e njollosoi, e turpëroi. Ia la lëren në derë. E bëri lerë dikë e turpëroi, i vuri njollë.

6. fig. Fjalë të ndyra e të turpshme. Nxori lerë nga goja.

7. përd. ndajf. Tërë, krejt (kur dikush a diçka fëlliqet shumë). U bë lerë me gjak.

* E bëri barkun lerë piu shumë ujë, piu sa u fry.

LERË II f. shih LERAN/Ë, ~A I 1.

LESË I f. 1. Vegël bujqësore, që bëhet me disa drurë, të thurur me thupra e zakonisht me kunjat të vegjël nga poshtë dhe që përdoret për të copëtuar plisat, për të shtruar dheun ose për të mbuluar farën në arë; trinë. Lesë e lehtë (e rëndë). Lesë druri (hekuri). I shkoi (i hoqi) lesën e lesoi. Merr lesë mund të lesohet. Rri mbi lesë.

2. Derë e vogël e thurur me thupra për të mbyllur vathën a ndonjë shteg tjetër kalimi; gardh thuprash për të rrethuar diçka; trinë. Lesa e kasolles (e oborrit, e vathës, e gardhit). E mbyllin shtegun me lesë. I rrethojnë pemët me lesa.

3. Thurimë me purteka, me kallama të hollë ose me kashtë që përdoret për të nderë gjëra të ndryshme mbi të, për të mbuluar diçka etj.; trinë e thurur rrallë, mbi të cilën rrahin me shkop kalinjtë e misrit kur i shkoqin. Lesë druri (kashte). Lesë duhani. Lesë tavani. Lesë për të zënë peshq. E mbuloi me lesë. E shkoqin misrin në lesë. I ndejnë fiqtë në lesë për t'i tharë.

4. Tezgë, zakonisht prej thuprash, që përdoret për të mbartur pleh, kashtë etj.; vig.

5. Lloj saje që shërben për të mbaratur diçka, duke e tërhequr mbi borë, rrëshqitëse. Lesë bore.

* U bë lesë u bë tapë. E bëri për lesë dikë e rrahu fort, e shqepi në dru, e bëri për vig. I bëri (i thuri) lesa dikujt i bëri një kurth, i ngriti grackë. E vuri (e futi) në lesë dikë e futi në kurth, e futi në grackë. I vuri lesë dikujt a diçkaje e ndaloi, e pengoi, ia preu hovin, i vuri gardh. I vuri lesën diçkaje e mbylli një çështje, i vuri kapak. Për çdo derë (për çdo shteg) ka një lesë nuk ka të metë a dobësi që nuk mund të ndreqet, çdo të keqeje a plage i gjendet ilaçi.

LESË II f. kryes. Xhufka që varen për zbukurim në veshjet popullore (sidomos në ato të grave).

LESHNIK I m. Veshje popullore burrash, e punuar me lesh deleje ose dhie; me mëngë

të rreme, që mbahet si pallto në dimër, tallagan. Hëngre fikun, vish leshnikun. fj. u.

LESHNIK II m. gjell. Lloj ëmbëlsire me qumësht delesh e me miell që piqet në tepsi.

LEVË I f. 1. Shufër e fortë dhe e gjatë, që ka një pikëmbështetje dhe shërben për të ngritur më lehtë a për të lëvizur nga vendi trupa të rëndë; ngritës, lloz. Levë e dyfishtë dy leva që kanë një pikëmbështetje të përbashkët si p.sh. gërshërët, darët etj. Krahët e levës. Mbështetja e levës. Boshti i levës. E ngre me levë.

2. tek. Shufër me një dorezë, që shërben për drejtimin e një makine, për të rregulluar lëvizjen e një mekanizmi etj. Levë dore. Levë komandimi. Levat e makinës (e traktorit). Leva e ndërrimit të marsheve.

3. fig. Mjet që ndihmon për të vënë në lëvizje diçka, për të zhvilluar një veprimtari, etj. Leva të fuqishme. Levat shtetërore (ekonomike).

LEVË II f. Njësia monetare bazë e Bullgarisë; monedhë që ka këtë vlerë.

LËKORE I f. 1. Cipa e hollë dhe e bardhë nën lëkurën e disa drurëve, lëkura e dytë, lëkostër.

Lëkore plepi (shelgu).

2. Cipë e hollë që zë diçka, shtresë e hollë që formohet nga diçka; kore.

Ka zënë plaga lëkore. Djathi ka vënë lëkore myku.

LËKORE II f. bot. Radhiqe. Lëkore e egër.

LËNDINË I f. 1. Tokë e lënë pa punuar, tokë djerr. Lëndinat e fshatit.

2. Shesh i vogël, i veshur me bar të njomë. Lëndinë malore. Lëndinë në mes të pyllit. Rrinte në lëndinë. Kullot bagëtia në lëndina.

* E bëri lëndinë diçka e shkatërroi krejt, e bëri rrafsh me tokën, e bëri shesh.

Ia nxori (ia qiti) në lëndinë diçka ia nxori diçka që e mbante të fshehtë, ia nxori në shesh.

LËNDINË II f. krahin. Lëndishtë.

LËNGOJ I jokal. 1. Vuaj e dergjem për shumë kohë nga një sëmundje e rëndë. Lëngoi gjatë (shumë). Lëngon në shtrat. Ka disa vjet që lëngon.

2. fig. Vuaj shumë, heq keq a mundohem nga dikush. Kemi lënguar nën zgjedhën e të huajve (e bejlerëve, e pasanikëve). Lëngoi në burg (në dhe të huaj, në kurbet). I lëngoј zemra vuajti shumë.

LËNGOJ II kal. 1. Lag me pak ujë, njom, stërpik. E lëngoј gjithin e dhive.

2. shih LËNGËSHTOHET 2. Lëngon rrushi. Lëngoјnë drurët në pranverë.

LIGË I f. bised. Jargë. Liga e njeriut (e kër-millit). I dilnin (i binin) ligat nga goja. E bëri me ligë.

LIGË II f. libr. Bashkim i grupeve të veçanta politike a shoqërore, i partive, i organizatave të ndryshme ose i shteteve për qëllime të caktuara; lidhje. Liga Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq. Liga e Prizrenit. vjet. Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

LIGJËRATË I f. 1. Fjalim për një çështje politike, ideologjike a shoqërore, që mbahet përpara një grupi të madh dëgjuesish. Ligjëratë e gjatë (e bukur). Mbajti një ligjëratë.

2. Mësim për një temë të caktuar që zhvillohet nga pedagogu në shkollat e larta; leksion. Cikël ligjëratash.

3. Kuvend, bisedë. Ligjëratë e këndshme. Ligjërata e plakut. gjuh. Ligjërim; e folme. Ligjëratë e shkruar (e folur). Ligjërata e zakonshme (e bisedave të përditshme).

* Ligjëratë e drejtë gjuh. formë e ndër-timit sintaksor të ligjërimin, në të cilën ai që flet a shkruan përsërit fjalë për fjalë, pa asnjë ndryshim ato që ka thënë një tjetër ose që ka thënë vetë më parë, duke i veçuar si fjali më vete. Ligjëratë e zhdrejt ë(e tërthortë) gjuh. formë e ndër-timit sintaksor të ligjërimin, në të cilën ai që flet a shkruan i riprodhon fjalët e një tjetri ose fjalët që ka thënë vetë

më parë pa bërë ndryshime në përmbajtje, por me ndryshime në formë, duke mos i veçuar si fjali më vete. Pjesët e ligjëratës gjuh. kategoritë themelore leksiko-gramatikore, në të cilat grupohen të gjitha fjalët e gjuhës sipas kuptimit leksikor dhe veçorive të tyre gramatikore (p.sh. emri, mbiemri, numërori, përemri, folja, ndajfolja, parafjala etj.).

LIGJËRATË II f. vjet. Vajtim me ligje i një të vdekuri nga gratë. E ëma nisi ligjëratën.

LIGJËRI I f. vjet. 1. Fjalë. Nuk mund të thuhet me ligjëri.

2. Këngë vaji; elegji.

LIGJËRI II f. vjet. 1. Legjislacion; ligjshmëri. 2. vet. nj. Drejtësi. Njeriu i ligjërësë.

LIGJËRIM I m. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve **LIGJËROJ I**, **LIGJËROHEM I**.

2. gjuh. Gjuha e gjallë kur e flasim a e shkruajmë, gjuha në çastin e përdorimit të saj nga njerëzit. Gjuha dhe ligjërimi. Stili i ligjërimin.

3. gjuh. Variant i gjuhës me disa veçori dalluese, që përcaktohen nga rrethanat në të cilat bëhet kumtimi dhe nga qëllimi i kumtimit; stil i gjuhës; mënyrë të foluri; mënyra e shqiptimit në të folur. Ligjërimi letrar ligjërim i normëzuar që përdoret nga njerëzit e shkolluar, gjuhë letrare. Ligjërimi bisedor. Ligjërimi libror. Ligjërimi poetik. Ligjërimi i thjeshtë. Ligjërimi dialektor. Ligjërim tregimtar. Ligjërim i plot ë(i lirë). Ligjërim i hollë (i trashë).

4. E folme; gjuhë. Ligjërimi i krahinës (i fshatit). Ligjërimet shqiptare të Atikës (të Italisë).

5. Kuvend, bisedë. U mbledhën në ligjërim.

6. fig. Zëri i disa zogjve që këndojnë ose cicërojnë bukur, kënga e zogjve; shushurimë a fëshfërimë e ëmbël që të ngjall kënaqësi. Ligjërimi i bilbilit.

Dëgjohej ligjërimi i lumit (i drurëve, i pyl-lit).

LIGJËRIM II m. Ligjësimit. Ligjërimit i një vendimi. U paraqit për ligjërimit.

LIGJËRIM III m. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve **LIGJËROJ** III, **LIGJËROHEM** II.

2. Vajtimit i një të vdekuri me ligje, ligje. E qanë me ligjërime.

LIGJËROHEM I vetv. bised. Flas, kuven-
doj, bisedoj; merrem vesh. Ligjërohu me
prindër (me vëllezërit)!

LIGJËROHEM II vetv. bised. Ankohe
për diçka, qahem te dikush. Mjaft u
ligjërove!

LIGJËROJ I jokal. 1. Flas; flas bukur. Ligjëro,
bilbili ynë. kr. pop. Ligjëron bukur.
Ligjëron shqip. Ligjëronin me zë të ulët.
Nuk i ligjëron goja.

2. kal. Lexoj ose e them përmendësh
e bukur një pjesë artistike përpara të
tjerëve, recitoj; vjet. lexoj. Ligjëroi një
vjershtë.

3. Mbjaj një ligjëratë a fjalim përpara një
grupi të madh dëgjuesish.

4. Shqyrtoj një çështje për të nxjerrë në
shesh të drejtën; e kuvendoj, e pleqëroj.

E kishte zgjedhur fshati për të ligjëruar.

5. vet. veta III fig. Këndon a ci-
cëron bukur (për disa zogj); shushurin
a fëshfërin ëmbël. Ligjëron bilbili
(kryeartëza). Ligjëron lumi. Ligjërojnë
gjethet (drurët).

* I ligjëron zemra është shumë i gëzuar,
i këndon zemra.

LIGJËROJ II kal. 1. shih **LIGJËSOJ** 1. E ka
ligjëruar statuti.

2. Vendos a urdhëroj si dua vetë, e kërkoj
diçka si me ligj; bëj ligjin. Në fshat vetëm
ai ligjëronte.

LIGJËROJ III kal. Qaj me ligje një të vdekur.

LIGJËRUES I m. 1. Folës; gojëtar.

2. Ai që lexon ose e thotë përmendësh e
bukur një pjesë artistike, recitues; vjet.
lexues. Ligjërues i zoti. Ligjëruesit e
gazetës.

3. Ai që mban një ligjëratë a fjalim për-
para një grupi të madh dëgjuesish.

LIGJËRUES II m. Ligjvënës. Është pasur
parasysht nga ligjëruesit.

LIGJIM I m. vjet. 1. Veprimi sipas kuptimeve
të foljeve **LIGJOJ** I, **LIGJOHEM**.

2. Diçka që vërteton se dikush është i
pafajshëm, shfajësim.

LIGJIM II m. Veprimi sipas kuptimeve të fol-
jeve **LIGJOJ** II, **LIGJOHET**.

LIGJOJ I kal. vjet. 1. jokal. Flas, ligjëroj.
Nisi të ligjojë.

2. I jap të drejtë dikujt; e nxjerr të pafa-
jshëm dikë, e shfajësoj; përligj.

3. Ngushëlloj; mëshiroj. S'kishte njeri që
ta ligjonte.

4. fet. Pagëzoj. I ligjonin në kishë.

LIGJOJ II kal. vjet. Pranoj diçka si të vërtetë,
vërtetoj; ligjësoj. Nuk e ka ligjuar dija
(shkenca).

LINJË I f. 1. Këmishë pëlhure e hollë, e gjatë
dhe e gjerë, që e përdorin si veshje të
sipërme ose të brendshme kryesisht gratë
fshatare; këmishë burrash, zakonisht prej
pëlhure të bardhë, që e veshin kryesisht
fshatarët. Linjë e hollë (e bardhë, e
thjeshtë, e qëndisur). Linjë grash. Linjë
burrash. Linjë pëlhure (liri, pambuku,
mëndafshi).

Linjë me mëngë të gjata.

2. Çarçaf prej pëlhure liri. Shtroi linjat.

3. Shami koke prej pëlhure të bardhë.
Lidhi kokën me linjë.

* Doli linjës u çudit shumë, u habit jashtë
mase. I vuri linjën dikujt e vuri nën vete
dikë, e vuri poshtë, e mposhti. Rrinte si
murga në linjë shih te **MURG/Ë**, ~A I.

LINJË II f. 1. shih **VIJ/Ë**, ~A 1, 3, 4, 9-
13. Linjë ajrore (hekurudhore). Linjë
telefonike (telegrafike). Linjë elektrike.
Linja e tensionit të lartë. Në dy linja.
Shtrirja e linjave. tek. Sistem pajisjesh e
makinerish të lidhura së bashku, të cilat
kryejnë në varg punë të ndryshme për
prodhimin e diçkaje. Linjë teknologjike.
Linjë prodhimi.

Linja e petëzimit. Ngritja e linjave të reja. bot. Pasardhës i një bime, që është fituar nga vetëpllenimi i saj i detyrueshëm, zakonisht gjatë katër ose gjashtë breznish. Linjë misri.

LIQE I f. bot. Xinë.

LIQE II f. vjet. Shpërblim për një punë të kryer, hak; qira. Kërkoi liqe. Mori liqen. Mori qetë me liqe. E pagoi liqen.

LIRË I f. 1. Vegël muzikore e përdorur që në kohë të lashta, me kasë të vogël e të përkulur në të dy anët, me dy brirë që zgjaten prej saj dhe me katër deri shtatë tela në mes tyre. Lira greke. Telat e lirës. I binte lirës. Figura e lirës është emblema e muzikës.

2. fig. Frymëzimi e krijimi poetik. Nuk heshti asnjëherë lira e Naimit.

LIRË II f. Njësia monetare bazë e Italisë, e Turqisë etj.; monedhë që ka këtë vlerë.

Lira italiane. Lira turke. Lirë sterlinë njësi monetare e Anglisë, funt sterlinë.

LIRI I f. 1. Të qenët i lirë në jetë e në punë; mungesa e shtypjes, e varësisë dhe e kufizimeve që pengojnë, vështirësojnë e ndrydhin veprimtarinë politike e shoqërore të një klase a shtrese të caktuar, të shoqërisë në tërësi ose të anëtarëve të saj; gjendja kur një vend nuk është i pushtuar dhe kur një popull rron i lirë dhe i pavarur. Liri politike (shoqërore, ekonomike). Liritë demokratike e drejta e fjalës, e shtypit, e mbledhjes, e grumbullimit dhe e manifestimit publik. Liri e plotë (e kufizuar). Liria e fjalës (e shtypit, e mbledhjeve). Lufta për liri e pavarësi. E fituam (e mbrojmë) lirinë.

Vdekje Fashizmit ? Liri Popullit! S'durohet jeta pa liri. Liria i ka rrënjët në gjak. fj. u. Liria nuk dhurohet, por fitohet. fj. u. Liria nuk mbrohet me fjalë e me urata, por me harqe e me shpata. fj. u.

2. Gjendja e dikujt që nuk është i burgosur, i internuar a i arrestuar dhe gëzon

të drejtat qytetare; të qenët i lirë. Liria personale. U dënua me heqje të lirisë.

3. vet. nj. hist. Gjendja e një njeriu, i cili nuk ishte skllav a bujkrob (në rendin skllavopronar e në atë feudal).

4. Mungesa e kufizimeve ose e pengesave në veprimtarinë e përditshme të dikujt ose në një fushë të caktuar; e drejta e plotë që i jepet dikujt për diçka; të qenët i lirë në mendime e veprime. Liria e mendimeve (e pikëpamjeve). Liria e ndërgjegjes.

Liri veprimi. Liria e martesës. I ka dhënë fëmijës liri të madhe.

5. vet. nj. filoz. Mundësia e njeriut për të njohur dhe për të përdorur sipas vullnetit të tij ligjet objektive të zhvillimit të natyrës e të shoqërisë. Liria dhe domosdoshmëria. Liria e vullnetit.

* I ka dhënë liri gjuhës keq. flet shumë e pa u menduar mirë, nuk i vë fre gjuhës. Liria poetike let. heqje e shtesa tingujsh ose ndryshime të tjera gjuhësore në vargjet për të ruajtur ritmin, numrin e rrokjeve etj. Liria e detit të hapët e drejta e anijeve të shteteve të ndryshme për të lundruar lirisht në det të hapët. Liria e hapësirës ajrore (liria e ajrit) e drejta e aeroplanëve të shteteve të ndryshme për të fluturuar lirisht në një hapësirë ajrore të caktuar.

LIRI II f. Jelja e kalit. Liri e gjatë. Mbahej nga liritë.

LIRISHTË I f. Livadh i vogël në mes të pyllit, çeltirë. Lirishtat e pyjeve. Lirishtë me bar.

Doli në lirishtë.

LIRISHTË II f. Arë e mbjellë me li; tokë që ka qenë e mbjellë me li.

LOJË I f. 1. Veprimi sipas kuptimeve 1 e 2 të foljes LUAJ. Loja me top. Loja me letra. Ndalohet loja në rrugë.

2. Tërësia e lëvizjeve dhe e veprimeve të tjera që bëjnë ata që luajnë (në kuptimin 1 e 2); ndeshje sportive; lloji i mënyrave dhe i mjeteve që përdorin ata

që luajnë; mënyra si luan dikush. Lojë e bukur (argëtuese, edukuese). Lojërat popullore. Lojëra sportive. Lojërat bal-kanike (olimpike). Lojëra për fëmijë (për të rinj). Loja e futbollit

(e basketbollit, e shahut). Pjesa e parë e lojës. Gjyqtari i lojës. sport. Edukimi i fëmijëve nëpërmjet lojës. Mori pjesë në lojë. E fitoi (e humbi) lojën. I pëlqen loja. Është dhënë pas lojës.

3. Send a tërësi sendesh që përdorim për të luajtur, lodër. Lojëra fëmijësh.

Bleu lojëra të reja.

4. art. Veprimet e lëvizjet që bën një aktor kur luan një rol në skenë; mënyra si e luan rolin e tij; mënyra si luhet një pjesë a një vepër muzikore. Loja skenike (teatrale). Lojë e shkathët. Loja e aktorit (e artistit).

5. fig. Sjellje e shtirur e veprime dredharake për të mashtruar të tjerët; diçka që organizohet me dredhi për t'ia hedhur një njeriu ose për t'u tallur me të; shaka. Lojë e rrezikshme. I luajti një lojë. Mos i bëj lojëra! E ka për lojë. Bëri lojë me dikë u tall; bëri shaka me të.

6. usht. vjet. Stërvipte luftarake, që kryhej nga forcat ushtarake të njësive të ndryshme sipas një plani të organizuar për të arritur një qëllim të caktuar.

Lojë luftarake (operative). Loja e trupave.

7. Tërësia e veprimeve që kryhen nga forcat e sigurimit të shtetit, nga zbuluesit etj. për të mashtruar kundërshtarit, për të shpëtuar prej tij a për të fituar kundër tij. Hyri (mori pjesë) në lojë.

8. fig. Këmbim i shpejtë i njollave të dritave, të ngjyrave etj.; ndryshimi i shpejtë e i shpeshtë a i përsëritur i diçkaje. Lojë dritash. Loja e flakëve. Loja e çmimeve të tregut. Loja e bursës.

* U bë lojë e dikujt e tallin a e qeshin të tjerët, u bë gazi i botës. Bën lojën e dikujt

a) shtiret për të ngatërruar të tjerët, bën veprime mashtruese për t'ia hedhur

dikujt;

b) sillet e vepron si ia do puna një tjetri, është vegël e dikujt. Doli nga loja u largua nga një punë e vështirë, e rrezikshme a e ndërlikuar, doli nga vallja. Hyri në lojë hyri në një punë të vështirë, të rrezikshme a të ndërlikuar, hyri në valle. E humbi lojën shih te HUMB. Lojë fëmijësh punë shumë e thjeshtë, që kryhet fare lehtë. Lojë fjalësh diçka që thuhet për shaka a për qëllime të tjera, duke përdorur fjalë që tingëllojnë njësoj a në mënyrë të ngjashme, por që kanë kuptime të ndryshme; fjalë që thuhet sa për të kaluar radhën dhe që nuk i japin zgjidhje a përgjigje të vërtetë një çështjeje. Luan lojën (lodrën) e dikujt shih te LUAJ. E vuri në lojë (në lodër) dikë e talli, e qesëndisi. Bën lojën e strucit libr. shih te STRUC, ~I.

LOJË II f. 1. Grua e bukur me lëkurë të bardhë e me trup të shëndoshë.

2. Përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Grua lojë.

LOZAK I mb. Që bën shumë lojëra; lodërtar, lozonjar. Vajzë lozake.

LOZAK II mb. Që ka loze, që është me loze. Bimë lozake.

LUGARE I f. 1. Enë prej druri si lug me bisht, që e përdorin muratorët për të mbajtur llaçin; govatë. Lugarja e muratorit.

2. Luginë e pjerrët dhe e thellë. Malësia është gjithë lugare.

LUGARE II f. Mbajtëse lugësh, lugës.

LUGËS I m. 1. Sqepar me presë të harkuar, që përdoret për të gdhendur drurin për bucela, për lugje etj.; thikë e lakuar që përdoret për të gdhendur pjesë të thellura në dru, për të bërë lugë etj. Gdhend me lugës.

2. Rende e përkulur. Lugësi i kungullit.

3. Vegël e metaltë, me një lopatëz të lugët, që përdoret për të kuar magjen nëpër qoshet; kruese. Lugësi i magjes.

LUGËS II m. 1. Kuti e posaçme prej druri, që varet në mur dhe shërben për të mbajtur lugët, mbajtëse lugësh, farashë. Lugës druri. Vë në lugës.

2. Mbathësi i këpucëve.

3. Lugë e madhe, qepshe, garuzhdë. E ndau gjellën me lugës.

4. përb. Lugëlëngës, sahanlëpirës. Lugësit e Ballit Kombëtar.

LUGËS III m. zool. Sqeplugë.

LULËBARDHË I f. bot. 1. Bimë barishtore e egër, me gjethe të vogla heshtore, me lule të bardha në vjollcë, që rritet zakonisht në arat e mbjella me drithëra.

2. Lloj lakre e ëmbël, me gjethe të mbledhura, që çel lule të bardha.

LULËBARDHË II f. mjek. Sëmundje e rëndë, që shfaqet me puçrra të vogla në trup, të cilat ënjten e mbushen me qelb dhe japin dhimbje të mëdha. Ka lulëbardhën. I ra lulëbardha.

LULËZ I f. 1. bot. Bimë barishtore, me gjethe të holla si hala pishe e të grumbulluara në tufë, e cila bën një boçë në majë që e thajnë dhe e përdorin për fare djathi.

2. mjek. Sëmundje e syrit që e vesh atë, e skuq ose i lë një njollës të kuqe; pika e syrit.

3. mjek. Elbth, kath. I ka dalë lulëza në sy.

LULËZ II f. zool. Lubardhë.

LUNDËR I f. 1. Mjet i thjeshtë lundrimi prej druri, që vihet në lëvizje me lopata ose me shtagë, barkë e ngushtë dhe e gjatë; anije e vogël me fund të sheshtë, që vihet në lëvizje me lopata ose me vela. Lundër peshkatarësh (peshkimi). Shtaga e lundrës. Hipi në lundër.

2. Trap druri që shërben për të kaluar lumin.

3. tek. Pjesë e makinës shirëse, që ka trajtën e një govate.

* U bë lundër mospërf. u deh sa mezi qëndron më këmbë, u bë tapë, u bë bër-ryl.

S'bëhet lundra me dru marene fj.u. shih te MAREN/Ë,~A.

LUNDËR II f. zool. Kafshë e egër e mishn-grënëse, e madhe sa një mace, me lëkurë të butë e të çmueshme, me qime të shndritshme në ngjyrë kafe të mbyllur, që rron në ujëra të ëmbla dhe ushqehet me peshq; vidër. Lëkurë lundre.

* U bë (si) lundër u ngjall a u majm shumë.

LLAJË I f. 1. Dele ose lopë krejt e zezë.

2. përd. mb. Që e ka qimen të zezë (për delet dhe lopët).

LLAJË II f. krahin. Hinkë.

LLALLË I f. 1. zool. Flutur, më e madhe se miza e zakonshme, e cila i bën vezët në zgjuan e bletëve dhe i detyron këto të largohen prej këtej. Llalla i prish bletët.

2. fig. Diçka që sjell grindje; grindje, gërnjë. U ka hyrë llalla në shtëpi.

LLALLË II f. bised. Mëndeshë.

LLASHKË I f. 1. Dele, dhi ose lopë që ka pjellë një vit para kohës së zakonshme; pëllezë motake.

Qengji (keci) i llashkës. Viçi i llashkës.

2. Përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Dele (dhi, lopë) llashkë.

LLASHKË II f. Përpajné. Llashkat e hardhive.

LLOGOBERE I f. 1. Lule që është hapur shumë dhe që e ka humbur bukurinë.

2. fig. Vajzë a grua që flet shumë, llafazane, gojëpashmagje.

LLOGOBERE II f. zool. Rosë e egër që e ka zënë vera pa shtegtuar.

LLONXHË I f. 1. Ngastër a rrip toke që mbillet me perime ose me lule në oborr a diku pranë shtëpisë, lehë. Llonxhë me lule (me spinaq, me domate).

2. përd. mb. fig. I mbushur plot, që ka të gjitha të mirat. Llonxhë e kishte shtëpinë.

3. përd. ndajf. fig. Me të ngrëna me të pira. Është mësuar llonxhë. Ia kaluan llonxhë.

LLONXHË II f. 1. Gropë e madhe e mbushur me ujë, pellg me ujë shiu.

2. Strofull; vrimë: Llonxha e dhelprës (e lepurit).

LLONXHË III f. 1. vjet. Kuvendi i gjithë fshatit; mbledhja e pleqësisë së fshatit; njerëzit që merrnin pjesë në kuvend a në mbledhje; vendi a sheshi i fshatit, ku bëhej kuvendi i tij ose mbledhje pleqësia. Llonxha e fshatit. Rrapi i llonxhës. U mblodh llonxha.

Ishin mbledhur në llonxhë.

2. fig. bised. Bisedë e gjatë dhe e shtruar.

3. fig. bised. Zhurmë e madhe që bëjnë shumë veta kur flasin njëherësh e nuk merren vesh njëri me tjetrin muhabet me zhurmë e me potere; potere, rrëmujë.

U bë llonxhë e madhe.

4. përd. ndajf. fig. Pa rregull, rrëmujë, plot zhurmë. Shkoi puna llonxhë.

LLUKË I f. 1. Vezë e prishur, e cila nuk mund të çelë zog. Llukat e pulës.

2. krahin. Kllloçkë, sqokë. Ka rënë të pala llukë.

3. fig. Njeri i trashë nga mendja, budalla.

4. Përd. mb. sipas kuptimeve 1, 3 të emrit. Vezë lluke. Ishte fare llukë.

LLUKË II f. bot. krahin. Bli.

MAÇ I m. 1. Njëra nga të dy ngjyrat e zeza në lojën e letrave, që shënohet me një figurë në trajtën e gjetes me bisht; letra me këtë figurë e ngjyrë. Hodhi maçin.

Kishte tre maçe në dorë.

2. Përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Asi (mbreti) maç. Dama (nënta) maç.

MAÇ II m. krahin. Mace.

* Erdhën (shkuan, ikën) me kuç e me maç (me qen e me mace) shih te KUÇ, ~I.

MAHI I f. ndërt. Secila nga gërshërezat anësore të çatisë së një ndërtese, që shkojnë nga streha në kulm. Shtëpia ka katër mahi.

MAHI II f. Pezmatim, malcim i një plage, mahisje. Mahia e plagës.

MAHI III f. Shaka; shpoti, qesëndi. Mahi e hollë. Bën mahi. E ka me (pa) mahi. Si për mahi.

MAJ I m. Muaji i pestë i vitit, që vjen pas prillit. Festa e Një Majit. Lulet e majit.

* Si bora në maj shih te BOR/Ë, ~A. Nuk ka kokë dëbora në maj fj. u. nuk qëndron gjatë, shkrin shpejt. Shkëndijat (shkëndijëzat) dalin në maj fj. u. shih te SHKËNDIJ/Ë, ~A. Zinin majin vjet., etnogr. ngriheshin herët ditën e një majit dhe dilnin në natyrë për të festuar ardhjen e muajit të luleve (sipas një zakoni të vjetër popullor). Lule maji bot. shih te LUL/E, ~JA. Zhuzhaku i majit zool. shih te ZHUZHAK, ~U.

MAJ II m. 1. Çekani i madh që e përdor farkëtarë për të rrahur hekurin; vare hekuri.

Maji i kovaçit. Maj për të thyer gurët.

2. Vare druri; tokmak; kopan. Maj samarxhinjsh. Majat e dërstilës. Maj për të rrahur rrobat. Thyejnë plisat me maj. E rrahin gjineshtrën me maj.

MAKTH I m. bot. Lloj bari i ngjashëm me trëndelinën, që rritet zakonisht në ara të mbjella me grurë dhe bën lule të verdha a të bardha e me erë si të mjaltit.

MAKTH II m. Këlysh lepurit; lepurush.

MAKTH III m. anat. Cipë e mishtë si sfungjer, që mbështjell e ushqen pjellën te grua shtatzënë ose te femrat barrsa të gjitarëve dhe që del jashtë bashkë me të, shtrat.

MAKTH IV m. folk. 1. Ankth.

2. mit., folk. Figurë e përrallave popullore, që përfytyrohet si njeri, i cili gjoja vjen natën e të zë frymën, por, po ta kapësh, mund të të japë çdo gjë që i kërkon në atë çast; të rëndët e dheut.

MALL I m. Dhembje e thellë shpirtërore e trishtim që ndjejmë për dikë a për diçka që ndodhet larg nesh; dëshirë e fortë për t'u kthyer përsëri në një vend që s'e harrojmë kurrë, për të takuar një njeri të dashur që është larguar, për të rijetuar edhe një herë si dikur ose për t'u marrë përsëri me diçka që na ka pëlqyer shumë. Me mall të madh. Malli për atdhe. Malli i nënës (i motrës). Kishte mall për prindërit (për fshatin, për shtëpinë, për gurët e sokakut). Kam mall për ato vite. Kishte mall t'i hipte kalit

(të ngiste qetë). Më merr (më zë, më kap) malli për dikë a për diçka.

* Sa për mall sa për qejf, sa për të nxjerrë mallin. Është për mall diçka është shumë e mirë a shumë e bukur, është diçka që ta do zemra gjithnjë. E kishte për mall dikë a diçka e donte shumë, e kishte për zemër. Do t'i kesh mallin dikujt a diçkaje do ta kërkosh e nuk do ta gesh më (thuhet kur dikush nuk e vlerëson si duhet dikë a diçka kur e ka). Më nxjerr (më heq) mallin e dikujt a të diçkaje shih te NXJERR 28. S'e ha malli për dikë a për diçka iron. nuk shqetësohet fare, as që bëhet merak për dikë a për diçka, aq i bën. Nuk më merr malli për dikë mospërf. nuk dua të di fare për të, nuk dua t'ia shoh fytyrën. E preu malli (barku) për dikë a për diçka iron. shih te PRES I. Rrallë e për mall shih te RRALLË 2. E bën nga halli e jo nga malli shih te HALL, ~I.

MALL II m. 1. ek. Produkt i punës, që plotëson një nevojë të njeriut dhe që prodhohet për t'u këmbyer ose për t'u shitur; send i prodhuar për t'u shitur. Mall i mir ë(i lirë, i shtrenjtë). Mallra ushqimore (industriale). Mall shqiptar (i huaj). Mallra të përdorimit të gjerë. Depo mallrash. Tren (vagon) mallrash. Agjencia e mallrave.

Shitja (blerja) e mallrave. Prodhimi i mallrave. Sasia (cilësia) e mallrave.

2. bised. Pasuri, kryesisht e patundshme, që mund të shitet ose të blihet; pasuri pri-

vate, shoqërore a shtetërore. Mall belik. vjet. pasuri shtetërore. Mall i trashëguar. Mall e gjë. Malli i shtëpisë. Është malli i shtetit (i kooperativës). I zoti i mallit.

Kishte shumë mall e para. E hëngri (e shtoi) mallin. Shinte në mallin e botës

(si në mallin e vet, si në mallin e babait).

3. bised. mospërf. Njeri ose send pa vlerë a pa rëndësi. E njoh mirë se çfarë malli është ai. Këto fjalë s'janë të tuat, janë mall i tjetërkujt. Mall bajat.

* Mall belik mall pa zot, diçka e lënë pa rojë e pa kujdesie. Mall pa zot diçka, për të cilën s'kujdeset askush, diçka me të cilën gjithkush mund të bëjë ç'të dojë.

S'e bëj mall dikë a diçka s'i jap rëndësi, s'e vë në hesap. Nuk ia dinte skajin mallit (pasurisë) shih te SKAJ, ~I.

MARKË I f. Njësia monetare bazë e Gjermanisë dhe e Finlandës; monedhë që ka këtë vlerë. Marka gjermane. Marka finlandeze.

MARKË II f. 1. Shenjë dalluese që u vihet prodhimeve të ndryshme për të treguar llojin, cilësinë dhe ndërmarrjen ose vendin ku janë prodhuar; prodhim i një fabrike, i cili mban një shenjë të tillë dhe që ka cilësi e tipare të caktuara; fabrika a uzina që prodhon një mall e që vlerësohet nga cilësia e tij. Marka shqiptare. Markë e njohur (e mirë). Me markë të huaj. Marka e fabrikës (e uzinës). Marka e stofrave (e makinave).

Mall pa markë. I vë markën. I ç'marke është? Mbrojnë markën e vet.

2. fig. bised., keq. Njeri çfarëdo, dikush; lloj, farë (për njerëzit). E njohim se çfarë marke është ai.

MARSH I m. muz. Pjesë muzikore me ritëm të theksuar, që luhet nga një bandë zakonisht për të shoqëruar ecjen me hap të rregullt të një grupi njerëzish (ushtarakësh, pjesëmarrësish në parakalim etj.). Marsh ushtarak. Marsh i përmortshëm.

Marshi i fizkulturistëve. Nën tingujt e marshit.

MARSH II m. tek. Shkallë shpejtësie në disa motorë, që vihet a ndërrohet me anë të një mekanizmi të posaçëm; mekanizmi i ndërrimit të shpejtësisë; shpejtësia e një automjeti në një shkallë të tillë. Marshi i parë (i dytë, i katërt). Marshi i shpejtësisë.

I ndërroi marshin automobil (makinës, traktorit).

MARROHEM I vetv. Marrosem, çmendem.

MARROHEM II vetv. 1. Turpërohem, bëhem me marre, koritem.

2. Pës. e MARROJ II.

MARROJ I kal. Marros, çmend.

MARROJ II kal. E turpëroj dikë, e bëj me marre, e korit. E marroi dhe e bëri horr e shau e s'i la gjë pa thënë.

MASË I f. 1. Njësi matjeje (e gjatësisë, e peshës, e vëllimit etj.); diçka që përdoret si mjet për të matur gjatësinë, vëllimin, peshën etj.; enë (gotë, tenxhere etj.), vëllimi i së cilës njihet dhe shërben si njësi matjeje për diçka zakonisht të lëngshme, si pluhur a kokrra-kokrra; sasia e lëndës që nxë një enë e tillë. Masë e madhe (e vogël).

Masë drithi (mielli). Masë vaji (rakie, vere). Masë njëlitërshe. Masë gjatësie.

Sistemi metrik i masave. Zyra e kontrollit të peshave dhe të masave. Mori një masë sheqer.

2. Vlera e një madhësie, e shprehur në njësi matëse; përmasat e diçkaje (gjatësia, gjerësia etj.), që duhen për t'i bërë një veshje, një pajisje etj. Masa e trupit. Masa e këmbës (e këpucës). Masa e enës. I mori masën. Janë prerë me një masë.

3. edhe fig. Madhësia a sasia e diçkaje; madhësi a vlerë që merret për krahasim. Në të njëjtën (në po atë) masë. Në masë të barabartë. Nuk duhen matur me të njëjtën masë.

4. fig. Kufi, cak; shkallë. Tej (jashtë) mase tepër, jashtë çdo kufiri. Ndjenja

e masës njohja e një caku që nuk duhet kaluar në veprime, në qëndrimet ndaj të tjerëve etj. E kaloj masën e teproi. Në një masë të madhe. Deri në atë masë sa... Deri në një farë mase. Në masën e duhur. E di masën. Nuk ka masë. U gëzova pa masë u gëzova shumë.

5. let. Numri dhe mënyra e radhitjes së rrokjeve të theksuara e të patheksuara në llojet e ndryshme të vargjeve. Masa e vargut. Masat e një vjershe.

6. muz. Ndarja e një pjese muzikore në disa pjesë të barabarta, për të formuar ritmin; takt. Masë muzikore. Masë e thjeshtë (e përzier, e përbërë, e çrregullt).

Masë teke (çifte).

* Me masë

a) as shumë as pak, aq sa duhet, me qokë;
b) me kursim, pak nga pak. Nuk i vë masë gojës edhe poh. flet të lara e të palara, flet shumë e pa përgjegjësi, nuk i vë fre gojës.

MASË II f. 1. Veprim a mënyrë veprimi, urdhër a udhëzim i nevojshëm për t'ia aritur një qëllimi të caktuar. Masë e rëndësishme (e shpejtë, e ngutshme, e drejtë, e rreptë). Masa konkrete (praktike, energjike, rrënjësore, përgatitore). Masa organizative.

Masa lehtësuese. Masat e nevojshme. Masa mjekësore (higjienike, parandaluese, parambrojtëse). Masa sigurimi. Plani i masave. Marr masa.

2. Ndëshkim, dënim që përdoret si mjet edukimi ndaj dikujt.

Masë disiplinore (ndëshkimore). Morën masë kundër tij.

MASË III f. 1. Sasi e madhe prej një lënde, pa formë të caktuar e vështruar si diçka më vete. Masë e madhe. Masë plastike. Masë e zjarhtë. Masë bimore. Masë e gjelbër (e njomë). Masë dheu (rëre). Masë ajri (ajrore). Masë uji (ujore). Masë debore.

2. Grumbull i madh sendesh a qeniesh të ndryshme. Masë gurësh.

Masë peshqish (shpendësh).

3. kryes. Grup i madh njerëzish që përbën një forcë të gjallë e të qëndrueshme në një vend; shtresë e gjerë shoqërore; populli punonjës. Masat e gjera (punonjëse). Masa e punëtorëve (e fshatarëve, e grave, e rinisë, e mësuesve, e nxënësve, e sportdashësve, e dëgjuesve, e shikuesve). Organizatë masash. Këngë masash (për masat). Zëri i masës. Vija e masave. Vepër e masave. Kërkesat e masës (e masave). Në gjirin e masave. Në krye (në bisht) të masave. Shkrirja me masat. T'u shërbejmë masave. E bëjnë masat. Për masat.

4. spec. Madhësi që mat sasinë e lëndës së një trupi dhe që është një nga madhësitë themelore të mekanikës; plogëtia e një trupi në raport me forcën që zbatohet mbi të.

5. filoz. Kategori që shpreh njësinë e sasisë e të cilësisë në sendet ose në dukuritë e botës reale. Masë e re. Kategoria e masës. Priset masa.

* Në masë me shumicë. Bën masë elektr. bën qark të shkurtër e nxjerr shkëndija (kur takohen dy përcjellës të zhveshur të rrymës elektrike).

MASHALLA I f. vjet. Monedhë ari ose argjendi që u vinin fëmijëve të vegjël në ballë gjoja për t'i mbrojtur nga syri i keq (sipas besëtytnive). Kujtonin se i mbronin fëmijët me mashalla e hudhra.

MASHALLA II f. vjet. Kutiteneqeje me hi e me vajguri, që përdorej për ndriçim; pishë a urë e madhe e ndezur. Ndiznin mashallanë. Rrugët ndriçoheshin me mashalla.

MASHKULLOR I m. Mashkulli i bletës.

MASHKULLOR II m. Shermend i hardhisë që nuk lidh kokrra.

MAT I m. 1. Buzë deti; breg lumi.

2. Ranishtë.

MAT II m. shah. Gjendje e lojës kur mbreti i kërcënuar me shah nuk mund të mbrohet ose nuk ka asnjë vend të lirë për të

lëvizur. Mat i bukur (i pashmangshëm). Shah mat!

Mbreti është mat! E bëri (e zuri) mat.

* E zuri (e bëri) mat dikë e zuri ngushtë, e bëri që të mos ketë asnjë mundësi shpëtimi, e mbërtheu me shpatulla në mur, e mundi.

MEKTH I m. Të fikët. I ra mekthi. Të raftë mekthi! mallk.

* I ra mekthi në punë u lodh e u këput, i ra bretku.

MEKTH II m. Këlysh lepurit, lepurush.

MEL I EGËR (MELI I PULËS) bot. Kostrevë.

MË II përem. 1. Trajtë e shkurtër e përemrit vetor të vetës së parë në numrin njëjës, në rasën dhanore. Më duket. Më pëlqen. Më vjen mirë. Më bëri një të mirë. Më gjeti një vend. Më thua të vërtetën! Më iku nga mendja. Më hëngri veshët.

2. Trajtë e shkurtër e përemrit vetor të vetës së parë në numrin njëjës, në rasën kallëzore. Më pa. Më dëgjoi. Më merr malli. Më la vetëm. Më falni!

3. bised. Përdoret para foljeve për të treguar një qëndrim të afërt e dashamirës të folësit për atë, për të cilën bëhet fjalë (si dhanore etike). Si më shkon? Si më je?

A m'i pe fëmijët? Të m'i bësh të fala nipit!

4. përd. pj. Përdoret para foljeve për t'i dhënë më shumë gjallëri dhe shprehësi ligjërimin. Më t'u ngrit në këmbë. Më ta bëri copë-copë. Më t'ia nisi këngës. Hë, më të lumtë!

MËTOJ I kal. Kërkoj me këmbëngulje të bëhet diçka, të më plotësohet a të më pranohet diçka etj., kërkoj diçka sikur të ishte e drejta ime, pretendoj. Mëton shumë. Mëton me (pa) të drejtë.

MËTOJ II kal. 1. Dalloj a kuptoj diçka, vë re; e marr vesh, e zbuloj diçka pasi e kam gjurmuar a hetuar, e pikas, e nuhat (edhe fig.). E mëtoi vonë (shpejt). S'e mëtoi dot nga larg.

- E mëtoi se çfarë njeriu ishte. E mëtoi ku e kishte hallin.
2. Rregulloj, ndreq, qeveris. Mëtoi dhomën (shtëpinë). Mëtoi opingat.
- MIROS** I kal. bised. Përmirësoj, mirësoj. Miros shtëpinë. Miros tokën (arën) me pleh.
- MIROS** II kal. fet. Lyej me vaj të bekuar një besimtar të krishterë, zakonisht në ballë, duke i bërë shenjën e kryqit, lyej me miro, vajoj (në vendet ku vepron kisha e krishtere).
- MIROSEM** I vetv. bised. Përmirësohem, mirësohem. U miros vendi.
- MIROSEM** II fet. Pës. e MIROS II.
- MIROSJE** I f. bised. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve MIROS I, MIROSEM I. Mirosja e vendit.
- MIROSJE** II f. fet. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve MIROS II, MIROSEM II.
2. Ceremonia e lyerjes së besimtarëve me miro nga prifti.
- MISHËL** I f. kryes. anat. Tejzat e zërit; penjëz.
- MISHËL** II f. bot. Lloj kërpudhe e tultë, që hahet, e cila e ka anën e poshtme të ombrellës në ngjyrë kafe të çelur.
- MITË** I f. 1. Bisk i ri që del rreth trungut të një druri të prerë; lastar.
2. Bisk i vogël i të lashtave ose i bimëve të tjera, që ka mbetur i pazhviluar, mitër. Mitat e misrit (e duhanit).
- MITË** II f. 1. keq. Para a diçka tjetër që dikush ia jep nën dorë një nëpunësi në kundërshtim me moralin socialist që t'i mbarojë një punë në rrugë të jashtëligjshme; ryshfet. Marrja (dhënia) e mitës dënohet me ligj. Merrte mitë.
2. etnogr. Shuma e parave që familja e dhëndrit i jepte familjes së nuses; shpërblymimi në para që i jepej shkuesit.
- MITËR** I f. anat. Organ i gruas dhe i femrës së gjitarëve, në trajtë të dardhës, ku zihet e zhvillohet pjella; an. Trupi i mitrës. Brirët e mitrës. Qafa e mitrës. Cipa e mitrës. Heqja e mitrës.
- MITËR** II f. bot. Bisk i vogël i të lashtave ose i bimëve të tjera, që ka mbetur i pazhviluar, mitë. Mitër misri (gruri).
- MITËR** III f. Kësulë e lartë me dy maja, e qëndisur me shirita ari etj., që mbajnë peshkopët e klerikët e tjerë eprorë gjatë ceremonive fetare. Mitër e peshkopit (e kryepeshkopit, e papës).
- MIZANTROP** I m. libr. 1. Njeri i mbyllur në vetvete e i zyrtë, të cilit i pëlqen të rrojë i vetmuar, larg njerëzve; ai që nuk i do a i urren njerëzit e shoqërinë.
2. Përd. mb. sipas. kuptimit të emrit. Njeri mizantrop.
- MJET** I m. 1. Vegël, send, makinë, tërësi pajisjesh etj., që shërben për të bërë një punë, për të kryer një veprim a veprimtari, për të udhëtuar etj.; çdo gjë që përdoret për të bërë një punë. Mjet i thjeshtë. Mjete shkollore. Mjete mbrojtëse. Mjete tokësore (detare, ajrore). Mjetet luftarake (e motorizuara). Mjetet e punës. Mjetet e transportit (e komunikacionit). Mjetet e lundrimit (e udhëtimit). Mjetet e mësimit. Mjetet e peshimit (e matjes).
2. Mënyrë veprimi a udha që ndiqet për t'ia arritur një qëllimi; rrugë. Mjet i fuqishëm (i rëndësishëm). Mjet i sigurt. I vetmi mjet shpëtimi. Teatri është një mjet edukimi dhe çlodhjeje. Përdori gjithfarë mjetesh për t'ia dalë mbanë. E gjeti mjetin për ta zgjidhur çështjen. Me të gjitha mjetet me çdo kusht, me çdo mënyrë. S'ka mjet tjetër.
3. kryes. Sende (para, ushqime etj.) të nevojshme për të jetuar; fin. fonde, para. Mjetet financiare (buxhetore, monetare, xhiruese). Mjetet e lira. Mjetet e jetesës. Mjetet e pagesave.
4. Pjesë përbërëse e diçkaje, element që hyn në përbërjen e një tërësie ose që

kryen një funksion të caktuar. Mjetet letrare (artistike). Mjete gramatikore (sintaksore, leksikore, fjalëformuese). Mjet stilistik (shprehës). Mjetet e kompozimit.

* Mjetet e prodhimit ek. tërësia e veglave dhe e objekteve të punës që përdorin njerëzit në procesin e punës për të përvetësuar lëndët natyrore dhe për të prodhuar të mirat materiale.

MJET II m. Mur i hollë, zakonisht me dërrasa, që ndan një dhomë nga një tjetër; ndërmjetëz dërrase.

MOLLDRAGË I f. Mëllë a bullungë që del nën thua ose afër thoit. I daltë molldraga! mallk.

MOLLDRAGË II f. bot. Bordullak.

MOLLËZ I f. 1. Pjesa e ngritur e faqes nën sy. Me mollëza të skuqura (të kërcyera). Me mollëza të dala. Mollëzat e faqeve. I digjeshin mollëzat.

2. Pjesa e mishtë dhe e ngritur në majat e gishtave ose në pëllëmbën e dorës. Mollëza e pëllëmbës. Mollëzat e gishtave. E prek me mollëza.

3. Pjesa e një dorëze që shtrëngohet me pjesën e tultë të pëllëmbës; koka e një dorëze. Mollëza e shpatës.

* Mollëza (molla) e fytyrës anat. fikthi.

MOLLËZ II f. bot. Modhull.

MOTIV I m. Shkaku që nxit e vë në lëvizje dikë për të bërë diçka, arsyeja që të shtyn për një veprim ose për një qëndrim a sjellje të caktuar. Motiv i rëndësishëm (i fuqishëm, fisnik, i ulët, i panjohur). Motiv politik (ideologjik, revolucionar, historik). I shtyrë nga motive vetjake. Motiv i nuk dihet.

MOTIV II m. 1. muz. Njësia më e vogël e më e thjeshtë ritmike e melodisë, që përbëhet zakonisht nga dy a tre tinguj të bashkuar në një theks; melodi. Motiv i ëmbël (i bukur). Motive të gëzuara. Motive partizane. Motive të njohura. Motive të muzikës së lehtë. Këndonte po atë motiv.

2. art., let. Pjesa më e thjeshtë përbërëse e subjektit të një veprë letrare a artistike, që shërben si bërthamë organizuese e saj; ideja kryesore, tek e cila mbështetet një krijim artistik, tema e tij; fill që përshkon një vepër letrare a krijim artistik nga fillimi deri në fund. Motivi kryesor. Motive plotësuese (të njohura). Motive kombëtare (popullore) në qilima (në qëndisma, në banesa). Motivi i veprës letrare (i poezisë). Motive nga vallet popullore. Është ndërtuar (është hartuar) sipas motiveve të vjetra.

MU I pj. Përdoret para një fjale a një togfjalëshi për të përcaktuar më mirë, për ta theksuar ose për ta bërë më të përpiktë vendin, kohën etj., atë që shprehet nga fjala a nga togfjalëshi; pikërisht; ashtu. Mu në fillim të librit. Mu në krye të dhomës. Mu në fund të enës. Mu në mes të qytetit (të sheshit, të ballit, të kraharorit, të ditës, të natës). Mu në kokë (në zemër). Mu në shenjë. Mu këtu (aty). Mu si (në) dasmë. Mu si luftë. Mu si i çmendur.

MU II onomat. Përdoret për të imituar britmën e lopës a të kaut kur muet. Lopa bën mu.

* Bën mu bised. Është fare e qartë, duket sheshit, bie në sy menjëherë.

MUND I jokal. 1. Kam fuqi, zotësi, aftësi etj. për të bërë një punë a një veprim, jam në gjendje të kryej a të arrij diçka; e kam në dorë ta bëj diçka; jam i zoti a i aftë për diçka; mundem. Po të mundësh, eja (rri)! Sa mund, aq bëj. Ndihej me ç'mundën. Bëri (piu, hëngri) sa mundi. Foli ç'mundi. Kush mundi, mori. Fle (ha) ku të mundë fle (ha) pa pyetur se ku, pa e zgjedhur vendin, ku të ketë mundësi, ku t'i jepet rasti. S'mund më.

2. (zakonisht me pjesëzat mohuese s, nuk dhe mos). Jam pa qejf, s'jam mirë me shëndet, jam sëmurë. Nuk para mund. Sot s'mund. Si je? - Më dhemb koka, nuk mund.

3. kal. Përdoret si folje gjysmëndihmëse me vlerë modale, zakonisht në tra-

jtën e vetës së tretë të numrit njëjës, për ta paraqitur si të mundshme a si të lejueshme atë që shpreh folja ose fjalia e mëpasme; mundem. Mund të hajë (të pijë) vetë. S'mund ta bëj (ta them, ta tregoj). S'mund të duronte (të priste) më. S'mund të lejohet (të pranohet). Mundi të shpëtonte. Mund të niset nesër a pasnesër. Mund të ketë ardhur. Mund të jetë kështu. U largua pa mundur të takohet me të.

* Aq mundi, aq shkundi shih te SHKUND.

MUND II kal. 1. E vë poshtë dikë, e vë nën vete, dal fitimtar mbi të në një ndeshje, në një luftë etj.; mposht. E mundi armikun (kundërshtarin). I mundëm në luftë. I mundën në futboll (në shah). E mundi me pikë. Dy mace mundin një ari. fj.u.

2. kal. Nuk e lë diçka të më thyejë a të më mposhtë, nuk dorëzohem, nuk jepem para diçkaje, por i qëndroj dhe ia nënshtroj vullnetit tim; e përballoj dhe e kapërcej diçka; e mposht, e shtyp; vet. veta III (me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor në r. kallëzore) më dobëson, më ligështon, më mposht a më thyen diçka e rëndë a e keqe (një sëmundje, një fatkeqësi, një ndjenjë e rëndë etj.). E mundi hidhërimin (dëshpërimin, dhembjen). E mundi gjumin. E mundi sëmundjen. I mundën fatkeqësitë (vuajtjet). Më mundi gjumi (lodhja). E mundi sëmundja. Trim është ai që mund veten. fj.u. trim është ai që mposht dobësitë e veta, veset etj. E mundën vështirësitë (vuajtjet, mundimet).

MUNDEM I vetv. 1. Kam fuqi, zotësi, aftësi etj. të bëj diçka, jam në gjendje të kryej, të plotësoj a të arrij diçka; mund. Po të mundem, do të nisem. Me sa mundet, nuk kursehet. Deshi të kthehej, po s'mundi. S'mundemi më.

2. shih MUND I 3. S'mundemi të rrimë pa punuar. S'munden të shkojnë.

3. pavet. Është e mundshme.

4. vet. veta III përd. pj. Ndoshta. - Kështu ka ndodhur? - Mundet.

MUNDEM II vetv. 1. Ndeshem trup me trup me dikë, duke u kapur për mes, për qafe etj. dhe përpiqem ta vë poshtë, bëj mundje me dikë. Mundej me moshatarët.

2. fig. Hahem me dikë e përpiqem t'ia kaloj në një punë. Nuk mundet dot ai me të.

3. Pës. e MUND II.

MURGESHË I f. Fem. e MURG, ~U. Murgeshë e re (plakë). Kuvend (shkollë) murgeshash. E zbehtë si murgeshë.

* Ka zemër murgeshë ka mëshirë e keqardhje kristiane për këdo pa përjashtim, nuk e ndan të mirin nga i ligu.

MURGESHË II f. zool. 1. Flutur e madhe me shirita të zinj e njolla të zeza në krahë dhe në bark, vemja e së cilës njihet si dëmtues i drurëve e sidomos i pishave.

2. Kandërr fluturuese që e ndryshon ngjyrën sipas mjedisit, me trup shumë të gjatë, me kokën trekëndëshe e shumë të lëvizshme, me sy të dalë, me dy palë krahë të hollë, me të cilët, duke i fërkuar bën një zhurmë.

MURGË I f. 1. fet. Murgeshë. U bë murgë.

2. bised. Vajzë a grua që ka mbetur e shkretë, e vetme, pa njeri; vajzë a grua e mjerë, që bën një jetë të rëndë. Murga e shkretë (e mjerë)! Ç'e gjeti, murgën! Hoqi të zitë e ullirit, murga!

* Rrinte si murga në linjë rrinte pa folur asnjë fjalë, rrinte e heshtur dhe e shushatur.

MURGË II f. Llumi i vajit që bie në fund të enës, fundërrri vaji; lëngu i errët që del kur shtypin ullinjtë. I heqin murgën (vajt). Murgën e përdorin për sapun.

MYSHK I m. bot. Grup bimësh me ndërtim më të ndërlikuar se algat, kërpudhat e likenet, pa lule, që kanë gjethe, kërcell dhe rrënjë, riprodhohen me spore dhe rriten në vende me lagështi, mbi trungje drurësh, mbi tjegulla, mbi gurë a mbi

shkëmbinj, buzë përrenjsh etj. Myshku i gjelbër (i butë). Myshqe të njoma. Myshk druri. Myshk uji. Myshk pylli. Myshku i kënetës. Fije myshku. I veshur (i mbuluar) me myshk. Mbrojtja e bimëve nga myshku. Zuri myshk.

MYSHK II m. 1. Lëndë me erë të fortë e të këndshme, që nxirret nga një gjëndër e mashkullit të një lloj dreri dhe që përdoret në parfumeri, në mjekësi etj.; erë e mirë dhe e këndshme që ka diçka. Myshku i rrushit (i kumbullave). Myshk e sheqer! ur. urim që u bëjnë fëmijëve kur teshtijnë.

2. Sapun me erë të mirë, sapun fytyre. U harxhua (u tret) myshku.

3. përd. mb. Që ka erë të mirë. Rrush (kumbulla) myshk. Sapun myshk.

MYSHKËT I mb. Që vjen erë myshk, që ka erë të mirë e të këndshme. Mollë e myshkët. Rrush i myshkët. Të dehte me erën e myshkët.

MYSHKËT II mb. Që ka zënë myshk, që është i veshur a i mbuluar me myshk. Gur (shkëmb, dru) i myshkët.

NA I 1. Trajtë e shkurtër e përemrit vetor NE në rasat dhanore e kallëzore.

Na tha se... Na dha librat. Na jep zemër. Na gëzoi pa masë.

2. Përdoret në rasën dhanore për të shprehur një farë qëndrimi të afërt të folësit ndaj asaj që ndodh, për të përforcuar shprehjen e veprimit ose për ironi. Na ishte ç'na ishte. Na shkon aty një plak. Na u kthye dimri. Pa shiko ç'na qenka!

NA II pasth. bised. 1. Përdoret kur i japim dikujt diçka, me kuptimin «merre», «urdhëro». Na librin. Na merre. Na edhe një.

2. Përdoret për të tërhequr vëmendjen e dikujt ose për ta thirrur. Na, more ti!

Na, moj vajzë, eja këtu!

NA III pj. 1. Përdoret kur duam të vëmë në dukje diçka që nuk e pritnim ose nuk e dëshironim; ja. Na edhe një përrua të

pret udhën. Të dëgjoja ty e, na tashti, se ç'më gjeti.

2. Përdoret për të vënë në dukje një send, një gjendje a një veprim me përmasa që na habitin (në kuptimin «kaq, aq», duke e shoqëruar zakonisht me lëvizje të duarve). E kishin gjoksin na-a! Na ta bësh dhëmbin! I hapi sytë na!

3. Përdoret në shprehjet që shoqërojnë lëvizjen e pëllëmbës kur i japim dikujt munxët. Na, të plaçin sytë!

NDER I kal. shih NDEROJ.

NDER II kal. shih NDEJ.

NDERMË I mb. shih NDERË (i,e) 1. Pjatë e nderme.

NDERMË II mb. bised. shih NDERSH/ËM (i), ~ME (e).

* Gjithë ditën e nderme tërë ditën pa pushim, sa zgjat dita, gjithë ditën e ditës.

NEFRIT I m. mjek. Pezmatimi i veshkave i shoqëruar me dhembje etj. Nefrit i qelbëzuar.

NEFRIT II m. min. Shkëmb i fortë me ngjyrë të gjelbër, që merr një shkëlqim të bukur kur punohet dhe që përdoret për shtylla, për të punuar vazo, statuja të vogla etj. Gurë nefriti. Statujë nefriti. Vazo nefriti.

NEN I m. Nënndarje e një ligji, e një kodi, e një rregulloreje etj., zakonisht e shënuar me një numër përpara. Nen plotësues. Nenet e ligjit (e kodit). Leximi (miratimi) i ligjit nen për nen.

NEN II m. krahin. Nyelli, syri i këmbës, noçka. Neni i këmbës.

* I ra nenit të këmbës e goditi dikë në pikën më të ndjeshme.

NË I parafj. Përdoret me një emër në rasën kallëzore për të treguar:

1. Vendin ku ndodhet dikush a diçka, ku bëhet një veprim. Në qendër (në mes, në anë). Në shtëpi (në shkollë, në rrugë, në fushë). Në qytet (në fshat, në malësi). Në rrjedhën e poshtme të lumit. Në veri të qytetit. Në faqe (në ballë, në kraharor). I plagosur në dorë (në këmbë).

2. Vendin drejt të cilit lëviz dikush a diçka ose vendin ku futet a mbyllet diçka. Shkoj në Durrës. U ngjitën në majë (në mal). E mbylli në arkë (në dollap). E shtiu (e futi, e kyçi) në sirtar.
3. Një send a frymor, me të cilin ndeshemi a takohemi gjatë lëvizjes, kërkimit etj. Ndeshi në një gur (në pengesa, në vështirësi). Rashë në gjurmë.
4. Një send, nëpërmjet të cilit kalon diçka a bëhet një veprim. Shkoj perin në gjilpërë. Shoh në teleskop. E pa në vrimën e çelësit. Foli në telefon. E dëgjoji në radio.
5. Një send, veprimi të të cilit i nënshtrohet diçka. E nxori në diell (në dritë). E la në ajër (në shi, në dëborë).
6. Gjendje në të cilën ndodhet dikush a diçka ose rrethanat, në të cilat kryhet diçka. Në shi (në tufan). Në inat e sipër. Në zjarrin e punës (e luftës). Është në nevojë. Jeton në varfëri. Është në qejf. Është në gjumë (në ethe). Jam në pritje. Është në dyshim. Është (ka rënë) në hall. S'është në vete. Rri në gatishmëri. Ra në ndeshje me dikë.
7. Mënyrën se si bëhet diçka. Eci në këmbë. Rri në gjuhë. Në këtë mënyrë.
8. Gjendjen e re tek e cila kalon diçka. E ktheu në gaz (në ujë, në lëng). U shndërrua në një vend socialist.
9. Punën, veprimtarinë, grupin a organizatën, ku përfshihet ose është dikush a diçka. Punon në ndërmarrje. Ishte në Brigadën e Parë. Është në një komision. Hyri në punë. Shkon në shkollë ndjek mësimet. Hyri në parti (në organizatë) u bë anëtar i partisë (i organizatës).
10. Diçka që merret si bartëse e veprimtarisë mendore e shpirtërore ose shfaqje të ndryshme të kësaj veprimtarie. Në zemër. Në mendje. Në kujtesë. Në shpirt. Në vullnetin (dëshirën) tonë. I zhytur në mendime.
11. Kohën kur kryhet ose brenda së cilës kryhet një punë a një veprim. Në verë (në dimër). Në rini (në pleqëri). Në të gdhirë (në të ngrysur). Në vitin e kaluar. Në orën dy. Në tri javë. Në dy muaj.
12. Qëllimin përse bëhet diçka; për. Në shenjë kujtimi (nderimi, miqësie). Në dobi të dikujt a të diçkaje. Në përgjigje të thirrjes. Në luftë kundër zakoneve prapanike.
13. Sasinë e njësive nga të cilat përbëhet diçka ose në të cilat ndahet diçka. Komedi në dy akte. Histori e letërsisë në tre vëllime. Pesha në tonë. Gjatësia në metra. E ndau në tri pjesë.
14. Sendin a dukurinë që shërben për të përcaktuar dikë a diçka. Në sasi (në cilësi). Në gjatësi (në gjerësi). Në numër. I kursyer në fjalë. I fortë në matematikë. I diplomuar në mjekësi. Kampion në futboll (në shah). Punime në pikturë (në skulpturë).
- Të ardhura në të holla.
15. Marrëdhënie me diçka. Në marrëveshje (në lidhje, në krahasim, në grindje, në kundërshtim) me një tjetër. Në gjak me dikë.
16. Diçka të cilën e mbikëqyrim, e kemi nën kujdes etj.; nën. E ka në kujdestari. Është në mbikëqyrje.
17. Një ngjarje ku merr pjesë dikush a diçka. Në festën tonë. Në gëzime! urim në doli. Në një dasmë (në një fejesë, në një vdekje).
18. Ngjyrën e diçkaje ose ngjyrën me të cilën ajo afrohet. Në ngjyrë trëndafili. E leu në të bardhë. I kuq në të verdhë.
19. Petkun ose sendin me të cilin është veshur ose mbështjellë dikush a diçka. I veshur në të bardha. I mbështjellë në letër. I paketuar në qese. Ishte vetëm në këmishë.
20. Ndër. Në të rinjtë. Në të sëmuret. Në të parët. Në më të mirët.
21. Përdoret me një emër në rasën kallëzore, i cili bën pjesë në një tog që ka kuptim foljor. Vë në dijeni njoftoj. Vë në dyshim dyshoj për diçka. Vë në lidhje lidh. Vë në zbatim zbattoj. Vë në lojë

tallem me dikë. Lë në harresë harroj. Vë në plan planifikoj. Rri në pritje pres.

22. Përdoret në një varg togjesh me kup-tim ndajfoljor. Në përgjithësi përgjithësisht. Në veçanti veçanërisht. Në krye. Në fund. Në kohë. Në kulm.

23. Përdoret në një varg shprehjesh, që luajnë rolin e parafjalëve. Në kundërshtim me... Në bashkëpunim me... Në krahasim me... Në lidhje me... Në drejtim të... Në sajë të... Në emër të... Në bazë të... Në mes të... Deri në... Që në...

24. Përdoret për të shënuar pikën e mbarimit (në bashkëlidhje me parafjalën «nga») në togje që kanë një gjymtyrë të përsëritur a përemrat «njëri... tjetri» dhe që tregojnë një shtrirje a një lëvizje të pandërprerë në hapësirë dhe në kohë ose një përsëritje të veprimit a të gjendjes. Nga mali në mal. Nga fshati në fshat. Nga dita në ditë. Nga çasti në çast. Nga koha në kohë. Nga njëri breg në tjetrin. Nga njëri vit në tjetrin. Nga njëra ditë në tjetrën.

NË II lidh. 1. Përdoret në fillim të një fjalie të varur kushtore; nëse. Në e di, ma thuaj! Në ardhsha vonë, mos më prit. Në u ktheftë, do ta takoj. Në s'gabohem, ky lloj fiku piqet në gusht.

2. Përdoret në krye të një fjalie pyetëse të zhdrejtë. Nuk e di në vjen apo jo.

3. Përdoret në disa shprehje lidhëzore. Në qoftë se. Në rast se. Në është se. Në mënyrë që.

NGAS I kal. 1. Prek diçka me dorë, me këmbë a me një send. Ngas me dorë (me këmbë). Mos i nga librat (fletët).

2. fig. Shqetësoj dikë me fjalë a me vepra; nuk e lë të qetë, trazoj, ngacmoj, cyt. E ngau rëndë. E ngau me fjalë. Nuk të nget njeri. Të sulmon, po e ngave.

3. bised. Zë diçka për ta ngrënë, për ta pirë ose për t'u marrë me të, prek, nis (zakonisht me mohim). Nuk e ngau gjellën fare nuk hëngri fare. Nuk i ngau mësimet nuk mësoi fare. Nuk e nget duhanin nuk e pi duhanin. E nget gotën pi raki.

4. vet. veta III bised. Më shqetëson një sëmundje ose shfaqja e saj herë pas here, nuk më lë të qetë duke më shkak-tuar dhembje, të dridhura etj. E ngasin ethet. Më nget reumatizmi. E nget kolla (lemza). E nget ajo e tokës.

5. Shtyj një kafshë që të ecë në një drej-tim të caktuar ose të punojë në arë. Ngau kalin (gjokun, doriun). E ngiste kalin me të katra. Nget qetë. Nget karvanin i drej-ton rrugën një karvani me kafshë barre.

6. krahin. Punoj tokën, me kafshë ose me mjete të mekanizuara, lëroj. Ngasin tokën me qe (me parmendë, me traktor). E ngau tokën tri herë.

7. E nis dhe e drejtoj gjatë ecjes një mjet transporti. Ngas veturën (kamionin, traktorin, qerren). Ngas biçikletën. Di (mësoi) të ngasë makinën. Ngas me sh-pejtësi.

8. bised. Merrem me një punë a me një çështje për ta shqyrtuar, për ta parë më tej; prek. Nuk po e ngasim më tej këtë punë (këtë bisedë, këtë muhabet).

9. bised. Merrem me një punë, me një mjeshtëri etj.; ndjek diçka. Nget bujqësinë (blegtorinë). Ngasin shkollën rreg-ullisht. Nuk ngasin zakonet e vjetra.

10. Vë në lëvizje me shpejtësi. Ngas duart (këmbët).

11. krahin. Mpreh. Ngas thikën (së-patën).

* E lau dhe e ngau shih te LAJ. Lëre mos e nga! shih te LË. Ngas fjalën

a) marr fjalën përsëri, vazhdoj të flas;

b) kapem pas fjalës, kërkoj grindje. Që ta ngas fjalën meqë ra fjala; që ta kam fjalën. E nget reja (këtë verë, këtë be-har) shih te RE, ~JA 1. E ngau shkuma shih te SHKUMË, ~A.

NGAS II jokal. Eci me vrap, ngarend. Ngau shpejt (me hapa të shpejtë). Ngau me vrap. Ngiste pas fëmijës. Ngava në shtëpi. Ngau përpara përparoi, bëri për-parime. Nget me të katra vrapon shumë shpejt.

NGASJE I f. 1. Diçka që të ngjall një dëshirë, që të shtyn për të bërë një veprim, të cilit përpiqemi t'i shmangemi; tundim. Ngasje e fortë. E futi (e vuri, e shtiu) në ngasje.

Iu shmang (i shpëtoi) ngasjes.

2. fet. Shtytje për të rënë në mëkat, tundim për të bërë një punë në kundërshtim me moralin fetar (sipas paragjykimeve fetare).

NGASJE II f. bot. Prall. Dru ngasjeje. Lëndët e ngasjes.

NGRIHEM I vetv. 1. Çohem në këmbë, merr qëndrimin drejt (për dikë që ishte ulur a kishte rënë përdhe) çohem; kund. ulem. Ngrihem në këmbë. U ngrit nga vendi (nga karrigia).

U ngrit nga toka (nga dyshemeja). U ngrit në mbledhje mori fjalën në një mbledhje, duke u çuar nga vendi. Ngrihem nga tryeza largohem nga tryeza, pranë së cilës isha ulur. Ngrihet arithi (has, sus). Mezi ngrihet.

2. Largohem nga shtrati ose nga vendi ku isha shtrirë për të fjetur, zgjohem; lë shtratin pas një sëmundjeje; çohem; kund. bie. Ngrihem herët (shpejt, vonë). Ngrihem që me natë. U ngrit i sëmuri nga shtrati (nga dysheku) nuk dergjet më i sëmurë, u shërua. Ngrihet me gjelat ngrihet shumë herët në mëngjes.

3. Nis të eci, mëkëmbem (për foshnjat). U ngrit fëmija me këmbë. Është ngritur shumë vonë.

4. bised. Largohem nga një vend, ku banoja ose ku isha vendosur përkohësisht.

U ngritën nga Tirana. U ngrit me gjithë familje. U ngritën të gjithë të huajt.

5. vet. veta III. Shton lartësinë; shkëputet nga toka ose nga një sipërfaqe tjetër dhe ngjitet lart; kund. ulet, zbrit. Ngrihen retë. Ngrihen zogjtë. Ngrihet aeroplani (helikopteri, raketa). Ngrihet nga aerodromi (nga pista).

6. vet. veta III. Shkëputet ngadalë nga një sipërfaqe dhe përhapet në ajër. Ngrihet pluhuri (avulli) nga toka. Ngrihet tymi shtëllunga-shtëllunga.

7. vet. veta III. Shkon më lart nga rrafshi i sipërfaqes, bëhet më i lartë ose më i bymyer; çohet, fryhet. U ngrit toka (vendi). I ngrihej gjoksi. Ngrihet brumi.

8. vet. veta III. Zë një vend duke dalë më lart se sendet e tjera përreth, duket mbi sendet e tjera. Atje tej ngrihet një mal (një kodër, një shkëmb). Anës rrugës ngrihej një përmendore (një lapidar). Ngrihen oxhakët e fabrikave.

9. vet. veta III. Duket në horizont, si pasojë e rrotullimit të Tokës, çohet, lind, del. U ngrit dielli tre peshë.

10. Drejtoj trupin, pasi kam qenë shtrirë a i përkulur; drejtohet lart diçka që rrinte varur ose ishte përkulur, merr drejtimin pingul. U ngrit drejt. U rritën degët. U ngrit përsëri gruri pas shiut. Më ngrihen flokët (qimet e kokës) përpjetë.

11. Ngre krye, bëj kryengritje, çohem në luftë; nuk pranoj t'i nënshtrohem më.

U ngritëm kundër pushtuesit. U ngrit i gjithë populli. U ngritën masat e gjera si një njeri (si një trup) i vetëm. Një bie, mijëra ngrihen.

12. vet. veta III. I shtohet madhësia, vlera, masa shkalla, bëhet më i madh, rritet. Ngrihet temperatura (shtypja, trysnia). Ngrihet niveli. Ngrihet mirëqenia. Ngrihet në mënyrë të ndjeshme.

13. vet. veta III. I shtohet vrulli ose shkalla e shfaqjes a e zhvillimit, i zmadhohet forca, bëhet më i fuqishëm. Ngrihet vigjilenca (fryma revolucionare). Ngrihet gjendja shpirtërore. In ngritën nervat u zemërua, u nevrkos.

14. vet. veta III. I shtohet forca e ndriçimit ose e zërit. Ngrihet drita. Iu ngrit zëri.

15. Marr një punë a një vend më të lartë se më parë, ngjitem. U ngrit ne detyrë (në përgjegjësi). U ngrit lart.

16. vet. veta III. Më rritet vlera ose rëndësia përpara të tjerëve. I është ngritur autoriteti (prestigji).

17. Fitoj përsëri vendin a gjendjen e mëparshme; përmirësoj gjendjen ekonomike; kund. bie. U ngritën pasi hynë në kooperativë.

18. vet. veta III. Krijohet, themelohet. U ngrit një çetë (një rreth, një organizatë).

U ngrit kooperativa.

19. vet. veta III. Fillon, nis me forcë. U ngrit një erë e madhe.

20. E ndërpres a i jap fund një pune, të cilën e kryeja ndenjurr. U ngritën nga tryeza (nga buka, nga sofa). U ngrit nga puna.

21. Para një foljeje tjetër tregon fillimin e një veprimi a një përpjekje më të madhe për të kryer diçka. U ngrit e vajti (e shkoi). Ngrihet e punon. Ngrihen dhe e mbrojnë shokët.

22. Pës. e NGRE. U ngrit flamuri. U ngritën doli.

* U ngrit (doli) nga balta shih te BALT/Ë, ~A. Ngrehu e bjer (bjer e çohu) shih te BIE I. Iu ngrit (i hipi, i kërceu, e zuri) damari shih te DAMAR, ~I. Iu ngrit (i hipi, kërceu) dielli i ballit shih te DELL, ~I. Iu ngrit mendja shih te MENDJ/E, ~A, Ngrihet (çohet) peshë shih te PESHË. Ngrihet me vesë (për vesë) shih te VES/Ë, ~A. Iu ngritën (iu çuan) flokët (qimet, leshrat e kokës) përpjetë shih te FLOK, ~U. I ngrihet (i çohet) pluhuri nga prapa dikujt shih te PLUHUR, ~I. Iu ngritën (i erdhën, i mblodhën) zorrët te goja (në grykë, në fyt) shih te ZORR/Ë, ~A. Ngrihu prift të ulet (të rrijë) hoxha! shih te PRIFT, ~I. Ngrihen (çohen) këmbët e bien kokës shih te KËMB/Ë, ~A. Kush fle me qenin (me qentë) ngrihet me pleshta fj.u. shih te QEN, ~I.

NGRIHEM II vetv. shih NGRIJ 1,3,4. M'u ngri qafa (krahu). U ngri në vend. U ngri uji.

NGJESH I kal. 1. Shtyp diçka dhe e bëj më të rrasët duke i pakësuar vëllimin; dendësoj, ndrydh. Ngjesh barin (sanën). Ngjesh leshin. Ngjesh një lëng (një gaz, ajrin). Shiu e ka ngjeshur tokën.

2. Shtie diçka në një vend duke e rrasur me forcë që të zërë pak vend a të rrijë shtrënguar; e afroj shumë pas diçkaje, rras, shtrëngoj. Ngjesh duhanin në llullë (në çibuk). Ngjesh rrobat në valixhe. E ngjeshi pas murit. Ngjesh kokën në jastëk. Ngjesh radhët. Ngjesh kapelën (festen) në kokë.

3. Përziej mirë me duar a me ndonjë mjet një lëndë derisa të bëhet si brumë i trashë, mbruj, gatuj; rrasallit, shtyp. Ngjesh brumin e bukës. Ngjeshi një kulaç. Ngjesh baltën (deltinën). Ngjesh llaçin (betonin).

4. Mbush plot me diçka. E ngjeshi mirë xhepin. E ngjeshi thesin. E ngjeshi barkun hëngri mirë, u ngop. E ngjeshi me majë.

5. fig. Mbush mirë me diçka, pa lënë zbrazëtira a mungesa, e pasuroj që të jetë plot me diçka; e bëj më të ngjeshur, i heq gjërat e tepërta. E ngjeshi tekstin. E ka ngjeshur me shembuj. I ka ngjeshur mirë ngjarjet në roman (në film).

6. Hedh me forcë që të ngjitë diku. Ia ngjeshi baltën (gëlqeren) murit.

7. bised. E rrah rëndë; e godas me diçka, i jap, i rras. E ngjeshi paq. Ia ngjeshi fytyrës (syve, turinjve). I ngjeshi një grusht (një pëllëmbë).

8. bised. Ia hedh fajin dikujt a e rëndo me diçka që nuk i takon; e ngarkoj me një punë që nuk i bie ta bëjë. Ia ngjeshi atij përgjegjësinë (fajin). Ua ngjesh të tjerëve. Ma ngjeshën mua. Ia ngjeshën të gjitha punët. Ia ngjeshi si me shaka.

* Ngjeshin (shtrëngojnë) radhët shih te SHTRËNGOJ. Qesh e ngjesh shih te QESH.

NGJESH II kal. 1. Vë e shtrëngoj mirë pas trupit; vë rreth mesit armë, marr një armë me vete; kund. zgjesh. Ngjesh brezin (rripin). Ngjesh shpatën (pallën,

kordhën). Ngjesh revolen (koburen). Ngjesh armët (e brezit). Ngjesh rripin (gjer-danin) e fishekëve.

2. I vë rrathë, e shtrëngoq me rrathë. E ngjeshi fuçinë.

NGJËROJ I kal. 1. Provoj një gjellë për kripë a për shije; marr fare pak, në majë të lugës, nga një gjellë. Ngjëroj gjellën. E ngjëroj për kripë. E mburr pa e ngjëruar fare. Nuk ngjëroi asnjë pikë nga ajo verë.

2. fig. Provoj a shijoj diçka. Ngjërojnë të mirat e arsimit (e diturisë, e përparimit).

NGJËROJ II jokal. 1. Eci me kujdes që të mos bëhem me baltë e të mos ndotem, kaloj aty ku nuk ka llucë; i bie rrotull. Ngjëroj anës rrugës. Ngjëron me kujdes.

2. fig. Kaloj kohën me diçka, zbavitem.

NGJISHEM I vetv. 1. vet. veta III. Bëhet më i rrasët dhe e pakëson vëllimin, bëhet më i dendur, rrasallitet. Ngjishet toka. Është ngjeshur tepër.

2. Afrohem shumë pas dikujt a pas diçkaje, shtrëngohem. Ngjishem pas murit. Ngjishej pas s'ëmës. Ngjishen njëri pas tjetrit.

3. bised. Ha sa ngopem mirë; marr me shumicë diçka, dendem. U ngjeshën së ngrëni. Hëngri sa u ngjesh. U ngjesh paq.

4. Pës. e NGJESH I. Ngjishet me dorë.

NGJISHEM II vetv. Vë armët në brez; kund. zgjishem. U veshën e u ngjeshën.

NGJIT I kal. 1. Bashkoj një gjë tek një tjetër me një lëndë veshulllore si zamkë, tutkall etj.; vë; kund. shqit, heq, çngjit. Ngjit pullën në zarf. Ngjit parullën (afishen, shpalljen) në mur. Ngjit me tutkall (me zamkë).

2. Bashkoj pjesët e diçkaje që ishte këputur e thyer; bashkoj një gjë me një tjetër duke e qepur a duke e mbërthyer. Ngjit kockën e thyer. Ngjit dorezën e çadrës.

I ngjiti mëngët këmishës.

3. Bashkoj dy pjesë prej metali duke i shkrirë me zjarr në dy skajet; i zë vrimat një ene prej metali duke e pikur. Ngjit hekurin (shufrën e këputur). Ngjit kovën (kazanin). Ngjit me kallaj (me plumb).

4. Ia kaloj një tjetri sëmundjen nga e cila vuaj vetë; fig. e bëj ta zërë një ndjenjë, që e kisha vetë. I ngjiti sëmundjen (gripin). Ua ngjit gëzimin (guximin, optimizmin) edhe të tjerëve.

5. I vë emrin; i vë një emër të dytë a një nofkë, quaj. Ia ngjitën emrin Agim.

I ngjitën një nofkë.

6. fig. I vë fajin pa të drejtë për diçka; ia vë në kurriz dikujt diçka që nuk i takon; ia vesh. Ia ngjiti fajin atij. Ia ngjiti tjetërkujt vrasjen (vjedhjen). Ia ngjitën të gjitha atij. I ngjiti një bisht.

7. Bashkoj fort pas diçkaje; afroj shumë sa të takohen. E ngjiti pas dheut (pas xhamit). I ngjitën tryezat. I ngjiti dhëmbin e kafshoi.

8. bised. Godas me diçka, qëlloj fort. Ia ngjiti me shuplakë (me pëllëmbë). Ia ngjiti në lule të ballit.

9. vet. veta III jokal. Ka aftësinë të bashkojë dy gjëra që të mos ndahen (për disa lëndë veshulllore etj.). Kjo zamkë nuk ngjit. Ngjit mirë.

10. vet. veta III jokal. Zë vend mirë dhe nuk shqitet lehtë, ngjitet. Ngjit bora.

Më ngjiti këmba në baltë. Më ngjiti në dorë.

11. vet. veta III jokal. Më zë vend një ushqim, më shijon e më shkon mirë. Nuk më ngjiti buka (dreka).

* I ngjit dorën (krahun) dikujt ndihmoj dikë që është në vështirësi. I ngjiste (i vinte) brirë (brirët e kaut) dikujt keq. shih te BRI,~RI. I ngjit fjala i shkon fjala, i zë vend ajo që thotë, e dëgjojnë. E ngjiti me barrë e la shtatzënë. Ia ngjiti sytë e shikoi me vëmendje të madhe. Më ngjit në zemër dikush shih te ZEM/ËR,~RA. Është për ta ngjitur pas murit shih te MUR,~I.

NGJIT II kal. 1. Shpie diçka nga një vend më i ulët në një vend më të lartë, ngre; kund. zbres, ul.

I ngjiti tullat në katin e tretë. E ngjiti shumë lart aeroplanin (helikopterin).

2. Kaloj nëpër një vend nga poshtë lart, ngjitem. Ngjitën të përpjetën. I ngjiti shkallët me vrap.

3. fig. Ngre, çoj lart. E ngjiti lart. E ngjiti në krye të klasifikimit.

* I ngjit shkallët një nga një dikush i merr punët shtruar; është i matur e i kujdesshëm në të folur e në të vepruar; nuk ngutet.

NGJITEM I vetv. 1. vet. veta III. Bashkohet te diçka tjetër me zamkë, me tutkall etj., kapet te diçka tjetër dhe nuk hiqet (për diçka të lyer me zamkë, për diçka të lagët etj.); kund. shqitet. U ngjit pulla. M'u ngjit në dorë. M'u ngjit këmisha pas trupit.

2. vet. veta III. Bashkohen përsëri pjesët e thyera të diçkaje; kund. thyhet.

Kocka e thyer fëmijëve u ngjitet shpejt.

3. vet. veta III. Ka aftësinë të bashkohet me diçka tjetër duke u nxehur.

Nuk ngjitet bakri me aluminin. Nuk ngjitet me kallaj.

4. I afrohem shumë dikujt a diçkaje sa puthitem me të; i ngjishem. U ngjitën pas tokës. Iu ngjit në gjoks.

5. fig. I vete prapa dikujt a diçkaje dhe nuk i shqitem, i qepem pas, i bëhem ferrë; i vardisem nga pas. Më ngjitet prapa. U ngjiten prapa karrocave (makina). I ngjitet të atit (s'ëmës) fëmija. I ngjitet si rodhe (si hije, si baltë).

6. bised. Jepem shumë pas diçkaje. U ngjitet mësimëve.

7. vet. veta III. Më zë sëmundja nga një tjetër. Iu ngjit rrufa (gripi, tifoja).

8. vjet. Pajtohem për të punuar me pagesë a për të mësuar mjeshtërinë te dikush. Ngjiteshin hyzmeqarë (shegertë).

* U ngjit me barrë mbeti shtatzënë. U ngjitet fjala shih te FJAL/Ë,~A 6. Ngjitet edhe pa shkallë dikush shih te SHKALL/Ë,~A. Iu ngjit si ushunjëz dikujt shih tek USHUNJËZ,~A. Iu ngjit si bajga (si balta) pas këpucës thjeshtligj. shih te BAJG/Ë,~A. Në çati ngjiten me shkallë fj.u. shih te SHKALL/Ë,~A. Iu ngjit barku pas shpine (me kurrizin) shih te BARK,~U. Nuk i ngjitej (nuk e kapte) ferra gjëkund shih te FERR/Ë,~A. Iu ngjit gjuha pas qiellze shih te GJUH/Ë, ~A I. Iu ngjit këmisha pas trupit (në trup) shih te KËMISH/Ë,~A. Ngjitet si pallaska pas brezit shih te PALLASK/Ë,~A. S'i ngjitet qimja në trup shih te QIM/E,~JA. U ngjitën shumë për shpinë shih te SHPIN/Ë,~A. Buka që thyhet, s'ngjitet me fj. u. shih te BUK/Ë,~A. Po u thye kulaçi, s'ngjitet më fj.u. shih te KULAÇ,~I.

NGJITEM II vetv. 1. Kaloj nga një vend më i ulët në një vend më të lartë, hipi; kund. zbres, ulem. Ngjitem në çati (në pemë). U ngjit në tribunë (në skenë). I ngjitet malit (kodrës). Ngjitem në majë. Ngjitet përpjetë. Ngjitet ngadalë (me mundim). Ngjitet me litar.

2. vet. veta III. Lëviz në drejtimin nga poshtë lart; ngrihet lart. Ngjitet dielli (hëna). Ngjitet aeroplani. Ngjitet tymi (flaka). Ngjiten retë. Iu ngjit një lëmsh në grykë.

3. vet. veta III. Bëhet gjithnjë e më i lartë, shkon përpjetë, merr drejtimin nga poshtë lart. Rruga (xhadeja) ngjitet më të dhathtë. Vjen duke u ngjitur.

4. vet. veta III. Ngrihet. U ngjit temperatura.

5. fig. Arrij në një shkallë më të lartë zhvillimi; marr vrull e fuqi të reja, ngrihem.

U ngjiten lart. Ngjitet revolucioni proletar. Ngjitet vendi ynë vazhdimisht. Ngjitemi në një shkallë të re (më të lartë) zhvillimi.

NGJITËS I m. 1. Lëndë veshtullore ose përzjerje e disa lëndëve, me të cilën lyhen

sipërfaqet e dy fletëve a të dy pjesëve për t'i ngjitur; zamkë. Ngjitës i lëngshëm (i trashë). Lyej me ngjitës. Tutkalli është ngjitës i mirë.

2. bot. Bimë barishtore që rritet ndër ara e nëpër gjerdhe, me kërcell të hollë e të gjatë si të kulprës, me gjethe të çara e me gjemba, që të ngjiten pas trupit, dhe me lule të bardha në të gjelbër, që lëshojnë disa fara të murrme.

3. bot. Urth.

NGJITËS II m. Ai që ngjitet diku; sport. ai që u ngjitet majave të larta, alpinist. Ngjitësit arritën majën e malit.

NGJITËS I mb. 1. Që shërben për të ngjitur dy gjëra; që është i lyer me një lëndë e cila ngjit. Lëndë ngjitëse. Gomë ngjitëse. Letër ngjitëse (për miza) rrip letre i lyer me një lëndë veshtullore për të kapur mizat.

2. Që ngjitet pas sendeve të tjera dhe nuk shqitet lehtë. Baltë ngjitëse. Truall i butë dhe ngjitës.

3. mjek. Që ka aftësinë të kalojë nga një i sëmurë te një i shëndoshë, që përhapet nga një i sëmurë tek të shëndoshët (për sëmundjet). Sëmundje ngjitëse. Spitali (pavijoni) i sëmundjeve ngjitëse. Nuk është ngjitëse.

4. fig. Që përhapet lehtë tek të tjerët, që i zë edhe të tjerët.

NGJITËS II mb. 1. Që merr drejtimin nga poshtë lart; që shkon duke u ngritur; që lëviz nga poshtë lart; kund. zbritës. Vijë ngjitëse. Rryma ngjitëse të ajrit. Shkallëzim ngjitës. Diftong ngjitës. gjuh. diftong tek i cili theksi bie mbi elementin e dytë. Shkallë ngjitëse. muz. shkallë muzikore në të cilën çdo tingull a zë është më i lartë se ai që gjendet para tij.

2. bot. Kacavarës. Fasule ngjitëse.

NGJITJE I f. 1. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve 1-5 të foljes NGJIT I dhe 1,2 të NGJITEM I. Ngjitje e fortë (e dobët). Ngjitje me tutkall (me zamkë). Ngjitja e kockës. Ngjitja e sëmundjes.

2. Vendi a pika ku bashkohen e puqen dy gjëra. Ngjitjet ndërmjet indeve.

NGJITJE II f. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve NGJIT II, NGJITEM II. Ngjitje alpinistike. Ngjitja në majë.

2. fig. Zhvillim drejt një shkallë më të lartë, ngritje; kund. rënie, zbritje. Periudhë ngjitjeje të vrullshme (revolucionare). Është në ngjitje.

3. Pjesë rruge ose shpat që shkon përpjetë, e përpjetë; kund. zbritje.

NOTË I f. 1. muz. Shenjë që përfaqëson një tingull muzikor sipas shkallës dhe gjatësisë; vetë tingulli kur këndohet ose luhet në një vegël; let. muz. tekst i një vepre muzikore, i shkruar me këtë shenja; fletë ose fletore me tekste të pjesëve muzikore. Nota «re». Notë e plotë. Notë katërshe (tetëshe). Nota nën pentagram (mbi pentagram). Mësoj notat. Marr një notë këndoj me zë një tingull ose i bie në vegël. Këndoj (i bie) me nota. E hedh në nota. I vë përpara notat.

2. fig. Ngjyrimi që merr diçka e shprehur ose e shkruar sipas ndjenjave dhe qëndrimit të njeriut; tipar dallues që merr në shprehjen e jashtme një dukuri; veçori e shprehjes në një vepër artistike. Nota optimiste (të gëzuara). Nota të zymta (pesimiste). Nota lirike (dramatike). Nota antifeydal (antiklerikale). Nota shqetësimi (ironie). Sjell nota të reja (një notë të re).

NOTË II f. Vlerësimi i shkallës së njohurive ose i sjelljes së nxënësve, i shprehur me një numër. Natë e mirë (e keqe, e dobët). Notë kaluese (pakaluese). Notë negative notë pakaluese. Nota mesatare. Nota e sjelljes (e përparimit). Nota vjetore. Librezja e notave.

Ul (zbres, ngre) notën. I thyen notën e sjelljes. Vlerësoj me notë. Dal me nota të mira. Nuk mësojmë për notë.

NOTË III f. dipl. Letër zyrtare, që i dërgon një shtet një shteti tjetër me anë të një përfaqësuesi. Notë diplomatike. Notë

proteste. Shkëmbim notash. I drejtoi (i dërgoi) një notë.

NUSKË I f. 1. vjet. Një copë letër e mbledhur zakonisht si trekëndësh, e mbushur me fjalë t'ëkota, të shkruara nga një fetar, të cilën e mbanin në trup njerëzit me paragjykim ose ua varnin fëmijëve, duke kujtuar se kishte fuqi për t'i mbrojtur nga një sëmundje ose nga të këqijat; hajmali. Nuskat e hoxhallarëve. Nuk u besojnë nuskave. I dogjën nuskat e pështira.

2. bised. Thelë ëmbëlsire në trajtë trekëndëshi ose rombi. Nuskat e bakllavasë.

NUSKË II f. 1. Kukull fëmijësh. Luan me nuska.

2. Grumbull me duaj misri të korrur dhe të mbështetur njëri pas tjetrit, kapule misri. E bënë misrin nuska.

NXË I kal. 1. Është në gjendje të mbajë, të përfshijë brenda vetes; merr, mban. Enë që nxë dhjetë kilogramë ujë. Sallë që nxë mbi katërqind veta. Këtë dollap nuk e nxë korridori (dhoma). Arka (valixhja) nuk i nxinte rrobat.

2. E lejon të kalojë diçka përmes tij a të futet diçka në të. Nuk e nxë vrima (dera). Nuk e nxënë këpucët. Është bërë sa nuk e nxë dera është trashur shumë.

* Si ta nxë goja! shih te GOJ/Ë,~A. S'ma nxë mendja (koka) nuk e marr dot me mend, nuk arrij ta kuptoj. S'më nxë vendi shih te VEND,~I. Një mill s'i nxë dy jataganë fj.u. shih te JATAGAN,~I.

NXË II kal. Fitoj njohuri të reja, mësoj. Nxë shkrim e këndim. Nxë një mjeshtëri. Nxë përmendsh. Nxë në shkollë.

* Nxuri (vuri) mend mësoi nga përvoja të mos e përsëritë një punë a një veprim, pësimi iu bë mësim.

O I

1. Një nga zanoret e gjuhës shqipe dhe shkronja e njëzetnjëte e alfabetit të saj, e cila shënon këtë zanore. Zanorja o. Shkronja o. Tingulli o.

2. si em. f. Zanorja dhe shkronja o. O-ja e madhe (e vogël). O-ja e shtypit (e dorës.)

O II lidh.

1. Përdoret zakonisht e përsëritur për të lidhur dy gjymtyrë të një fjalie a dy fjali që veçohen njëra nga tjetra, që kundërvihen nga kuptimi ose që plotësojnë njëra-tjetrën; ose, a. O djalë, o vajzë qoftë. O unë, o ti. Sot o nesër.

2. Përdoret e përsëritur për të lidhur dy gjymtyrë të një fjalie a dy fjalë që përfshijnë njëra-tjetrën; ose. O sot o kurrë. O flasin mirë për ty, o për asnjë tjetër. O do marrësh atë, o s'ka.

O III pj.

Përdoret për të përforcuar thirrjen kur i drejtohem dikujt (me emra në funksion thirrori). O shok! O nëna ime! Jo, o djem, nuk bëhet kështu! Eja, o bir! Kush je ti, o? Puna mbarë, o djalë! O malet e Shqipërisë!...

O IV pasth.

1. Përdoret kur shprehim dhimbje ose keqardhje për dikë a për diçka; oh. O, ç'më vrave në këmbë! O, unë i mjeri (i ziu, i gjori)! O, ku ta dija unë i shkreti!

2. Përdoret kur shprehim habi para një të papriture ose për diçka jo të zakonshme. O, po ç'është kështu me ty?! O, gjallë qenka a? !

3. Përdoret kur shprehim gëzim, kënaqësi a admirim për diçka; oh. O, sa mirë që erdhët! O, sa shpejt e paskeni kryer! O, sa e bukur qenka!

OBJEKTIV I m. Pjesë e një aparati optik, që përbëhet nga një ose nga disa thjerrëza dhe që vihet përballë një sendi, një njeriu etj. për ta parë a për ta fotografuar. Objekti i aparatit fotografik. Objekti i dylbisë (i mikroskopit). Objektiv me reze të largët. Thjerrëza e objektivit.

OBJEKTIV II m. 1. Sendi a pika ku drejtohet syri i njeriut a një aparat optik për ta parë ose për ta fotografuar. Hodhi sytë nga objekti. Drejtoi aparatën tek objektivi.

2. usht. Vendi a pika ku drejtohen veprimet luftarake për të goditur kundërshtarin. Objektiv tokësor (detar, ajror). Objektiv i lëvizshëm (i palëvizshëm). Objektiv i sulmit (i bombardimit). E goditën objektivin me predhën e parë.

3. fig. Synimi që kemi ndaj dikujt a diçkaje; qëllimi që duam të arrijmë. Objektiv i kryesor. Objektiva të qarta. Objektivat e revolucionit. Ka si objektiv. E arritën objektivin.

OJNË I f. 1. Sjellja a shtirja e dikujt sikur nuk e do ose nuk i pëlqen diçka me qëllim që t'i luten të tjerët; shprehje mospëlqimi për një gjë a për një punë, naze. Njeri me ojna dhe me teka. Bën ojna. U bën ojna gjellëve. Nuk i bën ojna punës.

2. Lëvizje, sjellje ose e folur me naze për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve ose për t'u pëlqyer atyre; shaka, lojë. Njeri me ojna. Ka ojna shumë. Flet me ojna. E bëri për vete me ojna. Ia di ojnata dikujt. Mos bëj ojna me mua!

3. Lëvizje a e folur e këndshme e fëmijëve të njomë, lojë. Ojnat e foshnjës (e fëmijëve). Ojna dasme. I luajti (i bëri) një ojnë dikujt.

OJNË II f. 1. Ojë. Shami (këmishë) me ojna.

2. fig. Zbukurim që i bëjmë diçkaje. I bëri ojna diçkaje. Flet me ojna për punën (për ndodhinë). Po ju flas pa ojna.

ORË I f. 1. Njësi kohe që është e barabartë me një të njëzetekatërtën pjesë të ditës e të natës dhe që ka gjashtëdhjetë minuta. Një gjysmë (një çerek) ore. Dita ka dymbëdhjetë orë. Punoj tetë orë. E bëri rrugën për gjashtë orë. Fluturon me shpejtësi tetëqind kilometra në orë. U mbush një orë. Erdhi pas dy orësh. U vonua një orë e gjysmë. Kaluan tri orë.

Paguhet me orë.

2. Kohë prej dyzetepesë ose gjashtëdhjetë minutash, gjatë së cilës bëjmë diçka, pushojmë etj.; kohë e tillë që përdoret për një mësim dhe që shërben si njësi për të caktuar ngarkesën mësimore të mësimdhënësit. Orë mësimore (ora e

mësimi). Orë akademike kohë prej rreth pesëdhjetë minutash. Ora e gjuhës (e leximit, e historisë, e fizikës). Ora e punës politike (e vizatimit, e punës me dru, e stërvitjes ushtarake, e praktikës mësimore). Orë pushimi (çlodhjeje). Filloi ora e dytë. Mbaroi ora. Kemi një orë bosh. bised. Ka shumë orë (një mësues). Jep gjashtë orë në javë.

3. astr. Njësi kohe, që përcaktohet për të llogaritur lëvizjen sipas rrotullimit të Tokës ose të një trupi tjetër qiellor. Orë diellore. Orë hënore. Orë astronomike kohë e përpiktë, që përcaktohet me vrojtme të veçanta, duke marrë si bazë meridianin e Grinuitit. Ora zyrtare (ligjore) ora që miratohet me ligj në një vend. Ora lokale ora që përcaktohet duke matur kohën e një vendi. Ora galaktike kohë e barabartë me 9,1 vjet të Tokës.

4. Kohë e caktuar me numër sipas ndarjes së ditës a të natës në dymbëdhjetë pjesë ose të ditës e të natës së bashku në njëzet e katër pjesë; kohë e caktuar si cak. Sa është ora? Erdhi në orën tetë. Në orën shtatë të mëngjesit. Në orën dymbëdhjetë të natës (në orën njëzet e katër). Në orën katër pasdite (në orën gjashtëmbëdhjetë).

Në ç'orë do të shihemi? Në ç'orë fillon puna? U ngrit me dy orë natë.

5. Kohë e papërcaktuar me përpikëri, zakonisht e shkurtër, gjatë së cilës ngjitet diçka, kryhet një veprim etj., çast, kohë. Ore për (me) orë nga një çast në tjetrin; shumë shpejt, fare së shpejti. Në orët e para të ditës (në orët e mëngjesit). Orë pas ore kohë pas kohe, herë pas here. Erdhi në orët e vona. Kaluan disa orë të këndshme. Iu gjend në orët më të vështira. Kishte ardhur ora e shpagimit. S'i ka ardhur ora kësaj pune. Erdhi ora e madhe. Rrinte me orë të tëra rrinte një kohë mjaft të gjatë. Në atë orë erdhi edhe ai në atë çast erdhi edhe ai. I erdhi ora e fundit (ora e vdekjes) i erdhi çasti i fundit, është para vdekjes. E prisnin nga një orë në tjetrën. Ç'sjell (ç'bie) ora, s'e

sjell (s'e bie) moti (viti). fj. u. Ç'sjell minuta s'e sjell ora (s'e sjell moti). fj. u.

6. bised. Kohë e caktuar posaçërisht për diçka; orari. Ora e pritjes. Ora e nisjes (e arritjes). Ora e pagesave.

7. Vegël e posaçme me një fushë të ndarë në dymbëdhjetë pjesë dhe me akrepa, që punon me kurdisje, me rrymë elektrike etj. dhe që shërben për të matur kohën. Orë e madhe. Orë elektrike. Orë e artë (floriri). Orë dore (xhepi, muri, tryeze). Ora e qytetit. Orë me zile. Akrepat e orës. Fusha e orës. Zinxhiri (rripi) i orës. Kurdis (ngreh) orën. Më mbeti (më ngeli) ora. Ra ora (zilja e orës).

* Sa (te) ora përnjëherësh, në çast, atë çast. Orë e çast vazhdimisht, duke u përsëritur shumë dendur, herë pas here dhe shpesh. Orë e minutë gjithnjë, orë e çast. Orë e kohë gjithnjë, orë e çast. Orë e pa kohë herë pas here; në kohë të papërshtatshme, kohë e pa kohë. I orës së fundit që është dhënë në kohën më të afërt, që sapo është dhënë nga dikush (për një lajm a njoftim). I orës së parë (i orëve të para) i fillimit të diçkaje, që ka marrë pjesë që në fillim në një veprimtari; i flaktë. Ora me dorë (ora me një)

a) shpejt e mirë;

b) me siguri, një me një. Një orë (çast, sahat) e më parë sa më shpejt, në një kohë sa më të afërt. Ra ora për diçka u dha shenja e fillimit të diçkaje; erdhi koha për diçka. I ndreqi orët me dikë keq. thuri a kurdisi planet me dikë kundër dikujt tjetër, i bashkërendoi veprimet me dikë kundër një tjetri. Nuk e zë ora dikë a diçka

a) është në mbarim e sipër, merr fund së shpejti;

b) do të nisët, do të largohet së shpejti. Mos të zëntë ora! mallk. vdeksh! I ka orët të numëruara është në mbarim e sipër, po i vjen fundi, s'e ka të gjatë. I bie ora (sahati) gjithnjë shtatë (dymbëdhjetë, tetë) nuk mërzhitet fare; nuk shqetësohet për asgjë, nuk bëhet merak

fare; qëndron gjithnjë në mendimin e vet, s'luan nga e vetja.

ORË II f. 1. mit. Figurë e besimeve popullore shqiptare, e cila përfytyrohej si një grua, si një gjarpër etj., besohej se jetonte në male, në pyje, në fusha, në kroje ose pranë njerëzve, u ndihmonte a u sillte fat të mirëve dhe ndëshkonte të këqijtë. Orët e bardha. Orët e liga. Orët e maleve (e pyjeve, e fushave, e krojeve). Ora e njeriut (e shtëpisë, e fisit). Ora e Shalës. Ora e përrallave. Të shitoftë (të preftë) ora! mallk. Shkoftë ora e dëgjoftë! ur. qoftë për të mirë, u bëftë ajo që dëshiron! Të vdektë ora! mallk. Të ngrëntë (të marrtë) ora e ligë! mallk.

2. fig. vjet. Fati. Ora e bardhë (e mirë, e tetë, e ligë, e keqe). Ka orë. Qofsh me orë! ur. I ka prirë ora dikujt. E ka lëshuar ora s'e ndihmon më fati.

* Ora e shtëpisë euf. bolla. Ia ha orën dikujt shih te HA. I hipën (i erdhën) orët dikujt u ndërkrue, u bë si i çmendur, i hipën xhindet. Ishte me orë të këqija (të liga) ishte në gjendje të keqe shpirtërore, ishte i zemëruar a i mërzhitur. Iu lig (iu ligështua) ora dikujt vjet. I ra hovi i mëparshëm, iu prenë krahët, e lëshoi zemra, u ligështua. I ka vdekur ora dikujt a diçkaje ka marrë fund dikush a diçka.

I ndërruar orësh i prishur nga mendtë, i shituar, i shkalur, i shuplakur; budalla. Ngre orën kundër dikujt nis a ndërmarr një veprim kundër dikujt. Njeri me orë njeri që bën si t'i shkrepët, njeri me teka. I zbritën (i ranë) orët u qetësua, i ra inati. E kishte orën gjallë vjet. i shkonte puna mbarë, kishte gjithnjë fat, e ndihmonte fati vazhdimisht. E mori ora e ligë shkoi dëm; vdiq. Iu pre ora (dita) shih te PRITEM I.

ORGANIK I mb. 1. Që ka të bëjë me organizmat e gjallë, i organizmave të gjallë; që karakterizon qeniet e gjalla, i gjallë; që bëhet a që formohet prej qenieve të gjalla. Qenie organike. Lëndë (materie) organike. Bota (natyra) organike. Limfë organike. Acidet organike.

2. Që është formuar nga mbeturinat dhe nga kalbëzimi i bimëve a i kafshëve; që është formuar nga jashtëqitjet e kafshëve. Plehu organik. Lëndët organike.

* Kimia organike pjesë e kimisë, që studion bashkimet e karbonit me elemente të tjera si në organizmat e gjallë.

ORGANIK II mb. 1. Që ka të bëjë me një organ të trupit të njeriut ose të kafshës; që ka të bëjë me ndërtimin e brendshëm të një organi. Sëmundjet organike. Ndiçimet organike. Cenët organike të zemrës.

2. fig. Që ka të bëjë me ndërtimin e brendshëm a me thelbin e diçkaje, me vetë natyrën e saj, i brendshëm; që përbehet nga pjesë të lidhura shumë ngushtë, mirë e bukur ndërmjet tyre, i gërshtuar në mënyrë të natyrshme. Lidhje organike. Gërshtim (ndërtim, unitet) organik. Në mënyrë organike. U bë pjesë organike e diçkaje.

PA I ndajf. bised. Pastaj. Mat, pa pri! Mendohu mirë, pa fol!

PA II parafj. Përdoret me një emër, me një përemër ose me një numëror në rasën kallëzore për të treguar:

1. Mungesën e dikujt a të diçkaje në një kohë a vend të caktuar ose gjatë një veprimi, mungesën e një vetie të brendshme a të një tipari thelbësor e të përhershëm ose mungesën e një gjymtyre a pjese të dikush a të diçka etj., mungesën a mohimin e një veprimi a gjendjeje të caktuar ose të një mënyrë veprimi, rrethane etj. gjatë kryerjes së një pune, gjatë shfaqjes së një dukurie etj., mungesën e caktuar a të kufijve në hapësirë, në kohë ose në sasi etj. Kafe pa sheqer. Shtëpi pa ballkon. Fustan pa mëngë. Bluzë pa jakë. Arrë pa bukë. Urë pa këmbë. Gjellë pa mish. Gjellë pa shije. Njeri pa cene (pa fjalë). Njeri pa cipë (pa turp, pa nder, pa vlerë, pa brumë). Vajzë pa djallëzi. Fëmijë pa vullnet. Djalë pa mend. Ditë pa diell. Shaka pa lezet (pa kripë). Çështje pa rëndësi. Fjalë pa vend.

Muhabet pa bulmet. Fushë (det) pa anë e pa fund. Doli pa kapelë. Rrinin pa bukë. Luftuan edhe pa pushkë. Erdhi pa djalin. Jetonte pa burrin. Nuk rrinte dot pa të. Mos shko pa mua! Kjo gjë bëhet edhe pa ty. Rronte pa shpresa. Doli pa humbje. U dorëzua pa kushte. Punonte pa kujdes (pa mend në kokë). Punon (flet) pa pushim. Mbeti (ra) pa ndjenja. Mbeti pa gojë. Kaloi pa vështirësi. Erdhi pa vonesë. Kishte pa numër. Shpenzon pa hesap. Ha (flet, shëtit, vjen) pa kohë. Ishte pa punë. Humbi pa gjurmë (pa të thënë). Ia tha pa shaka. E kish pa të keq. E mori pa dëshirë. E bëri pa dashje. E bëri pa bujë. E la pa frymë. Na la p'a mend. Erdhën të gjithë pa përjashtim. Fëmija pa nënë si nata pa hënë. fj.u.

2. Heqjen, përjashtimin, veçimin e diçkaje a të dikujt (në kuptimin «duke mos e llogaritur, duke e hequr a zbritur, duke e përjashtuar, veç, përveç»). Peshon tridhjetë kile pa arkën. Shkolla ka 600 nxënës, pa ata të degës së natës.

3. Mungesën e një pjese ndaj një njësie të plotë të peshës, të gjatësisë a të kohës (me fjalë që tregojnë sasi, masë, kohë). Tetë pa dy (minuta). Katër pa një çerek. Dhjetë pa pak. Një metër pa katër centimetra. Peshon pesë kile pa dyqind gramë. Është një vit pa dy muaj.

4. Përdoret me një emër të përsëritur për të ndërtuar togje të qëndrueshme që shënojnë një mënyrë veprimi ose një rrethanë, e cila zakonisht nuk është e përshtatshme a e dëshirueshme. Flet (ndërhyn) vend e pavend. Vjen kohë pa kohë. Udhëtuan rrugë pa rrugë.

* Pa dyshim shih te DYSHIM, ~I. Pa fjalë shih te FJAL/Ë, ~A. Pa një pa dy, shih te NJË.

PA III lidh. bised. 1. Prandaj. Ka ndodhur, pa e rrëfejnë. Kishte rrugë të gjatë, pa u ngrit herët.

2. Përdoret në periudha me fjali të bashkërenditura kundërshtore me kuptimin «përndryshe, në rast të kundërt».

Nuk e dinte, pa s' do ta kishte bërë kurrë një gjë të tillë. Nuk e vuri re, pa do t'i kishte folur.

3. Përdoret në periudha, me fjali të bashkërenditura kundërshtore me ngjyrim shtesore. Fliste me zë të lartë, pa se shqetësonte fqinjët nuk donte t'ia dinte. Ç't'i bënte atij, pa për të tjerë nuk pyeste fare.

4. Përdoret në periudha me fjali të bashkërenditura me ngjyrim shtesore në kuptimin «sa për... përsa i përket...». Shko në ke punë, pa ta mbaj unë djalin. Qoftë kryet shëndoshë, pa kësula gjen sa të duash. fj. u.

5. Përdoret në periudha me fjali të bashkërenditura që shprehin marrëdhënie qëllimore; që, për të... Duhet të lanin dy napolona në muaj, pa të shpëtonin shtëpinë.

6. Përdoret me ngarkesë të veçantë modale, kur numëroj më disa veprime që ndjekin njëri-tjetrin. Velenxat kanë shumë punë - pa duhet larë leshi, pa duhet krehur, pa duhet punuar në avlëmend, pa duhet dërstilur etj.

7. përd. kallëzues. mat. Heqim, zbresim (kur zbresim një numër nga një tjetër). Nëntë pa dy..

8. si em. ~,~ JA f.,~,,~TË mat. Shenja e zbritjes (-); minus; kund. edhe. Vëri panë!

PA IV pj. 1. Përdoret përpara një foljeje ose një fjale tjetër me funksion kallëzuesor për të zbutur urdhrin, kërkesën etj. që shprehet prej saj. Pa na i thuaj! Pa mendoni pak! Pa të bëjmë pak hesap! Pa eja këtu! Pa hë, de!

2. Përdoret me një pjesore për të ndër-tuar formën e pashtjelluar mohore. S'la gurë pa lëvizur. S'la gjë pa bërë. Qëndroi një kohë të gjatë pa folur. U nis po zbardhur dita.

Liria s'fitohet pa derdhur gjak.

3. Përdoret kur duam ta bëjmë më të gjallë, më të ngrohtë etj. bisedën ose kur flasim për diçka që vjen a që ndodh pas

diçkaje tjetër, si edhe kur zë fill ligjërimi, tregimi etj. Pa nisi kënga, valle merr rinia. Pa erdhi dimri. Pa u hap fjala anë e mbanë. Pa, kur filloi të punonte, ç'të shihje. Pa, do ti, edhe këtu e tregoi veten.

4. Përdoret kryesisht në fjali pyetëse për të theksuar ndjenjën e folësit ose qëndrimin e tij ndaj asaj që thotë, për të rritur fuqinë shprehëse të ligjërit etj.; se. Mirëpo kush besonte pa? E për kë foli pa! E përse pa? Dhe ku pa?! Dhe ç'krom pa!

5. Përdoret në fund të fjalisë kur e ndër-presim ligjërimin me qëllim, për të lënë të nënkuptuar diçka që do të ndodhte, do të bëhej, do të ndërmerrej etj! si kundërveprim. S'e pashë, pa nuk do ta lija të nisej. S'e mori vesh, pa do të ishte përgjigjur.

* Pa le shih te LE.

PAERË I mb. Që nuk ka erë të fortë, pa erë e i qetë. Mot i paerë.

PAERË II mb. Që nuk bie erë, që nuk ka ndonjë erë të veçantë a të rëndë. Gjellë e paerë.

PAGËZUAR I mb. fet. Që ka bërë pagëzimin dhe ka marrë emrin sipas ritit fetar (në vendet ku vepron feja e krishterë). Fëmijë i pagëzuar.

PAGËZUAR II mb. Që nuk ka njohur gëzimet kryesore në jetë (përdoret zakonisht për prindërit që vdesin përpara se të martojnë fëmijët e tyre ose për të rinjtë që vdesin përpara se të martohen). Shkoi (vdiq) i pagëzuar.

PAH I m. 1. Pjesa shumë e imët e miellit, që ngrihet si pluhur gjatë bluarjes; maja e miellit. Pah mielli.

2. Hedhet e të lashtave. Pahu i misrit (i grurit, i orizit).

3. Hedhet e imëta të lëndës së drurit kur e sharrojmë. Pahu i drurit. Pahu i shar-rës.

4. Endi i luleve, pjalm. Pahu i luleve (i pemëve).

5. Flokët e imët të dëborës; shtresë e imët dëbore. Pah dëbore.

6. Zbokth; zhuli që zë koka e fëmijëve. Pahu i kokës.

PAH II m. Pamje e jashtme, paraqitje; dukje, dukë, pashi. Ia humb pahun.

* Del në pah

a) bëhet i dukshëm qartë, del në dritë, del në dukje;

b) shquhet ndërmjet të tjerave, bie në sy, dallohet. Nxjerr në pah

a) e bëj të duket qartë, e nxjerr në dritë, e vë në dukje;

b) tërheq vëmendjen për diçka ndërmjet të tjerave, i vë theksin, e theksoj, e nënvizoj.

PAJË I f. 1. etnogr. Plaçkat dhe pasuria që merrte me vete nusja e i çonte në shtëpinë e dhëndrit kur martohej. Pajë e madhe. Paja e nuses (e vajzës). Qëndisimat (jastëkët) e pajës. Arka e pajës. Bënte (përgatiste) pajën. Nisi (dërgoi) pajën. Nuk sjellin më pajë me vete.

2. bised. Barrë që i ngarkohet dikujt. Ia bëri (ia la) pajë atë punë. I mbeti pajë.

* Bëhu pajë! keq. shporru, qërohu! E mori pajë me vete (iu bë pajë) i mbeti përgjithnjë si njollë, nuk i hiqet më. Ia bëri pajë dreqit (shejtanit) e shporri dikë, e hoqi qafe.

PAJË II f. Përkrahje e dikujt kur nuk ka të drejtë, anësi, anë, hatër. Mban pajë anon nga dikush, flet a vepron me anësi. I mban pajën dikujt e përkrah edhe kur nuk ka të drejtë, i mban anën. Flet me pajë.

PAJTIM I m. 1. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljeve PAJTOJ I, PAJTOHEM I. Pajtimi i gjaqeve. Kundër pajtimit me të metat. Politikë pajtimi. keq. Ra në pajtim u pajtua.

2. Përputhja me diçka tjetër, ana në të cilën diçka përputhet a pajtohet me një tjetër. Nuk kanë pajtime midis tyre.

* Në pajtim me ... libr. në përputhje me... në përshtatje me ...

PAJTIM II m. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve PAJTOJ II, PAJTOHEM II. Pajtimi i fuqisë punëtore.

2. Porosi që bën dikush, duke paguar sasinë përkatëse të të hollave, për të marrë rregullisht ose për të përdorur diçka për një kohë të caktuar. Pajtimet telefonike. Fushata e pajtimeve. Zyra e pajtimeve.

PAJTIMTAR I m. shih PAJTUES, ~I I 1. Vinin si pajtimtarë.

PAJTIMTAR II m. Ai që ka bërë pajtimin për një organ të shtypit ose për diçka tjetër. Pajtimtarë të rinj (të vjetër). Pajtimtarit e gazetës «Zëri i popullit». Porositë e pajtimtarëve. Lista e pajtimtarëve. Shtohet çdo vit numri i pajtimtarëve.

PAJTOHEM I vetv. 1. Vendos përsëri marrëdhënie të mira a miqësore me dikë, me të cilin kam pasur mëri ose isha grindur. U pajtuan pas dy muajsh.

2. Pranoj mendimet, arsyetimet etj. të dikujt, bashkohem me ato që thotë ose me qëndrimet që mban dikush. U pajtua me mendimet (me arsyetimet) e shokëve.

3. Pranoj një gjendje a diçka tjetër ashtu siç është dhe nuk bëj përpjekje për ta ndrequr ose për ta ndryshuar, nuk e kundërshtoj. Nuk pajtohen me të metat.

4. vet. veta III. Përputhet me diçka tjetër, përshtatet. Kjo nuk pajtohet me mendimet tona. Nuk u pajtoheshin karakteret.

5. Pës. e PAJTOJ I 1,3. U pajtuan gjaqet (hasmëritë).

PAJTOHEM II vetv. 1. Hyj në punë te dikush, duke rënë në ujdi për pagesën (në kushtet e sundimit të pronës private). Pajtoheshin shërbyes (argati). U pajtua në punë.

2. Bëj pajtimin për një organ shtypi a për diçka tjetër. U pajtua në gazetë (në revistë). Pajtohet çdo vit (çdo gjashtë muaj).

3. Pës. e PAJTOJ II.

PAJTOJ I kal. 1. Bëj që të kenë përsëri marrëdhënie të mira a miqësore dy a më shumë veta që i mbanin mëri njëri-tjetrit ose që ishin grindur. I pajtuan të dy shokët. Ndërhynë për t'i pajtuar. Pajtonin gjaqet. etnogr. ndërhynin që të pushonte gjakmarrja ndërmjet dy familjeve.

2. Sheshoj kundërtitë ndërmjet dy a më shumë pikëpamjeve, tezave, qëndrimeve etj., i afroj që të përputhen. Përpiqej t'i pajtonte pikëpamjet (qëndrimet) e të dyja palëve.

3. bised. E bëj të pushojë së qari; e qetësoj; i lehtësoj dhembjen. E pajtoi fëmijën. Pajtoi vajin. I pajtoi zemrën. I pajtoi plagët.

4. jokal. kryes. veta III. Shkon a përshtatet me diçka tjetër, përputhet; pajtohet. Ngjyra që pajtojnë njëra me tjetrën. Në këtë pikë pajtojnë.

5. jokal. bised. Bie në një mendje me dikë, arrij në një zgjidhje të përbashkët me dikë, bie në ujdi, merrem vesh. Pajtoi me të vëllanë.

PAJTOJ II kal. 1. E marr dikë në punë, duke rënë në ujdi për pagesën (në kushtet e sundimit të pronës private). Pajtonin shërbëtorë (ustallarë, argatë). E pajtoi lirë.

2. E fut dikë në një punë te dikush duke rënë në ujdi për pagesën (në kushtet e sundimit të pronës private). E pajtoi të birin te këpucari. E pajtoi në punë.

3. Marr a zë me qira diçka (një banesë, një mjet etj.) për ta përdorur për një kohë të caktuar. Pajtoi një karrocë.

4. Bëj pajtimin për dikë në një organ shtypi ose në diçka tjetër. E pajtoi në gazetë (në revistë).

PAJTUES I m. 1. Ai që ndërhyr për të pajtuar dy a më shumë njerëz, të cilët i mbanin mëri njëri-tjetrit ose që ishin në armiqësi midis tyre. Pajtues i gjaqeve. etnogr.

2. Ai që përpiqet të pajtojë dy gjëra (mendime, pikëpamje, ide etj.), që bien

ndesh a që janë në kundërshtim njëra me tjetrën. Pajtues i dy teorive.

PAJTUES II m. Ai që merr a zë me qira një mjet, një shtëpi etj. për një kohë të caktuar. Pajtuesi i karrocës.

PAK I pakuf. 1. Përdoret për të treguar në mënyrë të pacaktuar një numër të vogël qeniesh, sendesh, dukurish etj., një sasi a masë të vogël; kund. shumë. Pak njerëz (burra, nxënës, punëtorë). Pak shokë (të afërm, të ftuar). Pak ndërtesa (shkolla). Pak kohë më parë. Pak ujë. Pak lekë (para). Kishte pak pluhur (baltë). Ra pak shi. Ka pak të ngjarë. Me pak fjalë shkurt. Më mirë pak e sak, se shumë e për lumë. fj. u. Fjalë pak e punë shumë. fj. u.

2. Përdoret për të treguar në mënyrë të pacaktuar një numër të vogël ose një pjesë të vogël të një tërësie qeniesh a sendesh; kund. shumë. Pak nga të sëmurët. Pak prej tyre. Pak ishin të paven-dosur. Pak nga të tëra. Erdhën pak, të tjerët s'u dukën. Mori pak, të tjerat i la.

* Pak gjë pa... shih te GJË. Mish pak e pupla shumë shih te MISH, ~I. Shumë pula e pak vezë shih te PUL/Ë, ~A.

PAK II ndajf. 1. Në një shkallë jo të lartë, në një masë të vogël; kund. shumë. Pak fare. Pak a shumë në një fare mase, deri diku. Çdo ditë e më pak. Ku më pak e ku më shumë. Punon (lexon, shkruan) pak. Djeg (shkëlqen) pak. Pret pak (thika). Prodhon (jep) pak. Kanë mësuar pak. U lodh pak. Kënaqej me pak. Është bërë pak në këtë drejtim. Mbetet edhe pak për të bërë.

2. Jo aq sa duhet a sesa është e nevojshme. Ka fjetur pak. Ka zier pak. Ka ngrënë pak. Ke ndenjtur pak në diell. E ka mprehur pak. Pak e ka!

3. Jo shumë kohë, jo gjatë. Ndenji pak. S'ka pak që u kthye. Prit pak! Heshti pak.

Rri dhe pak. Të mendohem dhe pak. Era mbajti pak.

* Pak se... jo vetëm që..., nuk mjafton që... Për pak pothuaj, gati sa; për një fije, për një qime. Pak (e) nga pak ca nga ca, dalëngadalë.

PAK III pj. 1. Përdoret përpara një mbiemri a një ndajfoljeje për të treguar një shkallë jo të lartë të cilësisë së një frymori, të një sendi etj. ose të veprimit a të gjendjes; kund. shumë. Pak i egër. Pak i ftohur. Pak i shkuar në moshë. Pak i zbehtë. Pak larg (afër). Pak me gjerë. Pak më shumë.

2. Përdoret përpara shkallës krahasore të sipërisë të një mbiemri a ndajfoljeje për të treguar një farë dallimi cilësor ndërmjet gjymtyrës së parë e gjymtyrës së dytë të krahasimit; kund. shumë. Është pak më i fortë (më i mprehtë, më punëtor) se tjetri. Vrapon pak më shpejt (me ngadalë) se ai. Pak më mirë (më keq) se... Pak më tej (më poshtë).

3. Përdoret pas një foljeje në mënyrën urdhërore për të zbutur urdhrin, kërkesën etj. që shprehet prej saj. Ma jep pak shkrepësen! Hape pak dritaren! Thuajti pak të vijë!

PALË I f. 1. Pjesë e një pëlhure, e një petku, e një letre etj., e thyer me dysh në vijë të drejtë; e kthyer në fund a në anë të një rrobe ose të një cope. Palat e fundit. Fustan me pala. Ktheu palën. Qepi (shqepi) palën. Hekurosi palat.

2. Një e kthyer më dysh në vendin ku rrudhet një pëlhurë a një petk; rrudhë, zhubër. Iu bë një palë në fustan. Drejtoi palat.

3. Shtresa e lëkurës dhe e dhjavit që i varet në gushë, në bark etj. një njeriu shumë të ngjallur a të vjetër në moshë ose një bagëtie. Palat e gushës (e qafës, e barkut).

4. kryes. Valëzim i lehtë në sipërfaqen e diçkaje, rrudhë. Palat e flamurit. Palat e trurit. anat. Rrudhat e trurit.

5. gjeol. Rrudhë e shtresave të tokës. Palë e hapur (e drejtë). Krahët e palës. Bërthama e palës.

6. përd. ndajf. Më dysh a më trish; njëri mbi tjetrin, palë-palë, stive. E bëj palë e palos. Vë palë dy thekët (jorganët). Mbledh palë.

* E bëri palë dikë a diçka e shtypi, e bëri petë. E bëri bishtin palë përçm.

a) vdiq, ngordhi;

b) mori mësimin që meritonte, e uli hundën; i ranë pendët.

PALË II f. 1. Dy sende të një lloji dhe të një madhësie që shkojnë e përdoren bashkë.

Një palë këpucë (çizme, sandale, opinga). Një palë çorape (doreza). Një palë shtiza.

2. Veshje, vegël a diçka tjetër që ka dy pjesë të njëjta. Një palë pantallona (mbathje, pizhame). Një palë gërrshërë. Një palë darë. Një palë syze.

3. Një numër a sasi e caktuar sendesh të njëjta që merren së bashku si një e terë.

Një palë letra. Një palë ndërresa. Një palë domino. Ngjiti një (dy) palë shkallë.

4. Dhëndri me nusen ose i fejuari me të fejuarën së bashku; një djalë e një vajzë që vallëzojnë së bashku; çift. Vallëzonin me gëzim palët e të rinjve.

5. Një grup njerëzish a frymorësh që i bashkojnë tipare a rrethana të përkohshme; disa prej tyre; grup. Një palë erdhën, një palë shkuan. Një palë njerëz një kategori njerëzish, një takëm njerëzish.

6. Grup njerëzish me qëllime e interesa të përbashkëta, që i kundërvihet një grupi tjetër; anë. Pala kundërshtarë. Pala e interesuar. Pala paditëse. drejt. Me pëlqimin e të dy palëve. U pyetën të dy palët. Hynë në marrëveshje me palën tjetër.

7. Përdoret përpara disa emrave që përdoren vetëm në shumës, me kuptimin përforcues «disa, ca». E zunë një palë ethe të forta!

* Me sa palë mend? shih te MEND, ~TË. U plak me një palë mend mospërf. shih te MEND, ~TË. Për shtatë palë qejfe shih te SHTATË. E mbylli me shtatë palë çelësa (me shtatë kyçe) shih te

- SHTATË.** Qante me shtatë palë lot shih te SHTATË.
- I shkuan shtatë palë djersë shih te SHTATË. E kishin zënë shtatë palë ethe shih te SHTATË.
- PALË** III f. 1. Fik i shtypur ose i çarë me dysh dhe i tharë në diell, që ruhet për dimër. Palë fiku. Varg palash. I bëri palë. Ru-anin pala për dimër.
2. Pesë ose gjashtë gjethe duhani të thara dhe të vëna njëra mbi tjetrën për t'i grirë. Griu një palë duhani.
- * Si arra me palën (si fiku me arrën) shih te FIK,~U.
- PALË-PALË** I ndajf.
1. Në shumë pala njëra mbi tjetrën. I bëri (i vuri) palë-palë. Me shumicë të madhe.
- I kishte paratë palë-palë.
2. përd. mb. Që ka shumë pala njëra pas tjetrës a që ka disa shtresa a palë njëra mbi tjetrën. Fustan palë-palë fustan me pala. Dhjamë palë-palë.
- * Iu bë qafa palë-palë (me pala) shih te QAF/Ë,~A.
- PALË-PALË** II ndajf.
- Në shumë grupe njëri pas tjetrit. Vinin palë-palë.
- PALËZ** I f. 1. Bula e veshit.
2. Palë e vogël në një pëlhurë a petk. Palëzat e bluzës (e fustanit).
- PALËZ** II f. 1. Fije prej mëndafshi etj., e mbështjellë në një rrotull me trajtë vezake. Palëz mëndafshi.
2. Sasi leshi që del nga një e krehur me gërhanë. Palëz leshi.
- PALËZ** III f. Palë fiku.
- PALLANGË** I f. vjet. Fshat me shtëpi të mbledhura dhe me disa dyqane ose me një shesh të vogël për pazar.
- PALLANGË** II f. krahin. 1. Llozi i derës.
2. Secila nga lopatat e pendës së mullirit ose të dërstilës.
- PAQËSIM** I m. Veprimi dhe gjendja sipas kup-timeve të foljeve PAQËSOJ I, PAQËSOHEM I. Paqësimi i vendit. Paqësim ndërmjet dy shtetesh. Politika e paqësimit politikë e shteteve shtypëse dhe e formave oportuniste që synon të shuajë lëvizjet revolucionare ose të arrijë paqe ndërmjet dy shteteve pavarësisht nga karakteri i saj.
- PAQËSIM** II m. bised. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve PAQËSOJ II, PAQËSOHEM II.
- PAQËSOHEM** I vetv. 1. Bëhem përsëri mik dhe u jap fund grindjeve e mosmarrëveshjeve me një tjetër, pajtohem. U paqësuan më në fund.
2. Më ikën një shqetësim a një telash, bie në qetësi, qetësohem.
3. vet. veta III. Fashitet, qetësohet; i bie forca a vrulli. U paqësua plaga (dhem-bja).
4. Pës. e PAQËSOJ I.
- PAQËSOHEM** II vetv. pës. bised. shih PAQOHEM II.
- PAQËSOJ** I kal. 1. Ndërhyj që të vendosen përsëri marrëdhënie të mira ndërmjet dy njerëzve a palëve, i bëj përsëri miq, i pajtoj. I paqësoi fqinjët.
2. Vendos paqen përsëri në një vend, zhduk çrregullimet e turbullirat; ndikoj për t'u rivendosur marrëdhënie të mira ndërmjet dy a më shumë shteteve që ishin në luftë (zakonisht për veprimet e shteteve shtypëse e të forcave oportuniste).
3. I fashit a i qetësoj dikujt dhembjen ose diçka tjetër shqetësuese. I paqësoi dhembjen. I paqësoi plagën. E vë në udhë të mbarë, e vë për fije, e rregulloj. I paqësoi punët.
- PAQËSOJ** II kal. bised. shih PAQOJ II. E paqësoi shtëpinë.
- PAQOHEM** I vetv. shih PAQËSOHEM I 2,3. Iu paqua dhembja.

PAQOHEM II vetv. bised. 1. Lahem e pastrohëm mirë. U paqua mirë para se të flinte.

2. Pës. e PAQOJ II.

PAQOJ I kal. 1. shih PAQËSOJ I 1,3. I paqoi fëmijët. Ua paqoi zemrën.

2. jokal. vet. veta III. Fashitet, qetësohet (për plagën, dhembjen etj.); ul vrullin a forcën, bie në qetësi (për erën etj.). Paqoi plaga (dhembja). Paqoi deti (era).

PAQOJ II kal. bised. Laj a pastroj mirë dikë a diçka; e pastroj dhe e rregulloj mirë një vend. I paqoi enët. E paqoi shtëpinë. I paqoi fëmijët.

PARANIK I m. Lloj përparëseje prej leshi, zakonisht e zezë. Paranik me thekë. Vuri paranikun.

PARANIK II m. 1. Fëmija i parë, i parëlin-duri. Paranikun e kishin djalë.

2. vet. Të parët, stërgjyshërit.

PARË I as. 1. Njëra nga të pesë shqisat: mundësia dhe aftësia për të parë botën që na rrethon me anë të syrit Organi i të parit. Çrregullime të të parit. Higjiena e të parit. Iu dobësua të parët.

2. Veprimi sipas kuptimeve të foljes SHOH; shikim, vështrim. Të parët me sy kritik. Fusha e të parit.

3. Pamja, ana e jashtme e dikujt a e diçkaje; dukja. I bukur në të parë. Nga të parit është e mirë. Mos e shih nga të parët!

* Me të parë e me të bërë do të veprohet sipas gjendjes që do të krijohet, sipas rrethanave a kushteve konkrete.

PARË II as. etnogr. Vajtja e nuses për herë të parë te prindërit e vet pas martesës, pasi. Shkonte nusja në të parë.

PARTI I f. 1. Organizatë politike e një klase a e një shtrese shoqërore të caktuar, që ka programin e statutin e vet dhe që lufton për të mbrojtur interesat e klasës a të shtresës shoqërore, së cilës i përket. Parti politike. Parti borgjeze. Parti

demokratike (konservatore, republikane). Parti fashiste. Parti revizioniste. Kongresi i partisë.

2. Reparti pararojë dhe i organizuar i klasës punëtore, që e udhëheq atë drejt fitores së revolucionit proletar dhe për ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste, që ka në themel të të gjithë veprimtarisë së saj idetë e marksizmit. Parti komuniste. Parti marksiste. Parti e tipit të ri.

3. vjet. Grup njerëzish që i bashkon përkohësisht një qëllim i caktuar; palë; secili nga grupet që marrin pjesë në një lojë. U ndanë dy partish. Partia e parë mundi të dytën.

PARTI II f. Pjesë a sasi e madhe mallrash ose lëndësh që çohen së bashku diku. Parti malli. Parti leshi (pambuku, lëkure). Shitja e partisë së parë.

* Parti dyfishe fin. mënyrë regjistrimi, sipas së cilës çdo shumë që shënohet në dobi të një llogarie ose të disa llogarive, shënohet njëkohësisht edhe në kredi të një llogarie tjetër ose të disa llogarive të tjera.

PASANIK I m. Ai që ka pasuri të madhe, pronar shtëpish, tokash etj.; pjesëtar i shtresave të pasura që nxjerr fitime duke shfrytëzuar punën e të tjerëve (në vendet me sistem shfrytëzues). Pasanik i madh. Pasanikët e fshatit. Pasanikët dhe të varfrit. Shtëpi pasanikësh. Bij pasanikësh.

PASANIK II m. vjet. Ai që i shkonte pas një njeriu të pasur a me rëndësi për ta shoqëruar, për ta ruajtur etj.; bishti i një tjetri.

PASIV I mb. 1. Që nuk vepron, që nuk merr pjesë në një punë a veprimtari; që rri në pritje e nuk vetëvepron; jo i gjallë, i plogët; që nuk ndikon me forcë në zhvillimin e ngjarjeve; kund. aktiv. Njeri pasiv. Nxënës pasiv. Qëndrim pasiv. Qëndresë pasive. Mbrojtje pasive. Rol pasiv. Tregohej pasiv.

2. spec. Që nuk merr pjesë në një proces; që nuk vepron më, që është shuar; kund. aktiv. Vullkan pasiv vullkan i shuar.

3. Që nuk zotërohet në mënyrë të thelluar dhe nuk vihet në përdorim gjallërisht e pa vështirësi; kund. aktiv. Fjalori pasiv. E zotëron në mënyrë pasive një gjuhë.

PASIV II mb. fin. Që ka më shumë shpenzime se të ardhura; që ka të bëjë me pasivin e bilancit; kund. aktiv. Llogari pasive. Bilanc pasiv bilanc me shpenzime më të mëdha se të ardhurat.

PASOJ I kal. 1. edhe jokal. Ndjek dikë a diçka që ecën para meje, i shkoj prapa pa i ndarë; ndjek. Pasoi shokët. Skuadra pasonte udhërrëfyesin. I dyti pasoi të parin. Të tjerët pasojnë më vonë.

2. jokal. vet. veta III. Bëhet a ndodh menjëherë pas diçkaje, vjen fill pas diçkaje tjetër; vjen pas, vijon. Pasoi një heshtje. Ditët që pasuan. Rregullat që pasojnë.

3. E bëj diçka menjëherë e si një tjetër a si të tjerët, ndjek. Këngën e pasuan shokët.

4. fig. Eci në rrugën e dikujt a ndjek shembullin e tij; bëhem përkrahës i dikujt a i diçkaje; e çoj më tej punën e nisur prej dikujt, vijoj po atë rrugë. Pason shembullin e të përparuarve. Pason rrugën e tyre. Ata që e pasuan këtë teori.

PASOJ II kal. 1. E kaloj diçka dorë më dorë që të arrijë deri te dikush a në një vend të caktuar, i jap dikujt diçka për ta kaluar dorë më dorë në mënyrë që të gjithë ta shohin, ta lexojnë etj. Pasonin tullat (tjegullat, gurët). E pasoi letrën. Lexoje dhe pasojua shokëve.

2. sport. I hedh topin një lojtari tjetër me dorë ose duke e gjuajtur me këmbë (në ndeshjet që luhen me top). E pasoi bukur (keq). Nuk e pasoi mirë. Ia pasoi qendërsulmuesit (mbrojtësit).

PASOJ III jokal. etnogr. Shkonte në të parë te prindërit e vet, shkonte së pari (për nusen).

PASTË I f. Ëmbëlsirë me përmasa të vogla e në trajta të ndryshme, që përgatitet me miell, me vezë, me gjalpë e me sheqer dhe zbukurohet përsipër me krem.

PASTË II f. Lëndë e butë dhe e qullët si brumë, që përdoret për qëllime të ndryshme. Pastë ngjitëse (mbrojtëse). Pastë dhëmbësh. Pastë rroje. Pastë xhamash baltë xhamash. Paste druri lëndë veshtullore që del nga përpunimi i drurit dhe që përdoret për prodhimin e letrës. Pastë për heqjen e ndryshkut.

PENDË I f. 1. kryes. Gypa të brittë e të hollë, me push e me fije të imëta në të dyja anët, që mbulojnë trupin e krahët e shpendëve; pupël. Pendë të gjata (të bukura). Pendë pule (pate, palloi). Me pendë të ngritura. Pendët e krahut (e bishtit). Ua rrjepin pendët. Dikur shkruanin me pendë pate.

2. shih PEN/Ë,~A.

3. Fletë në pjesë të ndryshme të trupit të peshqve, e cila u shërben këtyre për të notuar. Pendë notuese. Penda e bishtit. Pendët e kurrizit (e barkut).

4. Fletë të një vegle a mekanizmi; rrotë me shumë fletë të tilla, që rrotullohet nën veprimin e ujit dhe vë në lëvizje gurët e mullirit. Penda rrotullohej shpejt. S'kthehej me penda.

5. përd. mb. Shumë i lehtë. Ishte pendë.

6. përd. ndajf. Shumë (me mbiemrin «i lehtë»). Pendë i lehtë (i lehtë pendë).

* I ranë pendët (puplat, fletët) dikujt mospërf.

a) s'ka më atë pushtet a fuqi që kishte, s'i shkon më fjala, ra nga fiku;

b) nuk mburret më si përpara, i ra hunda, u shtrua. I uli pendët (puplat)

a) i ra inati, u zbut;

b) i ranë pendët. I dolën pendët (puplat) dikujt shih te PUP/ËL,~LA. Ia la pendët (puplat) dikujt iron. i iku papritur a fshehurazi nga dikush dhe as që u bë merak për të, i iku nga duart papritur dhe e la me gisht në gojë; mori ç'mundi,

përfitoi sa mundi prej dikujt e iku papritur. Na la pendët (shëndetin) dikush shih te LË. S'e prek dot as me pendë (as me pupël) dikë shih te PUP/ËL, ~LA. Kjo është (kësaj i thonë) tre qe e dy pendë kjo është punë që nuk bëhet, që nuk ka si rregullohet. Sa të zbardhet penda e korbit shih te KORB, ~I

PENDË II f. 1. Një çift qe, buaj etj. si kafshë pune. Një (dy) pendë qe (buaj, kuaj). Nget pendën.

2. Sipërfaqe toke sa mund të lërohet me një çift qe brenda një dite. Kishte një pendë tokë. I mbeti edhe një pendë për të lëruar.

PENDË III f. Cfrat i ngritur me gardh e me dhe, me zhavorr ose me gurë anës lumenjve a përrenjve ose gjatë bregut të detit, të liqenit etj. për të penguar vërshimin e ujërave; digë. Pendë e lartë. Pendë lumi (liqeni). Mbrohet me pendë.

PENGOJ I kal. 1. I dal përpara dikujt a diçkaje dhe s'e lë të lëvizë më tej, i zë rrugën; e ndaloj ose e vonoj lëvizjen e dikujt a të diçkaje.

2. I lidh kafshës këmbët e para që të mos largohet nga vendi ku kullot. Pengoj kalin (viçin).

3. fig. I nxjerr pengesa dikujt a diçkaje; nuk e lë të bëhet a të zhvillohet diçka, e pengoj, e vështirësoj a e ndaloj diçka; bëhem pengesë për dikë a për diçka. Pengon zhvillimin (përdorimin, shfrytëzimin, arritjen) e diçkaje. Asgjë s'e pengon revolucionin.

PENGOJ II kal. Lë peng diçka; kund. sh-pengoj (në vendet me sistem shfrytëzues). Pengoi shtëpinë.

PERÇE I f. bised. 1. Balluke. Preu perçen.

2. vjet. Tufë flokësh të gjatë që linin burrat në majë të kokës; flokë tepër të gjatë e të lëshuar mbi supe (për burrat). Djalë (burrë) me perçe të zezë (me perçe të artë). Krihte perçen. E ka lëshuar perçen.

3. Tufë qimesh të gjata që kanë disa kafshë në qafë; jelja e kalit (e luanit). Tundi (shkundi) perçen.

4. Xhufka e misrit.

PERÇE II f. Pëlhurë e zezë dhe e hollë me të cilën gratë myslimane në disa vende mbulojnë fytyrën që të mos i shohin të tjerët (më parë edhe në disa vise të Shqipërisë); lloj nape e zezë. Mbuloheshin me perçe të zezë. S'dilnin pa perçe. Gratë tona i hoqën perçet njëherë e përgjithmonë.

PESHKATORE I f. Anije e ndërtuar dhe e pajisur posaçërisht për peshkim. Ndërtimi i peshkatoreve të reja.

PESHKATORE II f. tek. Shtagë e gjatë e metalta, me majë të kthyer si grep, e cila përdoret për ta nxjerrë nga toka pjesët e këputura të gypave që janë futur gjatë shpimeve të puseve të naftës. Kunja për peshkatore. Nxjerr me peshkatore.

PËLHURË I f. 1. Copë e endur hollë në avlëmend ose në tezgjah, zakonisht me fije pambuku a mëndafshi që përdoret për veshje të lehta, për mbulesa etj. Pëlhurë e hollë (e trashë). Pëlhura të pambukta (të mëndafshta). Pëlhurë liri. Prodhimi i pëlhurave. Bëjnë (endin) pëlhurë.

2. Veli i anijes. Anije me pëlhurë. Shpalosi (nde) pëlhurat. Mblodhën pëlhurat.

3. Rrjetë fijesh të holla që end merimanga, cergë merimange. Fshiu (hoqi) pëlhurat e merimangave.

4. fig. Diçka që shërben për të mbuluar a fshehur një send a një dukuri, perde. Një pëlhurë resh (me re). Pëlhura e misterit.

* Pëlhura e Penelopës libr. punë që zgjatet shumë a nuk merr fund kurrë.

PËLHURË II f. mit. Figurë e përrallave popullore shqiptare, që përfytyrohet si një qenie e gjatë dhe e bardhë, e cila u del përpara njerëzve natën dhe u pret udhën.

PËRCËLLAK I m. 1. Kulaç i hollë me miell gruri ose misri, i zënë me ujë të ftohtë dhe i pjekur në hi a në zjarr me flakë.

2. Zjarr me flakë, që ndizet e shuhet shpejt; zjarr me kashtë ose me shkarpa të holla e të thata, që bëhet zakonisht sa për të përcëlluar diçka (një pulë, këmbët e bagëtive për paçe etj.). Ndezëm një përcëllak sa për të ngrohur duart. E përcëlloi në përcëllak.

3. fig. Njeri i thatë dhe i dobët, që ka marrë një ngjyrë të hirtë në fytyrë.

4. Përd. mb. sipas kuptimit 3 të emrit. Fëmijë përcëllak.

PËRCËLLAK II m. Bimë barishtore rreth një metër e lartë, me kërcell të fortë, të drejtë e të degëzuar sipër, gjethet e së cilës janë të vogla e të mprehta si ato të mërsinës dhe kërcasin kur digjen në zjarr; përce. Kërcet si përcëllaku në zjarr.

PËRCILLEM I vetv. 1. Kaloj nga goja në stomak një ushqim, përpiqem të kapërdij një ushqim etj.; gëlltitem. Përcillem me zor (nga dhembja e grykës).

2. Bëj sikur gëlltit diçka kur jam i prekur a i tronditur ose kur më tërheq shumë diçka. Përcillej i mallëngjyer (nga zori).

PËRCILLEM II Pës. e PËRCJELL 2-9.

PËRDHES I m. mjek. Sëmundje që shfaqet me pezmatim të kyçeve e të mishrave, me dhembje e me dridhje, reumatizëm; cermë. E ka zënë përdhesi. I dhembin kyçet (këmbët, duart) nga përdhesi.

PËRDHES II m. euf. Gjarpri.

PËRFLAK I kal. 1. E djeg me flakë, i jap flakë, e mbuloj me flakë (një vend etj.). Rrufetë e përflakën korijen. Zjarri përflaku dheun.

2. E përcëlloj në flakë diçka, e përzhit. E përflaku pulën. I përflakin kularët.

3. fig. I jap një ngjyrë të kuqe të ndezur si të flakës, e përskuq, e ndez. Agimi përflaku diellin. Rrezet e diellit përflakën retë e bardha. Perëndimi përflaku liqenin.

PËRFLAK II kal. E hedh tutje me forcë, e flak tutje. E përflaku vala.

PËRFLAKET I vetv. 1. Digjet me flakë, merr flakë, mbulohet nga flakët. U përflak pylli. U përflak një kasolle.

2. fig. Merr një ngjyrë të kuqe të ndezur si të flakës, përskuqet, ndizet. U përflak qielli. U përflakën retë (nga rrezet e diellit). U përflak në fytyrë.

3. Pës. e PËRFLAK.

PËRFLAKET II Pës. e PËRFLAK II.

PËRFLAKJE I f. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljeve PËRFLAK I, PËRFLAKET I. Përflakja e qiellit.

PËRFLAKJE II f. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve PËRFLAK II, PËRFLAKET II.

PËRGJËRATË I f. 1. Qenie shumë e shëmtuar; përbindësh. Ç'na sollën atë përgjëratë. Iu duk si përgjëratë.

2. Përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Njeri përgjëratë.

PËRGJËRATË II f. Përgjërim. E zinte në gojë me përgjëratë. E donte me përgjëratë.

PËRGJIM I m. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve PËRGJOJ, PËRGJOHEM. Përgjimi i lëvizjeve të armikut. Përgjimi i zhurmave të dyshimta. Përgjim me anë të telefonit.

2. Përqendrim i vëmendjes dhe i shqisave për të hetuar çfarë ndodh rreth e rrotull; usht. vëzhgimi organizuar i çdo lëvizjeje të armikut. Rri (qëndron) në përgjim. Kompania forcoi përgjimin.

PËRGJIM II m. etnogr. Gostia a darka që bëhej kur i vihej emri fëmijës, zakonisht tri ditë pas lindjes; dhuratat që i çoheshin lehonës me këtë rast.

PËRHEQ I jokal. Jam në çastet e fundit të jetës, jam në grahmat e vdekjes, jam duke dhënë shpirt.

PËRHEQ II kal. Marr nëpër gojë dikë, përgoj, flas keq për dikë.

PËRKTHYER I mb. Që është kthyer në një gjuhë nga një gjuhë tjetër. Vepra të përkthyer.

PËRKTHYER II mb. Që është i kthyer në një anë, i harkuar. Me kthetra të përkthyer- era.

PËRMENDORE I f. 1. Vepër arkitekture ose skulpturë e ngritur në një vend për të përjetësuar kujtimin e një ngjarjeje historike a të një njeriu të shquar, monument. Përmendore madhështore. Përmendorja e Skënderbeut. I ngritën një përmendore.

2. Ndërtim a shkrim me rëndësi të veçantë historike a me vlerë kulturore, që ruhet si dëshmi e së kaluarës së një populli. Përmendore historike. Përmendore e vjetër e shkrimit shqip. Përmendore kulture. Mbishkrimet e përmendoreve.

3. fig. Vepër e shquar e me rëndësi të madhe që kujtohet brez pas brezi; vepër letrare me përmbajtje të thellë e me formë të përsosur. Mbeti përmendore e përjetshme. Poema «Bagëti e bujqësi» është përmendore e pavdekshme.

PËRMENDORE II f. dipl. vjet. Përkujtesë.

PËRPARJE I f. Përparëse (kryesisht si pjesë e disa veshjeve popullore). Përparje prej leshi (prej shajaku).

PËRPARJE II f. Lestar i ri që del në hardhi; përpajnë. I shumëzoi në hardhitë me përparje.

PËRZIHIM I vetv. 1. vet. veta III. Bashkohet një gjë me një tjetër a një lloj i një lënde etj. me një lloj tjetër dhe formon me të një masë pak a shumë të njëllojtë. U përzenë bojërat.

U përzje vaji. U përzenë portokalliet (mollët, ullinjët, fasulet).

2. Ndërhyj në punë që s'më përkasin; ndërhyj në çështjet e të tjerëve për qëlime të caktuara. Nuk përzihet në punët e të tjerëve. Nuk i lejojmë të përzihen në çështjet tona të brendshme. Mos u përziej në atë punë!

3. Futem diku a marr pjesë në diçka bashkë me të tjerë; shkoj me një grup njerëzish për të bërë një punë bashkë me ta, për t'i ndihmuar, për të mësuar prej tyre etj.

U përzenë me popullin (me turmën). Përzihet me gëzimet dhe hidhërimet e tyre.

4. pavet. (me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor në r. dhanore). Më vjen për të vjellë. Më përzihet nga udhëtimi (nga era e benzinës).

5. Pës. e PËRZIEJ.

* U përzie moti u prish koha. U përzien retë po prishet koha, pritet kohë e keqe. Përzihet si bolla me ngjallën shih te BOLL/Ë, ~A. Mos u përziej me krundet, se do të të hanë pulat! (Po të përzihesh me krundet, të hanë pulat.) fj. u. shih te KRUNDE, ~T.

PËRZIHIM II Pës. e PËRZË.

PËRZHITEM vetv. zakon. veta III. 1. Përcëllohet në flakë, përflakohet; digjet pak përsipër; theket pranë zjarrit.

U përzhit mishi (buka).

2. Pës. e PËRZHIT. U përzhit duarsh.

PILË I f. 1. Dy arra njëra mbi tjetrën ose tri arra të afuara me një kokërr tjetër përsipër, që i vënë fëmijët në tokë kur luajnë duke i gjuajtur me një arrë më të madhe. Një pilë arrash. I ra pilës.

2. Gur a dru ku mbështetet pilca.

3. Këmbë ure prej betoni e me përmasa të mëdha.

4. Secili nga trarët e mëdhenj, që vihen në urat e drunjta.

5. Brezi i murit.

6. Breg i vogël, bregore, sop. E ndoqi pilë më pilë e ndoqi këmba-këmbës.

7. përd. ndajf. Njëra mbi tjetrën, në dy shkallë (për arrat kur luajnë fëmijët); njëri mbi tjetrin. Pilë më pilë njëri mbi tjetrin dhe pa rregull. I vuri arrat pilë.

* I ka punët pilë dikush nuk ka asgjë të sigurt, e ka gjendjen të paqëndrueshme.

PILË II f. fiz. elektr. Aparat që shndërron një reaksion kimik, një reaksion bërthamor ose nxehtësinë në energji elektrike; mjet që shërben si burim i energjisë elektrike. Pilë elektrike. Pilë atomike. Pila e Voltës

pilë e përbërë prej disa pllakëzash zinku, të ndara nga disa rrathë cohe të ngopur me acid sulfurik. Pilë e thatë bateri.

PIQEM I vetv 1. vet. veta III. Bëhet i gatshëm për t'u ngrënë pasi zbruhet e rreshket në furrë ose në zjarr. U poqën bukët. U poq mishi. U poq byreku (lakrori). U poqën patatet (specat).

U poq kafeja.

2. vet. veta III. Bëhet më i fortë, më i qëndrueshëm, më i ngjeshur etj. në furrë ose në një vend të mbyllur me temperaturë të lartë. U poqën tullat (tjegullat, shtambat, qypat). U poq gëlqerja.

3. vet. veta III. Arrin zhvillimin e vet të plotë (një pemë, drithi etj.) dhe është në kohën më të mirë për t'u vjelë, për t'u korrur a për t'u përdorur. U poq gruri. U poqën mollët (fiqtë). U poq rrushi. U poqën pjeprat. U poqën para kohe (vonë). S'është pjekur mirë.

4. fig. Nxehem shumë e skuqem a rreshkem duke qëndruar në diell pranë zjarrit etj., thekem. U poqëm në diell (pranë zjarrit). U poq nga këmbët.

5. vet. veta III. Mbledh qelbin plaga, arrin në një fazë kur, pasi ka mbledhur, është gati të çahet; arrin në fazën kur e nxjerr këlbazën. U poq çibani (lunga).

M'u poq kolla.

6. fig. Bëhem i aftë për jetën a për një veprimtari, duke fituar përvojën e njohuritë e nevojshme, duke u kalitur etj.; arrij moshën e pjekurisë. Është pjekur shpejt ai djalë. U poq para kohe. Janë pjekur politikisht (ideologjikisht).

7. vet. veta III. Arrin kulmin ose pikën më të lartë të zhvillimit (një gjendje, një dukuri etj.); arrin në një gjendje kur është gati të shpërthejë e të veprojë për të sjellë ndryshime të reja cilësore. U poqën kushtet për diçka. U poq situata revolucionare. U poqën kushtet ekonomike (politike). U poq revolucionin.

8. Pës. e **PJEK** I.

* Piqet (digjet) në prush për dikë shih te **PRUSH**, ~I. Nuk piqet buka me shkarpa

fj. u. shih te **SHKARP/Ë**, ~A. Sheh rrushi rrushin (fiku fikun) e piqet fj. u. shih te **RRUSH**, ~I. Edhe mishi të piqet, edhe helli të mos digjet fj. u. shih te **MISH**, ~I.

PIQEM II vetv. bised. 1. Takohem me dikë; ndeshem me dikë. U poqëm me një mik. Po vete të piqem me një shok. Piqej me njerëz të ndryshëm. Mirë u pjekshim! (u pjekshim me të mira)! ur.

U poqën ballë për ballë. U poqën rrugës. Mali me malin nuk piqet, njeriu me njeriun piqet. fj. u.

2. vet. veta III. Takohet një gjë me një tjetër; ndërpritet. Vija ku duket se piqet toka me qiellin. Dy vija që piqen.

* Më piqet gjaku me dikë shih te **GJAK**, ~U I. U pjek ylli shih tek **YLL**, ~I.

U poq (u puq) qielli me detin shih te **QIELL**, ~I.

PJEK I kal. 1. Vë diçka në furrë ose në zjarr që të zbruhet e të rreshket dhe të bëhet e gatshme për t'u ngrënë. Pjek bukën (kulaçin, mishin). Pjek byrekun (lakrorin). Pjek qengjin në hell. Pjek patate (specat, kunguj, ftonj). Pjek misra në prush. Pjek qefullin në tjegull. Pjek kafënë vë kafënë në qebap dhe e rrotulloj në zjarr që të bëhet për t'u bluar. Pjek në zjarr (në prush, në furrë, në sobë, në saç).

2. Shtie diçka në një furrë të posaçme ose në një vend të mbyllur me temperaturë të lartë për ta bërë më të fortë, më të qëndrueshme, më të ngjeshur etj. Pjek tullat (tjegullat). Pjek vorbat (shtambat, qypat).

3. Ziej rrushin a pemë të tjera në një kazan të posaçëm për të nxjerrë raki; krahin. bëj një kafe. Pjek raki. Poqi një kafe.

4. vet. veta III. Bën që të arrijë zhvillimin e vet të plotë (një pemë, drithi etj.) dhe të jetë i gatshëm për t'u përdorur. I poqi vapa pemët (fiqtë, kumbullat). E

poqi shpejt të nxehtët grurin. Pema pa u pjekur s'hahet. fj. u.

5. edhe jokal. vet. veta III. Lëshon nxehtësi të madhe sa të djeg; përvëlon. Pjek dielli. Na poqi vapa.

6. vet. veta III. E bën të mbledhë, të çahet dhe të nxjerrë përjashta qelbin; e bën të nxjerrë këlbazën. Bar që e pjek çibanin. Shurup që e pjek kollën.

7. kryes. veta III fig. E bën të fortë e të aftë për jetën a për një veprimtari, duke i dhënë përvojën e njohuritë e nevojshme, duke e kalitur etj. Lufta (vuajtjet) e poqën para kohe.

* Djeg e pjek dikush shih te DJEG. Ma poqi buzën më mendoj shumë, ma solli në majë të hundës, ma plasi buzën. Ta pjek byrekun ta bën gropën, të vret, të zhduk. Ta pjek peshkun në buzë shih te BUZ/Ë, ~A. Mos pjektë dy bukë në një hi! mallk. shih te BUK/Ë, ~A.

PJEK II kal. bised. 1. Takoj dikë; ndesh. Poqi një mik (një shok). E poqa rrugës (papuritur).

2. Prek, çik. E poqi me gisht.

3. Përputh. I poqi bashkë dy fletë.

* Piqe (një herë) këtu! ma jep dorën ta shtrëngo! (i thuhet dikujt që s'e kemi parë ose kur duam ta lavdërojmë për një veprim të guximshëm). I pjekim hutat shih te HUT/Ë, ~A II.

PJEKË I f. vjet. Vendi i takimit; pikëpjekje. E nxirrin nusen në pjekë. etnogr. caktonin vendin e takimit për të marrë nusen krushqit.

PJEKË II f. Pengojcë që i vihet kalit, mushkës etj. ndër këmbë që të mos largohet shumë nga vendi ku kullot dhe të mos bëjë dëme rreth e përqark. U vuri pjeka kuaive.

PJEKË III f. Berr që piqet në hell.

PJEKJE I f. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljeve PJEK I, PIQEM I. Pjekja e bukëve. Pjekja e grurit (e mishit, e molëve). Pjekja e kushteve për diçka.

PJEKJE II f. bised. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve PJEK II, PIQEM II.

2. Takim, pikëpjekje. Kishte një pjekje me dikë.

PLAN I m. 1. Lloj vizatimi që paraqet me anë vijash e shenjash të posaçme dhe në një shkallë shumë të zvogëluar një sipërfaqe të vogël toke, hartë e shkallëzuar; vizatim që paraqet në përmasa zakonisht të zvogëluara pamjen nga një anë ose prerjen sipas një rrafshi të një sendi, të një ndërtese, të një pajisjeje etj., që do të ndërtohet a do të prodhohet; skicë. Plan topografik. Plani i qytetit. Plani i ndërtesës. Plani i bibliotekës. Plani i vendit. Shkalla e planit. Zbatoj planin.

2. Tërësi masash të menduara e të caktuara që më parë, që parashikojnë ecurinë a mënyrën e zhvillimit të një pune a veprimtarie, vëllimin e afatet e saj etj. Plani i punës. Plani i mbjelljeve (i ndërtimeve). Plani i punës edukative. Plani i stërvitjes. Punë me (pa) plan. Punojnë (ecin) me plan. Bën plane në hava. keq., bised.

3. ek. Tërësia e detyrave, e treguesve dhe e mjeteve për plotësimin e tyre, që përcaktohen a përllogariten që më parë për zhvillimin e harmonishëm e përpjesëtimor të ekonomisë e të kulturës gjatë një periudhe të caktuar në shoqërinë socialiste; dokumenti ku janë shënuar këto detyra e masa. Plani vjetor (tremujor, mujor). Plani perspektiv plani për disa vjet në të ardhmen. Plani i parë (i dytë, ... i gjashtë) pesëvjeçar. Plan ekonomik (financiar). Plan shtetëror. Plan shkençor. Plan real (mobilizues, i guximshëm). Plani i shtetit. Plani i prodhimit (i shpërndarjes). Treguesit e planit. Dega (zyra) e planit. Komisioni i Planit të Shtetit. Hartimi i planit. Ekonomi pa plan. Shtroj (diskutoj) një plan. Miratoj planin. E plotësuan (e tejkaluan) planin. E mbyllën planin. Prodhojnë mbi planin.

4. Përmbledhje paraprake e një mësimi, e një studimi etj., e cila përmban pikat ose vijat kryesore, ecurinë e shtjellimit

a të hartimit etj.; skicë. Plani i orës së mësimit. Plani i hartimit. Plani i copës së leximit. Pikat e planit. Bëj planin.

5. fig. Qëllimi a synimi që duam të arrijmë dhe që e parashikojmë që më parë.

Plan i guximshëm. Planet mashtruese (grabitqare, djallëzore) të armikut. Plane të errëta. Thuri (kurdisi) plane të reja. Ia prishën planet. S'i doli plani.

6. Fusha e veprimtarisë ose lëmi i shfaqjes së diçkaje; mënyra e shqyrtimit të diçkaje, drejtimi a këndi me të cilin e shohim; rrafsh (zakonisht në tog me parafjalën në). Në planin ekonomik (politik, ideologjik, teorik, moral, shoqëror).

Në plan të brendshëm (të jashtëm). Në planin kombëtar (ndërkombëtar, botëror).

Në planin kohor (historik). Del në dy plane.

7. Vendndodhja e një sendi a e një objekti lidhur me largësinë e tij nga shikuesi. Vinte më prapa, në plan të dytë. Janë në një plan.

8. fig. Vendi që zë dikush a diçka sipas rëndësisë që ka (kryes. me një numëror rreshtor). E nxori në plan të parë. E vuri në plan të dytë. Kalon në plan të fundit.

9. gjeom. Rrafsh. Plan i pjerrët (pingul, horizontal). Plane paralele. Plani i meridianit. Plani i ekuatorit. Drejtëzat e një plani.

* Kam në plan mendoj, kam parashikuar. Kam vënë në plan kam ndërmend, mendoj, synoj. I vë në plan libr. i quaj njësoj, i barazoj dy a më shumë njerëz, sende etj.

PLAN II m. Zdrukth i madh që përdoret për të rrafshuar faqen e parë të dërrasës, zdrukth për drejtim. Sheshoj me plan.

PLENG I m. 1. Send i rëndë.

2. përd. ndajf. Si plumb. Më ra buka pleng në bark.

PLENG II m. krahin. Dhunë, turp.

PLENG III m. krahin. 1. Kunj për të varur diçka.

2. Rrip pëlhure të hollë etj. që përdoret për të lidhur plagët.

PLËNG I m. bised. 1. Pasuri, mall. Plëngu i shtëpisë. Ishte pa plëng e pa shtëpi s'kishte asgjë, ishte shumë i varfër. Linin plëng në shtëpi e shkonin në kurbet. Rronte pa plëng e pa shtëpi rronte duke bredhur rrugëve. Me lëng e me plëng shih te **LËNG**, ~U 5.

2. Vatra familjare, gjiri i familjes. Iku nga plëngu.

PLËNG II m. bised. Malli e dashuria që ndiejmë për dikë a për diçka. Me plëng në zemër.

* Më mbeti plëng kam shumë mall e merak për dikë.

PLIS I m. 1. Copë e madhe dheu, që ngre plugu kur çan tokën; copë e tillë dheu me bar, e prerë me bel a me ndonjë mjet tjetër. Plisat e arës. Plis me bar. Thyen (shtyp, vret) plisat. I veshën anët e rrugës me plisa.

2. përd. ndajf. Si plëndës, pa lëvizur; si lëmsh, shuk. Ra plis në tokë. Më ra buka plis në stomak më ra buka si gur në stomak e më rëndoi shumë. Mbeti plis përdhe.

3. përd. ndajf. Plot, mizë. U mbush sheshi plis me nxënës.

4. përd. ndajf. Shumë (me mbiemrin i rëndë). Ishte plis i rëndë (i rëndë plis).

* Si breshka nëpër plisa shih te **BRESHK/Ë**, ~A. Nuk rri iriqi në plis fj. u. njeriu dëshiron të jetë gjithnjë i lirë, nuk i pëlqen zogut kafazi. Nuk zihet (nuk mbulohet) dielli me plisa fj. u. shih te **DIELL**, ~I.

PLIS II m. 1. Lloj cohe, që bëhet me lesh delesh të shkelur disa herë, duke e lagur me ujë të vakët e duke e fërkuar me sapun derisa të thahet e të forcohet; një cohë e tillë që përdoret si plaf. Shtroi plisin. Bënte plisa. Flinte (shtrihej) në plis.

2. Kësulë e bërë prej kësaj cohe, e cila sipër vjen zakonisht e rumbullakët si kupë; qeleshe. Plis i bardhë.

3. Copë prej cohe të tillë ose copë thesi e mbushur me kashtë thekre si jastëk, e cila vihet nën samar që të mos vritet kafsha në kurriz; një copë cohe prej leshi, prej thesi a prej lëkure, që i vihet kaut në qafë që të mos e vrasë zgjedha, qafëz.

4. Lëmyshk që zënë drurët, zakonisht nga ana e veriut.

PLLANGË I f. Njollë. Pllangë e zezë (e bardhë). Pllanga gjaku. Lopë me pllangë të bardhë në ballë.

PLLANGË II f. 1. Tra mbështetës, që i vihet një muri a një shtylle për ta mbajtur. I vuri një pllangë.

2. Levë që shërben për të shkukur gurë të mëdhenj; druri që përdoret për të lëshuar gurin e poshtëm të mullirit. E lëshoi me pllangë.

PO I lidh. 1. Përdoret për të lidhur dy fjali të bashkërenditura me marrëdhënie të ndryshme kundërshtore ose dy gjymtyrë të njëjta të një fjalie me marrëdhënie kundërshtore a kufizuese; por. Dukej i vogël, po ishte i rëndë. Lirinë s'jua solla unë, po e gjeta këtu në mes tuaj. Donte të vinte, po s'e lanë. Dua të fle, po nuk më flihet.

2. Përdoret për të lidhur dy fjali ose dy pjesë fjalie, njëra prej të cilave e plotëson a e zhvillon më tej atë që thuhet në tjetrën; por. Ai do të vijë, po pak më vonë. Gruri mbin edhe në lagështirë, po (mbin) me vështirësi. Hëngri, po me masë. Iu kujtua, po me vonesë. E ndihmonte vërtet, po pa qejf.

3. Përdoret, zakonisht së bashku me fjalët «megjithatë», «ende», «përkundrazi», për të përforcuar a për të theksuar më shumë kundërvënien; por. Vështirësitë qenë të mëdha, po megjithatë nuk e thyen. E kishte dëshiruar prej kohësh, po ende (megjithatë) s'e kishte arritur.

4. Përdoret, zakonisht me një ndajfolje kohe ose me një fjalë tjetër që tregon kohë, për të lidhur dy fjali a dy pjesë të një fjalie, njëra nga të cilat (e dyta)

shënon një gjendje ose një kohë të re, jo siç ishte parashikuar, kur kryhet veprimi i së pares; por. Arritëm, po kur gjithçka kishte marrë fund. Puna u krye, po një ditë më pas. Do të dalim, po kur të pushojë shiu. Ia solli, po kur ai s'kishte më nevojë.

5. Përdoret së bashku me lidhëzat «edhe», «as» në bashkëvajtje me shprehjet lidhëzore «jo vetëm..., jo vetëm që ..., le që...» për të formuar shprehje lidhëzore bashkërenditëse të shkallëzimit (jo që..., po; jo veç, po; jo vetëm që ..., po edhe; jo vetëm (veç) që ..., po as ...; jo vetëm..., po edhe; le që... po; le që... po as (që); le që...,po edhe). Jo vetëm që e ndërjuan shpejt, po e bënë edhe të bukur. Le që s'e kupton, po as përpiqet më shumë.

6. Përdoret në fillim të një fjalie të pavarur që shpreh një kundërshtim ndaj fjalisë së mëparshme; por. Po vetë e kërkoi. Po unë s'i thashë gjë. Po asnjë s'u ngrit. Po as që kanë për ta pritur.

7. Përdoret në fillim të një fjalie të varur kushtore, që tregon kushtin për realizimin e veprimit të shprehur nga fjalia drejtuese; në qoftë se. Po të kem kohë, do të vij. Po të pëlqeu, mbaje. Po e mbarove librin, sille. Po të kishe nxituar edhe ca, do ta kishe arritur trenin. Po s'punove, s'fiton. Po s'luajte këmbët, s'luan (as) dhëmbët. fj. u.

Po s'hëngre hudhra, s'bie erë. fj. u.

8. Përdoret në disa shprehje lidhëzore me kuptim kushtor (po qe se; po qe që; po të jetë se; po të jetë që). Po qe se e gjen, i thuaj se e kërkoi. Po të jetë e vërtetë, njofto edhe të tjerët.

9. Përdoret në fillim të një fjalie me kup-time të ndryshme e me ngjyrimë dëshire, urdhri, pyetjeje, habie, pakënaqësie etj. Eh, po të vinte! Po çelësin që e harrova! Erdhëm, po ç'e do, u lodhëm. Po nesër ç'do të bëjmë? Po ky djalë që s'vuri mend!

* Po deshe të lutem, në mundsh.

PO II pj. 1. Përdoret me vlerën e një fjalie, kur pranojmë a kur miratojmë diçka, kur

pajtohemi me atë që thuhet etj.; kund. jo. - Do të shkosh? -! Po. -E kuptove? - Po. Disa po, disa jo. Thotë po e pranon, nuk kundërshton. S' thotë as po as jo nuk vendos. Po apo jo? Po dhe jo.

2. Përdoret kur përforcojmë diçka që është thënë më parë, me kuptimin «patjetër, sigurisht, s'ka dyshim, vërtet»; kund. jo. Po, do të vijë. Po, do ta marr atë. Po, e mirë është. Po, s'ka dyshim që do ta bëjmë. Po, patjetër që do të nisemi.

3. Përdoret para a pas një fjale për të përforcuar kuptimin e saj duke e përsëritur urdhrin, përgjigjen, miratimin etj.; kund. jo. E shikon atë majën e malit? - E shikoj, po. Mua më kërkoi? - Ty, po. E gjeti, po. Po, nisul! Fol, po, ç'pret! E marrim, po, e marrim.

4. Përdoret kur tregojmë diçka, kur përfundojmë një bisedë a përmbyllim një mendim, me kuptimin «kështu, pra, është e vërtetë». Po ja, kështu ndodhi. Po, i tillë ishte ai. Po, ç' do gjë kapërcehet.

5. Përdoret kur gjatë të folurit kujtojmë papritur atë që është thënë më parë ose kur na kujtohet diçka tjetër. Po, m'u kujtua. Po vërtet, ishin dy. Po, ashtu ishte. Ku e patëm fjalën? Ah po, te gazeta e sotme.

6. Përdoret zakonisht në krye të fjalisë për t'i tërhequr vëmendjen bashkëbiseduesit që ai të ndalet e të mendojë më mirë për diçka. Po, ta thashë që ta shohësh edhe njëherë. Po, për të mirën tënde e kam.

7. Përdoret, edhe e shoqëruar me pasthirmë, për të shprehur habi, mosbesim, mospërfillje, qesëndi, përçmim, pakënaqësi etj. Po more, e ditke ti! Po moj, vërtet thua?! Pooo, dashke edhe më! Pooo, s'i pëlqyeka atij!

8. Përdoret në fjalitë pyetëse kur duam të përforcojmë e të mbështetim pyetjen.

Po si je? Po ç'të bëjmë sipas teje? Po sa vetë ishin? Po kush ta tha?

9. bised. Përdoret në fund të një fjalie pyetëse me ngjyrim dyshimi për të përsëritur pyetjen ose për të nxjerrë atë që kërkohet nëpërmjet përgjigjes së bashkëbiseduesit, me kuptimin «apo jo?». Ti do të vish, po? Do ta lexosh librin, po? Ti je me ne, po?

Ai mbeti i kënaqur, po?

10. Përdoret për të theksuar se është fjala për të njëjtin njeri, send etj.; pikërisht; krejt; gjithashtu. Po ai njeri. Po ajo gjë. Gjithnjë po kështu. Po atë ditë erdhi dhe ai. Po në të njëjtën mënyrë. Bathë, bathë, po një kokërr të njëjtën gjë përsërit, aty mbeti.

11. Përdoret përpara foljeve në kohën e tashme dhe në të pakryerën e mënyrës dëftore, nganjëherë edhe të mënyrës habitore, kur shprehim veprime që zgjatin, që janë duke u shtjelluar në çastin e ligjërimit ose në të njëjtin çast me një veprim tjetër. Po shkruaj. Po bie shi. Po perëndonte dielli. Po dilte kur hyra unë. Po mbushet viti që nga ajo ditë. Po i pëlqyeka shumë. Po e merr me të qeshur.

12. si em. ~, ~JA f. ~, ~TË. Pohim; miratim, pranim. Bëri «po» me kokë. Shqiptoi një po nëpër dhëmbë. Ponë e ka po.

* E po... përdoret kur duam të kundërshtojmë lehtë e me kujdes, kur duam të përmbyllim një mendim, kur duam të arsyetojmë për diçka ose kur pajtohemi më në fund me diçka. Po e po... (po se po...; po që po...) përdoret kur folësi dëshiron të miratojë a të vërtetojë diçka me forcë.

POÇAR I m. Ai që bën poçe a enë të tjera prej balte; vegshar, vorbar. Çarku i poçarit.

POÇAR II m. Qyp i vogël balte me një dorezë, që përdoret për të mbajtur ujë etj. e për të hedhur ujë për t'u larë. Mbushi poçarin. Hidhte ujë me poçar.

POL I m. 1. gjeogr. Secili nga dy skajet e boshtit të përfytyruar të Tokës, që mendohen si pika të palëvizshme gjatë rrotullimit të rruzullit rreth vetes; vendi a

zona rreth këtyre pikave. Poli Verior (i Veriut). Poli Jugor (i Jugut). Zonat e poleve. Jeta në pol.

2. astr. Çdonjëri nga dy skajet e boshtit të përfytyruar në sferën qiellore, rreth të cilit duket sikur rrotullohen yjet gjatë njëzet e katër orëve. Poli i Veriut. Poli i Jugut.

3. fiz. Secili nga dy skajet e kundërta të një qarku elektrik, që kanë rrymë me shenjë të kundërt; secili nga fundet e një magneti, të një elektromagneti ose të gjilpërës magnetike. Pol pozitiv (negativ). Polet e burimit pika ku burimi lidhet me qarkun e jashtëm. Polet e magnetit.

4. spec. Secila nga dy anët e diçkaje, që kanë veti të kundërta; pika më e fundit e qëndrimit të diçkaje. Poli i të ftohtit (i të nxehtit). Poli i thatësisë.

5. fig. libr. Ana krejt e kundërt e diçkaje; diçka që ndodhet në kundërvënie me një tjetër. Dy polet e shoqërisë borgjeze.

* Pol gjeografik gjeogr. vendi ku bashkohen meridianët. Pol magnetik pikë afër Polit të Veriut ose të Jugut, drejt së cilës kthehet gjilpëra e busullës.

POL II m. krahin. 1. Kind. Polat e fustanit. Fund me pola.

2. Fletë. Polat e qilimit. Qilim me dy pola.

POL III m. Thith, çivi dere. Pola dyersh.

POR I m. libr. kryes. 1. Vrima shumë të imëta në lëkurën e njeriut ose të kafshëve; vrima shumë të vogla në diçka. Poret e lëkurës. Poret e guaskës së vezës. Trup me pore. Hapen (lirohen) poret.

2. fig. Vrimë, hapësirë shumë e vogël; pjesë përbërëse e diçkaje; qelizë. Poret e jetës. Poret e shoqërisë.

POR II m. Hallkë e hekurt që i vihet boshtit të rrotave të qerres.

POR III m. Sobë, stufë.

POSTË I f. 1. Institucion zyrtar, që merret me dërgimin e letrave, të gazetave

e të revistave, të pakove, të të hollave etj. nga një vend në një tjetër dhe me shpërndarjen e tyre; ndërtesa e këtij institucioni. Posta qendrore. Posta dhe telegrafi. Posta e qytetit (e lagjes). Zyrat e postës. Nëpunësit e postës. E dërgoi me postë.

2. Dërgesa (letrat, pakot etj.) që çohet a shpërndahet nëpërmjet këtij institucioni; tërësia e letrave, e pakove etj. që shpërndahen njëherësh, dërgesa e radhës. Postë e shpejtë. Postë ajrore. Posta e parë. Posta e mbrëmjes. Pullë poste. Shpërndarësit e postës. Kutia e postës. Çon (merr) postën. Erdhi posta.

* Iu qep (iu ngjit, iu bë) si pullë poste dikujt shih te PULL/Ë, ~A.

POSTË II f. usht. Vend i posaçëm ku qëndron një njësi e vogël ushtarake, që është caktuar për të vëzhguar dhe për të ruajtur; ushtarakët e kësaj njësie; ndërtesa ku banojnë ata. Postë kufitare (ushtarake). Postë e fortifikuar. Postë policie. Postë vrojtimi (vëzhgimi). Komandanti i postës. Vendosën një postë të re. Sulmuan (shkatërruan) një postë armike. E çuan në postë.

PRAJ I jokal. krahin. Pushoj, resht, ndaloj; hesht. Prajti era (shiu, breshri, bora). S'e pran të qarët. Prajti pushka. Nuk e prajtëm luftën. Prajti pak pas punës.

PRAJ II kal. bised. I ngjit sëmundjen dikujt, e moleps.

PRAJË I f. Prehje, pushim.

PRAJË II f. bised. Prekja e një qenieje a e një bime nga mikrobe ose nga baktere që shkaktojnë sëmundje, infeksion. Prajë e rëndë (e lehtë). Prajë në këmbë (në dorë).

PRAPË I ndajf. 1. Nga ana e prapme; prap-tas, mbrapsht; kund. mbarë. Mbarë e prapë. E ktheu (e veshi) prapë.

2. bised. Në drejtim të kundërt me lëvizjen që ka bërë dikush a diçka, andej nga ka ardhur, prapa, prap-tas, mbrapsht. Iku prapë. E ktheu prapë. I mori fjalët prapë.

3. fig. bised. Në mënyrë të pakënaqshme, jo ashtu siç duhet; mbrapsht.

* Bën prapë bën prapësira, bën gjëra që s'lejohen (zakonisht për një fëmijë). E bëri prapë dikë ia ktheu mendjen për diçka, e bëri që ta lërë një punë, e prapë-soi. I ra vendit mbarë e prapë (mbrapsht) shih te MBARË. Folën mbart e prapë (mbrapsht) shih te MBARË. E pa mbarë e prapë shih te MBARË. E pyeti mbarë e prapë shih te MBARË. E rrahën (e shoshitën, e gjykuan) mbarë e prapë (mbrapsht) një çështje shih te MBARË.

PRAPË II ndajf. bised. 1. Përsëri, edhe një herë. Shkoi (erdhi) prapë. E pyeti prapë. E ndërtuan prapë.

E mori prapë. E pyeti prapë.

2. Ende; megjithatë, përsëri, prapësepapë. Prapë vijon me të tijën ai! Prapë me të vjetrën. S'e dëgjoi mirë, po prapë e kuptoi si qe puna.

PRASHITËSE I f. Fem. e PRASHITËS, ~I. Një nga prashitëset më të mira.

PRASHITËSE II f. 1. Makinë prashitëse. Prashitëse orizi. Shkrifëron tokën me prashitëse.

2. Bimë që duhen prashitur. Pas prashitëseve mbollën grurë.

PREKË I f. bot. Vrugu i bimëve. I ra preka grurit (misrit, duhanit, rrushit).

PREKË II f. kryes. 1. Pika të murrme a të kuqërreme që u dalin disa njerëzve zakonisht në fytyrë. Fytyrë me preka. Ka preka.

2. Gropëza a shenja që lë lija në fytyrë; quka. Preka lie.

3. fig. vjet. Njollë, damkë. Prekë e ligë.

PRES I kal. 1. Heq një pjesë nga e tëra me një përdorëse a mjet të mprehtë (me thikë, me gërshërë, me sëpatë etj.); ndaj diçka në pjesë, e bëj pjesë-pjesë me një vegël të tillë. Ia prenë degët e thata. Pres anët e letrës (e teneqesë). Pres bukën (mollën, pjeprin, mishin). Pres dru bëj

dru në pyll. Preu shiritin (kur inaugurohet një vepër) inauguroi, përuroi. Pres me thikë (me sëpatë, me gërshërë, me sharrë). Pres me dysh (me tresh). E preu thela-thela (copa-copa). E preu për së gjati (për së gjeri).

2. Shkurtoj, heq, krasit, korr, kosit, rrafshoj etj. diçka me një përdorëse a mjet të mprehtë. Preu flokët i shkurtoi ose i hoqi fare. Pres thonjtë. Pres misrin korr misrin. Prenë pyllin. E preu mollën se u tha. Ia prenë këmbën (dorën, gishtin).

Ia prenë kokën. I preu kërthizën. Prenë vreshtin e krasitën.

3. Çaj së gjati një pjesë të trupit me thikë, me brisk, me sëpatë, me sharrë etj., plagos me një mjet të tillë. Preu gishtin (dorën, këmbën). E preu pak berberi.

E preu me brisk (me xham). E ka prerë thellë.

4. bised. Ther me thikë a me një vegël tjetër të mprehtë. Preu një dele (një dash, një pulë). Ia prenë djalin nazistët.

5. Vras në masë, ther shumë vetë; shfaros me shumicë, grij. Armiqtë vranë e prenë pleq, gra e fëmijë. E prenë armikun në qafë të malit. E prenë bletën e mbytën bletën për t'i marrë mjaltin. Ia preu lia pulat. E preftë murtaja (kolera, e zeza, mortja)! mallk.

6. jokal. vet. veta III. Është i mprehtë, mund të ndajë lehtë një pjesë nga e tëra, të çajë diçka etj. (për thikën, gërshërën, sëpatën etj.). Thika (sëpata) nuk priste mirë.

Ky brisk nuk pret. Sharra priste shumë.

7. E çaj me diçka të mprehtë; vet. veta III hyn në mish dhe e çan si me thikë; futet diku dhe e çan. I ka prerë këmbët nëpër truskë. I preu gishtin një gjethe (një rrasë e hollë, një xham). M'i preu spangoja duart. E ka prerë litari. E preu me dhëmbë.

8. Ndjaj me gërshërë një copë stofi, basme etj. Në pjesë sipas përmasave të trupit kur qep një kostum, një fustan etj.; qep një petk të ri. Pres një kostum (një

pallto, një palë pantallona, një fustan, një këmbë. Di të presë e të qepë.

9. Caktoj a shënoj me përpikëri kufijtë e diçkaje, i vë shenjë kufiri; e ndaj a e bëj diçka sipas një forme, një kallëpi etj. Prenë themelet e ndërtesës. Presin tulla (tjegulla). Pres me vija.

10. Ndaj me diçka, e bëj në pjesë; vet. veta III e takon dhe e ndan më dysh, më tresh etj. E preu me një vijë. E preu arën me katërsh me hendek. Lumi e pret fushën më dysh. E pret pak në cepa. Vija AB pret vijën CD. gjeom.

11. Prodhoj e nxjerr në qarkullim një monedhë të re (zakonisht të metaltë).

Këtë monedhë e kanë prerë ardianët.

12. Marr një biletë, një faturë etj. kundrejt një pagese; marr një dokument për një porosi a për diçka tjetër. Premë bileta për teatër. Preu fletëdaljen (fletëporosinë, faturën).

13. Kapërcej rrugën kryq përpara dikujt; i dal përpara dikujt në rrugë dhe e pengoj të shkojë më tej; i zë udhën, e ndaloj ose i ndërroj drejtimin; kthej.

Na preu rrugën një gjarpër. U pres ballin deleve i kthej në një drejtim tjetër.

Prite kalin (dhinë) se iku!

14. edhe jokal. bised. Kaloj drejt e mes për mes një hapësire nga bie më shkurt; i bie, shkoj; kthej; bie. Prenë djathtas (majtas). Prenë në një rrugë anësore. Preu përmes arave (fushës, pylit). E preu timonin majtas (djathtas). Pret shkurt (gjatë) rruga andej.

15. fig. Them diçka shpejt dhe në mënyrë të vendosur; i përgjigjem menjëherë e shkurt për të mos e lënë dikë të flasë a të vijojë më tej. S'është ashtu - ia preu tjetri. Ia preu shkurt (ashpër). Ia preu aty për aty. Ma preu më tha fjalën e fundit, më tha mendimin e tij të pandryshueshëm.

16. fig. bised. Caktoj diçka përfundimisht (një çmim, një dënim, një afat etj.); vendos, e ndaj mendjen. Nuk ia

preu çmimin (pazarin). Prenë ditën e dasmës.

Nuk e ka prerë ç'zanat do të marrë. E prenë të niseshin bashkë.

17. vet. veta III (me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor në r. kallëzore) fig.

Më than, më ngrin; më hyn deri në palcë. Më preu era. Na preu të ftohtët (acari, dimri). Të pret veriu (thëllimi).

18. jokal. vet. veta III (me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor në r. dhanore) fig.

Më dhemb shumë, më ther, më sëmbon (një pjesë e trupit). Më pret barku.

Më pret në shpatull.

19. fig. Ndaloj diçka që kam nisur, e lë, ndërpres punën e dikujt a të diçkaje; nuk e lë të vijojë tutje, e ndal, ndërpres. E preu duhanin (rakinë) e la, nuk e pi më.

I prenë punimet. E preu këngën (bisedën, punën, lojën). I prenë shakatë. Na e prenë ndihmën. U prenë ujin (dritën). Ia preu gjakun. I pritnin rrogën (bukën).

Ia preu sisën foshnjës. Ia preu fjalën (në mes) nuk e la të fliste më; e ndërpreu kur fliste. E preu shoqërinë me të. I prenë marrëdhëniet.

20. fig. (me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor në r. kallëzore). E dobësoj a e pakësoj diçka; ia ul ose ia ndal forcën, vrullin etj.; shkurtoj, këput. Ia preu vrullin (hovin). Ia preu vrapin. Ma preu fuqinë. Ia preu oreksin. M'i preu këmbët (gjunjët, krahët, duart). Na preu e përpjeta na lodhi shumë, na këputi. E preu vdekja e djalit (ai lajm i hidhur). Ai bar ua pret qumështin bagëtive.

21. I shtie supës diçka zakonisht të thartë për ta përgatitur lëngun sipas një mënyre të veçantë; i hedh qumështit, hurrës etj. tharm ose diçka tjetër për ta mpiksuar; mpiks. E preu qumështin djathë (gjizë). E preu supën me limon (me vezë). Preu pekmezin.

22. fig. Nuk e mbaj fjalën a besën që i kam dhënë dikujt; e tradhtoj dikë, i dal i

pabesë, e lë në baltë. E preu në besë nuk ia mbajti besën e dhënë. E preu në fjalë nuk e mbajti fjalën, e gënjeu.

23. edhe jokal. fig. bised. Kap, kuptoj; mendoj, e marr me mend. Siç ma pret mua. Ashtu ma preu. Aq ia pret atij. Nuk ia pret fare. Pret hollë. Nuk ia pret mendja. S'ia pret mendja (koka, fiqiri, poçi) edhe poh. Nuk ma priste mendja se...

24. fig. bised. (me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor në r. kallëzore). Kam shumë nevojë për dikë a dëshirë për diçka, këputem për të; s'duroj dot pa të, e dua shumë; kam nevojë të ngutshme për të bërë diçka, mezi duroj, s'më durohet. E preu për gjumë i flihet shumë. Më preu për bukë (për të ngrënë) më hahet shumë. Nuk më preu për atë njeri nuk kam mall për atë njeri, aq më bën për të. E preu uria. E preu ujët e hollë.

25. Ia marr këngës pas këngëtarit të parë me zë plotësues, ia kthej me zë të dytë. Njëri ia merr e tjetri ia pret. Ia priste bukur.

* I preu bishtin dikujt ia hoqi gjërat e tepërta që ka e nuk i meriton. Ia preu me brisk shih te BRIS/K, ~KU. Ia preu me cakorre dikujt shih te CAKORR/E, ~JA.

E preva derën e dikujt nuk shkoj më te dikush. Ia preu derën d i k u j t nuk e lë të hyjë e të dalë diku, ia mbylli hyrjen; nuk e qas më në shtëpi. Ia preu (ia shkurtoi) dorën (duart) dikujt shih te DOR/Ë, ~A. I preu (i shkurtoi, i thau) duart (dorën, krahët) shih te DOR/Ë, ~A. I ka prerë një gërshërë (janë prerë me një gërshërë) shih te GËRSHËR/Ë, ~A. Ia prenë gëzofin shih te GËZOF, ~I. E preu gojën dikush

a) është në agoni, po vdes e nuk flet dot;
b) nuk flet më; nuk kërkon dot më asgjë.

Preu gozhdë (thumba) mërdhiu shumë, ngriu së ftohti. Ia preu me hanxhar shih te HANXHAR, ~I. Sikur i ka prerë kërthizën shih te KËRTHIZ/Ë, ~A. E pres kokën! e them me bindje të plotë

diçka, jam shumë i sigurt. I ka prerë kokën dikujt i ka ngjarë krejtësisht, është gjallë ai. I preu (i këputi) lakun dikujt shih te LAK, ~U. Pret (vret) larg shih te LARG. Ia preu litarin dikujt shih te LITAR, ~I. E preu malli (barku) për dikë a për diçka! iron. nuk e merr malli për të, as që do ta shohë me sy. Ta pret mendja! sigurisht, natyrisht, vetëkuptohet. I pret edhe myka shih te MYK/Ë, ~A. Ia preu orën (ditën, jetën) dikujt e vrau, e vdiq. Pret perin dikush është shumë i hollë nga mendja, është shumë i zgjuar e i mprehtë. Pret e qep dikush ç'thotë ai bëhet, ka në dorë edhe gurin edhe arrën. Ia pres rrënjët diçkaje e zhdruk me rrënjë diçka në mënyrë të tillë që të mos shfaqet më. Pres (shkul, përmbys) nga rrënjët (me rrënjë) shih te RRËNJ/Ë, ~A. I pres rrugën (udhën, shtegun) diçkaje marr masa që më parë që të mos ndodhë a të mos zhvillohet më, ia mbyll shtegun, e ndaloj. Ia preu (i ra) me sëpatë shih te SËPAT/Ë, ~A. I ka prerë një sharrë shih te SHARR/Ë, ~A. E pres (e ndaj) me thikë diçka shih te THIK/Ë, ~A. Ia preu thonjtë dikujt shih te THUA, THOI. Ia preu veshët dikujt e bëri që të mos mbahet më të madh, ia uli hundën, e bëri që t'i bien pendët. Ta pret xhokën dikush të bën zap, ta mbledh, t'i fut të dyja këmbët në një këpucë. Vriste e priste shih te VRAS. Gjuha pret hekurin (çan gurin, çan shkëmbin) fj. u. shih te GJUH/Ë, ~A. I preu drutë shkurt me dikë shih te SHKURT. I pret me dy teha dikujt shih tek TEH, ~U. I pret gjuha (goja) brisk (gozhdë, hekur) flet rrjedhshëm dhe me mprehtësi; ta jep përgjigjen menjëherë; është shumë i zgjuar. Preje (shkurtoje) gjuhën! shih te SHKURTOJ. Është për t'i prerë (për t'i rrëmbyer) kokën shih te RRËMBEJ. Është «pre e mos kosit» flet shumë dhe vend e pa vend, flet kot. Pre mish e ha shih te MISH, ~I. S'ia pret njeri qi-men (perin) është i zoti e i zgjuar, nuk mund t'ia hedhë dot njeri, s'e mashtron dot. Ka prerë para të madhe dikush ka

fituar shumë para.

Ia preu thekun gruas vjet. shih te THEK, ~U I. I priste shpata (palla, kordha, jatagani, sëpata) djathtas e majtas (nga të dyja anët) fliste e vepronte si donte vetë, s'pyeste për të tjerët. Nga një anë të puth, nga tjetra të pret keq. shtihet si i mirë, por s'është i tillë, të vret natën e të qan ditën, është njeri me dy faqe. Preje për vete e vishma mual mendo edhe për të tjerët si për vete. Mat tri (shtatë, dhjetë) herë e pre një herë! fj. u. shih te MAT.

PRES II kal. 1. edhe jokal. Rri në një vend për një kohë derisa të vijë dikush, të ndodhë diçka, të mbarojë një punë etj. Pres autobusin (trenin). Pres të më vijë radha. E prita gjithë pasditen. Të pres në shtëpi (në orën nëntë). Pret gjahun. Pret në radhë. Pres me padurim. Priti dy orë. Pritmë pak, se erdha! Ke kohë që po pret? Priti shumë (deri në darkë). S'mund të pres më (më gjatë). Më fal, se të bëra të presësh! Pres të pushojë shiu. Priti sa prit, pastaj iku. U lodh (u mërzit) duke pritur. Më doli mjekra duke pritur.

2. vet. veta III. Është gati për dikë a për diçka, mund të përdoret, të fillohet etj.; kërkon, do punën a dorën tonë, është për t'u nisur, për t'u bërë etj. Po ju pret dreka. Një veturë po e priste përjashta. Po vajti ora, treni s'të pret. Ajo punë pret zgjidhje. Detyra të mëdha na presin.

3. Ruaj, përgjoj; gjej; rri gati për të vepruar. Pret rastin (çastin) e volitshëm. Pret fjalën e tij. Pret ditën (orën, kohën) kur... Presim urdhrin e komandantit.

Pres njoftimin.

4. Besoj se do të vijë dikush ose se do të ndodhë diçka, e quaj të mundshme; e dëshiroj të vijë a të ndodhë; shpresoj të kem diçka; parashikoj, mendoj, kujtoj. Pres letër (përgjigje, fjalë) nga vël-lai. Ajo pret fëmijë do të lindë së shpejti. Ata presin që unë të kthehem sot. Ai pret ndihmë nga ne. I binim armikut aty ku nuk e priste. S'e prisja këtë prej teje!

E ç'pret prej tij?! Mos prit gjë (ndonjë të mirë) prej tij. Atdheu pret shumë nga ne. Prisja tjetër gjë. Ç'prisja e ç'më doli! Diçka pret. Prisin shumë nga jeta.

5. Kam përpara diçka që do të ndodhë patjetër dhe përgatitem për të; jam përpara diçkaje që do të vijë. E presim festën (kongresin) duarplot. E prisja këtë. Na pret e ardhmja e sigurt. Tradhtarët i pret plumbi.

6. edhe jokal. Bëj durim, duroj; lë të kalojë një kohë para se të bëj diçka, të marr një vendim etj. Do të presësh ca, se puna nuk zgjidhet menjëherë. Presim edhe pak para se të vendosim! Priti sa prit, pastaj doli.

7. E rrok me dorë ose me një gjë tjetër dikë a diçka që vjen drejt meje, e kap diçka që më hidhet. Trill topin (mollën). Prite, se e hodha! E prit në prehër (me çarçaf).

E prit me një dorë.

8. Pranoj dikë për vizitë; pranoj një shok, një mik a të ftuar në shtëpi; gëzohem kur më vjen dikush në shtëpi dhe e mbaj mirë, e gostit me të gjitha ç'kam. Është njeri që të pret është mikpritës. Shtëpi që pret miq. Na pritën mirë. Të pret me buzë në gaz (me dashamirësi, krahëhapur). Pret e përcjell është shumë mikpritës; i vijnë shumë miq në shtëpi, ka shumë hyrje e dalje.

9. Dal në mënyrë të organizuar në vendin ku do të arrijë dikush për ta përsëndetur a për t'i uruar mirëseardhjen. Populli pritit delegatët e kongresit.

10. I gjendem pranë dikujt, rri afër për t'i ardhur në ndihmë. Fëmijën e pritit mamia.

11. I dal përpara dikujt që nisat drejt meje, i bëj pritë. Armiqhtë i presim me pushkë.

12. E pranoj dikë për të zhvilluar bisedime, e lejoj të hyjë në zyrë për një punë, për ndonjë kërkesë etj.; takohem me dikë; e lejoj dikë të vijë të më takojë e të flasë me mua. Në ç'orë pret drejtori?

13. Shpreh qëndrimin e mendimin tim për dikë a për diçka; i përgjigjem aty për aty (me fjalë, me veprime etj.) duke shprehur mendimin e qëndrimin tim për diçka.

E pritën mirë ardhjen e tij. E pritë mirë (keq) kritikën.

14. përd. pj. Dale. Prit ta shoh! Prit se s'e mora vesh. Prit t'ia tregoj.

* I pret ditën dikujt e ruan ta zërë ngushtë, i ruan rastin që ta ketë në dorë. E pritë me hundë (me turinj, me hundë e buzë) shih te HUND/Ë,~A. Pa pritë e pa kujtuar menjëherë; papandehur. Prit të presim! thuhet kur dikush rri gjatë duke pritë. Nuk vepron a nuk lëviz ose e bën diçka me ngadalësi të madhe. Nuk më pret puna (koha) nuk kam kohë e mundësi; ngutem, shpejtoj. E pritë me këmbët e para shih te KËMB/Ë,~A. S'ia pret luga lugën shi te LUG/Ë,~A. Kape laro, prite balo! tall. shih te LARO,~JA. Njëri ia thotë e tjetri ia pret shih te THEM. Prit gomar të mbijë bar! shih te GOMAR,~I. Presin të ngordhë gomari (kali) që të marrin potkonjtë përb. shih te GOMAR, ~I.

PRESË I f. 1. Pjesa e metaltë e briskut, e thikës, e shpatës etj. pa dorezën; ana e mprehtë e thikës, e sëpatës a e një mjeti tjetër prerës, pjesa që pret, ten. Presë e mprehtë. Presë e thikës (e briskut, e sëpatës, e kosës, e bajonetës). Thikë me dy presa.

2. fig. Goditje kryesore, ana më e mprehtë dhe më e rëndësishme e diçkaje; teh. Presa e luftës. E drejtoi presën e fjalimit nga...

3. Vendi ku ndahet uji i kanalit a i vijës për të ujitur arën; secila nga vijat e vogla që të çojnë ujin nëpër hullitë e një are; hulli e hapur tërthorazi me plug në një arë për t'u prerë rrugën ujërave. Ndan presën. Ujit me presa.

4. Ledh me gurë a cfrat në një lumë për t'u prerë rrugën peshqve.

* Është (qëndron) në presë (në teh) të briskut (të thikës, të shpatës) shih

te TEH,~U. Është thikë (presë) me dy presa shih te THIKË,~A.

PRESË II f. tek. Makinë e posaçme që shërben për të përpunuar diçka ose për t'i dhënë formë me anë të shtypjes. Presë horizontale. Presë mekanike (hidraulike). E futi (e vuri) në presë.

PRESJE I f. 1. bot. Bimë barishtore shumëvjeçare gjithnjë e gjelbër, me kërcell të drejtë deri në dy metra të lartë, me gjethe të ngushta si të preshit, me anë të mprehta e të dhëmbëzuara si sharrë dhe me lulesë të gjatë, që rritet nëpër kënetat. Korrin presjet. Presja ta pret dorën si brisk.

2. shih PRES/Ë,~A I 3.

3. vjet. Vrasje mizore me thikë a me sëpatë.

PRESJE II f. gjuh. Shenjë pikësimi (,) që tregon një pushim të shkurtër dhe ndan një fjalë, një grup fjalësh ose një a më shumë fjali. Përdorimi i presjes. Vë presjen.

* Nuk luaj (nuk ndryshoj) asnjë presje nuk bëj asnjë ndryshim në atë që kam shkruar; nuk e ndryshoj fare qëndrimin tim. Nuk ndryshon në asnjë presje nuk ndryshon aspak, është njësoj me dikë a me diçka tjetër.

PREVË I f. mit. Vitore.

PREVË II f. krahin. 1. Udhë shumë e rrahur; xhade; vend kalimi. E kishte shtëpinë në prevë e kishte shtëpinë buzë udhës, në vend të dukshëm.

2. Lumë i vogël e i cekët, she; va lumi. Preva e lumit. Kërkon të zërë peshk në prevë bën një punë të padobishme, mundohet më kot.

PRIFT I m. 1. Titulli fetar më i thjeshtë në kishën e krishterë; ai që mban këtë titull dhe kryen shërbesat e zakonshme fetare (në vendet ku vepron kisha e krishterë); hist. ai që kryente shërbesat fetare në një tempull (në kohën e lashtë), faltar. Prifti katolik (ortodoks). Prifti fshati. U bë (doli) prift. Ishte bërë si prift ishte pa rruar. Barku i priftit është hambar për të pirë e për të marrë.

2. letr. Mbret, plak.

* I foltë prifti (hoxha)! mallk., vjet. shih te HOXH/Ë, ~A. E këndoftë prifti (hoxha)! mallk. shih te HOXH/Ë, ~A. Ia thëntë prifti (hoxha) në vesh! mallk. shih te THEM.

E bën priftin (dhespotin, hoxhën) me barrë tall. shih te BARR/Ë, ~A. Kërcen prifti nga belaja tall. thuhet kur dikush është i detyruar të bëjë diçka nga e keqja, ngaqë s'ka se si të veprojë ndryshe. E pagoi si prifti sorrën shih te SORR/Ë, ~A. Ngrihu prift të ulet (të rrijë) hoxha! Përdoret kur ia heqim një të drejtë njërit dhe ia japim një tjetri që është njësoj me të, pa ndonjë arsye të shëndoshë e pa dobi për punën. Po e bëre prift, mos i rruaj mjekrën! thuhet kur i besojmë dikujt një punë, po nuk i japin mundësinë e nuk e përfillin; hem të vë plak, hem të rruan mjekrën.

PRIFT II m. ndër. krahin. Baballëk.

PRIJË I f. 1. Vijë e thellë që kalon përmes arës për të kulluar a për të mbledhur ujërat; hulli që bihet në arë me plug për ujitje, presë; rrëke e vogël, rrëpirë. I bënë prijat arës.

2. Pjesë toke që gjendet midis dy hullive, kurri i hullisë; lehe, vulla. Prijë me qepë. Mbolli dy prija.

3. Radhë a varg pemësh në fund të një are etj. Prijë hardhish (mollësh).

PRIJË II f. Udhëheqje. Nën prijën e tij.

PRITEM I vetv. 1. Çahem së gjati në trup me diçka të mprehtë; plagosem me thikë, me brisk, me sëpatë, me xham etj. U pre duke u rruar.

2. vet. veta III fig. bised. Pushon, ndalon, ndërpritet (për shiun, për borën etj.).

U pre uji. U pre shiu (bora). Iu pre qumështi lehonës.

3. vet. veta III fig. bised. Nuk është më; nuk vjen më. Iu pre ky zakon. U prenë miqtë.

4. vet. veta III. Prishet (për qumështin). U pre qumështi kur po ziente.

5. vet. veta III. Kryqëzohet (për rrugët). Këtu priten rrugët.

6. vet. veta III gjeom. Takohet në një pikë a në një rrafsh me një tjetër. Priten dy drejtëza (dy rrafsh).

7. vet. veta III (me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor në r. dhanore) fig. bised. Ndiej lodhje të madhe në gjymtyrët, i ndiej gjymtyrët të rraskapitura, këputem; më pakësohet menjëherë, më ikën. M'u prenë fuqitë. Iu pre zëri (goja) nuk foli dot më; shtangu; ngriu në vend. M'u prenë këmbët (leqet e këmbëve, gjunjët) s'kisha më fuqi fare, u këputa, gati sa s'më ra të fikët, s'mbahesha dot me këmbë; u trondita shumë. Iu prenë gjunjët nga e përpjeta. Kur arriti në shtëpi u pre fare.

8. vetv. veta III bised. Ndiej një dëshirë a një nevojë të madhe e të ngutshme për diçka, s'bëj dot pa të. U pre për bukë. U premë për gjumë.

9. Pës. e PRES I.

* Është prerë për dikë a për diçka është pikërisht për atë, shkojnë mirë së bashku, është shumë i përshtatshëm për dikë a për diçka. U pre në fytyrë i ndryshoi fytyra nga një tronditje e fortë. Iu pre (iu lidh) goja (gjuha, fjala) shih te LIDHEM. U pre (i ngriu, i tremb) gjaku shih te GJAK, ~U I. S'pritet lisi (druri) me një shpatë (me një të rënë të sëpatës) fj. u. shih te SËPAT/Ë, ~A.

PRITEM II 1. Pavet. e PRES II. Siç pritej. S'më pritet sa të vijë dita. Pritet kohë e mirë në dyjavorin tjetër.

2. Pës. e PRES II. U prit me duartrokitje dhe me brohoritje. U pritën nga kryetari.

PRITË I f. 1. Ledh prej dheu, prej guri, prej betoni etj. që ngrihet në vende të pjerrëta, në shtratin e një lumi, të një përroi etj. për të ndaluar vërshimin e ujit ose për të mbrojtur tokën nga gërryerja; cfrat, pendë. Pritë malore. Pritë

- dheu (betoni). Pritë me gurë (me mur, prej zhavorri). Pritat e lumit. Ndërtoi (ngriti) një pritë.
- Vendi ku ndahet uji nga vija kryesore nëpër hulli të arës, presë. Pritat e orës.
 - spec. Send a pajisje që pengon kalimin e diçkaje. Pritë ere. Prita e avujve.
 - fig. Punë ë vështirë, vështirësi; pengesë që duhet kaluar. Pritë e vështirë. E kaloi priten. I vuri pritë diçkaje e pengoi diçka.
- PRITË** II f. 1. Vend i fshehtë ku dikush rri në pritje a në përgjim për të sulmuar në befasi dikë; pusi. I zuri (i bëri, i ngriti, i vuri) pritën. I doli (i rrinte) në pritë. E futën në pritë.
Ra në pritë.
2. përmb. Grupi i njerëzve që përgjojnë në një vend të fshehtë për të sulmuar dikë në befasi. Prita partizane.
- PRUAJ** I kal. krahin. Pretoj; plaçkit.
- PRUAJ** II jokal. krahin. I bie pas një sëmundjeje duke bërë mjekime popullore etj.
- PRUAJ** III kal. krahin. Ruaj, mbroj. Pruaje nga qentë!
- PUÇ** I m. libr. Grusht shteti që organizohet në fshehtësi nga një grup i kufizuar njerëzish, të cilët nuk kanë asnjë mbështetje në popull; rrëzimi i pushtetit shtetëror dhe marrja e tij me këtë rrugë. Puç fashist (kundërrevolucionar, ushtarak). Organizojnë puçe.
U zbulua një puç. U dështoi puçi.
- PUÇ** II m. 1. Maja e kokës, but. Në puç të kokës. I dhemb puçi i kokës.
2. Maja e vezës. I përplasin vezët nga puçi.
* Janë në majë e në puç shih te MAJ/Ë, ~A.
- PULITH** I m. bot. Bimë barishtore e egër dhe e helmët, me lule të verdha e të grumbulluara në tufë, që rritet zakonisht në toka të lëna djerr dhe që përdoret në mjekësi.
- PULITH** II m. 1. Thërija e morrit të pulave; morr pule. Pulat kishin zënë pulithë. Ishte sa një pulith ishte shumë i vogël.
2. Fik i bardhë e kokërrvogël, me bisht të gjatë, që piqet vonë; cingull.
3. fig. Njeri tinëzar; mistrec.
- PUPË** I f. bised. 1. Tufë e vogël prej diçkaje; xhufkë. Pupa pambuku. Pupa bari (duhani). Fes me pupë. Shami me pupa.
2. Veshul, bistak. Pupë rrushi.
- PUPË** II f. bised. 1. Kërcim me të dyja këmbët të bashkuara. E kapërceu me dy pupa. E arriti me dy a tri pupa e arriti shpejt.
2. Mënyrë vrapimi me këmbë të bashkuara, duke hedhur në fillim dy të parat pastaj të prapmet (për kuajt). E ka lëshuar kalin në pupë.
3. Hap. I ka pupat të gjata.
- PUPË** III f. kryes. Këpucë të vogla e të buta për foshnja, zakonisht prej lëkure të hollë a prej cohe. Pupa të bardha. Një palë pupa. I mbathi pupat fëmijës.
- PUPË** IV f. 1. Pjesa e prapme e anijes a e barkës, kic. Pupa e anijes (e vaporit, e lundrës). Qëndronte në pupë. E ka erën në pupë.
2. Pjesa më e ngritur në bordin e një anijeje. Velat (kabinat) e pupës. U ngjit (doli) në pupë.
3. Pjesë e ngritur e një mjeti, ku zakonisht ulen. Pupa e karrocës. U ul në pupë.
4. fig. bised. Rregull, terezi. E ka në pupë me të. I kishte punët në pupë.
* Është çuar në pupë është bërë mendjemadh, i është rritur mendja.
- QEPORË** I f. bot. Pjesa e nëndheshme e disa bimëve barishtore, që ka trajtën e një koke të rrumbullakët e pak të zgjatur si të qepës dhe prej shumë fletësh të mbledhura njëra mbi tjetrën. Qeporja e zambakut. Degëzat e qepores.
- QEPORË** II f. shih SMALT, ~I 1.

QËLLIM I m. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve QËLLOJ, QËLLOHEM. Qëllimi me armë. Qëllimi në shenjë.

QËLLIM II m. 1. Ajo që kërkohet të arrijmë, gjëja drejt së cilës synojmë, pika tek e cila përqipemi të vemi; synim. Qëllimi kryesor (i parë). Qëllimi i udhëtimit (i ekspeditës). Qëllimi i jetës. Qëllimi i mësimit. Qëllim në vetvete diçka që nuk shërben si mjet për të arritur një synim por që mbyllet në vetvete. Rrethanori i qëllimit. gjuh. Me të vetmin qëllim. Ka si qëllim. Ia arriti qëllimit. Punojnë për një qëllim. Ndjek një qëllim. Kjo ka si qëllim. Ia vë vetes si qëllim. Endet pa ndonjë qëllim.

2. Mendimi ose dëshira që kemi në kokë për të bërë diçka, plani ose ideja që kemi menduar a përgatitur për të arritur diçka. Qëllime fisnike. Me qëllime të mira (të këqija). Për qëllime paqësore. Për qëllime ushtarake (strategjike). I fsheh qëllimet.

Ia kuptoi (ia zbuloi) qëllimet dikujt.

3. Mendim i fshehtë që ka në kokë dikush për të bërë diçka (zakonisht të keqe a të dëmshme), paramendim (zakonisht keqdashës). Plagosje me qëllim. E bëri me (pa) qëllim. Ia tha me qëllim. E la me qëllim.

* Me qëllim që... për të ..., që ...

QINGËL I f. bot. shih SHPEND/ËR,~RA 1.

QINGËL II f. Rrip i gjerë leshi a lëkure, që u kalohet nën bark kafshëve të ngarkesës për të lidhur të dy anët e samarit a të shalës; nënbarkës, nënbarkje. I vuri qinglën samarit. Çliroi (shtrëngoi) qinglën. U këput qingla.

QOLE I m. bised. 1. edhe fig. vjet. Rob, skllav; shërbëtor. Ishte qole. Iu bë qole. I shkante pas si qole.

2. keq. Njeri pak i trashë nga mendja, që e përdorin të tjerët si të duan, budalla, leshko. E bënë qole.

QOLE II f. zool. Zog këngëtar i ngjashëm me laureshën, që jeton nëpër ara dhe në drurë.

QUKË I f. 1. Gropëz e vogël që e kanë disa njerëz në mjekër ose që u bëhet në faqe kur qeshin; burmë. Quka e mjekrës. Vazjë me dy quka në faqe.

2. Shenjë si gropëz e vogël që lë në fytyrë e në duar sëmundja e lisë. Quka të imëta. Quka të kuqe. Quka lije. Fytyrë me quka.

3. Pikël me ngjyrë tjetër, pikë. Shami me quka.

QUKË II f. zool. 1. Pulëdeti, misëroke.

2. krahin. Kukuvajkë.

QYL I m. Baltë, llucë. Ra shi e u bë qyl.

QYL II m. bised. 1. E ngrënë ose e pirë pa paguar asgjë; një send a diçka tjetër që merret rastësisht falas. I pëlqen qyli. I bie qylit. thjeshtligj., keq. e ka zakon t'i marrë gjërat falas, i pëlqen e përqipet të hajë e të pijë në kurriz të të tjerëve.

2. edhe ~A, ~AT keq. Njeri që nuk punon, por e pret çdo gjë nga të tjerët; njeri përtac, i ngathët e i pazoti.

RADIO- I fjalëform. libr.

Pjesë e parë e fjalëve të përbëra, që ka kuptimin e fjalës «radio» («i radios, me radio, me anë të radios»); p.sh. radiodëgjues, radiodramë, radiodrejtimit, radiofizikë, radiolidhje, radiozbulim etj.

RADIO- II fjalëform. libr.

Pjesë e parë e fjalëve të përbëra, që ka kuptimin e fjalëve «radioaktiv, rrezatim radioaktiv»; p.sh. radiobiologji, radorrezatim, radioterapi etj.

RADHOR I m. shih RADH/UA,~OI I.

RADHOR II m. 1. Varg gurësh që dalin nga toka ose në një shtresë shkëmbi; gur i madh. Rri mbi radhor. Nxjerr një radhor.

2. Varg që varet në qafë për zbulurim.

RADHUA I m. Fletore për të shkruar ose për të mbajtur shënime për një punë. Radhua shënimesh. Radhua vizatimi. E shënoj në radhua.

RADHUA II m. Radhor II.

RAKETË I f. usht. 1. Fishekzjarr që hidhet lart për të dhënë shenja ose për të ndriçuar. Raketë e bardhë (e kuqe). Raketë shumëngjyrëshe. Drita e raketës. Pistoletë për raketa. Hedh një raketë. Jap shenjë me raketë.

2. usht. Mjet luftarak me motor reaktiv, që shërben për të dërguar në largësi një predhë ose një bombë; predhë, e cila lëviz me forcën shtytëse të gazrave që lëshon pas. Raketë ndërkontinentale (balistike, e telekomanduar). Raketë bërthamore. Raketë kundërajrore. Raketë tokë-ajër (ajër-ajër). Raketë me rreze të mesme (të shkurtër) veprimi. Shtrati i raketës. Mbushja e raketës. Bazë raketash. Lëshoi (hodhi) raketën. E goditën me raketë.

3. Mjet fluturimi, që lëviz me shpejtësi të madhe me anë të një motori reaktiv. Raketë kozmike. Raketë meteorologjike (gjeofizike). Raketë shumëfazëshe. Faza e parë e raketës. Fluturimi i raketës.

RAKETË II f. sport. Pallaskë e rrumbullakët prej druri me një bisht të shkurtër, që përdoret për të qëlluar topin në lojën e pingpongut; rreth vezak i drunjtë, i thurur brenda me një rrjetë dhe me bisht të gjatë, që përdoret për të qëlluar topin në lojën e tenisit. Raketë pingpongu. Raketë tenisi.

RAPORT I m. 1. Kumtim a parashtresë me shkrim që i bëhet një organi më të lartë a epror ose një përgjegjësi për plotësimin e një detyre, për një çështje ose për gjendjen e një pune; llogari që jepet për një punë a për një detyrë, raportim. Raport ditor (javor, vjetor). Raport i hollësishtëm (i imët). Raport zyrtar. Raport hetimor (konsullor). Raport me shkrim (me gojë). I bëri një raport. E thërritën (e morën) në raport. Doli në raport. I paraqiti një raport.

2. Kumtim a parashtresë që lexohet përpara një organizate ose një mbledhjeje për veprimtarinë e kryer gjatë një periudhe dhe për detyrat që dalin. Raport politik. Raporti i Komitetit Qendror.

Tezat e raportit. Diskutimet rreth raportit. Përgatit (shkruaj, bëj) raportin. Lexoi (mbajti) raportin. Dëgjuan raportin. Miratuan raportin.

3. Dëshmi me shkrim që i lëshohet një të sëmuri nga mjeku kur është i paaftë për punë. Raport mjekësor. Raport pushimi. I dha (i nxori) një raport. Marr raport. Është me raport. bised. është me pushim për shkak të një sëmundjeje.

RAPORT II m. 1. kryes. shih **MARRËDHËNI/E,~A**.

2. Përpjesëtimi midis dy a më shumë anëve, dukurive, madhësive; lidhje e ndërsjellë sipas një përpjesëtimi të caktuar. Raporte sasiore (cilësore). Raporti i forcave. Raporti ndërmjet numrave (madhësive, vlerave). Raporti ndërmjet masës dhe energjisë. Në raportin një me njëqind. E ndryshoi (e prishi) raportin. U vendos një raport i drejtë.

* Në raport me... në krahasim me.

RASË I f. 1. gjuh. Secila nga trajtat e ndryshme që merr emri, mbiemri ose përemri gjatë lakimit, që shpreh një kuptim të caktuar gramatikor dhe që shërben për ta lidhur fjalën përkatëse me gjymtyrët e tjera të fjalisë; kategoria gramatikore që shprehet me këto trajta. Rasa emërore (gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore, thirrore, vendore). Rasa parafjalore. Rasë e drejtë (e zhdrejtë). Rasat e emrit. E lakoi në të gjitha rasat. 2. bised. Rast. Me këtë rasë. Kur ta bjerë rasa. Pret rasën. Me rasë e pa rasë.

RASË II f. Rrobë e sipërme prej pëlhure të zezë, e lirshme, me mëngë të gjera dhe e gjatë deri te këmbët, të cilën e veshin klerikët ortodoksë (në vendet ku vepron kisha ortodokse). Rasa e zezë. Rasa e priftit. Vuri (hoqi) rasën.

RE I f. 1. Grumbull avujsh uji, që rrinë pezull lart në qiell. Re të bardha (të zeza, të murrme, të kuqërremta). Re të imëta (të rralla, të dendura, të shpeshta). Re pupëloze (grumbulloze, shtresore). Re të

larta (të ulëta). Re të ngarkuara. Re shiu (dëbore, breshri). Re me shi. Shtëllunga resh. Qiell me (pa) re. Kohë me re. Doli një re.

U vesh (u mbush) qielli me re. U derdhën (u shkarkuan) retë. U mblodhën (u shpërndanë) retë. Një re shi pak shi.

2. Shtëllungë e madhe grimcash të imëta që enden në ajër; grumbull i dendur i diçkaje që ngrihet e që lëviz në ajër; mizëri. Re tymi (avulli, pluhuri). Një re riri.

Një re mushkonjash (karkalecash, zogjsh, plumbash). U ngrit një re.

3. Diçka që pengon vështrimin, perde. I zunë (i vunë) sytë re. M'u bë një re.

Kam një re përpara sysh.

4. fig. Diçka e zymtë, që paralajmëron një të keqe; diçka që sjell një shqetësim.

Retë e dyshimeve. Mblidhen (varen, dendësohen) re të zeza. Shpërndahen retë.

5. fig. Grumbull fjalësh ose veprimesh, zakonisht të mbledhura për të errësuar a shtrembëruar diçka. Re fjalësh (frazash, parullash). Re gënjeshttrash.

6. krahin. Rrufe. I ra (e goditi) reja. Krisi (shtiu) reja. E vrau reja.

* Gjer në re (te retë) shumë lart. Re e gjallë shih te GJALLË (i,e). Re me breshër

a) njeri zemërak, i hidhur;

b) trim i madh, të cilit nuk i del kush përpara. U bë re nuk duket më, u zhduk, u bë tym. Kullot retë shikon si i hutuar, nuk e ka mendjen aty.

E nget reja (këtë verë, këtë behar) bie shumë shi, s'po pushon shiu. Përpin retë shih te PËRPIJ. U përzien retë shih te PËRZIEJ. Pinin retë ishin shumë të shpejtë e të aftë (për trimat, për kuajt). Shpërthyen retë shih te SHPËRTHEJ. Treti (humbi) si re humbi fare nga sytë, u zhduk. U bë si re e bardhë mezi shquhej, mezi dallohej. Iku (erdhi, kaloi) si reja me breshër (me furtunë) iku me vrull

me shpejtësi të madhe. Nuk bie reja (rrufeja) në hithra fj. u. mospërf. shih te HITH/ËR,~RA.

RE II f. muz. Nota e dytë e shkallës muzikore; shenja për këtë notë. Nota re.

RE III f. Nusja e shtëpisë; e reja. Ime re. Re e vjehërr.

RE IV f. krahin. Fytyrë, pamje, çehre. Ka re të keqe.

RE I f. 1. Vajzë e re, vajzë në moshën e rinisë. Të rinj e të reja. Të rejat e skuadrës. Kampionati për të rejat.

2. Anëtare e organizatës së rinisë. Të rejat e organizatës. Mbledhje me të rejat.

3. Nusja e djalit (kundrejt prindërve të djalit), nusja e shtëpisë. E reja e djalit. Vjehrra me të renë.

* I bërtet së bijës ta dëgjojë e reja fj. u. e hedh fjalën për ta dëgjuar dikush tjetër, e thotë tërthorazi diçka, i bie pragut të dëgjojë dera.

RE II f. 1. kryes. Lajm, diçka që ka ndodhur kohët e fundit dhe që merret vesh, ngjarjet e fundit. Të rejat e ditës. Të rejat e fundit. Të rejat e shtypit (e gazetës). Mësoj (marr vesh) të rejat. Ç'të reja kemi? Ç'të re na solle? Ç'kemi ndonjë të re?

2. kryes. Diçka që është zbuluar ose studiuar kohët e fundit, arritjet e fundit në një fushë të shkencës, të teknikës a të prodhimit. Të rejat e shkencës e të teknikës.

3. vet. nj. Ajo që ka ardhur në jetë para pak kohësh, dukuri që sapo është shfaqur; diçka e re dhe përparimtare, ajo së cilës i përket e ardhmja; kund. e vjetra. E reja revolucionare (përparimtare). E reja në jetë (në art). Filizat e së resë. Lindja (fitorja) e së resë. Luftëtar (përfaqësues) i së resë. Mbrojtja (përkrahja) e së resë. Lufta e së resë me të vjetrën. Përqafoj (përhap) të renë. Jetoj me të renë. I hap rrugën së resë.

REAKSION I m. 1. libr. Lëvizje ose ndryshim tjetër që bën një organizëm kur mbi të

vepron një ngacmues i jashtëm a i brendshëm, kundërveprim i organizmit ndaj një ndikimi. Reaksioni i lëkurës (i organizmit). I bën (i shkakton, i jep) reaksion.

2. libr. Kundërveprim; reagim. Aksioni dhe reaksioni. Shkakton reaksion.

Si reaksion ndaj kësaj.

3. kim. Bashkëveprim midis dy a më shumë lëndëve gjatë shndërrimeve kimike. Reaksion kimik. Reaksion shkëmbimi (zëvendësimi, zërthimi). Reaksion acid (termik). Reaksioni i tokës. bujq. gjendje e tokës, që përcaktohet nga përpjesëtimi i disa lëndëve të nevojshme për bimët. Hyn në reaksion. Merr pjesë në reaksion. Kryhet (zhvillohet) një reaksion.

4. tek. Kundërveprimi i gazrave, që shtyjnë përpara një send duke dalë me forcë nga pas. Aeroplan (motor) me reaksion.

* Reaksion bërthamor fiz. zërthimi i bërthamave të atomeve të një elementi, si pasojë e të cilit ai shndërrohet në një element tjetër, duke lëshuar energji të madhe. Reaksion zinxhir

a) fiz., kim. shndërrim kimik ose zërthim i pandërprerë i elementeve dhe i lëndëve, gjatë të cilit produktet e zërthimit marrin pjesë në procesin e mëtejshëm;

b) fiz. varg veprimesh ose rrjedhimesh, që lidhen njëri me tjetrin dhe që nisin nga një shkak i vetëm fillestar.

REAKSION II m. 1. Politikë e klasave shfrytëzuese, që mbrojnë sistemin e vjetër sundues, shtypin egërsisht çdo lëvizje revolucionare, luftojnë kundër përparimit shoqëror dhe përpiqen të ruajnë me çdo kusht të drejtat dhe privilegjet e veta ose t'i rikthejnë këto, kur janë mundur nga revolucioni; regjimi i egër që vendosin këto klasa; kundërshtimi i çdo përparimi dhe zhvillimi shoqëror, qëndrimi kundër së resë e përparimtares. Reaksion i zi. Periudhë reaksioni. Organe të reaksionit borgjez (feudal).

2. përmb. Forcat e klasave shfrytëzuese, që ndjekin këtë politikë ose që kanë vendosur një regjim të tillë; kundër-revolucionarët, reaksionarët. Reaksioni i jashtëm (ndërkombëtar, i brendshëm). Forcat e reaksionit. Qendra e reaksionit. Krerët e reaksionit. Lufta kundër reaksionit. E shpartalluam reaksionin.

REAKTIV I m. kim. Lëndë që merr pjesë në një reaksion kimik dhe që duke u bashkuar me një lëndë tjetër jep mundësinë të zbulohet prania dhe sasia e kësaj në një përbërje që analizohet. Reaktiv kimik. Shishet e reaktivëve. Përdorimi i reaktivëve.

REAKTIV II m. bised. Aeroplan me motor reaktiv. Fluturojnë dy reaktivë.

REGJISTËR I m. Fletore e madhe, zakonisht e ndarë me vija sipas nevojës, ku shënohen emra, shifra, fakte etj. që të ruhen e të përdoren më pas për qëllime të ndryshme. Regjistri i llogarisë (i magazinës). Regjistri i klasës. Regjistri i kompanisë. Regjistri i të sëmurve. Regjistri themeltar i shtetasve libri që mbajnë zyrat e gjendjes civile, në të cilin shënohen të dhënat e plota për çdo shtetas (emri, mbiemri, atësia, amësia, seksi, vendlindja, data e lindjes, martesa, vdekja dhe çdo ndryshim tjetër që bëhet me vendim të organeve të pushtetit ose të gjykatës). Regjistri i anijes libri i anijes. Regjistri i amzës. Regjistri i hotelit. Shkruaj (shënoj, hedh) në regjistër.

REGJISTËR II m. 1. muz. Një nga pjesët e shkallës muzikore të një vegle ose të zërit të njeriut; shtrirja e zërit të një këngëtari. Regjistër i lartë (i mesëm, i ulët). Regjistri i zërit. Regjistra të ndryshëm.

2. muz. Tërësia e tasteve ose e gypave të një vegle me frymë, që japin të njëjtën shkallë muzikore. Regjistri i fizarmonikës (i organos). Ndërroj (shtyp) regjistrin.

3. tek. Mjet i posaçëm që shërben për të rregulluar në një masë të caktuar lëvizjen ose punën e një aparati a të një mekanizmi; mënyra e përpiktë ose masa, sipas së cilës duhet të punojë një aparat

a një mekanizëm. Regjistri i orës. Vë në regjistër.

REKLAMIM I m. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve REKLAMOJ I, REKLAMOHET I. Reklamimi i mallrave (i prodhimeve, i librave). Reklamimi i shfaqjeve (i filmave). Reklamimi i një politike.

REKLAMIM II m. Veprimi dhe gjendja sipas kuptimeve të foljeve REKLAMOJ II, REKLAMOHET II. Reklamime për mallrat. Reklamimi i ndeshjes. Bëj (paraqit) një reklamim. Nuk ka pasur asnjë reklamim.

REKLAMOHET I Pës. e REKLAMOJ I.

REKLAMOHET II Pës. e REKLAMOJ II.

REKLAMOJ I kal. 1. I bëj reklamë një malli, një shfaqjeje etj., paraqit cilësitë ose vlerat e një malli, të një shfaqjeje etj. për të tërhequr sa më shumë blerës a shikues; paraqit në një reklamë. Reklamojnë mallin (librat). Reklamojnë filmat. Reklamojnë modën.

2. keq. Lëvdoj me të madhe dikë a diçka për ta bërë sa më të njohur, duke i rritur vlerën para syve të botës.

REKLAMOJ II kal. 1. treg. Kthej prapa një mall për shkak se nuk i ka cilësitë e nevojshme ose sepse nuk i plotëson kërkesat. Reklamoj mallin.

2. sport. Kërkoj të quhet e pavlefshme një ndeshje, për shkak se nuk është zhvilluar sipas rregullave. Reklamoj ndeshjen.

REKLAMUES I m. 1. Ai që i bën reklamë një malli, një shfaqjeje etj.

2. keq. Ai që përpiqet të bëjë sa me të njohur dikë a diçka për t'i rritur vlerën para syve të botës. Reklamues i zellshëm. Reklamues i kapitalizmit. Luan rolin e reklamuesit.

REKLAMUES II m. treg. Ai që paraqit një reklamim për një mall, i cili nuk i ka cilësitë e nevojshme ose nuk i plotëson kërkesat. Reklamuesi i mallit.

REND I m. 1. Radhë, rresht. Rendi i parë (i dytë...). Në të njëjtin rend. Me tre rende e gajtanë. Dal nga rendi.

2. Vendosja e diçkaje sipas një radhe të caktuar, vendi që zënë sendet në një varg në lidhje me njëri-tjetrin. Rendi alfabetik. Rendi kronologjik (kohor). Rendi i fjalëve në fjali. Në rend të kundërt.

3. Rregulli sipas të cilit bëhet diçka, vijueshmëria në një mënyrë të caktuar për të kryer një veprim, radhë. Rendi i ujitjes (i kullotjes). Të gjithë me rend. Rend e pa rend. Pa rend e pa rregull. Ndjek një rend. Pres (lëshoj, kam) rendin. Më vjen rendi.

E bënë me rend. Flasin me rend.

* Rendi i ditës tërësia e çështjeve që shqyrtohen e që rrihen në një mbledhje a në një konferencë sipas një radhe të caktuar. Është (vë, mbetet) në rendin e ditës është (mbetet) në qendër të vëmendjes, qëndron në radhë të parë si diçka që duhet shqyrtuar e zgjidhur, është çështje e ditës. Nuk i del rend dikujt nuk i del koha, nuk ka kohë për të bërë diçka, ka shumë punë, është shumë i zënë me punë.

REND II m. 1. Sistemi i organizimit shoqëror, shtetëror dhe ekonomik; formë e organizimit të shoqërisë në një etapë të caktuar të zhvillimit të saj. Rendi shoqëror (ekonomik, politik, shtetëror). Rendi i vjetër (i ri). Rendi fisnor (gjinor). Rendi feudal. Rendi kapitalist (borgjez). Rendi socialist. Rendi kooperativist. Rend shtypës (shfrytëzues). Vendosja e një rendi. Mbroj (ruaj, forcoj, përmbys) një rend.

2. Tërësia e rregullave të vendosura, që shërbejnë për të ruajtur të pacenuar ndërtimin dhe veprimtarinë e një shoqërie, rregulli shoqëror e qytetar. Rendi publik tërësia e rregullave për të mbajtur dhe për të mbrojtur qetësinë, rregullin dhe moralin në marrëdhëniet shoqërore e qytetare. Forcat e rendit (ruajtësit e rendit) përdoret zakonisht për policinë dhe xhandarmërinë në vendet borgjeze e revizioniste. Mbaj (ruaj) rendin. Vendas

(prish) rendin. Shkel rendin publik.

3. Lloj i caktuar sendesh a dukurish me të njëjtat veti ose të një shkalle; klasë, kategori. Sendë (shifra) të të njëjtit rend. Njësi të rendit të parë.

4. hist. Shtresë shoqërore në periudhën e feudalizmit, e cila kishte të drejta e detyra të trashëgueshme, që pasqyronin marrëdhëniet klasore dhe luftën e klasave [në këtë periudhë. Rendet e privileguara aristokracia dhe kleri. Rendet e shtypura (e ulëta). Rendi i tregtarëve. Ndarja e popullsisë në rende. Zhdukja e rendeve.

5. biol. Njësi e botës bimore e shtazore, e cila përfshin një grup familjesh, që i kanë të përbashkëta tiparet kryesore dhe bën pjesë në një klasë të caktuar. Rend bimësh (kafshësh). Rendi i brejtësve. Rendi i kafshëve grabitqare.

6. vjet. Klasë, vit mësimi (në shkollë). Nxënësit e rendeve të para.

REND III m. Vrap. Eci me rend. Iku (shkoi) me rend. Mori rend. Një rend kali një vrap pele.

RENDOJ I kal. shih RENDIT. Rendoj librat. I rendoi në listë.

RENDOJ II kal. Grij në rende. Rendoj qepët (kungujt).

REPUBLIKË I f. 1. Formë e qeverisjes, në të cilën organet e larta të pushtetit dhe kryetari i shtetit, që përfaqësojnë interesat e klasës në fuqi, janë të zgjedhshëm për një afat të caktuar. Republikë popullore. Republikë demokratike popullore. Republikë demokratike borgjeze formë e sundimit politik të borgjezisë, në të cilën diktatura e saj ushtrohet nëpërmjet organeve të zgjedhura, që vetëm në dukje përfaqësojnë interesat e popullit. Republikë skllavopronare (aristokratike). Republikë parlamentare. Organet e republikës. Kushtetuta e republikës. Shpallja e republikës.

2. Vend që ka këtë formë shtetërore. Republika të bashkuara (të federuara).

Stema e republikës. Flamuri i republikës. Kufijtë e republikës. Kryetari (presidenti) i republikës.

REPUBLIKË II f. bised. Lloj kapeleje burrash, në trajtë të rrumbullakët, me majë të shtypur dhe me strehë rreth e përqark paksa të ngritur. Republikë e re (e vjetër). Mbaj republikë. Vë (heq) republikën.

RESË I f. 1. Lule në trajtë vileje, që lëshojnë disa drurë; gath, vastak, lëvare. Resat e arrës

(e gështenjës, e lajthisë). Nxjerr resa. I bien resat.

2. bot. Bimë barishtore e kënetave dhe e liqeneve, që bën fije të gjata, të cilat përdoren për të thurur; kashtë kënete.

3. Thurimë prej kallami ose prej kashte kënete, që përdoret për çati, për trina, etj.; thurimë e tillë në trajtë hinke që përdoret për të zënë peshk etj. Resë kallamash (thuprash). Resa e çatisë. Resa e peshkut. Thur (bëj) një resë. Mbuloj çatinë me resë.

4. Vend në një lumë ku i zihet pritë peshkut për ta kapur natën me resa; pritë, pusi.

RESË II f. Smirë. Resë e keqe. Plasi nga resa.

REVISTË I f. 1. Botim periodik, që përmban artikuj, studime dhe shkrime të tjera për një fushë të caktuar ose me karakter të përgjithshëm; e përkohshme. Revistë mujore

(e përmuajshme, e përjavshme, e përdyjavshme). Revistë letrare (shkencore, kulturore, politiko-shoqërore, satirike). Revistë e ilustruar. Redaksia e revistës.

REVISTË II f. Rreshtim i trupave ushtarake për inspektim para fillimit të një parade; rojë nderi e rreshtuar për të pritur a për të përcjellë një personalitet të shquar. Kaloi në revistë.

RIGË I f. 1. Curril i hollë, vijë e hollë uji. Rigat e shiut. Dy riga lot.

2. vet. nj. Shi i imët e i lehtë që bie për një kohë të shkurtër, vesë shiu. Ra një rigë shi.
- RIGË** II f. Vizore. Rigë e shkallëzuar (matëse). Rigë njehsimi. Riga e kontrollit.
- RIJ** I kal. 1. Përtërij. Rij zakonet. Rij vendin.
2. vet. veta III jokal. Del i ri; mbin; mbulohet, vishet me diçka që del e re. Rin bari (misri). Rin vetiu. I rinë pu-plat. Rin hëna e re. Rin plaga fillon të mbyllet plaga, duke zënë mish të ri. Riu mali (fusha) u mbulua me bar të ri.
- RIJ** II kal. 1. Njom, lag pakëz. Rij rrobat. Rij duhanin.
2. Koj, ushqej grepin për peshk. Rij gre-pin.
- RIJ** III kal. Kënaq, gëzoj. Rij sytë.
- ROMAN** I m. let. Vepër letrare e gjatë, zakon-ish në prozë, e cila pasqyron një rreth të gjerë ngjarjesh e dukurish nga jeta dhe karaktere, që shtjellohen në zhvillimin e tyre dhe në lidhjet e ndërlikuara me kohën e me jetën e shoqërisë; gjinia letrare që përfshin këto lloj veprash. Roman i gjatë (i shkurtër). Roman shoqëror (historik, epik, psikologjik). Roman kalorësiak (policor, fantastik). Roman në vargje. Autor romanësh. Heroi i romanit. Cikël romanësh. Shkruaj (botoj) një roman.
- ROMAN** II m. krahin. shih SHULËS, ~I 1.
- RRAGË** I f. 1. Pëlhurë e trashë prej liri, që përdoret për thasë etj., burdhë. E mbu-loi me rragë.
2. Përparëse prej kësaj pëlhure, që vihet për të mos u fëlliqur gjatë punës.
- RRAGË** II f. shih RRAGAT/Ë, ~A.
- RRAXHË** I f. 1. Një copë dërrasë që shër-ben për të rrafshuar drithin, miellin etj. në grykën e një ene të mbushur buzë me buzë. Rraxha e qases (e karroqes). Rraxha e baltës së tullave. E presin me rraxhë. E rrafshojnë me rraxhë. E mbushi me rraxhë e mbushi plot, buzë me buzë. Është me (në) rraxhë është plot, buzë me buzë.
2. përd. ndajf. Plot e përplot, buzë me buzë. U mbush rraxhë.
* Janë një rraxhë janë të një mase, sa njëri tjetri, të prerë me një gërshtë. I vë rraxhën e bëj rrafsh, e rrafshoj.
- RRAXHË** II f. zool. Peshk deti me trup petashuq në trajtë rombi që ka bisht të hollë e të gjatë.
- RRE** I f. 1. Shteg i ngushtë; rrugë e ngushtë e hapur në dëborë. Njëpër shtigje e njëpër rre.
2. Gjurma që lë pas kërmilli ose një zvar-ranik kur kalon. Rre kërmilli (gjarpri). Lë rre.
- RRE** II f. zool. Krimb që jeton si parazit në zorrët e fëmijëve, bubë. Bar rresh. Zuri rre. Nxori rre.
- RREKË** I f. 1. Fik i pjekur shumë e i rreshkur në degë, burmë. E ëmbël si rrekë. Një shportë me rreka.
2. kryes. Rezhdat e dhisë, vathët.
3. Përd. mb. sipas kuptimit 1 të emrit. Fiq rreka.
- RREKË** II f. 1. Lëvizje e shkathët për t'ia kaluar kundërshtarit në një lojë zakonisht me top.
Bën rreka. Luan me rreka.
2. Dredhi; shaka, shpoti duke ia hedhur tjetrit. Merret me rreka.
- RRËNJË** I f. 1. bot. Pjesa kryesisht nën dhe e një bime barishtore, e një shkurreje a e një druri, që e mban atë të ngulur dhe që i shërben për të thithur ujin a ushqimin; pjesa e nëndheshme e disa bimëve, që përdoret për ushqim, për të bërë barna a pije ose për të përgatitur sende të ndryshme. Rrënjë e hollë (e trashë, e shkurtër, e thellë). Rrënjë kryesore (nëntokësore, ajrore, mbitokësore, anësore). Rrënjë boshtore (xhufkore, penjëzore). Rrënjë të kalbura. Rrënjë në ujë. Qafa e rrënjës. Qimet (sythat) e rrënjës. Pije (barna) me rrënjë bimësh të egra. Çibuk nga

rrënja e shqopës. Lëshon (nxjerr, zë) rrënjë. I pres rrënjët. Shkul rrënjën. I zbuloj (i mbuloj, i mbath) rrënjët. E nxjerr me gjithë rrënjë. Shtoj me rrënjë.

2. Një bimë e mbjellë ose një pemë që jep kokrra; një bimë a një dru si njësi numërimi. Dyzet rrënjë mollë (hardhi). Njëzet rrënjë ullinj. Mbollën pesëqind rrënjë pemë. Plehërojnë çdo rrënjë (rrënjë me rrënjë).

3. anat. Pjesa me të cilën një organ me trajtë të zgjatur është kapur ose është ngulur në një ind; pjesa e prapme e një organi të tillë. Rrënja e flokut. Rrënja e thoit. Rrënja e hundës rrëza e hundës. Shkul (heq) rrënjët e dhëmbit. I mbeti një rrënjë. I këputi rrënjët.

4. fig. Burimi më i parë e më i thellë i një dukurie, prejardhja; mbështetja e thellë, mbi të cilën rritet e zhvillohet diçka, themeli. Rrënjë të thella (të forta). Rrënjët e vërteta. Rrënjët klasore. Rrënjët historike (ideologjike, shoqërore, filozofike). Rrënjët e së keqes (e paragjykimëve, e gabimeve, e kontraktave). I gabuar që në rrënjë. I gjeti rrënjët diçkaje. I ka rrënjët thellë në... E kap (e zë) nga rrënjët diçka. Gjer në rrënjë.

E tundi (e lëkund) nga rrënjët. E mësoi me rrënjë. Liria i ka rrënjët në gjak. fj. u.

5. gjuh. Pjesa kryesore e fjalës, që nuk mund të ndahet më tej në pjesë përbërëse, që bart e ruan kuptimin themelor dhe që shërben si bazë për të formuar fjalë të reja me anë parashtesash, prapashtesash etj. Rrënjë emërore (foljore). Rrënjë njërrrokëshe (dyrrrokëshe). Rrënja e përbashkët. Fjalë të një rrënjë. I gjej rrënjën fjalës.

6. mat. Numër a shprehje algjebrike, që, kur ngrihet në fuqi, jep madhësinë e dhënë më parë; numër që shërben si zgjidhje e një barazimi. Rrënjë katrore (kubike). Rrënjët aritmetike (algjebrike). Rrënja e një thyese. Shenja e rrënjës. Nxjerr (gjej) rrënjën katrore të një numri.

Ngre në fuqi një rrënjë.

7. kim. Grup me atome në molekulat e lëndëve kimike, që merr pjesë në reaksionet pa u ndryshuar. Rrënjë kimike. Rrënjë acide (bazike). Rrënjë e lirë.

8. bised. Prejardhja e një njeriu, familja a farefisi nga vjen dikush; mbështetja e përkrahja që ka dikush nga njerëzit e afërm ose të njohur, rrethi i ngushtë. Rrënja e një njeriu (e një fisi). Nga e ka rrënjën? Nga ç'familje a nga ç'shtresë rrjedh? Ka rrënjë të thella (të forta) dikush. Rrënjë pas rrënjë brez pas brezi. Është pa rrënjë ka mbetur pa familje. I ka dalë rrënja ka mbetur pa fëmijë, pa trashëgimtarë. I ka rrënjët të shkullura ka mbetur fill i vetëm, i shkretë, pa të afërm, pa njeri.

* Me rrënjë në mënyrë të thellë, shumë mirë e me hollësi. (E pyes) rrënjë më rrënjë (e pyes) me hollësi, imtësisht. Ia heq (ia tërheq) rrënja për diçka ka qejf për diçka, ia do qejfi. Lëshon (zë, ngul, hedh, shtie) rrënjë

a) dikush zë vend përgjithmonë diku, ngulet përgjithnjë; shkon në një vend e s'di të ikë më që andej;

b) diçka zë vend të qëndrueshëm, rrënjë fort. Numëron rrënjët shih te NUMËROJ. Ia pres rrënjët diçkaje shih te PRES I. Shkul (përmbys, pres) nga rrënjët (me rrënjë) e shkatërroj që nga themelet, i heq çdo mundësi për të jetuar a për t'u zhvilluar më tej, e shfaros, e zhbij. I zbuloj rrënjët dikujt a diçkaje shih te ZBULOJ. U bë rrap e rrënjë shih te RRAP, ~I. Nuk ka degë pa rrënjë fj.u. askush a asgjë nuk mund të ecë përpara pa pasur një themel të shëndoshë; nuk ka zhvillim pa mbështetje të shëndoshë; nuk ka majë pa rrëzë. I ka rrënjët mbi ujë është pa mbështetje, nuk ka themel të shëndoshë, qëndron në ajër. I ngeci plori në rrënjë shih te PLOK, ~I. E njoh (e di) me rrënjë e me degë e njoh shumë mirë, ia di të gjitha me hollësi. E shau rrënjë më rrënjë (me rrënjë e me degë) e shau shumë rëndë, s'i la gjë pa thënë. E

shkulën (e ngritën) me rrënjë e me degë e larguan a e dëbuan nga një vend me gjithë familje, me të madh e me të vogël. E kap për rrënjësh e jo pas degësh kap hallkën kryesore, i futem thelbit për të zgjidhur diçka, e kap demin për brirësh. Gjuha e ka rrënjën në zemër fj. u. shih te GJUH/Ë,~A. Mos mburr degët pa parë rrënjët! fj. u. për të vlerësuar diçka mos u mbështet në anët e jashtme, por shiko brendinë, thelbin, themelet, shkaqet, qëllimet.

RRËNJË II f. bot. Lloj dushku me trup të drejtë e me gjethe si të gështenjës, që bën lende të bashkuara zakonisht tri e nga tri dhe që përdoret për lëndë ndërtimi, për të nxjerrë tanin, për të bërë qymyr të cilësisë së lartë etj. Druri i rrënjës. Lende e rrënjës.

RRËSHQITJE I f. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljes RRËSHQAS. Rrëshqitje e shpejtë (e ngadalshme). Rrëshqitje artistike. Rrëshqitja e dheut. Rrëshqitja mbi akull. Rrëshqitja me figura. Rrëshqitje me ski (me patina). Sheshi i rrëshqitjes. Kampionati i rrëshqitjes.

2. fig. Gabim që bëhet pa dashur ose pa e kuptuar; fjalë e thënë ose e shkruar gabimisht pa e vënë re. Ruhet nga rrëshqitjet. Në tekst ka disa rrëshqitje.

RRËSHQITJE II f. bot. Lloj kërpudhe që hahet, e cila e ka kësulën ngjyrë hiri nga sipër e të bardhë poshtë dhe vjen si e yndyrshme kur preket me dorë. Mbledh (ha) rrëshqitje.

RRËZË I f. 1. Pjesa e poshtme e diçkaje që është e ngulur në tokë ose e mbështetur në të, fundi i diçkaje që ngrihet mbi tokë. Rrëza e murit (e gardhit). Rrëza e drurit (e pemës). Rrëza e malit brezi i fundit të një mali, ku ky fillon të ngrihet mbi fushën, këmbët e malit. Rrëza e shkëmbit (e kodrës). U ulën në një rrëzë muri (peme, kodre). E preu pemën deri në rrëzë. E prishi (e shembi) deri në rrëzë.

2. Krahinë që shtrihet në brezin e fundit të një mali ose vargmali. Rrëza e Korçës

(e Përmetit). Rrëzat e Shkodrës. Fshatrat e rrëzës.

3. Vendi ku një gjymtyrë ose një organ tjetër bashkohet me trungun kryesor; fundi i një gjymtyre ose i një organi aty ku lidhet. Rrëza e veshit. Rrëza e kofshës. Rrëza e hundës. Rrëza e flokëve. Rrëza e gjuhës (e dorës). Në rrëzë të qafës. Ia prenë këmbën (dorën) deri në rrëzë. T'u thaftë deri në rrëzë! mallk.

4. Pjesë e futur në skaj të një vendi ose të një sendi të mbyllur nga disa anë; kënd. skutë, cep. Rrëzat e arkës (e dollapit). Rrëzat e shtëpisë. E futi (e vuri) në një rrëzë. Fshijnë edhe rrëzat e dhomës. E ka harruar në ndonjë rrëzë. I kërkoi të gjitha rrëzat. Nuk lashë rrëzë pa parë.

5. fig. Vend i mënjanuar, pak i fshehur ose që nuk rrihet nga njerëzit; skutë, qoshe. Rrëza të fshehta. Rrëzat e lagjes (e qytetit). Rrëzat e pyllit. Njeri i rrëzave. Rri (ecën) rrëzave. Fshihet (futet) rrëzave. Ka gjetur (ka zënë) ndonjë rrëzë.

6. bised. Rrënjë bime. Një rrëzë ulliri (duhani, misri). Dru me rrëza. Lëshon rrëza.

* Është nga rrëza vjet. është nga lagjet e skajshme të qytetit, është nga lagjet e të varfërve, është i varfër (thuhej në të kaluarën me mospërfillje nga shtresat shfrytëzuese për të shfrytëzuarit). Në rrëzë të veshit shih te VESH,~I. Ai është në rrëzë të dardhës shih te DARDH/Ë,~A. Nuk ka majë pa rrëzë fj. u. askush a asgjë nuk mund të ecë përpara pa pasur një themel të shëndoshë; nuk ka zhvillim pa një mbështetje të shëndoshë.

RRËZË II f. bot. Bimë barishtore e vendeve të ngrohta, me gjethe të holla që dalin si fije nga kërcelli, me lule të imëta, të verdha e të mbledhura tufë dhe me rrënjë të tultë, e cila thahet, bluhet e përdoret si bojë për të ngjyer në të kuqe të ndezur. Rrënjët e rrëzës. Ngjyey me rrëzë.

RRIKË I f. bot. Rrepë. Rrikë e kuqe. Lëngu i rrikës.

* I lë rrikën dikujt ia ngarkoi fajin a gabimin dikujt tjetër, ia hedh fajin tjetrit.

Ia bëri (kokën) rrikë e qethi shumë shkurt, ia bëri kokën rrafsh.

RRIKË II f. Kutit druri e varur në mur për të mbajtur lugët, lugës, shelqe.

RRIPA-RRIPA I

1. ndajf. Në shumë fije a copë si rripa, në rripa. E presin rripa-ripa. E grisi rripa-ripa. E bëri rripa-ripa.

2. mb. Që është i ndarë në shumë rripa a breza. Tokë rripa-ripa. Pyll rripa-ripa.

RRIPA-RRIPA II mb.

Që i ka shpatet të thepisura e të gërryera, që ka shumë brinjë e rrëpira, me shumë rripa. Male (kodra, maja) rripa-ripa. Vende rripa-ripa.

RRJEPËS I m. 1. Ai që rrjep bagëtitë e therura. Rrjepës lëkurësh. Rrjepës bagëtish.

2. keq. Ai që grabit ose që shfrytëzon të tjerët pa mëshirë.

RRJEPËS II m. mjek. Sëmundje e rëndë, që shfaqet në fillim me disa njolla të kuqe në lëkurë, e cila thahet, zhvoshket e leskërohet, pastaj me fshikëza në buzë e në gojë e më vonë me çrregullime të mëdha të tretjes e të veprimtarisë nervore dhe që shkaktohet nga mungesa e një vitamine në ushqim.

RROJË I f. Jetë; jetesë, rrojte. Rrojë e mirë (e keqe, e vështirë). Rroja e popullit.

RROJË II f. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve **RRUAJ**, **RRUHEM**. Sapun (pastë, krem) rroje. Brisk (makinë) rroje. Veglat e rrojës takëmi (makina, furça etj.) që përdoret për t'u rruar.

RROKJE I f. Një tingull zanor ose një grup tingujsh, i përbërë nga një zanore e nga një a më shumë bashkëtingëllore, që shqiptohen me një të nxjerrë të frymës. Rrokja e parë (e dytë... e fundit). Rrokje e hapur (e mbyllur). Rrokje e theksuar (e pathek-suar). Fjalë me një (dy, tri) rrokje. Varg

me tetë rrokje. Ndjaj në rrokje. Lexoj rrokje për rrokje. Theksi bie mbi rrokjen e parafundit.

RROKJE II f. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve **RROK**, **RROKEM**. Rrokja e armëve. Rrokja e duarve.

RROKME I f. Shkop i gjatë me një rrotull në krye, me të cilin rrahim qumështin në tundës; filiç.

RROKME II f. krahin. 1. Punë që e ndërmerr dikush për ta bërë.

2. Veprim që bën dikush pa i menduar pasojat ose për të kënaqur dëshirat e rastit, aventurë. Jepet pas rrokmesh. Nuk u përton rrokmeve.

RRUSHI I **QYQES** bot. Rrushqyqe.

SAGË I f. Tepsi e thellë me fundin të shpuar vrima-vrima, që përdoret për të pjekur gështenja.

SAGË II f. let. Këngë epike popullore ose legjendë e përhapur sidomos në vendet skandinave e në Islandë në mesjetën e hershme. Sagë historike. Saga të lashta. Sagat norvegjeze (daneze).

SAK I m. krahin. Rrjetë peshkimi në trajtë të një traste me një rreth druri e me bisht të gjatë.

Zë peshk me sak.

SAK II m. Ai që u mbush gotat e rakisë njerëzve në tryezën e gostisë. Sonte të kemi vënë sak.

SERRË I f. Ngrehinë e lehtë, e mbuluar me xham ose me lëndë plastike të tejdukshme, në të cilën rriten në të ngrohtë bimë të ndryshme; perimore e mbuluar. Serrë diellore. Serrë e ngrohtë. Serra me xham. Serra domatesh (lulesh). Perimet e serrave. Rritet në serra.

SERRË II f. Shkëmbinj të lartë e të thepisur.

SË I gjin. dhan., rrjedh. e nyjës së përparme e. Ndjenja e së bukurës. Drejtoreshës së kopshtit. Mjelëses së dalluar. Për hir të së vërtetës. I klasës së dytë. I foli së bijës (vajzës së saj).

SË II pj. Pjesëz trajtëformuese në disa shprehje ndajfoljore. Së pari. Së paku. Së tepërmi. Së afërmi. Së gjalli. Së bashku. Për së largu. Për së mbari.

SIRENË I f. Pajisje që lëshon tinguj të mprehtë e të vazhdueshëm dhe që përdoret si mjet për të dhënë alarmin, për të paralajmëruar ose për të njoftuar diçka. Sirena e lokomotivës (e trenit). Sirenat e fabrikave. Zëri i sirenave. Fishkëllima (oshitima) e sirenës. Ra (buçiti) sirena. I bie sirenës.

SIRENË II f. 1. mit. Figurë mitologjike që përfytyrohej nga grekët e lashtë si qenie me pjesën e sipërme të trupit si grua ose si zog e me bisht si peshk, e cila rrinte mbi shkëmbinjtë e detit dhe me këngën e saj joshte anijetarët aq sa i bënte të mbyteshin. Kënga e sirenave.

2. fig. Grua e bukur dhe shumë tërheqëse.

SJELL I kal. 1. Mbart diçka nga vendi ku është dhe e vë diku me afër, bie; e mbart dikush nga larg dhe e bie në vendin ku jam unë; kund. shpie, çoj. Solli plaçkat. Solli orendi të reja. E solli në krah (me kalë, me kamion). Sille këtu! Na sollën veglat e punës. Sollën ujin në fshat. Më sill pak ujë!

2. Marr e bie dikë a diçka me vete; bie; kund. shpie, çoj. Solli një letër (një libër). Solli edhe djalin. E solli me zor (zvarrë). E solli me vete. E solli uji (lumi, rryma).

3. Vij dhe bëj të ditur; vij e njoftoj diçka nga ana e një tjetri, bie një lajm a diçka tjetër; bie; kund. dërgoj, çoj, shpie. Solli një lajm të mirë. Na solli shumë lajme të reja. Na solli të fala. Nuk i solli përgjigje. Sjell mendimet e masës. Sjell zërin e klasës punëtore.

4. Nxjerr dhe parashtroj, paraqit; e nxjerr atje ku dua, e bie (bisedën, fjalën). Solli shumë prova. E solli si shembull. E solli fjalën (bisedën) te dikush a te diçka.

5. Bëj që të vijë diçka si rrjedhim a si pasojë, shkaktoj. Të sjell gjumë. Sjell

shi (stuhi, borë). Sjell dobi (dëm). Sjell pengesa (shqetësime). Solli përmirësime (ndryshime). I solli gëzim (kënaqësi). Sjell mërzi. I solli vdekjen. Kjo sjell me vete... kjo ka si pasojë, shkakton.

6. fig. I siguroj a i dhuroj dikujt diçka që kërkon përpjekje e luftë për t'u arritur.

I solli lirinë (shpëtimin). U solli fitoren.

7. E bie diçka deri në një cak a përfundim; e bëj një punë a diçka deri në një pjesë. E solli gjer në mes punën. E ka sjellë në fund. E solli në të mbaruar. Deri atje ku e kishin sjellë studiuesit paraardhës.

8. E bëj dikë a diçka të jetë a të vijë në një gjendje të caktuar (të mirë a të keqe).

E solli në vete (në udhë të mbarë). E solli në qejf. E solli punën në vijë (në rregull).

E solli në fitore. Ai e solli në këtë gjendje (në këtë ditë). Ja ku e solli kokëfortësia (mendjemadhësia, pakujdesia).

9. E tërheq dikë për të ardhur në një vend; e bëj të vijë a të kthehet diku. E solli malli për fshatin (për vendlindjen). Ç'e solli këtu?

10. vet. veta III. Bën që të vijë a të ndodhë rastësisht ose pa e pritur e pa e kërkuar; më detyron të shkoj diku. E solli koha (rasti). E solli puna (nevoja). E solli hera (fati).

11. E vë të punojë në një organ drejtues a i jap një pozitë drejtuese; e pranoj në një organizatë etj. E sollën në fuqi (në pushtet). Sollën punëtorë në udhëheqje (në organet e pushtetit).

12. I kthej njëherë anë diçkaje ose e kthej nga njëra anë; i paraqit njëherë anë; drejtoj. I solli fytyrën (kurrizin) diellit. E solli përmbys. Sille nga ana tjetër! Mos i sill sytë nga rruga! Sille kokën prapa!

13. bised. E shqep një rrobë dhe e qep nga faqja tjetër, kthej. Solli pallton (pantallonat).

14. E bëj që të vijë rrotull a të ecë përqark; rrotulloj. Sjell rrotën. E sjell rrotull.

E solli përqark shtëpisë.

15. fig. bised. Nuk ia mbaroj një punë dikujt dhe ia zvarrit për një kohë të gjatë; e vonoj dikë, e sorollat. E solli ditë të tëra kot. Mos i sill njerëzit! Po i sjell poshtë e përpjetë (rrugëve).

16. Ringjall në kujtesë. Sjell ndërmend kujtoj. E solli në hatër. bised. e kujtoi, e solli në kujtesë. Ia solli ndër mend ia kujtoi.

* Këtu ma solli (ma solli këtu) shih te KËTU. E solli në biçim dikë a diçka shih te BIÇIM,~I. E solli me bisht dikë shih te BISHT,~I. E solli çarku shih te ÇARK,~U.

E solli (e pruri) në din dikë shih te DIN,~I. Ia sjell (i vete, i shkon) djathtazi shih te DJATHTAZI. E sjell dokërr dikë shih te DOK/ËRR,~RRA. E ka sjellë era dikë a diçka shih tek ER/Ë,~A I. E solli (e pruri) kokën mospërf. shih te KOK/Ë,~A. I solli (i ktheu) krahët (shpinën, kurrizin) dikujt shih te KTHEJ. E ka sjellë laraska iron. shih te LARASK/Ë,~A. E sjell në rreth dikë a diçka shih te RRETH,~I. E sjell rrotull (vërdallë) dikë shih te RROTULL. E sjell (e marr, e çoj) për veshi dikë shih te VESH,~I. Solli (futi) zjarrin (në shtëpi) shih te ZJARR,~I. Gjumi sjell gjumin shih te GJUM/Ë,~I. Sjell (kthej) në një emërues të përbashkët libr. shih tek EMËRUES,~I. Ia sjell (ia bie, ia hedh) fjalën rrotull (larg e larg) shih te RROTULL. E sjell gajtan muhabetin shih te GAJTAN, ~I I. Ia solla në grykë të pushkës dikë a diçka shih te PUSHK/Ë,~A. Ia solla gjakun në vend dikujt shih te GJAK,~U I. E sjell (e luan) në majë të gishtit (të gishtave) dikë shih te GISHT,~I. E solli (e ktheu) mbrapsht shtëpinë shih te MBRAPSHT. Ia sjell mendjen rrotull (vërdallë, përqark) dikujt shih te MENDJ/E,~A. Ma solli (ma pruri) shpirtin në fyt (ndër dhëmbë) shih te FYT,~I. Ma solli (ma pruri) shpirtin në majë të hundës shih te HUND/Ë,~A. Nuk hahen ato petulla që t'i sjell (t'i jep)

shigjetulla fj.u. shih te PETULL,~A. Ç'sjell minuta, s'e sjell ora (s'e sjell moti) fj.u. shih te MINUT/Ë,~A.

SJELL II jokal. I bie ose e godas me diçka. I solli me gurë. I solli me dorë (me pëlëmbë). I solli me kamxhik. I solli topit me këmbë. I solli me sa fuqi kishte.

SKLLOP I m. zool. Shpend uji i murrinë, i madh sa një pulë. Skllopat me sqep të gjatë.

SKLLOP II m. Baltë e përzier me borë të shkrirë; baltë, llucë. Rrugë tërë skllop.

* E bëri skllop diçka e zbuti shumë duke e rrahur me diçka a duke e zier, e squlli.

SKUADËR I f. 1. usht. Njësi bazë e reparteve ushtarake, nënndarje e togës që arrin deri në 10-15 veta dhe që ka në krye një ushtar më të vjetër a një nënoficer. Skuadër pushkatare. Skuadër këmbësorie. Skuadër artiljerësh (tankistësh, ndërlidhësish). Komandanti i skuadrës. Rreshtimi i skuadrës. Togë me tri skuadra.

2. Njësia më e vogël e një brigade pune, e një kompanie fëmijësh ose e një organizimi tjetër të ngjashëm me atë ushtarak; grup prej pak vetash, i organizuar për të kryer një punë të caktuar. Skuadrat e brigadës së kooperativës. Skuadër pionierësh. Skuadër vullnetarësh. Skuadrat e ndërtimit. Skuadrat e shpëtimit. Skuadër zjarrfikësish. Skuadrat e minatorëve. Përgjegjësi i skuadrës. Anëtarët e skuadrës. Komandanti i skuadrës.

3. sport. Grup lojtarësh që marrin pjesë në ndeshje si përfaqësues të një vendi, të një klubi, të një shoqërie etj. Skuadra përfaqësuese (kombëtare). Skuadra mike (fituese). Skuadër futbollit (volejbollit, basketbollit). Lojtarët e skuadrës. Kapiteni i skuadrës. Ndeshjet midis skuadrave.

SKUADËR II f. Vegël e thjeshtë në trajtën e një trekëndëshi kënddrejtë, që përdoret për të vizatuar kënde të drejta ose për të matur nëse një kënd është i drejtë (zakonisht në ndërtim). E vuri në skuadër

- e kontrollon dhe e bëri që të jetë si kënd i drejtë.
- SKUTË** I f. 1. Cep i futur, vend i mënjeluar dhe i fshehtë; kënd, qoshe. Skutë e errët. Skutat e shtëpisë. Rri në një skutë. Gërmoi në të gjitha skutat. E kërkoi skutë më skutë. Flisnin qosheve e skutave flisnin prapa shpine.
2. fig. Ana e panjohur, e thellë ose e fshehtë e diçkaje. Në skutat më të thella të zemrës (të shpirtit). Në skutat më të errëta të ndërgjegjes.
- SKUTË** II f. Përparëse e leshtë grash; një copë pëlhurë katrore prej leshi që përdoret si mbulojë. I hodhi përsipër një skutë fëmijës.
- SOP** I m. 1. Pjesë e ngritur si gungë a si breg në sipërfaqen e tokës; kodrinë e vogël dhe e ulët, bregore, stom. Tokë gjithë sapa e gropa. U ul në një sop.
2. tek. Pjesa vijore e ngritur ndërmjet dy kanaleve të thelluara në një vegël a në një gyp. Vjaskat dhe sopat e tytës së armës.
- SOP** II m. 1. Pjesa e fundit në lugun e mulirit, nga del uji me forcë dhe godet fletët e gurit.
2. Muslluku i një fuçie, i një buti, i një voze etj. Hapi sopin e butit.
3. Një copë dru si pykë a koçan misri, që përdoret në vend të shtupës për enët prej druri. Sopi i kades. I vuri sopin bucelës.
- SPIRË** I f. mjek. 1. Heqje barku, diarre. E ka zënë spira. E lau spira.
2. keq. Supë fare e hollë e pa shije, gjellë e keqe tërë lëng, fare pa yndyrë; spirilëng. As që futej në gojë ajo spire.
- SPIRË** II f. mek., elektr. Një rrotullim i një përçuesi ose i një teli të dredhur si spirale; dredhë. Spirat e telit (e bobinës). Numëron spirat.
- STELË** I f. 1. Rrobë e vjetër që i shtrohet qenit për t'u shtrirë, shtrojë për qenin.
2. Kasolle e vogël prej dërrase ku rri qeni. Lidh qenin te stela. I bëri qenit një stelë.
- Qeni leh atje ku ka stelën. fj.u.
3. fig. mospërf. Banesë ose dhomë fare e vogël dhe e mbajtur keq. Banonte në një stelë.
4. vet. krahin. Shtresat dhe mbulesat e fjetjes.
5. vet. krahin. mospërf. Lecka të vjetra; rroba të grisura e të vjetra. I veshur me stela.
6. Dysheku i samarit, stromë. Lëkura dhe kashta e stelës. Mbushi stelën me kashtë.
7. mospërf. Duhan i keq nga gjethet e dorës së fundit; duhan vjeshtak, batraq.
- STELË** II f. arkeol. Shtyllëz ose pllakë guri a mermeri me një mbishkrim dhe shpesh e zbukuruar me figura në relief, që i kushtohet kujtimit të një të vdekuri, një perëndie etj. Stelë varri. Stelë me mbishkrime. Stelë e gjetur në Pojan. Stelë e mesit të shekullit I para erës së re.
- STËRPIK** I kal. 1. Lag lehtë përsipër duke i hedhur pikla uji a lëngu tjetër; spërkat. Stërpik rasatin. Stërpik murin. Stërpik pantallonat për t'i hekurosuar.
2. Ndot me pikla balte ose të diçkaje tjetër, që përhapen me vrull; çikloj. Na stërpiku makina me baltë (me llucë).
- STËRPIK** II kal. 1. E nxjerr përpajnë, përpa-jnoj. Stërpik hardhinë.
2. jokal. vet. veta III. Nxjerr filiza afër rrënjës. Stërpik lisi.
- STRUGË** I f. Mbulesë e leshtë që hidhej kraheve si rrobë ose që përdorej si shtrojë; lloj bërruce e bardhë, që e përdornin barinjtë në disa krahinat të Veriut të Shqipërisë. Strugë e bardhë. Struga e Zadrimës. Hodhi (shtroi) strugën.
- STRUGË** II f. 1. Vend me ujë dhe me shkurre moçalore; vend i ulët, si gropë, që mban ujë edhe gjatë verës.
2. Vijë uji.

SHAH I m. 1. Lojë me prejardhje nga vendet e Lindjes, që luhet ndërmjet dy vetave në një dërrasë të ndarë në gjashtëdhjetë e katër katrorë të vegjël dhe me tridhjetë e dy figura (gjashtëmbëdhjetë të bardha e gjashtëmbëdhjetë të zeza), të cilat kanë vlera të ndryshme dhe vendosen e lëvizin sipas disa rregullash të caktuara; fusha dhe figurat e kësaj loje. Loja e shahut. Kampionati i shahut. Fushë (dërrasë, gur) shahu. E mundi në shah.

2. Gjendja në këtë lojë, kur figura e mbretit është sulmuar drejtpërdrejt nga një figurë kundërshtarë; sulm i drejtpërdrejtë me një figurë mbi mbretin e kundërshtarit. Shah i përhershëm. Shah mat. Shah me kalë. I jap shah. Jam shah.

* Gur shahu dikush që vepron sipas dëshirave të një tjetri.

SHAH II m. Titulli që mbanin mbretërit në disa vende të Lindjes (si në Iran etj.); ai që mbante këtë titull.

SHAKULLORE I f. Qese lëkure për të mbajtur një sasi të vogël duhani a bulmeti. Shakullorja e duhanit. Mbushi shakulloren me gjizë.

SHAKULLORE II f. Shakullinë. Shakullore rëre. Vjen rrotull si shakullore.

SHALË I f. Pjesa e këmbës së njeriut nga gjuri e sipër, kofshë; ana e brendshme e kësaj pjese; këmba e njeriut nga rrëza e kofshës deri poshtë te nyelli. Shala e djathtë (e majtë). Me shalë të trasha (të gjata, të holla, të shtrembra). I shkoi topi nëpër shalë.

* Iku me bisht ndër shalë përçm. shih te **BISHT**,~I. Mori bishtin ndër shalë përçm. shih te **BISHT**,~I. I shtie prush në shalë dikujt shih te **PRUSH**,~I.

SHALË II f. 1. Mbulesë e posaçme prej lëkure, që i vihet kalit a mushkës në shpinë, shtrëngohet me rrip pas trupit të tyre dhe shërben për t'u ulur në të. Kalë me shalë. Kalë (kafshë) shale kalë (kafshë) që shërben për t'i hipur dhe për të

shkuar nga një vend në një tjetër. Molla e shalës. I vë (i heq) shalën kalit (mushkës). Ulem në shalë. U rrëzua (ra) nga shala.

2. Ndenjësja e biçikletës ose e motoçikletës, zakonisht si trekëndësh, që bëhet prej lëkure të trashë dhe prej disa sustash. Shalë biçiklete. I ndërroi (i hoqi) shalën (biçikletës).

* Shalë mbi samar barrë a detyrë e re, e një shkallë më të lartë, të cilën ia ngarkojmë dikujt që është i zënë me shumë punë të tjera dhe nuk e përballon dot.

I shkon (i ka hije) si shala gomarit iron. nuk i shkon fare, nuk i përshtatet (për një rrobë etj.). Shkoi (vajti) gjaku deri në shalë (deri në bark) të kalit (deri në tra) shih te **BAR**K,~U. Zbriti (u ul) nga shala e hipi në samar iron. ra nga përgjegjësia, zbriti nga një detyrë a punë e lartë në një detyrë a punë më të ulët, zbriti nga kali e hipi në gomar.

SHAP I m. kim. Kripë minerale (sulfati i dyfishtë i aluminit e i kaliumit) që të rrudh gojën; gur i bardhë që përbëhet prej kristalesh të kësaj kripe minerale dhe që përdoret për të bërë të qëndrueshme ngjyrat e pëlhurave, për të regjur lëkurët, për të ndaluar gjakun kur pritemi pak etj. Shap i zakonshëm. Minierë shapi. Fërkoj të prerën me shap.

* E ha (e merr) shapin për sheqer e kujton si të mirë diçka që nuk është aspak e tillë, e merr sapunin për djathë. Ndjaj shapin nga sheqeri dalloj të padobishmen nga e dobishmja; dalloj të keqen nga e mira a të drejtën nga e padrejta; sqaroj një çështje që s'është e kthjellët, duke dalluar atë që është e vërtetë nga ajo që s'është e vërtetë.

SHAP II m. veter. Sëmundje e rëndë ngjitëse, që zë kryesisht gjedhin dhe që shfaqet me disa fluska në gojë, në gji e në thundër. Masat kundër shapit.

SHAPKË I f. Kapelë burrash, e sheshtë e me strehë përpara, kasketë. Shapkë ushtarake. Shapkë lëkure. Streha e shapkës. Vë (heq) shapkën.

* I heq shapkën (kapelën) dikujt shih te HEQ. Ka mizën nën shapkë (nën kësulë, nën feste) shih te MIZ/Ë,~A.

SHAPKË II f. kryes. 1. Lloj pantoflash të thjeshta, të hapura nga prapa, që mbahen zakonisht në shtëpi; sheshje. Një palë shapka. Vë (heq) shapkat.

2. Këpucë e vjetër, e shtypur prapa; këpucë e keqe. Hiqte shapkat zvarrë.

SHAPKË III f. zool. Shaptore, pulëdushke. Shapkë ujëse (uji) lloj shpendi i tillë, që rron nëpër moçalishte.

SHARK I m. 1. Lëvozhga e gjelbër që mbështjell kokrrat e disa pemëve si arra, bajamja, lajthia e gështenja, e cila bie a u hiqet lehtë kur këto piqen. Sharku i arrës (i bajames, i lajthisë, i gështenjës). Shark me gjemba. I ra sharku.

2. bot. Tuli që mbështjell bërthamën ose farat e disa pemëve si pjeshka, kumbulla, rrushi, portokalli etj. Sharku i pjeshkës (i qershisë, i ullirit, i thanës). Pemë me shark të ëmbël.

3. Lëkura që zhvesh gjarpri, këmisha e gjarprit. Sharku i bollës.

SHARK II m. Bërruc. Shark çobani. Hodhi sharkun krahëve. Mbështillem me shark.

SHARKË I f. 1. Petk i sipërm grash, i leshtë, i qepur gjerë e me kinda dhe pa mëngë ose me mëngë që nuk vishen.

2. Xhokë e gjatë.

SHARKË II f. 1. Dele sharane.

2. Përd. mb. sipas kuptimit të emrit. Dele sharkë.

SHARRËZ I f. mjek. veter. 1. Sëmundje shumë e rëndë, e cila shkaktohet nga një bacil që hyn në organizëm nëpërmjet plagësh a gërvishtjesh dhe shfaqet me tkurrje të të gjithë muskujve të trupit e me të dredhura të forta; tetanos. E zuri sharrëza. Vdiq nga sharrëza.

2. Sëmundje e kafshëve të trasha, që shfaqet me koqëza të vogla në bulçitë e në gjuhë, i fryn këto dhe i pengon kafshët që të hanë. U ra sharrëza lopëve.

3. anat. Zgjatime të mishta mbi sipërfaqen e lëkurës e të disa mukozave, që përmbajnë fundin e fijeve nervore ose të enëve të gjakut dhe që janë shumë të ndjeshme. Sharrëzat e gjuhës.

SHARRËZ II f. 1. anat. Vija dhëmbë-dhëmbë ku lidhen pjesët e kafkës.

2. Penda e kurrizit të peshqve.

SHARROJ I kal. Pres ose çaj me sharrë një copë dru, hekur, mermer etj. Sharroj një dërrasë. Sharroj drutë. Sharroj hekurat. Sharroj trupat.

* E sharroftë sharra! mallk. shih te SHARR/Ë,~A.

SHARROJ II jokal. 1. Fundosem, shkoj në fund, humbulloj; zhytem në diçka të shkrifët ose të ujshme. Sharroj në dëborë. Sharroj në llucë (në baltë). Sharroi lundra.

2. fig. Zhytem, futem thellë. Sharroj në terr. Sharroj në mendime.

3. Më vjen fundi, mbaroj; vuaj, heq keq për diçka; ngordh për të ngrënë, për të pirë etj. (edhe fig.). Sharroi krejt. Sharruan atyre maleve. Sharroi për të ngrënë. Sharroi për duhan (për një cigare). Sharroi nga uria.

SHKALIT I kal. Shkreh, dobësoj, ligështoj, flashk. E shkaliti sëmundja. E shkalitën ethet.

SHKALIT II jokal. vjet. 1. Zbres nga kali; zbres në një shtëpi a në një han për të bujtur; sos diku, arrij. Shkaliti në han.

2. kal. Shkarkoj, nxjerr, zbarkoj. Vapori i shkaliti në breg.

SHKALIT III kal. tek. I heq kalitjen diçkaje prej çeliku.

SHKALITUR I mb. I shkrehur, i dobësuar, i ligështuar, i flashkur. Ishte krejt i shkalitur.

SHKALITUR II mb. tek. Që i është hequr kalitja.

SHKALLOJ I jokal. 1. Luaj mendsh, prishem mendsh, çmendem, marrosem. Paska shkalluar fare. Shkalloi nga gëzimi. Shkallove nga mendtë? Është në vete apo shkalloi?

2. kal. E çmend, e bëj të luajë mendsh me veprimet a me sjelljet e mia. Pusho, se na shkallove! Shkalloi dynjanë!

SHKALLOJ II kal. 1. Gdhend një dru duke i bërë një si shkallë, e pres një dru me sëpatë deri në zemër, i bëj një çallatë. Shkalloj një lis (një pishë, një tra).

2. U bëj dhenve a dhive një shenjë si shkallë në vesh. I shkalloi në veshin e djathtë.

SHKARPË I f. kryes. Degë të holla e të thata, që përdoren për të ndezur zjarrin a për të bërë zjarr me flakë; karthje. Shkarpa të thata. Një krah shkarpa. Mbledh shkarpa. Vete për shkarpa. Ndez zjarrin me shkarpa.

* U bë shkarpë

a) u dobësua shumë, u hollua tepër, u tha (për njerëzit e për kafshët);

b) s'i ka mbetur më gjë, u shkund fare. Kërceu përmbi shkarpa (përmbi samar) shih te KËRCU, ~RI. Iu bë buka shkarpë mezi e kapërcen bukën a ushqimin, nuk i hahet ngaqë është i mërziur, i shqetësuar a i pikëlluar. La dasmën e shkoi për shkarpa la një punë të rëndësishme dhe merret me një punë të parëndësishme e jo të ngutshme. Nuk piqet buka me shkarpa fj. u. nuk mund të kryhet mirë një punë pa pasur mjetet e nevojshme.

SHKARPË II f. kryes. Këpucë të vjetra, të shqepura a të grisura, këpucë që s'mbathen më.

SHKARPË III f. bot. krahin. Xinë.

SHKARPË IV f. Pite pa mjaltë.

SHKESË I f. 1. etnogr. Shkuese.

2. Shkuesi. Ishte fejuar me shkesë.

SHKESË II f. 1. Kalim, shtegtim (për bagëtinë); bagëtia që është në shtegtim nëpër një vend. Dhentë janë në shkesë.

2. Reshje të forta e të befasishme, që vijnë e shkojnë shpejt. Shkesë shiu (breshri).

SHKORSË I f. Qilim i thjeshtë, i punuar zakonisht me lesh dhe, cergë; mbulesë e leshtë, velenxë; rrobë e thjeshtë që përdoret për ta shtruar a për t'u mbuluar. Shkorsë e dhirtë. Shkorsë e vjetër. Shkorsë liri (kërpi). Me një shkorsë krahëve. Shtroj (shkund) shkorsën.

SHKORSË II f. Trinë thuprash e lyer me baltë, që vendosej mbi vatër për të ruajtur trarët nga shkëndijat (në disa krahina ku e ndiznin zjarrin në mes të shtëpisë); pjesë e oxhakut të thjeshtë, e bërë prej një trine në trajtë hinke të lyer me baltë, që shërbente për të mbledhur e për të nxjerrë jashtë tymin dhe për të ruajtur trarët nga shkëndijat.

SHKRIFËRIM I m. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve SHKRIFËROJ, SHKRIFËROHET. Shkrifërimi i tokës. Ndjeu një shkrifërim në trup.

SHKRIFËRIM II m. kryes. gjeol. Shtresa të shkrifëta të kores së tokës, të formuara nga kokrrizat e lëndëve të ngurta të sjella nga lumenjtë, të cilat përmbajnë shpesh edhe grimca minerale të rralla (ar, platin, diamante); mbathje të shkrifëta. Shkrifërimi të vjetra (të reja). Shkrifërimi bregdetare. Shfrytëzimi i shkrifëtimeve.

SHKRHEM I vetv. 1. vet. veta III. Kalon nga gjendja e ngurtë në gjendje të lëngët duke u ngrohur a duke u nxehur; tretet. U shkri dëbora (akulli). U shkri gjalpi (çokollata). U shkri kallaçi.

2. fig. Bashkohem ngushtë me një tjetër duke formuar një gjë të vetme; lidhem fort shpirtërisht me një grup a me një kolektiv dhe bëhem pjesë e pandashme e tij. Shkrihem me masat (me punëtorët, me fshatarët, me ushtarët, me popullin, me nxënësit). U shkri e u bë një me malësorët. U shkrinë në një parti të vetme (në një organizatë). Këto batalione u shkrinë

në Brigadën e Pestë. Lëvizja e studentëve u shkri me luftën e klasës punëtore. Gëzimi i mësueses u shkri me gëzimin e nxënësve. Në horizont deti shkrihej me qiellin. Këto të ardhura shkrihen në pasurinë e përbashkët. Janë shkriurë organikisht.

3. vet. veta III fig. Pushon së qeni e së vepruari si një organizëm më vete. U shkri në dy drejtori (katër sektorë, dy ndërmarje).

4. vet. veta III fig. Harxhohet i tëri deri në fund, tretet, shkapërderdhet (për mallin, për pasurinë, për forcat etj.). Iu shkri gjëja e malli. Iu shkri edhe trashëgimi. Iu shkri në fuqitë.

5. Derdh të gjitha fuqitë, punoj pa kursyer asgjë. U shkri në punë.

6. Shkrihem, gjallërohem. M'u shkri në gjymtyrët.

7. fig. Tretem, dobësohem, bie nga shëndeti. U tha e u shkri. U shkri në burgjet e fashizmit.

8. fig. bised. Më del frika, çlirohem nga një anktë a nga një shqetësim i madh, më vete zemra në vend. U shkri nga lajmi që mori. Iu shkri zemra (gjaku).

9. fig. bised. Qesh a qaj me të madhe e pa pushim. U shkrimë gazit (së qeshuri). U shkri në lot (në vaj, së qari).

10. fig. Ndiej një kënaqësi të madhe, më pushton një ëndje e papërshkrueshme; jepem i tëri pas dikujt a pas diçkaje. Shkrihet pas muzikës. U shkri pas të birit.

Ai shkrihet pas saj. Shkriheshin pas njëritjetrit.

11. Pës. e SHKRIJ.

* U shkri (u tret) si krija në ujë shih te KRIP/Ë,~A

SHKRIHEM II vet.v. Sthtur gërshetat; shprish flokët e krehur, shpupurish flokët.

SHKUL I m. 1. Litër leshi, pambuku, mëndafshi etj.; torkë, çile. Një shkul lesh (pambuk, mëndafsh). Bëri katër shkule. Ngjeu dy shkule. E bëri shkulin lëmsh. E bëri lëmshin shkul.

2. fig. Shtëllungë; tufë. Një shkul drite.

SHKUL II m. 1. Shkulm. Shkul gjaku. I shkonin lotët shkul. Këndonte me shkul të zemrës.

2. përd. mb. Shumë i ngrohtë, i nxehtë, i valë. Uji ishte shkul. E përvëloi me ujë shkul. E kishte trupin shkul.

3. përd. ndajf. Shumë ngrohtë. Kjo pallto të mban shkul.

4. përd. ndajf. Duke hedhur valë, me valë (për ujin kur valon). Hiqe ujin se valoi shkul.

SHKURT I m. Muaji i dytë i vitit, që vjen pas janarit. Të ftohtët e shkurtit. Java e parë e shkurtit.

SHKURT II m. Djalë a burrë me trup të shkurtër.

SHKURTAQE I f. bised. 1. Fjala e fundit (kur bëjnë pazar). Fol shkurtaqen! Sa e ke shkurtaqen?

2. shih SHKURTJ/E,~A. I erdhi shkurtaqja.

SHKURTAQE II f. Grua me shtat të shkurtër, shkurtabiqe (edhe mospërf).

SHKURTË I f. zool. Zog shtegtar që i ngjan thëllëzës, me pendë të murrme e laralara, me këmbë të shkurtra dhe me mish shumë të shijshëm; shkurtëz. Shkurtë pikaloshë. Ecën si shkurtë.

SHKURTË II f. 1. Petk i sipërm prej shajaku ose prej pëlhure, i hapur përpara e me mëngë, që arrin deri mbi gju ose deri në mes (sipas krahinave); mëngore a gunë e shkurtër; xhakëtë e shkurtër grash, zakonisht e mbushur me pambuk dhe e rrahur me tegel. Shkurtë grash (burrash). Vishnin shkurta.

2. shih SHKURTËZ,~A 1.

3. Grua e shkurtër.

SHOJZË I f. zool. Peshk i ujërave të kripura e të ëmbla, me trup vezak e petashuq, i murrmë nga sipër e në të bardhë nga poshtë, me të dy sytë të vendosur nga ana e djathtë e trupit dhe me mish të shijshëm.

SHOJZË II f. bot. Fryti i thatë i disa drurëve, i pajisur me një flatër vemesore, që e lejon të përhapet duke fluturuar në ajër. Shojzë frashri (vidhi, panje).

SHOSHARE I f. Fem. e SHOSHAR, ~I.

SHOSHARE II f. 1. Qepshe me vrima, biralie.
2. Kulluese çaji.

SHOSHË I f. 1. Përdorëse që bëhet zakonisht prej një cope teneqeje a lëkure të shpuar vrima-vrime e të mbërthyer në një rreth druri dhe që shërben për të ndarë drithin nga gëzhutat e nga papastërti të tjera; sasia sa nxë një enë e tillë; përdorëse për të pastruar lëndë të ndryshme (si rëra, zhavorri, çaklli) ose për t'i ndarë këto sipas madhësisë së kokrrave a të copave. Shoshë e thellë. Shoshë mekanike (rrotulluese, dridhëse). Shoshë cilindrike. Shoshë dore. Shoshë gruri (misri). Shoshë zhavorri. Shoshat e kombajnës. Rrethi i shoshës. Një shoshë grurë.

2. fig. Mjet a mënyrë që shërben për të shqyrtuar diçka me imtësi e me kujdes dhe për të ndarë të mirën nga e keqja, të vërtetën nga e rrema, të drejtën nga e gabuara, atë që vlen nga ajo që nuk vlen. Shosha e parë. Shosha e Partisë. I kaloj në shoshë.

3. fig. Vend i vogël, një copë, pak. Një shoshë vend (qiell).

4. Lagës.

5. si mb. Vrime-vrime, tërë vrime. E ka tavanin shoshë. U bë shoshë nga plumbat.

* Bën vrime në shoshë bën një punë pa vlerë, bën një vrimë në ujë. Është shoshë pa rreth ka një farë aftësie a vlere, por i mungon diçka, që e bën të padobishëm. Është shoshë e prishur shih te PRISHUR (i,e). Është shoshë e shpuar mospërf. shih te SHPUAR (i,e). Të jep ujë me shoshë

a) është shumë i zgjuar e i shkathët;

b) të ngop me lugë të zbrazët. Mbush (mban, merr) ujë me shoshë (me shportë) bën punë kot; përpiqet në një

mënyrë që nuk sjell asnjë dobi. Të nis me shoshë për ujë të gënjen, ta mbush mendjen për gjëra që nuk janë të vërteta, të bën të besosh për gjëra të paqena. Rronte me një shoshë lakra shih te LAK/ËR, ~RA. Sillet si lëmshi në shoshë shih te LËMSH, ~I. Shkon (vete) me shoshë për ujë mban ujë me shoshë. I kishte zënë shosha (hambari) merimanga shih te MERIMANG/Ë, ~A. Nuk trembet ariu (arusha) me shoshë. fj. u.

a) për të bërë një punë të rëndësishme duhen mjetet e përshtatshme;

b) keq. armiku a e keqja duhen goditur me mjete të forta, derri do plumb. Nuk mbulohet (nuk zihet, nuk fshihet) dielli me shoshë fj. u. shih te DIELL, ~I. E vunë në sitë e në shoshë dikë shih te SIT/Ë, ~A. Shosha shosh, sita sit fj. u. secili ka aftësitë e veta e bën punën që ka mundësi të bëjë.

SHOSHË II f. bot. Një lloj gjembaçi, që rritet në vende të thata e nëpër rripa, me lule të përbëra e me kërcell të ëmbël, i cili hahet pasi të qërohet.

SHPATËZ I f. 1. Pjesë e parmendës që vihet pingul dhe lidh shtizën me përdhecin. Iu thye shpatëza parmendës.

2. Dërrasë e hollë dhe e ngushtë, që përdoret kur i vënë jaki këmbës a krahut të thyer. I vuri katër shpatëza.

3. shih SHPAT/Ë, ~A 3-6.

SHPATËZ II f. 1. bot. Bimë barishtore zbukuruese me gjethe të gjata, të ngushta e me majë si shpatë, me kërcell të lartë, e cila nxjerr një vile lulesh të mëdha, zakonisht të bardha, të purpurta ose të trëndafilta. Shpatëz e bardhë (e kuqe).

2. bot. Shpatore, luleshpatë. Lule (ngjyrë) shpatëze.

SHPATORE I f. Shpatinë. Shpatoret e maleve. Arat në shpatore.

SHPATORE II f. bot. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe si shpatë, me rizomë zvarritëse dhe me lule të mëdha ngjyrëvjollcë në të kaltër, që rritet deri

- në një metër; luleshpatë. Lulja e shpatores. Rrënjët e shpatores. Kanë çelur shpatoret.
2. vet. Familje bimësh barishtore shumëvjeçare si shpatorja, shpatëza etj., që i kanë gjethet si shpatë dhe lulet të mëdha, të bukura e zakonisht të mbledhura në vastakë, në kallinj a në vile.
- SHPENGM** I m. Gjendje kur e ndiejmë veten të çliruar nga diçka që na pengon, na ndrydh a na kufizon në sjelljet e në veprimet tona. Ndjeu një shpengim. I jap shpengim dikujt.
- SHPENGM** II m. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve SHPENGOJ II, SHPENGOHEM II. Afati i shpengimit.
2. Shuma që paguhet për të nxjerrë nga pengu dikë a diçka (në vendet ku merren a lihen pengje ose për kohën e kaluar). Paguanin shpengimin.
- SHPENGOHEM** I vetv. 1. vet. veta III. Lirohet nga pengorja, zgjidhet vetë (për kafshët). U shpengua mushka.
2. fig. Çlirohesh nga diçka që më pengon, më ndrydh a më kufizon në sjelljet e në veprimet e mia, i jap liri vetes.
- SHPENGOHEM** II Pës. e SHPENGOJ II.
- SHPENGOJ** I kal. I heq pengoren një kafshe, i zgjidh këmbët; kund. pengoj. Shpengoj kalin (mushkën).
- SHPENGOJ** II kal. Marr përsëri diçka që kam lënë peng, duke paguar për të shumën e caktuar; çliroj dikë që e kanë marrë peng (në vendet ku merren a lihen pengje ose për kohën e kaluar). Shpengoi shtëpinë.
- SHPËRBYTHEM** I përcm. Pës. e SHPËRBYTH.
- SHPËRBYTHEM** II vetv. krahin. Largohem; prapsem, zbythem.
- SHPËRGËTI** I f. mjek. Urdhje.
- SHPËRGËTI** II f. bot. Liken. Pastroj drurët nga shpërgëtitë.
- SHPIK** I kal. 1. E pi deri në pikën e fundit, shkulloj; nuk i lë asnjë pikë, shkrënd (kur e mjel).
- E shpiku gotën (faqoren). E shpikën pusin. E shpiku lopën.
2. fig. Përdor a shfrytëzoj diçka tërësisht e deri në fund, shteroj. I shpikën të gjitha burimet.
3. bised. Ia fitoj tjetrit të gjitha paratë, arrat etj. në lojë; ia thaj (xhepin, kuletën).
- I shpiku shokët. Ia shpikën xhepat.
4. Nxjerr ujë (nga pusi). Shpik ujë në pus.
- SHPIK** II kal. 1. Krijoj a zbuloj diçka të re që nuk njihet më parë, bëj një shpikje, ndërtoj për së pari diçka që nuk dihet. Punëtorët kanë shpikur metoda të reja pune. Ka shpikur mikroskopin (telefonin).
2. Gjej, mendoj një mjet ose një mënyrë për të bërë diçka, sajoj. Shpiku një marifet.
3. bised. Mendoj gjëra të paqena a të rreme, trilloj, shpif. E shpiku nga koka. S'kam shpikur asgjë!
4. bised. Shkaktoj, bëj, krijoj, shpif. Shpikin ngatërresa e turbullira. I shpiku të keqen ai fëmijë.
- SHPOR** I m. 1. Kocka e kraharorit të shpendëve, samari a gjoksi i shpendëve; heqës.
2. Samari i kafshës.
- SHPOR** II m. 1. Mamuz. Shporet e çizmeve. I nguli shporet kalit. Vuri shporet.
2. bot. Zgjatim si gyp i kupës a i kurorëzës së lules, ku mbledhet nektari.
- SHPOR** III m. 1. Lehe, vllajë; pjesa ndërmjet dy hullive në një arë të palëruar, e gjerë aq sa arrin krahu kur hedhim farën e grurit. Ujitje me shpore. Ka mbjellë dy shpore me duhan. Hedh farën shpor për shpor. Tetë shpore u bë ara.
2. Vijat që ndajnë lehet dhe që shërbejnë për të ujitur a për kullimin e tokës; vija të vogla që hapen nëpër ara, që të përhapet

uji sa më mirë gjatë ujitjes; lehe. Zë shporin. I bëmë shporet arës.

SHPREHEM I vetv. 1. Shpreh mendimet, ndjenjat a pikëpamjet e mia. U shprehën të një mendimi me ne. U shprehën me fjalët më të mira. Shprehem për diçka (kundër diçkaje). Shprehet bukur (qartë). Nuk di të shprehet.

2. vet. veta III. Pasqyrohet, mishërohet. Në festivalin folklorik u shpreh gjenia krijuese e popullit.

3. vet. veta III. Shënohet a njehsohet në një njësi ose në një masë të caktuar. Shprehet në centimetra katrorë. Shpenzimet shprehen në para.

4. Pës. e SHPREH.

SHPREHEM II vetv. bised. Prehem, çlodhem. Shprehu pak! Më shprehet mendja.

SHQIPE I f. Gjuha shqipe. Shqipja e sotme. Shqipja letrare kombëtare. Leksiku i shqipes. E di

(e ka mësuar) shqipen mirë.

SHQIPE II f. zool. 1. Shqiponjë. Shqipja arbërore. Shqipja dykrenore. Shqipe mali. E rrëmbeu shqipja. U vërsul si shqipe.

2. përd. mb. Shumë e shkathët dhe e zonja në punë; trime (për vajzat e gratë). E ka nusen (çupën) shqipe. Është shqipe.

SHTËNË I mb. Që i pëlqen dikush a diçka, që e do a që e ka qejf shumë, i dhënë (me një emër të paraprirë nga parafjala «pas»). I shtënë pas punës. I shtënë pas gjahut (pas muzikës, pas sportit, pas matematikës). I shtënë pas parave pas (rakisë) Është shumë i shtënë pas fëmijëve (pas së shoqes).

SHTËNË II mb. I shtirë. Gëzim i shtënë. Mirësjellje e shtënë.

SHTËNË III mb. Shtiak. Kec i shtënë.

SHTIAK I mb. 1. Që shtiret, që është me dy faqe. Njeri shtiak.

2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Ua nxori bojën shtiakëve.

SHTIAK II mb. 1. Pjellë e dështuar, dështak. 2. Përd. em. sipas kuptimit të mbiemrit. Shtiakët janë pakësuar.

SHTIHEM I vetv. 1. Jepem fort ose bie, pas dikujt a pas diçkaje. Është shtënë pas muzikës (pas gjahut, pas të pirit). U shti pas saj.

2. pavet. Më teket, më pushton një dëshirë e madhe për diçka (zakonisht për gjëra që hahen). M'u shti për peshk. Iu shti për byrek me kungull.

3. pavet. Më bëhet sikur shikoj dikë a diçka (në ëndërr), më duket, më përhihet. M'u shti në ëndërr (në gjumë).

4. Pës. e SHTIE.

SHTIHEM II vetv. shih SHTIREM.

SHTIRË I mb. Që bëhet sa për sy e faqe për të mashtruar të tjerët, për të përfituar diçka etj., jo i sinqertë, shtinjak. Përzemërsi e shtirë. Gëzim i shtirë. Buzëqeshje (keqardhje) e shtirë.

SHTIRË II mb. 1. Dështak, shtiak. Kec i shtirë.

2. Që ka dështuar, që ka shtirë. Dele (dhi) e shtirë.

3. fig. I dobët nga trupi, ligaç, ngordhalaq. Është si i shtirë.

SHTUF I m. 1. Gur i lehtë, i thërrmueshëm e me shumë pore, i formuar nga lidhja e çimentimi i grimcave të hirit dhe të pluhurit vullkanik, që përdoret në ndërtim etj. Gur shtufi. Pllakë shtufi. Damar shtufi.

2. Shkëmb ranor i butë e i thërrmueshëm, që përdoret në ndërtim në vend të rërës. Shtuf gëlqeror (ranor).

3. Përd. mb. sipas kuptimeve të mbiemrit. Gur shtuf. Tokë (kodër, vend) shtuf.

SHTUF II m. anat. Ashti i krahut nga bërryli deri te supi; sup. Shtufi i krahut. Puna do shtufe e shpatulla.

SHUMË I pakuf. 1. Përdoret për të treguar në mënyrë të pacaktuar një numër të madh qeniesh, sendesh, dukurish etj., një sasi a masë të madhe; kund. pak. Shumë

njerëz (gra, fëmijë, fshatarë). Shumë shtëpi (shkolla, libra). Shumë fjalë. Shumë zhurmë. Shumë kohë. Ka shumë shokë (miq). Ka rënë shumë shi (dëborë). Kishte shumë baltë (pluhur). Kaluan shumë vjet. Ka shumë durim (vullnet, dëshirë). Ka shumë të drejtë. Ishin ftuar (erdhën) shumë. Ka parë (njeh) shumë ai. Trimi i mirë me shokë shumë. fj. u. Më mirë pak e saktë, se shumë e për lumë. fj. u.

2. Përdoret për të treguar në mënyrë të pacaktuar një numër të madh ose një pjesë të madhe të një tërësie qeniesh, sendesh etj.; kund. pak. Shumë nga partizanët. Shumë nga mësuesit. Shumë prej tyre. Shumëve nuk u pëlqejnë këto.

* Është lis me shumë degë shih te LIS, ~I. I lëshon shumë ujë mullirit tall. shih te LËSHOJ. Mish pak e pupla shumë shih te MISH, ~I. Njeri me dyzet (me njëqind) flamurë shih te FLAMUR, ~I. Ka pirë ujë në shumë burime (kroje) shih tek UJ/Ë, ~I. Ka rrjedhur shumë ujë shih tek UJ/Ë, ~I. Shumë pula e pak vezë shih te PUL/Ë, ~A.

SHUMË II ndajf. 1. Në një shkallë të lartë, fort; në një masë të madhe; kund. pak. Shumë e më shumë gjithnjë e më tepër. Gjithnjë e më shumë. Çdo vit më shumë. Pak a shumë në një farë mase. Ku më pak e ku më shumë. Punon (lexon, mëson, mendon) shumë. Kupton (sheh, dëgjon) shumë. Djeg (shkëlqen) shumë. Ka hequr (ka vuar) shumë. U lodhën shumë. I dhemb shumë. Duhet shumë ata të dy. Pret shumë (thika). Të falënderoj shumë. Flitet shumë për këtë ngjarje.

2. Më tepër sesa duhet a sesa është e nevojshme, tepër. Ka zier shumë. Ai flet shumë. Fjeti shumë. Ka ngrënë shumë. Ka ndenjtur shumë në diell.

3. Gjatë, për një kohë të gjatë, mjaft kohë. Ndenji shumë. S'ka shumë që u kthye. Ka shumë që ka ikur? Zgjati shumë (mbledhja). Nuk do të vejë shumë kjo punë.

4. Përdoret me pjesëzën «më» kur pohojmë diçka më me forcë, duke e krahasuar ose duke e kundërvënë me diçka tjetër (në kuptimin «kryesisht, në radhë të parë»). Është më shumë yni se juaji. E kam më shumë me ty se me atë. Është më shumë tregim i gjatë sesa roman.

* Aq më shumë veçanërisht, sidomos, aq më tepër; madje. E hapi shumë gojën shih te GOJ/Ë, ~A.

SHUMË III pj. 1. Përdoret para një mbiemri a një ndajfoljeje për të formuar shkallën sipërore dhe tregon një shkallë të lartë të cilësisë së një frymori, të një sendi etj. ose të veprimit a të gjendjes. Shumë i gjatë (i mirë, i dashur, i shpejtë, i ri, i aftë, i kënaqur, i fortë). Shumë trim (besnik, kokëfortë, mendjehetë). Shumë pjellore. I bukur shumë. Shumë mirë (keq). Shumë afër (larg). Mbahet shumë rëndë. Janë shumë shokë (miq) janë shokë (miq) të ngushtë.

2. Përdoret përpara shkallës krahasore të sipërisë të një mbiemri a të një ndajfoljeje për të treguar dallimin e madh cilësor ndërmjet gjymtyrës së parë e gjymtyrës së dytë të krahasimit; kund. pak. Është shumë më i fortë (më i aftë, më zemërgjerë, më punëtor) se tjetri. Futuron shumë më lart (më shpejt, më ngadalë) se ai. Shumë më mirë (më keq, më pak) se ...

TA I 1. Trajtë e shkurtër e shkrirë e përemrit vetor, e formuar nga bashkimi i trajtës së shkurtër të vetës së dytë në rasën dhanore të numrit njëjës (të) me trajtën e shkurtër të vetës së tretë në rasën kallëzore të numrit njëjës (e). Ta dhashë fjalën. Ta thashë një herë.

2. Shkrirja e pjesëzës (të) të mënyrës lidhore të foljeve me trajtën e shkurtër të përemrit vetor të rasës kallëzore të numrit njëjës (e). Ta gjejë menjëherë! Ta kthejë mbrapsht! Ta marrë domosdo!

TA II përem. Ata (kur përdoret pas parafjalëve). Fola me ta. Shkoi me ta. Kujdeset për ta.

- TABAK** I m. Fletë e madhe dhe e hollë letre, llamarine etj.; fletë e madhe letre për të shkruar, e palosur më dysh; fletë letre për duhan. Një tabak letër. Tabak i madh llamarine. Tabak kartoni (lëkure). Tabak duhani. Pres tabakët. Mbush dy tabakë me shkrim të imët.
- TABAK** II m. vjet. Lëkurëregjës. Dyqani i tabakëve. Lagjja (rruga) e tabakëve.
- TAÇ** I m. 1. Derrkuci që dosa e pjell të fundit, derrkuci më i vogël.
2. I fundit i fëmijëve, djali më i vogël e më i përkëdhelur; fëmija i pleqërisë.
Është taçi i tij ai.
- TAÇ** II m. vjet. Qylaf i bardhë me një rrip të gjelbër, që e mbante shehu, dervishi e babai i bektashinjeve.
- TAJË** I f. Grua që ushqen me gji një foshnjë të huaj, mëndeshë. E ka tajë. E vuri foshnjën në tajë i gjeti foshnjës një grua për t'i dhënë gji.
- TAJË** II f. spec. 1. Vidhë, burme.
2. vjet. Torno.
- TAKT** I m. Kujdes e pjekuri në veprime e në të folur me të tjerët, sjellje e matur dhe e menduar mirë, mënyrë e kujdesshme dhe e përmbajtur kur u flasim të tjerëve, kur i qortojmë ose kur u vëmë në dukje ndonjë të metë. Takt pedagogjik. Takt diplomatik. Njeri me takt. Duhet takt me njerëzit. Kërkon (do) takt puna. Ka takt. Sillet (vepron) me takt. Ndërhyri pa takt.
- TAKT** II m. 1. muz. Një nga njësitë metrike, në të cilat ndahet një pjesë muzikore; shenjë grafike në trajtë të një vije pingule, që vihet në kufijtë e kësaj njësie. Luajti (këndoi) tri taktet e para.
2. gjuh. Pjesa më e shkurtër e kupitshme e frazës, që veçohet gjatë të folurit me anë të intonacionit dhe të ritmit. Takti i ligjërimit (ligjërimor).
3. spec. Pjesë e ciklit të plotë, që kryen një mekanizëm gjatë punës së vet.
Takti i parë. Takti i pistonit të makinës. Fundi i taktit të shtypjes.
- TAMAM** I ndajf. 1. Aq sa duhet, as më shumë e as më pak; ashtu si duhet, në rregull. I rrinë tamam këpucët (rrobat). I vjen tamam bluza (kostumet). Janë tamam paratë (delet).
Është tamam për martesë.
2. Krejt njëlloj, pikë për pikë, njësoj, gjallë; barabar. Tamam i ati (e ëma, e motra, i vëllai). Janë tamam me njëri-tjetrin (nga mosha, nga madhësia, nga gjendja).
- TAMBLATORE** I f. krahin. Lopë qumështore.
- TAMBLATORE** II f. bot. krahin. Qumështore.
- TAS** I m. 1. Enë e thellë dhe e rrumbullakët, në madhësi të ndryshme, prej balte, prej metali etj., që përdoret për gjellë, për bulmet ose për ushqime të tjera; sasia sa nxë një enë e tillë. Tas kosi. Një tas fasule (pilaf, qumësht, kos). Një tas me miell (me gjizë, me gjalpë, me supë, me ashure, me pilaf). Mbushi tasin. Hanin në një tas.
2. Gotë a filxhan i madh e pa bisht, zakonisht prej balte ose prej metali. Tas uji.
Tas çaji. Pi me tas.
- TAS** II m. Pëllumb me kaçul në kokë.
- TELISH** I m. Tërësia e fijeve të holla prej argjendi ose prej ari për punime argjendarie; punim i hollë a i imët me këto fije. Figurë prej telishi. Zbukuruar (punuar) me telish.
- TELISH** II m. bot. Bimë shumëvjeçare, me kërcëj të dendur, me rrënjë të holla e me shumë gjethe në fund, që rritet në kulota e në livadhe dimërore, lulëzon nga maji në korrik dhe shërben si ushqim për bagëtinë.
- TERRATISËT** vetv. vet. veta III. Errësohet, erret. U terratis qielli. U terratis jashtë. M'u terratisën sytë.
Iu terratis mendja.
- TERROHET** vetv. vet. veta III. Errësohet, erret. U terrua jashtë. I terroheshin sytë.

TESTE I f. 1. Moshë e njëjtë, vërsë; brez njerëzish. Testja jonë. Ishin të një testeje.

Ishte si në testen tënde.

2. Njerëz të një zanati, të një profesioni a të një niveli kulturor, njerëz të një shkalle a të një dore. Ishin një teste. Ishte i testes sonë.

3. Cilësi, lloj, kategori (për pijet dhe sendet ushqimore). Testja e parë (e dytë).

TESTE II f. 1. Dhjetë copë të një lloji (lugë, pirunj, thika, filxhanë etj.) të marra së bashku.

Bleu një teste pjata (filxhanë). U thye një pjatë nga testja.

2. krahin. Shtupës hudhrash; qysqi për të shtypur kafënë në gur.

3. Filxhani ku fshihet unaza a diçka tjetër (në lojën e filxhanëve a të kapçave).

E gjeti testen.

* I ra në teste e kuptoi ku ishte qëllimi, e kapi menjëherë, i ra në të, i ra në shenjë.

TË I Trajtë e shkurtër e përemrave vetorë të vetës së dytë në rasën dhanore e kallëzore të numrit njëjës. Të pashë nga larg (ty). Të fola (ty). Të thashë një herë (ty).

TË II përem. Trajtë e shkurtuar e përemrave vetorë e dëftorë ai, ajo, në rasën kallëzore; atë (në bashkëvajtje me parafjalë). E pashë me të. Folëm për të. E mora pa të.

* I ra në të (në fije, në fill) shih te FIJ/E, ~A. Nuk është në të nuk është në vete, nuk është në rregull. S'ka gjë në të nuk i ka punët në vijë; e ka gabim.

TË III 1. Nyjë e përparme e gjinisë mashkullore a femërore në numrin njëjës ose shumës tek emrat e rasës gjinore, tek emrat e mbiemrat e nyjshëm, te mbiemrat e emëruar, te numërorët rreshtorë dhe te disa përemra; nyjë e përparme e emrave prejpesorë të gjinisë asnjësore. Nxënësve të shkollës sonë. Punonjësvë

të institutit tonë. Vajzave të fshatit tonë. Qytetit të ri. Të dashur, shokë! Të parët, në punë. Djemve të tij

(të saj, të vet). Njerëz të tillë. Të dhëna të përpikta. I foli me të butë.

Procesi i të menduarit.

2. Nyjë e përparme me kuptimin e përemrave pronorë të vetës së tretë, e cila përdoret me emra që shënojnë njerëz sipas lidhjeve të gjakut, sipas lidhjeve familjare etj.; të tij, të saj. I tha të birit (të vëllait, të vjehrrit, të shoqit, të nipit, të kushëririt, të kunatit). Ua la trashëgim të bijve (të bijave, të vëllezërve).

Ia ktheu (ia dha) të zotit.

TË IV 1. Nyjë e pasme e mbaresë shquese e shumësit të emrave (sot në një varg rastesh edhe në trajtën -t; p.sh. miq-të, kala-të, vëllezërit, motrat, lisa-t, gurë-t, toka-t etj.).

2. Nyjë shquese për emrat asnjës prejpesorë (sot një trajtën -t; p.sh. të hyrët, të dalët etj.); vjet. nyjë shquese për emrat asnjës (p.sh. ballë-t, mjaltë-t, ujë-t etj.).

TIS I m. 1. Cipë a napë e hollë. Tis i bardhë (i zi).

2. mjek. Cipë e hollë në sy, perde. I kanë vënë sytë tis.

3. Shtresë e hollë; që mbështjell a që mbulon diçka. Tis avulli (mjegulle, tymi).

Një tis resh.

* I kanë vënë sytë tis nuk i kupton gjërat, i janë verbuar sytë.

TIS II m. bot. Bërshen.

TITAN I m. kim. Metal i bardhë si argjendi, më i rëndë dhe më i fortë se alumini, që përdoret në industri, zakonisht i lidhur me metale të tjera, për të bërë vagonë, lokomotiva, automobila, traktorë etj. (Simboli Ti). Fletë titani. Lidhje titani.

TITAN II m. mit. 1. Qenie, që sipas mitologjisë greke, përfytyrohej si njeri me trup shumë të madh e me fuqi të

mbinatyrshe dhe që gjoja luftonte me perënditë.

2. fig Njeri me trup të madh dhe me fuqi të jashtëzakonshme, vigan.

3. fig. lart. Njeri shumë i shquar, që ka çarë rrugë të reja në një fushë të veprimtarisë shoqërore, të kulturës, të shkencës etj. dhe i ka sjellë shërbime të mëdha njerëzimit, njeri që dallohet për dhuntinë e tij të jashtëzakonshme; vigan. Titan i shkencës (i letërsisë). Titanët e mendimit njerëzor.

TOGË I f. usht. Njësi e vogël ushtarake në përbërje të kompanisë, e ndarë në dy deri në katër skuadra. Togë këmbësore. Toga e zbulimit. Komandanti togës.

Mbledh (shpërndaj, stërvit) togën.

TOGË II f. hist. 1. Veshje sipërme e gjatë, zakonisht e bardhë, që mbanin qytetarët; zyrtarët lartë e priftërinjtë në Romën e lashtë. Togë me shirit të qëndisur.

2. fig. libr., keq. Mbulesë për të fshehur përmbajtjen e diçkaje ose qëllimin e vërtetë, petk, veshje. Ka veshur togën e marksistit.

TOJË I f. 1. Gjalmë a lidhëse prej leshi, prej pambuku a prej liri me shumë fije të dredhura, që përdoret për të lidhur çorapet ose opingat; retër; fill çfarëdo, për të lidhur diçka, lidhëse; litar. Tojë lesh (pambuku, liri). Tojë e hollë (e trashë). E lidhi me tojë.

Lidhi (zgjidhi, shtrëngoi) tojën.

2. Fiteli i kandilit. U dogj toja.

3. Secila nga fjetet e para të trasha që tërhiqen nga fshikëza e mëndafshit dhe që zakonisht nuk përdoren për punime; tepricat e fshikëzave të mëndafshit. Grumbullimi (shfrytëzimi) i tojave. Tërhoqi tojën.

4. Fill i gjatë, me një grep në fund; i lidhur zakonisht në kallam, që përdoret për të zënë peshk. Hodhi tojën. Mblodhi (tërhoqi) tojën.

5. Pipi i hardhisë, që lidh rrush. Tojat e hardhisë.

TOJË II f. zool. Kurrillë. Tufë tojash. Fluturimi i tojave.

TOKË I f. vet. nj. 1. Planeti ynë, si një nga planetët e sistemit diellor; rruzulli i këtij planeti me pjesën e fortë e me pjesën ujore, si edhe shtresa e gaztë (atmosfera) që e rrethon atë; planeti ku jeton njerëzimi në tërësinë e tij; bota. Rruzulli i tokës. Boshti i Tokës. Korja e Tokës. Bërthama (qendra) e tokës. Ekuatori i tokës. Meridianët e tokës. Jeta në tokë. Toka rrotullohet rreth Diellit. Toka është e rrumbullakët.

2. Pjesa e fortë e rruzullit tonë në kundërvënien me ujin a e kufizuar prej tij; Tokë e mbyllur. Toka e Arktikut. Në tokë e në det. Zbriti (zbarkoi) në tokë. Zbriti (zbarkoi) në tokë. Doli në tokë. E nxori në tokë. Uji lag tokën.

3. Korja e rruzullit tonë në tërësinë e saj a në një pjesë të caktuar; shtresa e sipërme e kësaj koreje; lënda e fortë a e shkrifët që përbën koren e rruzullit tonë; dhe. Tokë e bardhë (e zezë, e verdhë, e përhime). Tokë e hedhur. Lëkundjet e tokës. Shembjet (shkarjet) e tokës. E futi në tokë. E nxori nga toka.

4. Rrafshi, në të cilin qëndrojnë e lëvizin njerëzit, kafshët etj., sipërfaqja, trualli. Ulem (shtrihem) në tokë. Rri (bie) në tokë. Zvarritem për tokë. Ngrihet mbi tokë. Zhvillohet nën tokë. Vë këmbën (gjurin) në tokë. Prek tokën. U ngrit nga toka.

Zuri tokë. Shkeli në tokë. Preku tokën. U bë njësh me tokën.

5. Copë trualli që e punojmë dhe e mbjellim me bimë bujqësore; me pemë, me bar etj.; arë, vresht, pemishte etj.; vend i kufizuar, i punuar a në gjendje natyrore, që e ka dikush dhe e përdor për diçka. Tokë e vogël (e madhe). Tokë pjellore. Tokë e lëruar. Toka të reja. Tokë e ujtur (nën ujë). Tokë e punueshme. Tokë djerre. Tokë buke. Tokë për vreshta (për duhan, për pyje, për kullotë). Tokë për vreshta (për duhan, për pyje). Tokë kullotë. Tokat e kooperativës. Tokat e

kishës (e teqesë). vjet. Kullimi i tokës. Pjelloria e tokës. Punojmë (lërojnë, mbjellin) tokën. Hapën tokë të re. Pasurohet (varfërohet) toka. Nuk lejohet shita (blerja) e tokës. Toka i takon atij që e punon.

6. Sipërfaqe e pakufizuar; pjesë e sipërfaqes së rruzullit tonë ashtu siç është. Tokë e zhveshur (e veshur). Toka të panjohura (të pafundme).

7. gjeol. Shtresë gjeologjike me ndërtim të veçantë nën ndikimin e faktorëve kimikë, biologjikë etj. Tokë ranore argjilore, gëlqerore. Tokë e kripur. Përbërësit e tokës. Shkenca mbi tokën.

8. lart. Vend, shtet; atdhe. Toka arbërore. O toka ime! Toka mëmë. E duam tokën tonë. Dëbuam armikun nga toka jonë.

* Ra në tokë lindi (për fëmijët). Ra për tokë ra shumë poshtë (për gjendjen shpirtërore etj.). Fiton tokë (truall, vend) shih te FITOJ. Humb tokë libr. shih te HUMB. Është për tokë është në gjendje shumë të keqe (për prodhimin, disiplinën etj.); nuk vlen fare, është shumë keq (për një njëri me përgatitje të dobët, e sjellje të keqe etj.). S'e ka toka! është shumë i mirë a i bukur, s'e ka shokun a shoqen, s'ka të tillë në botë. Nuk e mban toka diçka shih te MBAJ. Nuk e mban toka (vendi) dikë shih te MBAJ. Dy pëllëmbë mbi tokë shih te PËLLËMB/Ë, ~A 4. S'e prek tokën dikush shih te PREK. Prush në tokë (në hi) shih te PRUSH, ~I. Puthi tokën (truallin) dikush u përul me nderim përpara dikujt; ra në gjunjë përpara dikujt a diçkaje. Si qielli me tokën shih te QIELL, ~I. Rren për tokë (shtruar) shih te RREJ. Rri në tokë! iron. jo more! (kur dikush thotë diçka shumë të çuditshme e të pabesueshme). Me shpinë në tokë (përdhe, përfundi) shih te SHPIN/Ë, ~A. E zbriti në tokë dikë e ka bërë të njohë e të kuptojë jetën e vërtetë që e rrethon, kushtet e vërteta, në të cilat punon e vepron. Zë tokë shih te ZË. Kur të bashkohet (të takohet, të puqet) qielli e toka (qielli me tokën) iron.

shih te QIELL, ~I. U bë një (njësh) me tokën vdiq. E bëri një (njësh) me tokën e shkatërroi krejt, e rrafshoi (një qytet, një fshat, një shtëpi etj.). E bëri tokë e tavan shtëpinë etj. e bëri rrëmujë, e bëri lesh e li, e bëri lëmsh. E bëri rrafsh me tokën shih te RRAFSH. S'i bie fjala në (për) tokë nuk thotë asnjë fjalë pa vend, e di se ç'flet, nuk flet kot; është i pjekur, i matur; është i zgjuar. I ranë duart në tokë dikujt

a) i ngrinë, iu thanë duart nga të ftohtët;

b) iu këputën, iu lodhën shumë duart nga një punë e rëndë dhe e pandërprerë. Mos të rëntë shpina për tokë! shih te SHPIN/Ë, ~A. I digjet (i zien) toka (trualli) nën këmbë shih te DIGJEM. Nuk është ende në tokë të bukës dikush nuk ka filuar ende ta fitojë bukën vetë. S'është as në qiell as në tokë (as në dhe) shih te QIELL, ~I. S'e mban (s'e duron) as qielli as toka (as dheu) shih te QIELL, ~I. Qielli me tokën të bashkohen! shih te QIELL, ~I. I rrëshqet (i shket, i luan, i lëviz, i dridhet) toka (trualli) nën këmbë shih te KËMB/Ë, ~A. Taktika (politika) e tokës së djegur shkatërrimi i plotë i çdo gjëje, që bën një ushtri pushtuese në një vend të caktuar për të mposhtur qëndresën e popullit. S'i zënë këmbët tokë (dhe, vend) shih te KËMB/Ë, ~A. E kërkoi në qiell, e gjeti në tokë shih te QIELL, ~I. S'e lë fjalën të bjerë në tokë (përdhe, përtokë) i dëgjon me vëmendje fjalët që i thotë dikush, nuk i shpëton asnjë fjalë; është i zgjuar dhe i mprehtë. E ka një këmbë në tokë, një këmbë në varr shih te VARR, ~I. Ajo e tokës (sëmundja e tokës) mjek., euf. epilepsia. Kadaifi i tokës bot. shih te KADAIF, ~I. Lëngata e tokës (e hënës) mjek., euf. shih te LËNGAT/Ë, ~A. Skeleti i tokës bujq. shih te SKELET, ~I. Tokë skeletore bujq. shih te SKELETOR, ~E. Krimb toke bot. shih te KRIMB, ~I. Man toke bot. shih te MAN, ~I. Mizë toke (dheu) zool. milingtonë. Qershi toke bot. shih te QERSHI, ~A. Rrush toke (frëngu) bot. shih te RRUSH, ~I.

TOKË II f. Pllakë e metaltë, së cilës i bien për të dhënë një shenjë; tingëllima e saj; çangë.

Toka e punës (e pushimit). Toka e drekës. Ra toka. Fillojnë punën me tokë.

TON I m. Njësi peshe e barabartë me një mijë kilogramë ose me dhjetë quintalë. Një ton grurë. Dhjetë tonë misër. Kanë prodhuar njëqind tonë mbi planin.

TON II m. zool. Peshk i madh grabitqar, deri në pesë metra i gjatë e me peshë deri në pesëqind kilogramë, me kurriz në ngjyrë blu të errët e me bark pulla -pulla, që rron zakonisht në detet e ngrohta. Gjue-tia e tonit. Konserva toni.

TON III m. 1. Tingull i rregullt në një lartësi të caktuar, që prodhohet nga lëkundje të njëpasnjëshme të valëve të ajrit; tingulli në kundërvënie me zhurmën. Ton i thjeshtë (i përbërë). Ton i lartë (i ulët). Ton i pastër.

2. muz. Tingull muzikor; intervali më i madh ndërmjet dy notave të njëpasnjëshme në gamën muzikore; tingulli muzikor bazë me të cilin nis një këngë a një vepër tjetër muzikore. Gama ka pesë tone dhe dy gjysmëtone. Një ton më lart (më poshtë). I dha tonin korit (orkestrës).

3. Forca a lartësia e zërit kur flasim. Ngre (ul) tonin. Fliste me ton të lartë.

4. zakon. libr. Nuancë e hollë e një ngjyre, ngjyra a nuanca nga anon një ngjyrë tjetër. Me tone të hapura (të çelura). Me tone të errëta. Tonet e ngjyrës.

5. Mënyra si flasim a si shkruajmë, mënyra si i themi gjërat për të shprehur më qartë ndjenjat, qëndrimin e vlerësimin tonë për dikë a për diçka. Me ton të ashpër (të butë). Me ton të ngrohtë (të ftohtë). Me ton lutës. Me ton atëror (këshillues).

Me ton të prerë (të vendosur). Me ton tallës (qortues). Me ton zyrtar. Iu përgjigj me po atë ton. Ndërroi (ndryshoi) tonin.

* I jep tonin (jetës, mbledhjes, etj.) libr. e përcakton, e bën të marrë një drejtim a një rrugë të caktuar (një mbledhje, një punë etj.); bën diçka që shërben si shembull për të tjerët bëhet shembull për diçka.

TORBË I f. Trastë. Torbë e madhe (e vogël). Mbushi (zbrazi) torbën.

* E futi në torbë e bëri për vete plotësisht duke ia hedhur, e shtiu në grackë. Me kokë (me krye) në torbë (në trastë, në thes) me rrezik të madh për jetën, duke rrezikuar jetën. Si torba (si trasta) në degë shih te DEGË, ~A. Me torbë me trastë shih tek TRASTË, ~A. Nuk ia var torbën (trastën, kapistrën, kapistallin, këmborën, hejbetë) shih te VAR. S'ka gjë në torbë (në trastë) nuk ka siguruar gjë, nuk ka gjë në dorë nuk i ka punët mirë, nuk ka gjë në vijë (për një punë, një çështje). Iu qep me bukë në torbë (në trastë) dikujt shih te BUK/Ë, ~A. E vuri kokën (kryet) në torbë (në trastë) rrezikoi kokën, ndërmori një veprim duke rrezikuar jetën. Fjalë të mira e gurë në torbë (në trastë) shih te GUR, ~I. As në thes, as në torbë shih te THES, ~I. E mban në torbë bukën e barutit është gati për gjithçka, me bukë e me armë, është gati për të përballuar çdo rrezik.

TORBË II f. Deng fijesh pambuku, me peshë nëntë kilogramë. Dy torba pambuk! Mblodhi (lidhi) torbën. Ngarkoi torbat.

TORTË I f. Litar i trashë, zakonisht prej lëkure bliri, që përdoret për të lidhur, për të mbartur a për të tërhequr barrë të rënda. Lidhi barrën (varkën) me tortë.

* E zgjat (e tjerr) tortë diçka e zgjat shumë dhe pa nevojë një punë, një bisedë etj., e bën tërkuzë.

TORTË II f. Ëmbëlsirë në trajtë të rrumbullakët a katërkëndëshe me përmasa të ndryshme, pa sherbet e me disa shtresa që bëhet me miell, me vezë, me sheqer, me qumësht etj., mbushet brenda, me krem, me arra të shtypura etj. dhe zbukurohet përsipër e anash; një copë

nga kjo ëmbëlsirë, e prerë zakonisht në trajtë trekëndëshi. Tortë me arra e me gjalpë. Tortë me bajame. Një copë tortë. Preu tortën. Hëngrën nga një tortë.

TRAP I m. 1. Vija që hap plori, hulli, brazdë; vijë e thellë në tokë; hendek. Trap i thellë. Kapërceu trapin. Mos ec me vrap, se bie në trap. fj. u. Pa hedhur trapin, mos thua j «hop». fj. u.

2. Përrua i ngushtë dhe i thellë; shtrati i tij. Kaloi trapin.

3. Gropë e thellë në tokë ku futin patatet gjatë dimrit për t'i ruajtur nga të ftohtët;; gropë e madhe. I futën patatet në trap.

4. Vend i ngritur anës një hendeku nga dheu i hedhur, ledh; rrip toke në mes të dy arave, zakonisht i ngritur dhe i papunuar, që shërben si kufi a për të kaluar; ana e arës që nuk punohet; breg. Trapi i hendekut. Trapi i orës. Ecin (kalojnë) trapeve. Ishte mbushur lumi (hendeku) trap më trap.

5. Udhë e ngushtë në mal a në pyll, shteg; dhiare.

6. krahin. Lehe. Trap me domate (me qepë, me duhan). Trap lulesh.

7. krahin. Pyll i dendur me drurë të shkurtër. Hyri në trap.

* Bie në trap (në kurth) shih te KURTH, ~I. Ku ta nxjerrë trapi të bëhet si të bëhet; të dalë ku të dalë (për një punë, për një çështje etj.).

TRAP II m. Mjet i thjeshtë lundrimi, i ndër-tuar zakonisht me trungje të lehtë ose me dy lundra të vogla, mbi të cilat mbërthehen dërrasa që formojnë një shesh të gjerë; trung druri ose disa dërrasa të lidhura bashkë, me të cilat kalohet një lumë, një liqen etj. Trap i madh. Nget trapin. E kaloi lumin me trap. I ngarkoi në trap.

TRAPIT I jokal. 1. Kaloj nëpër shtigje të ngushta e dhiare, eci nëpër trape (në mal a në pyll); eci nëpër shtigje që e shkurtojnë udhën, shkoj rrugë e pa rrugë për të arritur më shpejt, i bie shkurt, pres

shkurt. Trapiti sapo e lajmëruan erdhi shumë shpejt.

2. Bredh poshtë e lart, shëtit a shkoj andej-këtej. Trapit gjithë ditën. Trapit andej-këtej. Nga trapit? Kush trapit shumë, mbetet pa punë. fj.u.

3. kal. Kërkoj diçka a dikë andej-këtej, e kërkojnë çdo vend. Ku nuk e trapitën.

E trapiti tërë ditën dhe s'e gjeti.

TRAPIT II kal. Bëj gjedhen e një veprë artistike me baltë, me allçi, me laps etj., i jap trajtën e parë; bëj modelin, modeloj; përvijoj. Trapiti një shtatore.

TRETAR I m. 1. hist. Ai që i merrte pronarit për përdorim tokën a bagëtinë dhe i jepte një të tretën e prodhimit.

2. hist. Ai që mblidhte të tretën, ai që merrte të tretën.

TRETAR II m. Trinjak. Lindi tretarë.

TROP I m. let. Fjalë a shprehje që përdoret me kuptim të figurshëm për t'i dhënë ligjërimin fuqi shprehëse më të madhe. Metafora është një lloj tropi.

TROP II m. Bërsi rrushi; rrushi i shtypur që lihet për t'u bërë verë.

TULLAR I m. Vegjë, avlëmend, tezgjah. Punon në tullar.

TULLAR II m. Ai që bën tulla. Punon si tullar.

TURRË I f. 1. Grumbull drush të vëna me rregull njëra mbi tjetrën, stivë; grumbull sendesh të një lloji. Turrë drush. Turrë librash (fletorësh). Turrë rrobash. Turrë kashte disa duaj kashte të lidhur së bashku. I vuri drutë turrë.

2. Tufë, grup. Ka një turrë fëmijë.

3. Torkë, shkull leshi, pambuku etj.; katër-pesë shkule të lidhura së bashku. Turrë leshi (pambuku). E bëj fillin turrë. Trikoja do katër turra.

4. Topth që bëhet me bukë të përsheshur, me djathë e me gjalpë, të ngjeshur në një shami dhe që e marrin fëmijët në dorë; topth buke, brumi etj.; që bëjnë për t'ua

futur shpendëve në gojë (sidomos për të mëkuar gjelat e detit). I dha një turrë në dorë. E ushqeu me turra buke. E bëri bukën turra.

* Është bërë turrë

a) është mbledhur grusht;

b) nuk dëgjon nga veshët është shurdhuar.

TURRË II f. 1. Shami a peshqir, që e përdredhin mirë, e lidhin një nga njëra anë dhe e përdorin për të goditur me të në disa lodra, (kapuçash, filxhanash, unazash); loja që bëhet me këtë shami a peshqir. E bëri turrë shaminë. E qëlloi me turrë. I dredh flokët si turrë.

2. hist. Vula e sulltanëve në shkresat e në paratë e Perandorisë Osmane.

THARTORE I f. bot. Lëpjetë mali, uthullaç; uthullishte, uthullnike, lëpjetë lepuri.

THARTORE II f. Hirrë e thartuar me farë kosi.

THEK I m. kryes. 1. Tufë fijesh të bashkuara më një kokë, që varen varg në fund ose anëve të një petku, të një qilimi, të në mbulesë, të një perdeje etj. për ta zbukuruar, xhufkë; fundet e fijeve anës një qilimi a një endjeje tjetër; fijet e shkurtra, me të cilat mbushet një qilim, një sixhade etj. thekë të gjatë (të kuq, të zez). Thekë ari. Qilim me thekë. Xhoke me thekë. Mbulesë me thekë. Shall me thekë. Gërshërë për thekë.

I presim thekët. Bie borë me thekë bie borë flokë-flokë.

2. Halat e kallirit të grurit, të thekrës etj. thekët e grurit.

* Thekë e degë shumë i grisur, copë-copë. Në thekun e zembrës në thelbin e zembrës.

Ia preu thekun guas vjet. e ndau gruan dhe e turpëroi para të tjerëve, duke ia prerë xhufkat e brezit. Ia tjerrin thekun bisedës e zhvillojnë mirë bisedën, e qëndisin mirë muhabetin.

THEK II m. kryes. bot. Pjesa e lules së disa bimëve, që përmban endin. Thekët e misrit. Theket e zambakut.

THEK I kal. 1. Shpojë me diçka të mprehtë a me majë. E theku me shpatë (me thikë).

2. E qëlloj fortë dikë, i bie dikujt me forcë e pa pritur. Ia theku syve. Ia theku në fytyrë (në bark, në gju). Ia theku me shuplakë.

3. E mpreh, e nxjerr me forcë të veçantë; e nxjerr me fuqi dhe duke e dredhur (për zërin). Ia theku një kënge. Ia theku një gjel.

4. E bëj më të shpejtë, e nxitoj (hapin, vrapin etj.); shpejtoj, u jap këmbëve, iki me të shpejtë, nxitoj. Theku vrapin. Theki këmbët! Ia theku tutje. Thekja përpara!

5. fig. Më prek thellë në shpirt, më shpon a më ther në zemër, më mallëngjen, thekem. Më theku zembrën. Na theku shpirtin.

6. jokal. Bie borë e hollë dhe me flokë, bie borë me thekë. Po thek bora maleve.

* Të thek ai është shumë i zoti, është shumë i fortë.

THEK II kal. 1. E ngrohë bukën mirë para zjarrit sa të thahet e të marrë të skuqur. Thek bukën.

E theku në zjarr. E vuri për të thekur.

2. Ngroh mirë pranë zjarrit a e lë në diell për një kohë të gjatë sa të skuqet a të rreshket. Thek këmbët (duart, kurrizin) pranë zjarrit. E theku trupin në diell.

THEKEM I vetv. 1. Prekem thellë në zemër, mallëngjehem. Theket lehtë. S'theket fare.

2. Pës. e THEK I.

THEKEM II vetv. 1. vet. vetv III. Ngroh mirë pranë zjarrit, thahet e merr të skuqur (për bukën).

U thek buka.

2. Ngrohem mirë pranë zjarrit, rri pranë zjarrit sa të thahem mirë, sa të skuqem etj.; rri në diell sa të ngrohem mirë, të skuqem a të rreshkem.

U thekën pranë zjarrit. U thek në diell.

3. Pës. e THEK II.

U I

1. Një nga zanoret e gjuhës shqipe dhe shkronja e tridhjetë e alfabetit të saj, e cila shënon këtë zanore. Zanorja u. Tingulli u. Shkronja u.

2. si em. f. Zanorja dhe shkronja u. U-ja e vogël (e madhe). U-ja e dorës (e shtypit).

U-ja nistore.

U II

Trajtë e shkurtër e përemrave vetor ATA, ATO në rasën dhanore. U dhashë librin. U thashë të vinin. U çova fjalë. U erdhi mirë.

U III pj.

Përdoret përpara foljeve pësore dhe vetvetore për të ndërtuar trajtat e kohës së kryer të thjesht, të mënyrës dëshirore e të përcjellores e paskajores. U nis. U derdh. U lanë. U shpall. U bëftë! Duke u përpjekur. Për t'u shqyrtuar.

U IV pasth.

1. Përdoret për të shprehur habi, kur ndodhemi përpara një të papriture ose para diçkaje jo të zakonshme; ua. U, sa më gëzove! U, sa mirë! U, nga erdhi ky? U, si qenka bërë! U, more djalë!

2. Përdoret kur kujtohemi papritur për diçka; ah. U, po! U, dale se harrova! U, prit, se do të të jap diçka!

3. Përdoret kur shprehim dhembje ose pakënaqësi për diçka të papëlqyeshme; uh. U, sa më dhemb! U, të shkretën! U, ta kisha ditur më parë! U, ç'më gjeti!

UA I Trajtë e shkurtër e shkrirë e përemrit vetor, e formuar nga bashkimi i trajtës së shkurtër u të përemrave ATA, ATO në rasën dhanore dhe e të përemrave AI, AJO në rasën kallëzore ose i të përemrave ATA, ATO në rasën kallëzore. Ua thashë lajmin. Ua dhashë librat. Ua bleva fletoret.

UA II pasth. bised. Përdoret kur habitemi shumë për diçka jo të zakonshme ose të papritur. Ua, sa bukur! Ua, sa i mirë! Ua, ç'më the! Ua, si qenka bërë! Ua, edhe ti!

UJËSE I f. Enë për të mbajtur ujë të pijshëm.

UJËSE II f. zakon. Flluska të vogla me ujë që u dalin fëmijëve në trup; sëmundje lëkure që shfaqet me flluska me ujë. U dalin ujëse në kokë.

UJK I m. 1. zool. Kafshë e egër mishn-grënëse, e ngjashme me qenin, me qime të përhimë në të verdheme, me veshë të drejtë e me majë, që sulmon shpesh bagëtitë. Ujk i murrm ë(i kuqërremë). Ujk i madh. Ujk i uritur. Kope (lukuni) ujqish. Këlysh ujku. Lëkurë ujku. Strofull e ujkut. Angullima e ujkut. Të çaftë (të preftë) ujku! mallk. Delen (dhinë) që ndahet nga tufa, e ha ujku. fj. u. Ujku mjegull do. fj. u. Kur thonë «ngordhi ujku», atëherë ruaje gomarin. fj. u. Qeni i keq e sjell ujkun në vathë. fj. u. Nuk fle (nuk kullot) delja me ujkun bashkë. fj. u. Ujku bari s'bëhet. fj. u.

2. fig. keq. Njeri shumë i egër e i pamëshirshëm; ai që kërkon të vrasë të tjerët e të gllabërojë gjithçka; lakmues i pangopshëm. Ujqit imperialistë.

3. fig. bised. Njeri shumë i fortë e i shëndoshë; njeri shumë i aftë për punë. Është ujk.

* Iu bë ujk diçka iu mërzi shumë diçka, i doli fare nga zemra, s'e duron dot, s'e sheh dot me sy. U bë ujk (bishë) shih te BISHË, ~A. Në gojë të ujkut rrethuar nga armiq të egër, fare pranë një rreziku të mundshëm. I kalli ujkun thjeshtligj. shih te KALL. Ujk me birër thjeshtligj. shih te BRI, ~RI. Ujk deti njeri i regjur me vështirësitë e detit, detar i vjetër e me përvojë. Ujk i vjetër (plak) njeri i rrahur me jetën; ai që e njeh mirë një punë. Fut ujkun në vathë shih te VATHË. Ka lëkurën (qimen) e ujkut e ndjekin gjithmonë të këqijat, nuk i ndahen të zezat; i vërsulen të gjithë edhe pa të drejtë. I la një qime ujku te dera (te pragu) dikujt i la një ngatërresë, i la një çështje të ngatërruar për ta zgjidhur, një grindje etj. Mori udhën e ujqve mori një rrugë të shtrembër, hyri në një udhë të keqe. Mbeti (ra) si ujku (si zagari) në thekër mbeti

në gjendje të vështirë, shumë ngushtë, sa s'ka ku të vejë më keq, pa përkrahje, pa rrugëdalje, pa shpresë. E pagoi si ujku me lëkurë mori dënimin e merituar, e pagoi shtrenjtë, me kokë një veprim të keq. E shikon (e vështron) si ujku hënën e shikon me inat. E ka parë ujkun që i vogël (që në vogëli, që foshnjë) është njeri i rrahur me jetën, ka parë e ka kaluar shumë të këqija e rreziqe, nuk trembet nga rreziqet e nga kërcënimet. I tregon lëkurën e ujkut dikujt e frikëson, e tremb dikë duke iu kanosur me diçka. S'trembet ujku nga mushkonjat fj. u. thuhet për dikë që nuk do t'ia dijë fare kur e kërcënon një kundërshtar i pafuqishëm. Ujk me lëkurë qengji njeri i pabesë, që i mbulon qëllimet e veta grabitqare duke u shtirë sikur është i mirë. Prej ujkut ra në gjarpër shih te GJARPËR,~RI. Vuri (bëri) ujkun bari shih te BARI,~U I. Ka lëkurën e ujkut në kurriz (në shpinë) është me turp mbi shpinë; ka shumë faj. Leshtë e ujkut, thonjtë e bufit fj. u. kundër të keqit e të egrit duhet përdorur forca. I vari ujkut mëlçitë në qafë iron. shih te VAR. Ujku qimen ndërron, por zakonin s'e harron thuhet për dikë që hiqet sikur ka ndryshuar qëllimet dhe natyrën e tij, por që në të vërtetë është po ai i pari. Unë them «ja ujku!», ti kërkon gjurmët (kur ke ujkun, mos i kërko gjurmët!) fj. u. thuhet për dikë që kërkon të fshehtë diçka që duket fare qartë ose që e kërkon të vërtetën jo aty ku ajo duket qartë, por aty ku ajo mbulohet e errësohet. Çakalli bëri kërdinë, ujkut i doli nami fj. u. thuhet për dikë që ka bërë shumë të këqija, por është fshehur pas dikujt tjetër që njihej nga të gjithë si keqbërës. Dhentë pa bari i ha ujku një nga një fj. u. shih te BARI,~U I. Gojë ujku bot. gojujk. Gjemb ujku bot. ashe. Thanë ujku bot. shih te THAN/Ë,~A.

UJK II m. Shtyllëz që mbështetet tërthorazi mbi trarët e tavanit dhe që mban mbi vete cungalët e kulmit. Ujqit e vatrës. Mbërtheu ujkun. U thye ujku.

UJTIS I jokal. Lëshon lagështi, bulon nga pak

ujë, lagëson. Ujtisin muret. Ujtis toka.

UJTIS II kal. krahin. Hekuros rrobat me hekur.

UJTH I m. 1. Lëng si ujë që del nga një plagë ose nga një fluskë. Ujth me qelb. Ujthi i kallove. Fshikë me ujth. Pikon ujth. Nxjerr ujthin.

2. bot. Lëng që qarkullon në trupin e bimëve dhe që ndryshon sipas stinëve, limfë. Ujthi i pemëve.

3. anat. Fshikëza e ujit të hollë; sëmundje e fshikëzës së ujit të hollë. Ujthi i qengjit.

4. veter. Sëmundje që u bie kafshëve zakonisht në këmbë, ku u dalin fluska me ujë.

5. Buti i kokës (zakonisht për fëmijët).

UJTH II m. bised. Qepje e rrallë dhe e çlirët me dorë, ildisje. I shkoi një ujth rrobës.

URDHËR I m. 1. Porosi me gojë ose me shkrim që jepet nga një organ më i lartë nga një përfaqësues i tij, nga një epror etj. dhe që duhet zbatuar pa kundërshtim; letra ku është shkruar kjo porosi. Urdhër i prerë (i rreptë, i padiskutueshëm). Urdhër i drejtë (i padrejtë). Urdhër i ministrisë (i komitetit ekzekutiv, i kryesisë, i drejtorisë). Urdhër i ministrit (i kryetarit, drejtorit, i përgjegjësit). Mori urdhër e urdhëruan. Jap urdhër urdhëroj. Bëri urdhër. bised. urdhëroi. Zbaton urdhrin. Shkel (thyen) urdhrin. Pres urdhër. Lëshoi një urdhër. Kam urdhër jam urdhëruar. Sipas urdhrit të dikujt. Me urdhër të dikujt. Jam nën urdhrat e dikujt jam i gatshëm të zbatoj çdo gjë që më ngarkohet nga dikush.

2. usht. Detyra ose tërësia e detyrave që jep komanda a komandanti, të cilat duhet të kryhen nga vartësit pa asnjë kundërshtim; letra, ku janë shënuar këto detyra.

Urdhri luftarak (i luftimit) tërësia e detyrave, që përcakton komandanti për të bërë një betejë. Urdhri i komandës. Urdhri i mësymjes. Urdhër dite. Zbaton urdhrin.

3. Shkresë zyrtare, që i jepet dikujt për të filluar një punë. Urdhër pune.

* Me urdhër të peshkut iron. shih te PESHK, ~U.

URDHËR II m. 1. Bashkësi e mbyllur fetare në gjirin e kishës katolike, anëtarët e së cilës jetojnë sipas dogmave të veçanta, sipas disa rregullave e shkallëzimeve të rrepta dhe zhvillojnë një veprimtari reaksionare të organizuar në shumë vende.

Urdhri i jezuitëve (i françeskanëve, i dominikanëve). Anëtar (pjesëtar) i urdhrit. Hyri në një urdhër. I përket një urdhri.

2. hist. Bashkësi ushtarako-fetare në mesjetë, e krijuar nga shtetet feudale e nga papa për qëllime pushtuese e grabitqare. Urdhri teuton. Urdhri i kryqtarëve.

URDHËR III m. Shenjë e lartë nderi, që i jepet një kolektivi a një njeriu nga shteti për merita të veçanta në punë ose për vepra trimërie; guximi e heroizmi në luftë. Urdhër i lartë. Urdhër pune. Urdhër lufte. Urdhri i Flamurit. Urdhri i Lirisë. Urdhri i Skënderbeut. Urdhri i Punës i Klasisit të Parë.

URË I f. sh 1. Ndërtim prej druri guri ose metali, që lidh dy anë të një lumi, të një përroi etj. dhe që shërben për të kaluar mbi të njerëz kafshë e mjete transporti. Urë e gjatë (e gjerë). Urë e lartë (e ulët). Urë e drunjte (e hekurt). Urë e varur. Urë e vjetër. Urë e prishur. Urë lëvizëse (ngritëse). Urë hekurudhore. Urë lundruese.

Urë guri (betoni). Urë me këmbë (pa këmbë). Urë me qemer. Harku i urës. Këmbët e urës. Parmakët e urës. Ndërtoi një urë. Kaloi mbi urë (nën urë). Kur s'ka urë, edhe vau është i mirë fj. u.

2. Diçka në trajtë të një harku, që shërben për të lidhur dy pjesë ose si mbështetës.

Ura e syzeve. Ura e vinçit. Ura e violinës. Ura e supit. anat. heqësi. Ura e këmbës. anat. pjesa e thelluar e shputës së këmbës. Urë dhëmbësh pllakë e posaçme që

mban dhëmbët e vënë duke u lidhur nga të dyja anët me dy dhëmbët e shëndoshë.

3. fig. Shteg që hapet duke kapërcyer mbi pengesat a kundërtitë ndërmjet dy anëve për të kaluar më tej ose për të arritur diçka tjetër; diçka që lidh dy anë.

Ura ideologjike (ekonomike). Urë kalimi. Urë lidhjeje. Urë pajtimi. I këput (i preu) urat më dikë. Hodhi një urë.

4. sport. Përkulja që merr trupi kur mbështetemi me duar prapa (në gjimnastikë); përkulja që merr trupi kur mbështetemi mbi këmbë e qafë (në mundje). Bëri urën. Kaloi në urë.

5. tek. Pjesa e shtratit të automobilit ose të traktorit ku është vendosur mekanizmi për ta kaluar lëvizjen të rrotat. Ura e përparme (e pasme) e automobilit.

6. spec. Kullë në anije ose në disa makina, e cila ka një shesh të vogël ku qëndrojnë për të vrojtuar ose për të drejtuar. Ura e anijes. Ura e komandimit.

7. shih URËZ, ~A I 1,2. Ura e pararendës.

8. shih KULMAR, ~I. Ura e çatisë.

* Me urë e pa urë me të gjitha mënyrat e mjetet me çdo kusht. I bëhet urë (urë e vig) dikujt përulet, nënshtrohet përpara dikujt dhe e lejon të bëjë ç'të dojë. Urë pa qemer shih te QEMER, ~I. S'bëhet urë me gëzhdalla fj. u. çdo gjë ka nevojë për mjetin ose për mënyrën e vet që të bëhet. U bë urë e gurë u robtua në punë u përpoq me të gjitha fuqitë për të përballuar vështirësitë e jetës e për të fituar diçka. Është ende (akoma, hala) tek ura iron. i thuhet dikujt që nuk ka ndryshuar fare që ka ngelur me të vjetrën a ka ngelur prapa nga të tjerët ose dikujt që nuk ka marrë vesh se ç'bëhet përreth, që është në bisht të situatës. Është këmbëza e urës është njeri shumë i prapë njeri që llap gjithmonë telashe. Mbeti në bisht të urës (të bishti i urës) nuk eci me hapin e kohës, mbeti prapa. Nuk i shkoi kali (gomari) në urë (në udhë) edhe poh. shih tek UDH/Ë, ~A. Një herë shkoi lepuri mbi urë edhe iron. thuhet për një veprim

që ndodh rrallë ose që nuk përsëritet më. Urë ajrore vijë nëpër të cilën kalojnë për një kohë pa ndërprerje aeroplanë nga një pikë në tjetrën për qëllime të veçanta.

URË II f. Copë druri, kopaçe që është e ndezur ose që vazhdon të digjet në zjarr. Urë e ndezur. Urët e zjarrit. Afroj (shtyj) urët. Shkrep urët. E ndezi me urë. U bëfsh urë e zezë! mallk.

* Luan urët shih te LUAJ. Shkund urët shih te SHKUND. Shtyn (trazon, ngacmon) urët bëhet shkak që të acarohet më tej një grindje një mosmarrëveshje, i nxit nga prapa kraheve të tjerët që të grinden, fut spicat. U bë urë e zezë

a) u nxi tepër;

b) u mërzit e u dëshpërua jashtë mase, u pikëllua. Është urë e pashuar është i fshehtë, thëngjill i mbuluar. Vjen, (kalon) me urë (me pishë) në dorë djeg e shkretën ç'gjen përpara. Shkurti shkurtën urët fj. u. shih te SHKURTOJ.

URËZ I f. 1. Pjesa e poshtme e parmendës, e cila mbështetet në tokë.

2. Druja e poshtme e zgjedhës së qeve.

3. Pjesë e qerres, mbi shtizën a boshtin, që lidhet me zgjedhën.

4. shih KULAR, ~I 1.

URËZ II f. vjet. Vendi përballë këmbëzës, ku vihej baruti (tek armët e vjetra me zjarr).

URTH I m. bot. Shkurre kacavarëse, më kërcell të bardhë në të verdhë, me gjethe gjithmonë të gjelbra e me bisht të gjatë me lule të vogla, të verdha në të blertë, që bën kokrra të vogla sa një qiçër dhe që rritet si bimë zbukuruese. E mbuloi urthi. Ngjitet si urth.

URTH II m. 1. Sëmundje, e cila shkatërron, kallingjtë e të lashtave, duke bërë që kokrrat e tyre të zbuten e të mbushen me një pluhur të zi që mban erë të keqe. I ka rënë urthi.

E prishi grurin urthi.

2. mjek. Urdhje.

URTH III m. Djegësira që ndiejmë në grykë nga thartira që vjen prej stomakut. Më djeg urthi.

I vjen urth.

VAJ I m. 1. Lëng i trashë dhe i yndyrshëm, më i lehtë se uji, që nxirret prej farave a prej kokrrave të disa bimëve (si luledielli, ulliri, kikiriku, etj.), prej bimësh të veçanta, prej disa kafshësh ose nga përpunimi i disa mineraleve e i naftës dhe që përdoret për ushqim, në industri, në mjekësi etj. Vaj i pastër (i kulluar). Vaj i mirë vaj ulliri. Vaj i trashë. bised. vaj recini. Vaj i djegur. tek. vaj makinash i përpunuar. Vaj ulliri (kikiriku, luledielli, misri). Vaj peshku. Vaj balene. Vaj recini. Vaj arrash (bajamesh). Vaj liri (dafine, dëllinje). Vaj makinash. Vaj flokësh. Vaj plazhi. Vaj pushke vaj që përdoret për të pastruar pushkët, automatikët etj. dhe për të lyer pjesët metalike të tyre që të mos ndryshken. Bojë vaji bojë e shkrirë në një lëng të tillë. Fabrikë (mulli) vaji. Ngjyrë vaji. Fërgoj (skuq) me vaj.

2. vet. Lloje të ndryshme të këtyre lëngjeve. Vajra bimore (shtazore). Vajra aromatike. Vajra minerale.

3. përmb. Bojëra në ngjyra të ndryshme, që përpunohen me lëngje të tilla dhe që përdoren për pikturë. Pikturë në vaj.

4. përd. mb. Shumë i qetë, pa dallgë (për detin, liqenin); i shtruar, i bindur; i qetë (për njerëzit). Ishte bërë deti vaj. U shtrua, u bë vaj.

5. përd. ndajf. Mirë, pa ndonjë vështirësi, pa pengesa, lehtë; qetë. Ecën vaj puna. Diskutimi (mbledhja) shkoi vaj.

* E ka vaj (grurë, dhjamë) me dikë shih te GRURI/Ë, ~I. I nxori vaj dikujt e lodhi shumë, e stërmundoi. Shkon (ecën) si në vaj shkon mirë, pa asnjë vështirësi e pengesë. E vuri në vaj

a) diçka e vuri në rregull, e rregulloi;

b) dikë e qetësoi, e shtroi. I bën petullat pa vaj (me ujë) shih tek UJ/Ë, ~I. E bëri për vaj e për uthull dikë

a) e rrahu shumë;

b) e qortoi ashpër. Doli si vaji mbi ujë doli pa faj, i shfajësuar; doli i fituar. S'del vaj nga guri fj.u. thuhet kur është e pamundur të bëhet diçka. U derdh vaji, s'mblidhet më fj.u. thuhet për një punë a për një veprim të gabuar që bëhet dhe nuk mund të ndreqet më. U derdh vaji në uthull (u derdh vaji e ra në uthull) shih tek UTHULL,~A. S'hahet as me vaj, as me uthull, nuk mund të pranohet a të durohet, nuk shkon fare. Është hapur si vaji në lakra (në ujë)

a) flet a lëviz pa drojtje e pa u matur mirë, e tepron duke u sjellë kudo si në shtëpi të vet;

b) është hapur shumë shpejt e në të gjitha anët. E ka (shkon, është) gjalpë e vaj me dikë shih te GJALP/Ë,~I. Nxjerr (qit) vaj (mjaltë, ujë) nga guri dikush është shumë i zoti, bën të pamundurën, nxjerr dhjamë nga pleshti. I rrahur (i regjur) me vaj e me uthull që ka shumë përvojë, që e njeh mirë jetën, i regjur në jetë, që ka provuar të mira e të këqija. Vaji në lakra bie fj.u. shih te BIE I. E drejta rri si vaji mbi ujë fj.u. shih te DREJT/Ë,~A (e). Humbi në vaj e fitoi në presh fj.u. më shumë humbi se fitoi, s'fitoi gjë. I rri punës përsipër si vaji mbi uthull shih tek UTHULL,~A. Vaj e verë e uthull bised. ylberi.

VAJ II m. 1. Britma a ulërira të zgjatura, që lëshon dikush në rast vdekjeje a kur i ndodh ndonjë fatkeqësi tjetër; kujë. Vaj i thekshëm. Plasi vaji. Lëshoi vajin.

2. Të qarët me ligje në rast vdekjeje, vajtim; fjalët që thuhet gjatë vajtimit, ligje; vet. vjet. këngë popullore, që këndoheshin në raste vdekjesh dhe që shprehnin hidhërim e dhembje të thellë. Vaji i grave. Këngë vaji. Nisi (filloi, hapi) vajin. Pushoi (ndali) vajin. E qante me vaje. Bëri vaj për dikë e qau me ligje.

3. Të qarët. Më vjen vaj. Ia dha (ia plasi, ia shkrep) vajit. Shpërtheu në vaj.

U shkri në vaj. Është gati për vaj. E mori vaji kur e pa ashtu.

4. Fatkeqësi e madhe, mynxyrë, gjëmë; pikëllim. Vaj i madh (i kobshëm). I gjeti një vaj.

* Bëj vaj ankohe, qahem për diçka. E ka vajin në buzë dikush ankohet vazhdimisht, gjithnjë qahet. Mbeti me vaj në buzë dikush.

a) mbeti duke qarë; s'iu ndanë fatkeqësitë;

b) s'pushon së ankuari.

VAJËS I mb. Që përmban shumë vaj, që jep shumë vaj; vajor. Ulli vajës. Arrë (bajame) vajëse. Fara vajëse.

VAJËS II mb. Që qan orë e çast, qaraman. Fëmijë vajës.

VALËBUKE I f. Gjym i vogël që mbahet gjithnjë në zjarr për të zier ujë. Mbushi valëbuken. Vuri valëbuken në zjarr.

VALËBUKE II f. Bukëvale; përshesh me qumësht; papare me qumësht. Valëbuke me gjalpë (me vaj).

VARE I f. 1. Çekan i madh prej metali, që përdoret për të thyer gurë të mëdhenj ose për të rrahur hekurin e skuqur në zjarr. I bien shkëmbit me vare. E goditi (e theu) me vare. Rëndon si vare.

2. Tokmak druri që përdoret për të thyer plisat në arë.

3. përd. mb. Shumë i rëndë, plumb; shumë i fortë. Ishte vare. E kishte grushtin (dorën) vare.

4. përd. ndaj. Shumë, plumb (zakonisht me mbiemrin i rëndë). I rëndë vare.

* E ka kokën vare është shumë kokëfortë.

VARE II f. Vend i pjerrët e pa bimësi në një mal, shpat mali i zhveshur.

VARRIM I m. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve VARROJ I, VARROHEM I.

VARRIM II m. 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve VARROJ II, VARROHEM II. Vendi i varrimit. Dita e varrimit. Zyra e varrimeve. Ceremonia e varrimit. U bë varrimi.

2. Ceremonia e përcjelljes së trupit të të vdekurit për në varr. Varrim solemn. Shpenzimet e varrimit. Shkoi (mori pjesë) në varrim.

VARROHEM I vetv. 1. Plagosem.

2. Pës. e VARROJ I.

VARROHEM II Pës. e VARROJ II.

VARROJ I kal. Plagos.

VARROJ II kal. Varros.

VEGULLOJ jokal. vet. veta III Vegon. Vegulloi drita. Vegullonin yjet. Nisi të vegullonte. S'ma vegullojnë sytë.

VERË I f. 1. Stina e dytë dhe më e ngrohtë e vitit, që vjen pas pranverës (në gjysmërruzullin verior fillon më 21 qershor e mbaron më shtator). Verë e nxehtë (me shi). Verë për verë në çdo verë. Stina e verës. Vapa (thatësira) e verës. Ethet e verës. mjek. Barku i verës. mjek. Rroba vere. Pushimet e verës. Iku vera e filloi vjeshta.

2. Tërësia e muajve të ngrohtë të vitit, behar. Verë e dimër. Dita e verës dita e parë e marsit. Doli dimri e erdhi vera.

* Buka e verës shih te BUK/Ë,~A. Dimër e verë shih te DIM/ËR,~RI 2. Si gjethja në verë shumë, me shumicë; shumë i përhapur, i dendur a i zhvilluar. Si qyqja verën shih te QYQ/E,~JA. Ta bën verë (me gojë) të premtion shumë, ta bën shesh me lule. Ardhtë si vera! ur. ardhtë me shumë të mira! Është shend e verë shih te SHEND,~I. I erdhi vera te dera i erdhi e mira pranë. Në atë shtëpi nuk qesh as vera shih te QESH. Na rrofsh për dimër, se për verë jemi vetë! thjeshtligj., iron. shih te DIM/ËR,~RI. Korani i verë zool. shih te KORAN,~I. Lule vere bot. shih te LUL/E,~JA. Qe-fulli i verës zool. shih te QEFULL,~I.

VERË II f. 1. Pije alkoolike që nxirret zakonisht nga tharbëtimi i mushtit të rrushit; një sasi e kësaj pijeje sa nxë një gotë. Verë e ëmbël. Verë e kuqe (e bardhë). Verë e vjetër (e re). Verë e gazuar. Verë

e hapur verë fuçie që shitet me litra, jo në shishe të mbyllura. Gotë vere. Një gotë verë. Shishe me verë. Fabrika (kantina) e verës. Industria e verës. Rrush për verë. Pi verë. Pres verën holloj verën. Prodhoj verë. U deh me verë.

2. Pije e tillë, që del nga tharbëtimi i disa pemëve dhe që ka një shije të veçantë.

Verë molle.

3. vet. ~ËRA,~ËRAT. Lloje të ndryshme të kësaj pijeje. Verëra mjekësore. Konkursi i verërave.

* I hedh ujë verës shih tek UJ/Ë,~I. Nuk mban më ujë vera (orizi, pilafi, kosi) shih tek UJ/Ë,~I. Mbart (mban) verë e pi uji është dorështrenguar, është koprrac. Ta shet ujin e pusit për verë ta hedh, të mashtron, nuk mund t'i zihet besë. Këtej të pi verën, andej të shan derën shih te PI. Vaj e verë e uthull bised. ylberi.

VERI I m. 1. Pika e horizontit që është përkundrajt jugut, drejtimi në të kundërtën e jugut, ana që është në të majtë kur kthehem me fytyrë nga lind dielli. Ylli i Veriut. Në veri të qytetit (të fshatit). Me dritare nga veriu. Sheh nga veriu. Fryn nga veriu. Vjen nga veriu. Pusulla tregon veriun.

2. Vend që gjendet në këtë drejtim; banorët e këtij vendi. Veriu i Evropës (i Afrikës). Detet e veriut. Banorët (popujt) e veriut. Poli i Veriut. gjeogr. pika më veriore e rruzullit tokësor. Rrethi polar i Veriut. Oqeani i Ngrirë i Veriut. Amerika e Veriut.

Në veri të vendit.

3. Vend i ftohtë, në krahasim me vendet e ngrohta të jugut. Dielli i veriut. E ftohta e veriut.

4. Erë e fortë dhe e ftohtë që fryn nga ky drejtim. Fryn veriu. E largoi shiu veriu. Të pret (të than) veriu.

5. Erë e lehtë, erë e dobët, fllad; erë që bëjmë me diçka për t'u freskuar. Hap dritaren të hyjë pak veri. I bëj veri dikujt.

* U bë veri iku shumë shpejt, u zhduk papritur, u bë erë. I është bërë mendja veri është trullor fare, s'është në vete; i është ngritur mendja. E ka mendjen si veriu është mendjelehtë, s'mbahet me asgjë. Kakaris si pula në veri (si pula pa grurë) shih te PUL/Ë,~A.

VERI II m. shih VEROR/E,~JA III. Veri prej letre. Bënte fresk me veri.

VERORE I f. enogr. Gjalmë i hollë, i dredhur me dy-tri fije të kuqe e të bardha prej leshi a mëndafshi që ua lidhnin fëmijëve në duar a në qafë ditën e verës; larës. Vuri (lidhi) veroren.

VERORE II f. zool. Zhabë e vogël me ngjyrë të gjelbër, që del e kuak në fillim të pranverës. Veroret e kënetës. Këndojnë veroret.

VERORE III f. Përdorëse në trajtë gjysmërrethi prej letre, prej pendësh, prej plastike etj., që shërben për të bërë veri, kur është vapë, erashkë. Verore prej letre (prej mëndafshi).

VERZË I kryes. zool. Organet që kanë peshqit e disa kafshë të tjera në të dy anët e kokës nën vesh, që hapen e mbyllen dhe që u shërbejnë atyre për të marrë frymë në ujë. Verzat e kokës. Kapakët e verzave. I heq verzat.

VERZË II f. 1. Kulari i derrit, kërçabë. I vuri verzën.

2. Veshëza e parmendës, llapari.

VEZHËZ I f. Pjesë e parmendës që vihet pas plorit dhe që shërben për të hedhur dheun anash. vesh, llapar. Parmendë me veshëz. U thye veshëza.

VEZHËZ II f. Gërshërëza.

VESHJE I f. sh 1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve VESH, VISHEM. Veshja me gur ë(me pllaka, me dru). Reparti i veshjes së telave.

2. Tërësia e petkave të qepura, me të cilat mbulojmë trupin, rrobat që përdorim për t'u veshur; tërësia e rrobave

që veshim mbi të linjtat; secila prej këtyre rrobave. Veshje e lehtë (e rëndë). Veshjet e brendshme (e jashtme). Veshje e sipërme

(e poshtme). Veshje dimërore (verore). Veshje popullore. Veshje dibrane (kolonjare, kosovare, labe, matjane, mirditore, myzeqare, shkodrane). Veshje grash (burrash). Ndërroi veshjen.

3. spec. Shtresa e sipërme prej druri, prej guri, prej metali a prej një lënde tjetër, me të cilën veshim orenditë, muret etj. Veshje zjarrduruese. Veshje prej guri (prej kalldrëmi) e kanalit. Veshje plumbi (alumini). Veshje gome (betoni). Veshje me pllaka (me mermer).

VESHJE II f. Kusi me veshë.

VIDË I f. zool. 1. Pëllumb femër, pëllumbeshë. Vida e bardhë.

2. fig. përk. Grua e bukur.

VIDË II f. Vidhë.

VIGËL I f. Vegël e thjeshtë, që përbëhet nga dy dërrasa të bashkuara njëra me tjetrën dhe nga katër këmbë, me të cilën mësohen fëmijët e vegjël të ecin; kular. E vuri fëmijën në vigël.

VIGËL II f. 1. Ajka e qumështit, mazë. I mori viglën qumështit.

2. fig. Pjesa më e mirë e diçkaje, ajka; thelbi.

VILË I f. 1. Shtëpi e bukur e rrethuar zakonisht me kopsht dhe e pajisur mirë; shtëpi e tillë jashtë qytetit për të pushuar gjatë verës. Vilë dykatëshe. Vilat e plazhit. Banonte në vilë.

2. hist. Çifligu i skllavopronarit në Romën e Vjetër.

VILË II f. Dy kokrra arra të vendosura njëra mbi tjetrën, me të cilat luajnë fëmijët; pilë.

I vuri arrat vilë. Gjuajti vilën. E rrëzoi vilën.

VIZË I f. 1. Shenjë e zgjatur dhe e hollë që bëhet mbi diçka me laps, me penë etj.,

- vijë. Vizë e drejtë (e lakuar, gjarpëruese). Vizë lidhëse. gjuh. vizë e shkurtër që shërben për të lidhur dy pjesë të një fjale. Vizë ndarëse. gjuh. vizë e shkurtër që shërben për të ndarë fjalën në fund të rreshtit. Viza e dialogut. Heq një vizë. Shkruhet me vizë në mes.
2. E thelluar a e çarë e ngushtë në diçka, vijë. Vizat e dorës.
- * I hoqi (i vuri, i futi) vizë (vijë) dikujt a diçkaje nuk e përfill më; hoqi dorë nga dikush a nga diçka, e fshiu nga defteri.
- VIZË** II f. Shënim zyrtar me vulë të posaçme në pasaportën a në letërnjoftimin e dikujt, me të cilin ai lejohet të hyjë e të dalë nga kufiri ose të kalojë në një shtet tjetër. Viza e hyrjes. Vizë për hyrje e dalje. Zyra e vizave. Nxjerr (marr) vizën. I dhanë vizën.
- E ka vizën.
- VIZOHET** I vetv. 1. Zgjatet diçka si vijë, formon një vijë.
2. Nis të shfaqet diçka, sa duket pak, përvijohet. Iu vizua një buzëqeshje e lehtë.
3. Pës. e VIZOJ I.
- VIZOHET** II Pës. e VIZOJ II.
- VIZOJ** I kal. 1. Heq viza në diçka, vijëzoj.
2. fig. Paraqit në vija të përgjithshme diçka, vizatoj, përvijoj. Vizoi portretin e punëtorit.
3. vjet. Vizatoj. Vizoi një rreth.
- VIZOJ** II kal. I shënoj vizën dikujt në pasaportë a në letërnjoftim. I vizoi pasaportën.
- VIZUAR** I mb. Që i janë hequr vijat, që është vizuar. Fushë e vizuar. Letër e vizuar.
- VIZUAR** II mb. Që i është shënuar viza. Pasaportë e vizuar.
- VLOHET** I Pës. e VLOJ I.
- VLOHET** II Pës. e VLOJ III.
- VLOJ** I jokal. 1. edhe kal. Valoj (edhe fig.). Vloj qumështin. Vloi uji. Vlon puna. Vlon jeta. Vlonte lufta. Vlon kënga (vallja).
2. vet. veta III fig. Është i mbushur plot me njerëz, kafshë etj., që lëvizin shpejt e pa rregull; lëviz shpejt e në mënyrë të parregullt (për një shumicë njerëzish, kafshësh etj.), ka gjallëri të madhe, gëlon, lëvrin. Vlonin rrugët. Vlonte qyteti. Vlonte sheshi nga aksionistët. Vlonte bleta.
3. vet. veta III fig. Shfaqet me forcë a me gjallëri (një mendim, një ndjenjë etj.); zien. Më vlojnë mendimet.
- * I vlon (i zien, lëvrin) gjaku shih te GJAK, ~U I.
- VLOJ** II kal. shih FEJOJ. Vloi vajzën (djalin).
- VLOJ** III kal. Vë mënjanë diçka për ta ruajtur; vendoj. E vloi në vend të sigurt.
- XINË** I f. Majë pene për të shkruar. I vë xinën. Iu thye xina.
- XINË** II f. bot. Shkurre me shumë degë, me lëvore të murrme leskra-leskra me gjethe vezake përherë të blerta që përmbajnë tanin e me lule të kuqërreme në vile që lidh si fryt disa kokrra të vogla të zeza, nga të cilat nxirret një lloj vaji me erë të këndshëm; shqind. Degë xinash. Pyll xinash.
- XHOL** I m. 1. Arra ose guri më i madh, me të cilin goditen arrat e tjera ose gurët e tjerë në një lojë; guri që hedhim e presim në lojën guraçokthi; kaqol; qokël. Xhol i madh.
- Xhol i rëndë (i lehtë). E gjuajti (e goditi) me xhol. Priti xholin.
2. Pjesë e një sendi në trajtë të rrumbullakët, kokë. Xholi i çomanges.
- XHOL** II m. Figurë e veçantë në letra, që përdoret në vend të çdo letre tjetër; lojë me letra, në të cilën fiton ai që lidh i pari letrat që ka në dorë, zakonisht me ndihmën e kësaj figure.
- Marr xholin. Gjeti xholin. I doli (i ra) xholi. Luajnë xhol.

* Hyn (futet) si xhol fut hundët në çdo punë, përzihet edhe aty ku nuk i takon.

Y I

1. Një nga zanoret e gjuhës shqipe dhe shkronja e tridhjetekatër e alfabetit të saj, e cila shënon këtë zanore. Zanorja y. Tingulli y. Shkronja y.

2. si em. f. Zanorja dhe shkronja y. Y-ja nistore. Y-ja e vogël (e madhe).

Y-ja e dorës (e shtypit).

3. (lexo: ipsilon). Përdoret në matematikë e në fizikë për të shënuar një madhësi të panjohur ose të varur, zakonisht krahas shkronjës «x» lexo: (iks).

Y II pasth. thjeshtligj.

1. Përdoret për të shprehur përbuzje a neveri për dikë a diçka. Y, sa i pacipë! Y, turp të ketë!

2. Përdoret për të shprehur habi kur shohim diçka jo të zakonshme; ua. Y, sa qenka!

ZGJIDHEM I Pës. e ZGJEDH. Fara zgjidhet me kujdes. U zgjodh kryetar (sekretar). U zgjodh njëzëri.

ZGJIDHEM II vetv. 1. vet. veta III. Lirohet nyja ose diçka tjetër e lidhur a e bashkuar; i lirohen e i bien lidhëset diçkaje të lidhur. Iu zgjidh gryka thesit. Iu zgjidh këpuca (opinga). U zgjidh litari. U zgjidh dengju.

2. Lirohem nga diçka që më mban të lidhur, lirohem nga lidhëset a nga diçka me të cilën më kanë lidhur. Zgjidhu tani, po munde! Tani nuk zgjidhesh dot.

3. fig. Lirohem nga një detyrim; bëhet i pavlefshëm detyrimi që kam ndaj dikujt; vet. veta III merr fund a ndërpritet diçka; kund, lidhet. Zgjidhem nga detyrimi që kisha. U zgjidh magjia. vjet.

4. Pës. e ZGJIDH.

* As lidhet, as zgjidhet shih te LIDHEM. Iu zgjidh (iu çel) gryka thesit shih te GRYK/Ë,~A. Iu zgjidh gjuha (goja) dikujt filloi të flasë lirisht, filloi ta thotë hapur mendimin e tij; e theu heshtjen.

ZOT I m. fet. Sipas parafytyrimeve fetare e mistike: qenia më e lartë e mbinatyrshme, e trilluar nga fetë e ndryshme, e cila gjoja ka krijuar botën, qëndron mbi të dhe drejton gjithçka; perëndi. S'ka zot. Nuk i lutemi me zotit.

ZOT II m. 1. vjet. Pronar i një pasurie që kishte edhe pushtet kundrejt të tjerëve; pronari kundrejt shërbëtorëve ose kundrejt atyre që punonin për të; zotëri. Zotërinj dhe skllëvër. Sillej si zot. Ndëroi zot. Ti zot, unë zot, gomarin kush e kullot? fj.u.

2. vjet. Përdorej për të thirrur me nderim një burrë; përdorej nga nusja e re për të thirrur me nderim vjehrrin, burrin ose kunatin.

3. libr. Përdoret për t'iu drejtuar në mënyrë zyrtare a me nderim burrave që janë shtetas të një vendi josocialist e që nuk janë komunistë, zotëri. Zoti president! Zoti ministër! Zoti ambasador!

4. Ai që ka në dorë diçka dhe që e përdor atë sipas dëshirës, ai që ka të drejta të plota mbi diçka; i zoti. Zoti i shtëpisë kryefamiljari, i zoti i shtëpisë. Mali (qen) pa zot. Shqipëria sot ka zot. Toka sot ka zot. Do zot shtëpia. Fushën pa zot, gjithkush e kullot. fj.u.

* I dal (për) zot

a) diçkaje e pranoj, e marr përsipër ta bëj diçka; jam i aftë ta kryej;

b) dikujt e ndihmoj dikë me gjithçka; e marr nën mbrojtjen time, e përkrah. U bë zot i vetes

a) u rrit, u burrërua;

b) e ka në dorë vetë gjithçka që ka të bëjë me të, vendos vetë për fatin e tij. Ka zot (plak) ahuri shih tek AHUR,~I. Vetë zot, vetë shkop është i plotfuqishëm, bën siç do vetë, nuk varet nga të tjerët, por vendos dhe urdhëron vetë ai; s'pyet për të tjerët.

ZHAKË I f. Pellg me ujë lë ndenjor, bërrakë. Ra në një zhakë. Vendi ishte tërë zhaka.

ZHAKË II f. 1. Pëlhurë e trashë prej liri a prej kërpi, që shtrohet në vend të qilimit; thes a petk që bëhet me këtë pëlhurë a me ndonjë pëlhurë tjetër të trashë e të ashpër. E mbuloi me zhakë. E mbushi zhakën plot. Kishte veshur një zhakë.

2. Leckë e trashë që përdoret për të larë dyshemenë, për të fshirë çerepin ose për të kapur një gjë të nxehtë, për të fshirë këpucët përpara pragut të derës etj.; robë e vjetër. Zhakë çerepi. E lau dyshemenë (i fshiu këpucët) me zhakë.

3. vet. nj. Shtupë liri, greth.

ZHAP I kal. 1. Bëj që të fishket e të varet; e bëj si zhapë. Foshnja ia zhapi gjirin s'ëmës.

2. fig. E lodh shumë, e rraskapit dikë.

ZHAP II kal. bised. 1. Fut me forcë diku (një njeri, një send etj.); rras, ngjesh. E zhapën brenda.

E zhapi në xhep. E zhapi në ujë. I zhapi rrobat në kazan.

2. Zhdëp dikë me të ngrëna, ngjesh, dend. E zhapi me rrush.

ZHAPEM II vetv. bised. 1. Futem a zhytem me forcë diku, rrasem. U zhapen në një përdhese.

2. Ha shumë, ngopem mirë, fryhem së ngrëni, zhdëpem. U zhap me pilaf.

U zhapën me mish.

3. Pës. e ZHAP II.

ZHAVELLË I f. hist. Lloj shtize jo shumë e gjatë. Qëllonin me zhavella.

ZHAVELLË II mjek. Sëmundje e rëndë ngjitëse, që shfaqet me temperaturë e me të hequr të barkut.

I ka rënë (e ka zënë) zhavella.

ZHUKË I f. 1. bot. Lloj xunkthi, me rrënjë të gjerë dhe me fije të holla e të gjata, që dalin drejtpërdrejt nga rrënja dhe që mbarojnë sipër me një krekëz të mbushur me fara dhe me një gjemb. Krekëza zhuke. Shkulën (dogjën) zhukat. U fshehën nëpër zhuka.

2. Fijet e kësaj bime që shkulen, përpunohen e përdoren për thurje, për litarë etj.

Kapele (shportë, litar) zhuke. Një tufë zhuka. E mbulojnë me zhuka. E lidhi me zhukë.

ZHUKË II f. Burim, uji i të cilit nuk rrjedh në një vijë, po përhapet në sipërfaqe të tokës dhe humbet; vend me shumë lagështirë, tokë e lagësht që nxjerr ujë; buronjë.

Vend me zhuka.